



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 22 dhe 26 KORRIK 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22. i 26. JULA 2010. GODINE

KORRIK – JULI
2010

E enjte, më 22 korrik 2010, ora 10:00

Drejtën seancën: anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti,

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Po fillojmë seancën e radhës. Sipas Rregullores, është koha për

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit zgjatë 5 minuta dhe diskutimet e deputetëve 3 minuta. Në bazë të nenit 47.3, deputetët e lajmëruar të cilët kanë mbetur pa diskutuar, u jepet fjala në fillim të mbledhjes plenare të radhës. Në këtë rast nuk kemi.

Sipas kërkesës së grupeve parlamentare, në emër të grupeve parlamentare janë paraqitur Suzana Novobrdaliu, e lus që ta marrë fjalën, dhe pastaj në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë do të japë mendimin e vet këshillëdhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ne i besojmë të drejtës ndërkombëtare që formimi i shteteve është çështje faktike e assesi juridike. Këtë konstatim për ditë e më shumë po e theksojnë edhe zyrtarët e rëndësishëm të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Por, të nderuar kolegë deputetë, ne e kemi një shqetësim tjetër, e që mund të fillojë pas mendimit të kësaj Gjykate, që po flitet për ditë e më shumë dhe që ka zëra që edhe institucionet tona tani kanë pranuar, fjalën këtu e kam për negociatat që duhet të zhvillohen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Po thuhet që bisedat do të bëhen për çështje teknike. Mund të jetë edhe e vërtetë, por ne si deputetë akoma nuk e kemi të njohur agjendën e këtyre negociatave teknike, se cila është agjenda kosovare në këto negociata, se cila është agjenda e Serbisë në këto negociata dhe se si është disponimi ndërkombëtar për këto negociata. Ne duhet t'i besojmë varantit të Qeverisë së Kosovës se këto negociata nuk do të zhvillohen për statusin politik të Kosovës apo për shkëmbimin e territoreve. Shumë e drejtë, por cilat janë ato çështje teknike, a mos janë negociata Ahtisari plus, apo zbatim i 6 pikëshit të Ban ki Munit apo autonomi politike dhe juridike për serbët e Kosovës. Ulja në tavolinë bisedash nënkupton edhe kompromis dhe ju e dini se Kosova i ka bërë kompromiset e veta dhe çdo kompromis tjetër është prekje e pakos së Ahtisarit dhe e çon këtë vend drejt bosnjizimit.

Të nderuar kolegë,

Qëndrimet e vazhdueshme të Qeverisë së Kosovës se Serbia e ka humbur luftën në Kosovë, janë shumë të drejta. Por, synimet e saja po gjejnë mbështetje në forma të ndryshme dhe këtu po përmendi faktin se Kosova është njohur vetëm nga 69 vende dhe e dini se ka më shumë shtete që nuk e ka njohur Kosovës dhe këto mosnjohje neve si vend i ri po na shkaktojnë shumë probleme, sidomos në aderimin në organizatat ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova po shkon drejtë një kompromisi të ri me Serbinë dhe Qeveria e Kosovës thotë se këto biseda janë çështje teknike. Kjo mos përgjegjësi e Qeverisë së këtij vendi do t'i shkaktojë shumë probleme Kosovës dhe lus këtë Kuvend që ta obligojë Qeverinë që t'i drejtohet këtij Kuvendi dhe të zbardhet agjenda e negociatave, temave për bisedimin me shtetin serb dhe të marrë një miratim paraprak prej Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Jemi dëshmitarë të dy ngjarjeve që kanë ndodhur këtyre dy ditëve ose që po ndodhin momentalisht. Dje, në Hagë, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë ka nisur rigjykimi i zotit Ramush Haradinaj, ish kryeministër i Kosovës dhe kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe zotit Lahi Ibrahimaj dhe Idriz Balaj. Jemi të gjithë dëshmitarë, po ashtu, të një lufte të pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të atyre që mbrojtën popullin dhe luftuan në territorin e Kosovës kundër policisë, ushtrisë dhe mekanizmave shfarosës të shtetit serb dhe ambicieve të tyre që me program Kosovën ta bëjnë vend pa popullatë shqiptare. Duke pasur parasysh luftën e drejtë të UÇK-së dhe të atyre që e komanduan këtë luftë, jemi të indinjuar shumë dhe të shokuar pse pas një vendimi unanim të drejtë të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, pas dy vitesh përsëritet një storje e cila lë përshtypje se dikush nuk e do stabilitetin e Kosovës, se i vjen erë e keqe kësaj gjendje në momentin kur përsëri në Gjykatën e Drejtësisë kemi edhe një gjykim të pa drejtë, konsideroj, padia nga ana e Serbisë për pavarësinë e Kosovës. Kjo lidhje na bën me dije se dikujt i ka konvencuar që zoti Haradinaj të kthehet përsëri në Hagë, pa asnjë paralajmërim paraprak përveç se një ditë para nisjes së tij për në Hagë. Pikat të cilat janë të kontestueshme kanë qenë pjesë e akuzës së përgjithshme prej 32 pikash dhe vendimi i dytë për të kthyer rigjykimin është i padrejtë dhe e cenon jo vetëm personalitetin, jo vetëm individin, por e cenon të kaluarën e Kosovës, cenon edhe të ardhmen e Kosovës. Nëse në rastin e parë zoti Haradinaj shkoj si kryeministër i Kosovës, është bërë një goditje ndaj institucioneve të Kosovës. Nëse në rastin e dytë tani zoti Ramush Haradinaj përsëri duhet të rigjykohet në Gjykatën e Hagës, është një goditje ndaj demokracisë në Kosovë, sepse oponenca më e fuqishme është lidhur me emrin e Ramush Haradinaj, për forcimin e demokracisë, për zhvillimin e vendit tonë.

Deklarata e Ramush Haradinaj në shkuarjen e dytë është shumë kuptimplote. Është kuptimplote sepse para vetes vë Kosovën, vë interesat e vendit të vet. Prandaj, po e citoj: “Në këtë fazë më me rëndësi është vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës, sesa shkuarja ime në Hagë”. Kjo është shumë e kuptueshme, se vazhdimisht dikush po duhet të sakrifikohet për Kosovën edhe 10 vite pas lufte. Kjo është e padrejtë për zotin Haradinaj, për bashkëluftëtarët e tij, për popullin e Kosovës, për lirinë dhe për pavarësinë tonë.

Edhe sa ishte në mbrojtje në liri nga Gjykata e Hagës, me respektin më të madh zoti Haradinaj është sjellë në mënyrën më të mirë, duke respektuar të gjitha normat ndërkombëtare të drejtësisë. Prandaj, për neve është e pakuptueshme pse bëhet një veprim i tillë në këtë moment, pse duhet të mbytet demokracia në Kosovë dhe pse duhet të pengohen proceset në Kosovë. Tash kur kemi edhe një mendim të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për pavarësinë e Kosovës dhe në të njëjtën kohë hapjen e bisedimeve për Kosovën, është sinjifikative dhe është diçka që...

KRYESUESI: Një sekondë, ju lutem, Ahmet, a tu ka fikur mikrofonin? Ndizeni mikrofonin, se e keni fikur gabimisht, 5 minuta i ke.

AHMET ISUFI: Kërkesa e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është që institucionet e vendit në mënyrë zyrtare të bëjnë të gjitha veprimet zyrtare, në mënyrë që Ramush Haradinaj të kthehet i pafajshëm në Kosovë, të kthehet në vendin e vet, në familjen e vet, në punë dhe të vazhdojë punën si një qytetar i një vendit të lirë, i një vendi të qytetëruar, i një vendi që prosperon demokracinë dhe lirinë.

Prandaj, të jemi të bindur në pafajësinë e zotit Ramush Haradinaj dhe të jem të bindur përsëri se ai do të kthehet në Kosovë me gjithë pengesat që po bëjnë në vazhdimësi, duke cenuar personalitetin e tij dhe, po ashtu, duke cenuar luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke cenuar madje edhe të ardhmen e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje, ministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë,
Unë edhe një herë nga java e kaluar, seanca e kaluar, që e ngritëm çështjen për Universitetin e Prizrenit, pikërisht do ta ngrejë edhe një herë çështjen, sepse në Prizren është dalë konkursi për Universitetin e Prizrenit, ndërsa është mbyllur Fakulteti i Edukimit.

Në Prizren kanë dalë në protesta studentët, edhe qytetarët iu kanë bashkëngjitë pikërisht kundër mbylljes së Fakultetit të Edukimit. Të gjithë e dinë që Prizreni për 50 vjet ka qenë pjesë e kulturës, e zhvillimit të arsimit, të edukimit dhe tani ne e kemi bërë hapin e parë për hapjen e universitetit, ndërsa në anën e kundër kemi bërë hapin e parë po ashtu kundër vetvetes, mbylljes së Fakultetit të Edukimit.

Mbyllja e Fakultetit të Edukimit kinse për akreditim, do të thotë është një jo e drejtë për qytetarët e Prizrenit, ndërsa më e keqja është se atje është lejuar tash akreditimi në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke, ndërsa në gjuhën shqipe është mbyllur fakulteti me departamentet e veta. Kjo për mua është e papranueshme, e papranueshme është edhe për qytetarët e Prizrenit, që unë i mbështesë ata pikërisht në mbrojtjen e Fakultetit të Edukimit.

Unë, mund të them që Fakulteti i Edukimit edhe studentët që e kanë kryer Fakultetin e Edukimit ose Shkollën e Lartë atje, kanë qenë më të përgatitur se të gjithë studentët që kanë qenë në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Prandaj, ndalja dhe mbyllja është e papranueshme dhe unë kërkoj që Ministria e Arsimit, kryeministri, zëvendëskryeministri, të gjithë ata të merren me këtë çështje dhe të kërkojnë që pikërisht Fakulteti i Edukimit, të bëhet inkorporimi i tij në Universitetin e Prizrenit, sepse ka dalë konkursi dhe ne kemi premtuar atje që 5000 studentë do të regjistrohet, tani ka dalë konkursi për 600 studentë edhe ky është një diskriminim ose është një mashtrim optik që ua kemi bërë qytetarëve të Prizrenit. Prandaj, kërkoj që edhe këto të korrigjohen dhe të lejohet integrimi i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prizrenit dhe të rritet numri aq sa kemi kërkuar dhe u kemi treguar qytetarëve se do të ketë 5000 studentë. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Çështjen që do ta ngrejë sot, ka të bëjë me Marrëveshjen CEFTA. Me qenë se mendoj se në këtë drejtim ne kemi ngecur dhe kemi disa vështirësi, prandaj mendoj se duhet të merremi më tepër me këtë marrëveshje.

Një ndër sfidat kryesore me të cilën përballlet ekonomia e Kosovës, është importi shumë i lartë në krahasim me eksportin, gjë që rezulton me deficit tregtar në bilancin e llogarisë rrjedhëse. Një nga motivet kryesore të anëtarësimit të Kosovës në Marrëveshjen e tregtisë së lirë CEFTA, ka qenë edhe eliminimi i barrierave jotarifore dhe si rezultat - intensifikimi i marrëdhënieve tregtare me vendet e rajonit, që do të rezultonte me rritjen e eksportit kosovar. Mirëpo, pritjet tona për përfitim nga CEFTA nuk janë realizuar pasi që marrëveshja ka rezultuar me rënie të vazhdueshme të eksportit të Kosovës me vendet anëtare të CEFTA-s gjatë periudhës 2006-2009. Kështu, eksporti i Kosovës në vitin 2009 në vendet e CEFTA-s ishte i njëjtë me atë të vitit 2006 dhe atë rreth 52 milionë euro. Ky është një sinjal negativ i cili i dekurajon prodhuesit kosovarë, të cilët kanë pasur për synim të përfitojnë nga ky integrim rajonal, prandaj edhe nuk mund të jemi të kënaqur me gjendjen e tanishme. Kjo gjendje është rezultat i ndikimit të faktorit ekonomik, që nënkupton mungesën e kapaciteteve prodhuese vendore, si dhe të faktorit politik, që do me thanë se në kuadër të këtij integrimi rajonal Kosova është përballur me proteksionizmin dhe nacionalizmin ekonomik të disa vendeve anëtare të CEFTA-s, gjë që edhe pengon funksionimin më efikas të kësaj marrëveshje dhe është në kundërshtim me objektivat e CEFTA-s. Tani parashtrohet pyetja – çka më tutje, si të ndryshohet gjendja në mënyrë që të përfitojmë më shumë nga ky integrim rajonal? Çka duhet të ndërmerret në mënyrë që të rriten eksportet e Kosovës në këtë integrim? Qeveria duhet të angazhohet në të dy drejtimet, në drejtimin ekonomik, duke i përmirësuar kushtet e prodhuesve, si dhe në atë politik, duke kërkuar alternativa tjera që do të jenë në favor të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë sot do ta ngrejë një çështje që duke përshkruar rastin konkret, dua të jap më shumë shembull se çfarë po ndodhë në Kosovë, sidomos me procesin e privatizimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka vendosur t'i shesë 232m² të parkut të Germisë.

Zoti kryetar dhe kolegë të nderuar,

Ky është, unë po e quaj një turp, jo vetëm shkelje ligjore, por vërtet është turp i tepruar. Sipas Agjencisë Kosovare të Privatizimit, paskan të drejtë të sheshin, sepse qenkan prona publike, qoftë edhe nga 232m².

Kolegë të nderuar deputetë,

Unë dua t'ua citoj Ligjin për mbrojtjen e natyrës, ku thuhet se "Parqet me karakter nacional apo lokal gëzojnë mbrojtje të veçantë institucionale dhe ato nuk mund të tjetërsohen apo destinohen për qëllime tjera". Po në këtë ligj, në nenin 16.7, thuhet: "Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe autoritetet

komunale janë kompetente për shpalljen e zonave të mbrojtura sipas kategorizimit të propozuar nga instancat përkatëse në Ministrinë e Ambientit”.

Të nderuar kolegë deputetë, zoti kryetar, po edhe Kabinet qeveritar, kjo pjesë që është këtu, Realisht, unë dua të bëj sot thirrje dhe apel që ky proces ose kjo çështje që e ngrita konkretisht, të stopohet, jo vetëm kjo, por Kuvendi të monitorojë mirë Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që është trup i Kuvendit, i drejtohem sot dhe i bëj thirrje dhe e pyes, - vërtet, ky trup a është i Kosovës apo qysh e konsideron veten, ku jeton dhe çfarë bën? Nga kjo kërkoj që ky Kuvend dhe Qeveria ta stopojë këtë tjetërsim të pronës kështu në mënyrë kaq të paligjshme dhe, po e them edhe një herë, dhe të turpshme. Qysh mendon Agjencia e Privatizimit të privatizojë 232m², a ka nevojë për koment, pse bëhet kjo shitje, kujt i bëhej dhe për çfarë qëllimesh? Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryetar!
Dëshiroj të shpreh shqetësimin tim me rastin e hapjes së rigjykimit të luftëtarit të lirisë, zotit Ramush Haradinaj, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balaj. Konsideroj se me këtë akt i është ndalë fryma opozitës në Kosovë dhe në përgjithësi klasës politike. Konsideroj dhe mendoj se duhet që institucionet e shtetit në të gjitha instancat të ofrojnë, në qoftë se është e nevojshme, gjithë ndihmën dhe garancionet e nevojshme, në mënyrë që djemtë tanë të mbrohen në kushtet dhe rrethanat maksimale. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë,
Vendimi për rigjykimin e kryeministrit Haradinaj po bëhet në kohën e vendimeve dhe të proceseve të rëndësishme për Kosovës. Sot jemi para një vendimi shumë të rëndësishëm të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe jemi shumë të bindur që do të jetë në favor të pavarësisë së Kosovës. Por, kjo po ndodhë, po ashtu, edhe në kohën kur janë paralajmëruar bisedimet me Beogradin, për të cilat kryeministri Haradinaj është shprehur shumë qartë dhe, po ashtu, është shprehur shumë qartë edhe për veriun e vendit tonë.

Për rigjykimin e Ramush Haradinaj në këtë kohë është shumë e qartë se është tepër e interesuar Serbia, por po ashtu po shihet se janë të interesuar edhe qarqet e caktuara brenda dhe jashtë Kosovës. Do të thosha se nuk është mirë për t’u gëzuar shumë, mos u gëzoni shumë sepse koha e errët e sundimit të Qeverisë Thaçi po perëndon, po vjen koha e Ramush Haradinajt dhe ai si kryeministër i Kosovës do të ketë shumë punë për ta ndërtuar vendin, të cilin pandalshëm po e shkatërrojnë kryeministri Thaçi dhe presidenti Sejdiu.

Është mbase ironi e jetës, por heroi dhe lideri i Kosovës, Ramush Haradinaj, po sakrifikon sepse sakrifikoi dhe luftoi ai dhe familja e tij për vendin tonë. Ai po paguan sepse punoi dhe po punon për vendin tonë, ai po paguan edhe sepse punoi me presidentin Rugova dhe ai po paguan edhe sepse nuk u bë hajni i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Nurisha Hula.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë e përkrah plotësisht çështjen që e ngriti deputeti Nait Hasani, por po e paraqes edhe një herë për Fakultetin e Edukimit në kuadër të Universitetit që do të hapet në Prizren, më 1 tetor 2010. Kërkojmë, edhe një herë po e paraqes, kërkojmë deklaratën që e ka dhënë kryeministri Thaçi, që do ta përkrahë kërkesën tonë që në kuadër të Universitetit të Prizrenit të inkorporohen edhe programet e Fakultetit të Edukimit. Andaj, në këtë drejtim kërkojmë, në emër të studentëve dhe të prindërve të rajonit të Prizrenit kërkojmë hapjen e konkursit për programet e Fakultetit të Edukimit në Prizren. Kaq, ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Unë me këtë rast kërkoj nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala, si përgjegjës për ndërmarrjet publike, dhe nga kryeministri, zoti Hashim Thaçi, si shef i zotit Ahmet Shala, të sqarojnë deklaratën e drejtorit të PTK-së, zotit Haxha, i cili e dha në mbledhjen e Komisionit për Ekonomi, citoj: “Jam në presion tepër të madh politik për shkak të thirrjeve të ndryshme për punësim në PTK”. Zoti Haxha po ashtu u deklaroi mediave se presionet i kanë ardhur edhe nga njerëzit e fuqishëm, nga udhëheqësit e institucioneve të rëndësishme shtetërore, duke mos përjashtuar as Kuvendin.

Të nderuar,

Ngase presioni politik është edhe kërcënim dhe shantazh, që janë veprime antiligjore, unë kërkoj edhe nga institucionet tjera të cilat merren me ligje dhe rendin, të intervenojnë, duke investiguar çdo detal dhe dalë në ndihmë ta mbrojnë zotin Haxha nga të gjithë ata huliganë që bëjnë presion, bëjnë shantazhe apo kërcënime ndaj tij dhe të publikohen emrat e tyre, sidomos të personave publikë. Kush janë ata që shfrytëzojnë postet zyrtare, kush janë ata zyrtarë që e keqpërdorin postin e tyre edhe në këtë mënyrë sepse, siç e dimë, të nderuar qytetarë të Kosovës, mbi punësimi PTK-në e ka dëmtuar, duke ia ulur vlerën asaj tash në prag të privatizimit. Sa për hir të argumentit të ceket se në vitin 2009 janë punësuar rreth 640 punëtorë, shumica e tyre të pakualifikuar për postet që i kanë marrë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ismail Kurteshi e ka fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Përsëendetje për deputetë dhe Kabinetin qeveritar!

Unë sot dëshiroj ta ngrejë këtu një çështje shumë praktike. Bëhet fjalë për fytin e ngushtë të rrugës në hyrje të Prishtinës, kjo pjesa e Veternikut, me të cilën lidhen shumë komuna të Kosovës qendrore, jugore dhe lindore. Në këtë pjesë tanimë secili që udhëton, duhet të planifikojë që ta humbë një gjysmë ore vetëm për nja 2 kilometra ose ndodhë shpesh edhe një orë, prandaj është mirë që përgjegjësitë, qoftë Ministria e Transportit, qoftë komuna e Prishtinës të ndërmarrin diçka që vërtet ta rregullojnë këtë çështje shumë të rëndësishme për një pjesë të madhe të qytetarëve të Kosovës, të cilët ja mësyjnë Prishtinës në orët e paradites. Për pjesën lindore të Kosovës, për ta bërë një zgjidhje dhe për ta shkarkuar këtë pjesë, mund të bëhet një riparim që nuk kushton shtrenjtë në rrugën që e lidhë Anamoravën me rrugën përmes Mramorit dhe aty do të duhej vetëm disa kamionë rërë që ajo

rrugë të aftësohet dhe njerëzit mos të presin në këtë rrugë, të them, edhe me orë të tëra. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dy minuta do t'ua marrë unë dhe koha harxhohet.

Lajmi që e kemi marrë për vazhdimin e pjesërishëm të gjykit të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, ka shqetësuar gjithë opinionin, sigurisht institucionet e Kosovës, edhe Kuvendin e Kosovës. Ne jemi të vetëdijshëm që Lufta Çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e popullit shqiptar ka qenë luftë e imponuar, luftë e lavdishme, luftë për liri, për paqe dhe për prosperitet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Një lajm i tillë ka shqetësuar institucionet e Kosovës dhe gjithë opinionin, përveç të tjerash edhe për faktin se ai është bërë në prag të një vendimi të madh që është pritur nga të gjithë qytetarët e Kosovës, nga të gjitha forcat politike të Kosovës dhe nga përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës, nga institucioni përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, siç është Kuvendi. Prandaj, ky rast është i dhimbshëm, është shqetësues, është i papritshëm për të gjithë ne dhe nuk duhet të politizohet për të akuzuar këtë apo atë. Ne konsiderojmë që ashtu, siç edhe në të kaluarën jemi përballur me gjykime të tilla, edhe kësaj radhe drejtësia do të triumfojë. Ne kemi besim në drejtësinë ndërkombëtare dhe shpresojmë që edhe kësaj radhe të akuzuarit nga Kosova për krimet ndaj njerëzimit, që konsiderojmë nuk pasur në Kosovë ose, në fakt, nuk janë kryer nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë, të dalë e vërteta në shesh dhe t'i kthehet edhe familjes, por edhe politikës në Kosovë.

U apostrofua Kuvendi për ndonjë..., Kuvendi është shumë i gjerë për të bërë presion në Postë, por unë ju garantoj që si kryetar i Kuvendit të Kosovës, që e përfaqësoj Kuvendin e Kosovës, asnjë rast dhe asnjë telefonatë askujt s'ia kam bërë për punësim dhe konsideroj që edhe anëtarët e Kryesisë kanë ndjekur këtë rrugë. Ai është ankuar në ndonjë deputetë të Kuvendit të Kosovës, por realisht në deputetë, jo në organet përfaqësuese të Kuvendit të Kosovës.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare. Lidhur me pikën 18, kërkoj që Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion të ngarkohet që të takohet gjatë pauzës së seancës dhe seancës t'i parashtrijë rekomandimet përkatëse. A jeni dakord, si Kuvend? Kusht është "për"? Faleminderit! Nuk ka. Pra, kërkoj nga komisioni që ta kryej obligimin e vetë. Faleminderit!

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 8 dhe 12 korrik 2010

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbale? Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Unë nuk e kërkoja fjalën, po e shfrytëzoja momentin për të bërë një protestë publike ndaj kryetarit të Parlamentit, i cili për herë të dytë nuk ma jep fjalën. Isha nga deputetët që i treti e kërkoja fjalën, vetë folën dhe unë nuk fola. Thjeshtë, unë konsideroj se kjo tendencë e zotit Krasniqi për ta ndaluar mendimin në Parlament është e papranueshme dhe është ajo që e kam thënë dikur në aspektin partiak, staliniste. Mendimin e lirë në Parlament për çështje të ndryshme, zoti Krasniqi, nuk mund ta

ndalni dhe unë në shenj proteste e lëshoj këtë seancë, sepse konsideroj se kjo formë është shkelje flagrante, domethënë e të drejtës së deputetit. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi disa herë po përsëritet çështja staliniste në Kuvendin e Kosovës, unë dua ta them një deklaratë të shkurtër. Në Kongresin e 20-të të Bashkimit Sovjetik, kur Hrushqovi e kërkonte Stalinin, një nga anëtarët atëherë, në atë kongres, tha – pse s'ke fol me kohë? Ai tha: - Kush foli, por nuk mori përgjigje. I ra tavolinës edhe një herë tha: - Kush foli, po ai përsëri nuk bëzani më. Tha: – Tash po e dini ku kam qenë! Megjithatë, këta janë më trima se ata që... Kanë mundësi për të akuzuar edhe po më vjen mirë që janë krijuar këto kushte. Realisht, është keqpërdor mikrofoni.

Rendi i ditës është - Miratimi procesverbalit dhe këtu duhet të bëhen vërejtje në procesverbal, jo çka t'iu teket deputetëve. Duhet ta krijojmë një kulturë, ta respektojmë rendin e ditës. Jo, megjithatë, për hir të opinionit dua ta lexoja. “Kryetari ose kryesuesi i mbledhjes kujdeset t'i harmonizojë diskutimet e secilit deputetë sipas përkatësisë së grupeve parlamentare”. Megjithatë, nga një herë e marrin fjalën edhe deputetët e pavarur.

Konstatohet se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 8 dhe 12 korrik 2010.

Pika e tretë e rendit të ditës është:

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje. Vazhdojmë me pyetjen e parë. Deputeti Ismail Kurteshi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputet, e ke fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për të gjithë!

Zoti ministër,

Njëra nga arsyet kryesore të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ka qenë punësimi i atyre që presin punë. Sa është numri i të punësuarve në ndërmarrjet e privatizuara pas luftës, a i ka përmbushur pritjet e Ministrisë që ju e udhëhoqi në planin e punësimit privatizimi i lartpërmendur? Ju faleminderit!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče Skupštine,

Poštovani zamenici premijera, poštovane kolege ministri,

Dame i gospode narodnih poslanici,

Poštovani gospodine Kurteši,

Što se tiče broja radnika koji ste sami vi pomenuli, mi monitorišemo samo slučajeve koje obuhvataju ove metode spin off special, da vas podsetim, ima osnovne metode, to bi u stvari verovatno drugi organi trebali da znaju bolje, poput Agencije za privatizaciju, ali ja ću sa moje strane dati informacije one koji mi imamo.

Znači, u slučaju Ministarstva, mi kontrolišemo odnosno dobijamo informacije iz metoda takozvanih spin off special, u kojima pored ponude sa najvećom cenom, ocenjuje se investicija koja će biti sprovedena, kao i broj radnika koji će biti zaposlen. U slučaju ostalih preduzeća, koja se prodaju bez posebnih uslova, to je onaj drugi deo koji sam rekao spin off, jednostran spin off ili samo spin off, ne

kontroliše se broj radnika, jer kupci nisu obavezni da raportiraju u vezi ispunjavanja tih uslova. Znači, još jednom kažem, mi smo institucija koja imamo informacije, monitorišemo spin off special, a spin off je nešto za šta kupci nemaju preduslove, nemaju obaveze da informišu. U svakom slučaju, broj ... ovih registrovanih ili broj koji je kod nas stigao kao registrovani u tim akcijama koje su bile tokom privatizacije, odnosno spin off special je 6954. Takođe, imamo uslove za zapošljavanje kod javnih preduzeća koje su komercijalizovane, znači ona preduzeća koje su prodana u ovaj broj su negde, ova cifra je negde odo hiljadu radnika. Tako da, još jednom ponavljam, možda mi nismo institucija koja ima sve podatke o tome, ali ja vam iznosim onaj deo koji se nas tiče, a to je spin off special ili spinof i većantë, koji je do sad po registraciji uposlio 6954 ljudi, takođe sa jednim brojem javnih preduzeća, komercijalizovanih javnih preduzeća koji dostiže šifru od blizu hiljadu radnika. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Ismail Kurteshi.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Kohëve të fundit, në lidhje me efektet e privatizimit në lëmin e punësimit iu jam drejtuar disa ministrave dhe asnjëri nuk ka qenë në gjendje të japë ndonjë përgjigje të saktë. Meqë ju drejtoni Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, a mundeni së paku të më thoni - cili institucion në Kosovë merret me këto shifra dhe me efektet e privatizimit në sferën e punësimit ose, së paku, e adresoni institucionin i cili merret me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Pa da budem iskren, da vam priznam, jedna od međuministarskih grupa koja se najdirektnije bavi tom problematikom je međuministarska grupa za ndërmarrje publike ili za javna preduzeća. Ja nisam član te grupe, samim tim te informacije koje mogu ja da vam dam su vrlo limitirane. Znam da možda bi trebalo biti predviđeno da ministar za rad ili neko od odgovornih ili Ministarstvo za rad treba da bude deo te same jedne organizacije ili međuministarske grupe, a sa druge strane imate i Agenciju za privatizaciju, koja ima stvarno obimnu dokumentaciju u vezi svih predloga i projekta. Kad kažem projekta, mislim na regulisanje onih firmi koje su u procesu privatizacije. Mislim da, recimo, u koliko se te informacije skupe onako adekvatnije možda, sigurno ćemo imati jedan onako jasniji uvid u sve to. Kad vi kažete, u jednom svojem pitanju ste rekli – dali ste vi zadovoljni tim brojem radnika? Naravno, ja kao ministar ne mogu da budem zadovoljan time, uvek moram ka tražim više i sad u svim tim delatnostima, u svim tim pravcima u koje radimo, mi pokušavamo da taj broj bude maksimalno najveći mogući, a naravno znate i sami da kod tih samih sistema privatizacije, kupac uvek hoće da zaradi, uvek hoće da zaštiti svoja prava. Mi kroz one osnovne forme, po gotovo onome što smo pričali sa Zakonom o radu, možemo stvarno dosta toga da uradimo, da zaštitimo te naše radnike ali, s druge strane, dok to ne bude harmonizovano zajedno sa ostalim zakonima, od Zakona za rad, preko Zakona za inspektorijat...

KRYETARI: Ti përfundoje, po koha ka shkuar.

Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Ministri s'është këtu. Ju e dini, mund ta lexoni pyetjen, deputete.

SANIJE ALIAJ: Zoti kryetar, faleminderit!

Unë, në seancën e kaluar e kam lexuar pyetjen. Edhe në seancën e kaluar nuk ishte ministri, edhe sot s'është, s'ka nevojë ta përsëris. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputet, do ta lexosh pyetjen? E ke fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Unë do ta lexoj pyetjen, sepse edhe ashtu kalojnë pushimet verore. Ministri Ahmet Shala vitin e kaluar pati premtuar se është në fazën e implementimit të projektit dhe shpejt kur do të shkojmë në Shqipëri, do të flasim me 9 centë për minutë. Po, unë isha në Shqipëri dhe Vala nuk punonte. Posta dhe Telekom i Kosovës pati paguar 2.4 milionë euro për licencën e katërt të Telefonisë Mobile në Shqipëri, siç e pati quajtur ministri Ahmet Shala me patriotizmin e vetë Mobile for Albanian dhe pati deklaruar se në muajin shtator të vitit 2009 së shpejti pritet të futet në veprim dhe është në fazën e implementimit. Kur do të lëshohet në veprim Mobile for Albanian, një veprim i vonuar patriotik dhe çfarë ndikimi ka kjo kontratë me vlerën e supozuar të shitjes së Valës.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

E ke edhe një pyetje për ministrin Shala, dy pyetje i ke. Deputeti Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Është raportuar nëpër media të shkruara se gjatë furnizimit me energji elektrike, KEK-ut i është shkaktuar dëm diku rreth 8 milionë euro me vonesat në kontratën për blerjen e rrymës. Pyes publikisht Ahmet Shalën, a mund të na japë sqarime, në rast se janë identifikuar fajtorët për vonesa në kontrata për furnizim me energji elektrike, a është ndërmarrë ndonjë hap, a është iniciuar ndonjë procedurë penale, sepse në Kosovë ekziston një Kod penal i Kosovës, i cili parasheh se lidhja e kontratave të dëmshme është e dënueshme?

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministren Justina Pula Shiroka. Deputet, do ta lexosh pyetjen?

RIZA SMAKA:.. u lexua, prandaj nuk është edhe korrekte që ta lexoj, po me keqardhje e them se nuk e lexoj. Faleminderit!

KRYETARI: E drejta jote është, deputet.

Vazhdojmë. Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin, Ahmet Shala. Elektronika s'është kah punon, si duket. Deputetja Drita Maliqi e ka fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo është radha e dytë, domethënë, që nga seanca e kaluar, që zoti Shala nuk është prezent në seancë. Unë kam parashtruar në takimin e kaluar pyetjen për dy zëvendëskryeministrat, që edhe sot janë këtu, mirëpo ata nuk më janë përgjigjur, kështu që nuk e di të kujt janë këta dy zëvendëskryeministra dhe sot po protestoj, nuk po e paraqes pyetjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë për korrektësi dua të them se kësaj radhe ministri Shala vërtet ka arsye të mos jetë këtu. Deputetja Nurishahe Hulaaj, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Deputete, e ke fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Çështja: Shumë toka bujqësore ndërtohen dhe po mbindërtohen me objekte të ndryshme biznesi, e në anën tjetër po reduktohet vlera e prodhimeve vendore. Po e ilustruam një shembull. Republika e Kosovës, në bazë të të dhënave që kemi, siguron diku rreth 30% miellin nga tokat vendore bujqësore brenda një viti, që konsiderojmë se është një përqindje shumë e vogël për prodhimet vendore për miellin. Tjetër, bujqit për prodhime tjera vendore, si pemët e perimet, nuk e kanë sigurinë e duhur të plasimit të tyre në treg, sepse i njëjti mall me shumicë nga vendet tjera hynë në Kosovë. Pyetja është: “A ka Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural strategji të veçantë për mbrojtjen e tokave bujqësore, që do të reflektonte edhe mbrojtjen e prodhimeve vendore në drejtim të plasimit të tyre në treg të brendshëm dhe në atë të jashtëm? Nëse ekziston strategjia për mbrojtjen e tokave bujqësore, na i theksoni 4 – 5 objektiva kryesore operacionale të strategjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryetar,
Të nderuar dhe të respektuar deputetë,
E nderuara deputete, zonja Hulaj,
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka përgatitur Strategjinë për konsolidimin e tokës bujqësore 2010 – 2020, në bashkëpunim me ekspertët e Komisionit Evropian kemi përgatitur edhe planin e veprimit së bashku me koston përcjellëse për secilin vit, pra për dhjetë vitet e ardhshme. Strategjia në fjalë përbënë një guidë bazale të politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe të menaxhimit të drejtë e të arsyeshëm të tokës. Ajo ka për qëllim rregullimin e tokave për shfrytëzim më racional, rritjen e konkurrencës së fermës, rregullimin pronësor – juridik, planifikimin e shfrytëzimit të tokës, mbrojtjen e tokës dhe të ambientit, realizimin e aktiviteteve alternative në ferma, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës të banorëve në zonat rurale.

Gjatë këtij viti jemi duke realizuar projektin e konsolidimit të tokave bujqësore të papërfunduara gjatë viteve ‘80 në dy komuna të Kosovës, në Vushtri dhe në Obiliq. Përveç kësaj, Ministria ka përgatitur planin e veprimit për mbrojtjen e tokave bujqësore me këto objektiva specifike:

- Mbikëqyrja dhe zbatimi i ligjit për tokën bujqësore nga inspektorët e nivelit qendror dhe nga inspektorët e nivelit komunal pranë drejtorive përkatëse komunale, në bazë të detyrave dhe të përgjegjësiave të përcaktuara me dispozitat ligjore.

- Ndarja e saktë dhe e mirëfilltë e përgjegjësiave nga të gjitha institucionet që kanë akses në administrimin e tokës, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal,

- Përfundimi i konsolidimit të realizuar gjatë viteve ‘80, më saktësisht vitet 83 -89, që është i papërfunduar,

- Inicimi dhe zhvillimi i projekteve të reja të konsolidimit në baza vullnetare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputete, ke pyetje shtesë? Fjala për deputeten Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, zoti ministër! Ishin objektiva shumë të qarta, por kam një pyetje shtesë. Në ditët e fundit është plasuar në shtyp që 500.000 euro Qeveria ka ndarë subvencione për kombajnerët, që më erdhi shumë mirë. Po më intereson, në këtë ndihmë që do t’u jepet

kombajnerëve, a do të thotë kjo që do të lirohen edhe bujqit, që kanë mbjellë grurë, 30% nga pagesa që do t'iu korret gruri? Po më intereson, sa për bujqit të kemi informatë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Meqenëse edhe këtyre ditëve aktiviteti kryesor i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është realizimi dhe përcjellja e aktiviteteve të fushatës së korrje - shirjeve, ju siç e dini, ky është viti i tretë që ne i subvencionojmë auto-kombajnerët me 30% të derivateve të naftës, kjo iu mundëson automatikisht që të ketë një çmim unik dhe më të lirë për fermerët, kështu që do të thotë çmimi i korrje shirjeve është 90 euro për hektar. Po ashtu, të gjithë jemi dëshmitarë që nga viti i kaluar Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar të subvencionojë edhe sipërfaqet e mbjella me grurë me nga 90 euro për hektar, gjë të cilën po ashtu do ta vazhdojmë edhe gjatë këtij viti. Madje, ne jemi në përpunim dhe në kërkim të një modeli më të qëndrueshëm, ndoshta, që kjo përkrahje të mos jetë vetëm për hektar, po të shohim edhe mundësinë për subvencionimin e agro-imputeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Vazhdojmë. Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar, ministri s'është këtu. Deputet, do ta lexosh pyetjen? Vazhdojmë, deputeti Bujar Dugolli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Deputet, do ta bësh pyetjen? Fjala deputetit Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Pyetja ime ka bëjë me një vendim të ministrit apo të Ministrisë për zhvendosjen e ndërtimit të dy instituteve, të atij të ndërtimit dhe të industrisë, siç ishte paraparë dhe për këtë ishin përfunduar edhe projektet në lokacionin – Parku industrial i Drenasit, dhe me një vendim që jemi informuar, këto janë zhvendosur për t'u bërë në një lokacion në Bërnice, në komunën e Prishtinës. Unë kam pyetur ministrin pse është ndërmarrë një hapë i tillë dhe sa do të jenë implikimet buxhetore pas këtij hapi që konsideroj që është, ka qenë jo i duhur, jo i mirë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputete, doni ta lexoni pyetjen? Regjia, fjalën deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Me qenë se pyetja ime ka të bëjë me një çështje të rëndësishme lidhur me autostradën, unë kisha dashur t'ia bëjë pyetjen drejtpërdrejt ministrit kur është këtu, se besoj që është me interes ta dëgjojnë përgjigjen qytetarët e Kosovës dhe deputetët. Prandaj, do ta pres ministrin të përgjigjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën. Regjia, fjalën deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!

Paraprakisht më lejo të them, zoti Krasniqi, se sa më kujtohet, unë kërkoja nga ministri Shala, si përgjegjës i ndërmarrjeve publike, dhe kryeministri Thaçi të hulumtojnë dhe të zbulojnë ata që i kanë bërë presion zotit Haxha për të punësuar njerëzit e vet. Sidoqoftë, po kthehem te pyetja.

Qeveria ka vendosur që PTK-në, që ka të bëjë drejtpërdrejt me PTK-në, ta privatizojë PTK-në, pra Qeveria ka vendosur që PTK-në ta privatizojë. Për këtë arsye, kohë më parë pati angazhuar

këshilltarët e transaksionit për ta përgatitur PTK-në për privatizim. Pyetja është kjo: Sa janë vlerësuar asetet e PTK-së nga këshilltarët e transaksionit dhe për çfarë çmimi pret Qeveria që PTK të shitet? Është një pyetje që shumë është kah ju intereson qytetarëve të Kosovës, e sidomos atyre që në mënyrë direkte janë të involvuar me PTK-në. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet Tali, pyetje përsëri për ministrin Ahmet Shala. Doni ta lexoni pyetjen? Fjala deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Po, edhe kjo pyetje ka të bëjë me një sektor shumë të rëndësishëm të afarizmit në Kosovë që është shumë profitabil, ku profiti apo qarkullimi vjetor sipas disa të dhënave sillet rreth 100 milionë euro në vit, kemi të bëjmë pra me bastoret, ndonëse po them edhe një herë, qarkullimi sillet rreth 100 milionë euro në vit, edhe më tutje Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka arritur të fus rend dhe rregull në këtë fushë. ATK nuk e di saktë se sa para kanë në qarkullim bastoret dhe as sa kanë fitim. Këtë e them nga deklaratat të cilat i kanë dhënë udhëheqësit e ATK-së. Andaj, pyetja për ministrin është kjo: A ka Qeveria ndonjë plan për të futur rend dhe rregull në këtë sektor të biznesit dhe kur mendon që do të ketë rend e rregull ky sektor i biznesit përfundimisht në Kosovë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Haki Demolli. Ministri s'është këtu. A doni ta bëni pyetjen? As deputeti s'është këtu.

Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Lutfi Haziri. Ss deputeti, as ministri nuk janë këtu.

Vazhdojmë, me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për gjykatat dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftojme deputetët që të kthehen në sallë, se menjëherë fillojmë me votimin, Regjia, i bini ziles! Kryetari i komisionit a e do fjalën? Mirë, fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje, të nderuar ministra!

Kolegë deputetë,

Do të jem shumë i shkurtër. Projektligjin e kemi hartuar në bashkëpunim edhe me ekspertë, edhe me zyrtarë që ndihmojnë nga faktori ndërKombëtar. Kemi pasur edhe propozime nga deputetët e ndryshëm. Prandaj, lus që me rastin e votimeve t'i keni parasysh qëndrimet që i ka dhënë komisioni dhe do të jemi në gjendje të japim sqarime edhe pse nuk i kemi marrë parasysh propozimet apo amendamentet që vinë nga deputetët. Prandaj, qëllimi im pse e mora fjalën, është ligj mjaft i rëndësishëm, e bënë organizimin e sistemit të drejtësisë dhe është mirë që të mos lejojmë gjatë votimit të na kalojnë amendamentet të cilat mandej do ta prishin strukturën. Kjo nuk vlen vetëm për këtë ligj, por vlen për të gjitha ligjet që i kemi sot, sepse janë të një rëndësie të veçantë dhe mos të na përvidhen gabime, mandej të vrapojmë nëpër zyra të ndryshme dhe të vijmë në situata që mos me mund t'i standardizojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Jemi në pritje të numrit të deputetëve për të filluar votimin.

Nëse ndonjë përfaqësues i ndonjë komisioni e do fjalën?

Besoj, tash e kemi numrin e caktuar, andaj vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash, 61 deputet janë në sallë.

Konstatoj se me 52 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 51 votë “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Propozimi i deputetes Nekibe Kelmendi, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Më falni, po realisht unë kam kërkuar që të bëhet dallimi mes amendamenteve që janë dhe si duket i kanë bërë, por më vonë i kanë bërë dallimet, por jo te i 12-ti.

Atëherë, votojmë edhe një herë.

Amendamenti 12.

Propozimi i deputetes Nekibe Kelmendi, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 28 vota “për”, 22 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 12, i propozimit të deputetes Nekibe Kelmendi, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Amendamenti 13, i komisionit funksional

Konstatohet se me 43 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14, i komisioni funksional

Konstatohet se me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15, i komisioni funksional

Me 51 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamentin 16, i komisioni funksional

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Është propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, me mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18, i komisionit funksional

Votojmë tash:

Me 56 “për” asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19, i komisionit funksional

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20, i komisionit funksional

Me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21, i komisionit funksional

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22, i komisionit funksional

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

I komisionit funksional

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24, i komisionit funksional

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25, i komisionit funksional

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26, i komisionit funksional

Me 63 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27 – janë dy propozime. Propozimi i parë është i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 27.

Ky ishte propozim i Komisionit për Legjislacion. Tash e votojmë propozimin e deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 34 “për”, 22 “kundër”. Megjithatë, nuk shkon varianti i dytë ose varianti (b).

Amendamenti 28

Me 54 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Propozim i deputetes Nekibe Kelmendi pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 30 vota “për”, 25 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti i 29 i deputetes Nekibe Kelmendi.

Amendamenti 30

Propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Unë, nuk e thash jo rastësisht në fillim që të kemi kujdes. A e dini çka kemi votuar? Kemi votuar për t'i hequr të gjitha kriteret, të emërohen gjyqtarët në të gjitha gjykatat e Kosovës dhe kjo është antikushtetuese. Ne duhet një herë të mësohemi se nuk duhet të votojmë amendamente antikushtetuese. Ato kriteret të cilat janë përcaktuar për të qenë gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, po i eliminojmë në ligjin, i cili ka për të qenë bazë për t'u emëruar të gjithë gjyqtarët. Unë nuk e di ku shkojmë më tutje dhe kjo bie ndesh me të gjitha parimet. Ligji bëhet i pazbatueshëm, por unë nuk po kam mundësi. Ne e kemi sqaruar, e sqarova edhe në fillim të seancës. Po duket se deputetët po dëshirojnë vetëm mos të sqarojnë dhe të bëhen pengesë. Prandaj, mos të flasim shumë që janë pengesë të tjerët, pengesë jemi ne dhe ne nuk po duam të bëjmë shtet si duhet.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Unë kam propozuar të shtohet neni i ri 28: “Mandati fillestar për gjyqtarët është 3 vjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën 65 vjeçare. Kurse me kërkesën e gjyqtarit, mandati mund të zgjasë deri në moshën 70 vjeçare, nëse konstatohet se gjyqtari është i aftë për ta ushtruar funksionin e gjyqtarit”.
Neni 29 do të bëhet neni 30.

Kur kjo po për aplikohet për arsim, pse mos të aplikohet edhe për gjyqtarë.

(Reagim nga salla)

KRYETARI: Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: E nderuara deputete,
Aktualisht, asnjë gjyqtar dhe prokuror i Kosovës nuk ka pasur të drejtë të emërohet pasi e ka mbushur 65 vjet dhe mbi këtë kriter janë eliminuar shumë prokurorë dhe gjyqtarë shumë të respektuar. Prandaj, si po ua japim ne mundësinë, kur sot po i eliminojmë njerëzit që ndoshta na duhen për momentin, pas 10 viteve nuk do të na duhen, por sot i kemi eliminuar, sepse ka qenë me rregullore dhe aktualisht është e ndaluar moshë mbi 65 vjet dhe ekziston një softuer, as nuk kanë pasur mundësi për të aplikuar, se lëre më të zgjedhen moshë 65 vet. Ne tash po e mbrojmë, po themi që pas vitit 2013, ka mundësi moshë 65 vjet, në vend që të jetë e kundërta, domethënë sot ndoshta do të kishte mundësi dikush të emërohet, kurse pas një kohe nuk ka nevojë absolutisht, sepse po përgatiten shumë zyrtarë. Prandaj, është mirë që së paku të veprojmë realisht dhe të mos veprojmë me dy teke. Janë mbi 100 ndoshta që do të shkojnë në pension mu për shkak të këtij kriteri që ka qenë i përcaktuar me ligj.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë e kam një kërkesë. Tjera herë, çdo kryetar i komisionit funksional, kur ka amendamente nga deputetët, pa përkrahjen e komisionit funksional, të cekën paraprakisht të gjitha nenet që nuk duhet të votohen dhe arsyet pse nuk duhet të votohen. Realisht, mos të na qesim në lajthitje. Edhe një herë e përsërisim votimin për amendamentin 29.

Votojmë tash amendamentin 29, propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Me 5 vota “për”, 44 “kundër”, 5 abstenime, nuk votohet amendamenti 29.

Amendamenti 30, është propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Regjia, fjalën deputetit Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Amendamenti 30 po flet për atë që deputetja Nekibe Kelemendi ka kërkuar që pas moshës 65 vjeçare t’i shtohet mandati gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjë e cila ju thashë në fillim, nuk po i marrë më shumë kohë Kuvendit, është e ndaluar aktualisht. Asnjë gjyqtar dhe prokuror nuk mundet të zgjedhet nga Këshilli Gjyqësor, nëse e ka moshën 65 vjeçare, bile nuk mundet as të aplikojë. Prandaj, është mirë mos të përkrahet.

KRYETARI: Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Ky ligj nuk mund të aplikohet retroaktivisht. Ajo çka ka ndodhur, ka ndodhur në bazë të Rregullores, në bazë të të cilës janë emëruar gjyqtarët dhe prokurorët. Ky ligj vlen për të ardhmen. Prandaj, mos t’i vejmë në lajthitje deputetët e Parlamentit me një interpretim

gjithmonë, gjithmonë të bërë nga deputeti Bahri Hyseni dhe gjithmonë të përkrahur nga Parlamenti i Kosovës, ishte apo nuk ishte i drejtë. Interpretimin e ligjit e bënë Kuvendi i Kosovës dhe ai quhet interpretim autentik, e jo interpretim nga ana e një personi apo një kryetari të komisionit.

KRYETARI: Nuk kemi, nuk kemi debat. E dëgjuam kryetarin e komisionit, dëgjuam deputeten që e ka bërë amendamentin. Amendamenti 30 është propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 9 vota “për” 46 “kundër”, 11 abstenime, nuk votohet amendamenti 30, i propozuar nga deputetja Nekibe Kelmendi.

Votojmë tash amendamentin 31 të komisionit funksional. Më falni, fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Unë propozoj që të mos votohet amendamenti 31. Ja pse: termin “porotë” nuk është shqip, absolutisht nuk është shqip. Nuk po them, është i një gjuhe tjetër. Edhe termi “laik” më i mirë është se sa “porotë”, se është i pranuar disi edhe në praktikë. Disa e përdorin “gjykatës”, jo “profesionist” apo “laik”. Prandaj, termi “porotë”, meqenëse nuk është në gjuhën shqipe, nuk duhet të miratohet. Kjo është një dhe apropos me këtë, zotëri kryetar, ekziston një tendencë e një grupi të caktuar për t’i ngulfatur nismat e deputetëve për të bërë amendamente të mira, të qëlluara çfarë ishin ato të zonjës Kelmendi. Edhe unë shpreh keqardhje që refuzohen disi me njëfarë qëndrimi aprioristik edhe grupor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Komisioni funksional nuk ka diçka në këtë drejtim. Edhe unë mendoj se fjala “laik” është më mirë se “porotë”, por megjithatë vendos Kuvendi.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Me 43 vota “për”, 19 “kundër”, 7 abstenime, kalon amendamenti 31.

Amendamentin 32, i komisionit funksional

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33, i komisionit funksional

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë tash:

Me 65 vota “për” asnjë “kundër” 9 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Është propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetje të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 25 vota “për”, 31 “kundër”, 10 abstenime, nuk miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36, i komisionit funksional

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37

Propozim i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 28 vota “për”, 27 “kundër” dhe 12 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38, ka dy propozime.

Propozimi i parë i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 62 vota “për”, 2 “kundër”, 10 abstenime, miratohet amendamenti 38, varianti (a).

Varianti (b) është i deputetes Nekibe Kelmendi, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion.

Votojmë tash:

Rregullorja e parasheh të votojmë, ne po e zbatojmë Rregulloren. Ndryshojeni Rregulloren, unë nuk i votoj më.

Me 11 vota “për”, 35 “kundër”, 12 abstenime, nuk miratohet amendamenti, varianti b).

Amendamenti 39, ka dy propozime

Propozimi i parë i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 3 “kundër”, 8 abstenime, miratohet varianti a) i amendamentit 39.

Tash votojmë variantin b) të amendamentit 39.

Me 15 vota “për”, 31 “kundër”, 10 abstenime, nuk miratohet varianti b) i amendamentit 39.

Amendamenti 40, ka dy propozime

Propozimi i parë i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti i 40-të, varianti a)

Tani votojmë për variantin b)

Votojmë tash:

Me 15 vota “për”, 32 “kundër”, 5 abstenime, nuk votohet varianti b) i amendamentit 40.

Tash votojmë amendamentin 41 të komisionit funksional, i fundit.

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 41 dhe i fundit.

Në sallë kemi 76 deputetë.

Tani votojmë Ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për gjykatat.

Ju falënderoj për votimin korrekt, pjesërisht.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Komisionet parlamentare, e kanë shqyrtuar Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i komisionit, nëse e do fjalën, mund ta marrë. Deputeti Bahri Haseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Jo, këtu nuk kemi ndonjë pengesë, vetëm nëse del gjatë seancës, po mendoj.

KRYETARI: Tash votojmë amendamentin e parë.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 58 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 63 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 59 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 59 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 59 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 61 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 54 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Me 61 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Me 61 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Me 60 vota ”për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Me 58 vota ”për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Me 58 vota ”për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Me 60 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Me 61 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Me 64 vota ”për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë tash:

Me 55 vota ”për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë tash:

Me 65 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë tash:

Me 63 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë tash:

Me 64 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë tash:

Me 63 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Me 60 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë tash:

Me 58 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Me 62 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Votojmë tash:

Me 63 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Votojmë tash:

Me 64 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë tash:

Me 63 vota ”për”, asnjë ”kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Votojmë tash:

Me 59 vota ”për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36

Votojmë tash:

Me 61 vota ”për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37

Votojmë tash:

Me 60 vota ”për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38

Votojmë tash:

Me 60 vota ”për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39

Votojmë tash:

Me 63 vota ”për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40, i fundit

Votojmë tash:

Me 66 vota ”për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 40.

Tani votojmë Ligjin në tërësi. Në sallë janë 72 deputetë.

Votojmë tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 6-të të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit

Tani po ia lë fjalën Xhavitit.

Drejtimin e seancës e merr Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

XHAVIT HALITI: Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Avokatin e Popullit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Zoti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministre,

Të nderuar deputetë,

Brenda afatit të paraparë, me angazhimin të ekspertëve, të deputetëve edhe të organizatave që na ndihmojmë, kemi hartuar amendamentet për projektligjin në fjalë.

Grupin punues e ka udhëhequr deputeti Bajram Kosumi dhe mendojmë që kemi bërë një punë jashtëzakonisht të mirë. Edhe në këtë projektligj ka propozime të ndryshme të cilat kanë ardhur nga deputetët dhe prapë kërkoj vëmendje te deputetëve për amendamentet që nuk i kemi përkrahur dhe nuk u kemi dhënë mbështetje nga Komisioni funksional. Nëse dëshironi unë do të bëja tani arsyetimin e amendamenteve. Nëse dëshironi, do ta marr fjalën amendament për amendament atje ku ka propozime dhe do ta arsyetoj që mos të dalë që po dëshirojmë ne që të mos i aprovojmë, sepse dëshira jonë është t'i marrim amendamentet të cilat e bëjnë ligjin më të mirë, mirëpo, në raste të caktuara po propozohen amendamente, të cilat janë të pazbatueshme dhe bien në kundërshtim me dispozitat ligjore aktuale që janë në fuqi.

Prandaj, nëse dëshironi menjëherë mund t'i them amendamentet të cilat nuk i kam mbështetur apo kur janë amendamentet për t'u votuar, atëherë sqarojmë ndonjë amendament që duhet gjithsesi të sqarohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit

Sipas Rregullores, të drejtë kanë kryetarët e komisioneve përkatëse dhe kryetarët e grupeve parlamentare si dhe deputetët. Deri më tani, janë të paraqitur vetëm dy deputetë për të diskutuar për këtë dhe si duket, zoti Koci është në emër të Komisionit për Buxhet.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në 18 pika të rendit të ditës, të mos flas kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, është pak vështirë, por kësaj radhe e mora fjalën që të përmirësoj pak këtë performancën time si deputet në raportet e KDI-së dhe pak t'i përafrohem asaj performance që kanë deputetët e pavarur këtu në Kuvend.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar amendamentet e Komisionit funksional për Ligjin për Avokatin e Popullit dhe ka konstatuar që të njëjtat nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe si të tilla, mendoj se duhet të miratohen. Kam një vërejtje personale rreth fuqisë së amendamenteve, qoftë të propozuara nga deputeti, qoftë të propozuara nga komisionet, në praktikën parlamentare amendamentet kanë fuqinë e njëjtë. Renditja e tyre bëhet vetëm mbi bazë të asaj se çfarë shkalle të ndryshimit kërkohet me dispozitën përkatëse, prandaj nuk di se si është e rregulluar në Rregullore, por unë mendoj se këtë çështje, Komisioni për Rregullore do të duhej ta trajtonte, sepse po bëmë në pozita të palakmueshme edhe gjatë votimit edhe gjatë shqyrtimit të amendamenteve në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni- Kaloshi.

HYDAJET HYSENI- KALOSHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Më lejoni që duke ju përshëndetur, së pari të parashtoj dy-tri vërejtje parimore edhe atë miqësisht.

Së pari mendoj që është mirë që komisionet kur i shqyrtojnë amendamentet, t'i ftojnë edhe bartësit e amendamenteve alternative, në mënyrë që harmonizimi eventualisht dhe sqarimi të bëhet në komisione. Së dyti, kjo që e tha zoti Koci, pak më parë, radhitja e amendamenteve edhe me Rregullore bëhet në mënyrën siç po bëhet. Amendamentet e mbështetura nga Komisioni funksional kanë përparësi, mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk duhet edhe të jenë të paraqitura edhe në shtyllën

tretë, si do të duken në rast se miratohen, në këtë mënyrë edhe krijohet ajo që me të drejtë, zoti Koci insistoi barasvlershmëria e amendamenteve alternative.

Unë dua të paralajmëroj se në amendamentin 7,8, 11, 13 dhe në 16, në dy amendamente, kam nevojë për shqyrtime plotësuese, prandaj ju lutem që të më jepet fjala. Kam edhe një kërkesë konform edhe konkluzionit që kemi nxjerr në Komisionin për Rregullore, meqë ne kemi paraqitur si Komision për Rregullore disa amendamente, nëse amendamenti që votohet i pari, do të thotë, amendamenti që ka mbështetje nga Komisioni funksional, merr shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë sipas Rregullores, ne konsiderojmë kështu dhe kemi konkluduar se nuk ka nevojë të votohet amendamenti i dytë. Këtë rekomandim ia kemi dërguar Kryesisë, por ende nuk ka arritur, nuk është shqyrtuar, por ne nuk kërkojmë që amendamentet tona të votohen kësaj radhe, nëse amendamenti i parë merr shumicën në të. Ju faleminderit!

KRYEUSESI: Ju faleminderit!

Meqë nuk ka të tjerë të paraqitur, atëherë po vazhdojmë me amendamentet e propozuara në Projektligjin për Avokatin e Popullit dhe fillojmë me votimin e amendamentit të parë.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 45 vota “për”, 2 “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 31 vota ”për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3, i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi
Votojmë tash:

A ka dikush për të diskutuar?

Prezentë janë 64 deputetë .

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues,

Propozim-amendamenti im është suplementar ndaj tekstit ekzistues të neni 3. Në këtë përmenden vetëm 3 parime. Unë i kam shtuar edhe 3-4 parime fundamentale që janë tepër kruciale për punën e mbarëvajtshme të Avokatit të Popullit dhe ato janë, po e zëmë, mbrojtja e interesit publik, është obligim imperativ, si dhe privat, që do të thotë jo vetëm publik, por edhe privat. Ky është parim i njohur, kështu, në doktrinë edhe në praktikë. Ligjshmëria është imperativ, publiciteti shumë i rëndësishëm edhe udhëzimi profesional i palës. Kjo është detyrë permanente e Avokatit, por edhe i cilitdo autoritet publik, se pala gjithmonë konsiderohet laike në procedurë. Plus e kam zëvendësuar ku thuhet këtu “konfidencialiteti”, përderisa edhe nuk ka nevojë ta themi asisoj, e kam thënë “besueshmëria”, i bindur se ky propozim do të ishte adekuat, i pranueshëm, angazhohem që të miratohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Unë po e bëj të njohur pse nuk e kemi aprovuar si Komision dhe po e lexoj në projektligj si është: “Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit. Dispozitat e këtij ligjit zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe

interesave të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të organeve të autoriteteve publike, organeve tjera dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre”.

Propozimi i deputetit, edhe një herë po ua lexoj, është: Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, besueshmërisë, profesionalizmit, mbrojtjes së interesit publik dhe privat, ligjshmërisë, publicitetit dhe udhëzimit profesional të palës. Ju lutem, shumë më e qartë, ka qenë në projektligj, prandaj në këtë aspekt dhe nga udhëzimet e palës, prandaj këtu nuk e kemi aprovuar unanimisht, sepse ka dal “po e ndërron”, nuk ka ndërruar as në koncept, veç ka dhënë edhe sugjerime të tjera të panevojshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Smaka, dëshiron edhe një sqarim.

(Reagim nga salla - S’ka nevojë.)

KRYESUESI: Unë jam duke udhëhequr. Unë ia jap fjalën.

RIZA SMAKA: Zotëri kryesues, ju lutem! Nuk insistoј në kuptimin, si të them kështu, për sistem. Mirëpo, kolegu e lexoi pa vend paragrafin e dytë, unë iu kam adresuar paragrafit të parë, prandaj e prish kuptimin, si të them, nuk po dua të them ndryshe vetëm se nuk pat nevojë ta lexojë fare dispozitën e paragrafit të dytë, sepse asaj nuk iu kam adresuar, ajo do të mbetej si e tillë, por ky paragrafi i parë, pos tri parimeve, i ka edhe 4 parime fundamentale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Mbes pranë mendimit të zotit Hyseni, që vërtet kur shqyrtohen ligjet në komision dhe ka amendamente, ata që i kanë bërë amendamentet duhet të ftohen në komisionet përkatëse, me qëllim që të mos hapet debat gjatë miratimit të amendamenteve.

Pra, e hapi votimin për amendamentin e tretë, propozimin e deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tani:

Me 23 “kundër”, 21 “për”, 11 abstenime, rrëzohet amendamenti 3, i propozuar nga deputeti Smaka.

Amendamenti 4

Votojmë, tani:

Me 43 vota “për”, 3 abstenime, kërkoј të di se sa deputetë janë në sallë, sepse nuk ka votim të duhur. Në sallë janë 61 deputetë, disa nuk donë të votojnë. Pra, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tani:

Me 53 vota “për”, 3 abstenime, 2 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tani:

Me 43 vota “për”, 3 abstenime...

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Po, për amendamentin 6 është fjala. Por pritni tash unë ta hap, është propozimi i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Për fjalë është paraqitur në fillim deputeti Riza Smaka si propozues, dhe pastaj kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues!

Deputetë të respektuar,

Projekt amendamenti im i referohet nenit 6, paragrafi 1, alineja 2, ku thuhet se Avokati i Popullit do të duhej të kishte arsimim të lartë e me këtë do të krijohej bazë juridike, që për Avokat të Popullit të emërohej, eventualisht edhe gjeografi edhe biologu et cetera, et cetera, a puna e Avokatit të Popullit është ekskluzivisht juridike, prandaj do të bëhej një laramani, e do të krijohej një bazament i papërshtatshëm dhe mundësi që të emërohej edhe personi in adekuat. Unë e kam propozuar kështu, meqenëse tani i kemi dy sisteme aktuale: juristi i diplomuar edhe master programs, sepse becheler është 3 vjet edhe kam propozuar që paragrafi 1, pika 2 të riformulohet siç vijon: të jetë master-jurist, ose jurist i diplomuar, përkatësisht becheler-jurist, por me provimin e dhënë të jurisprudencës. Përafërsisht këto janë nivele adekuate, përpos kushteve të tjera për t'u emëruar Avokat i Popullit. Ky ishte motivi për çka unë iu kam adresuar Komisionit me këtë propozim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Hyseni, e keni fjalën.

BAHRI HYSENI: Po, po gjithsesi. Ju faleminderit, zoti kryesues!

Dhe, unë me gjithë respektin që e kam prej propozuesve, megjithatë dëshiroj t'i tregoj dy –tri arsye pse nuk është aprovuar.

Së pari, ne konsiderojmë që përcaktimi për një profesion është ngushtim dhe nuk kemi të drejtë, sepse është një çështje për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

E dyta, nëse e lexoni me vëmendje, edhe një herë po e lexoj: ka kërkuar thotë të plotësohen këto kushte: të jetë master-jurist; jurist i diplomuar, përkatësisht becheler-jurist, me provimin e dhënë të jurisprudencës.

Së pari, e njoftoj zotin deputet, që becheler-juristët nuk kanë mundësi ta japin provimin e jurisprudencës, duhet për ta kryer edhe masterin dhe mandej për t'u futur në provimin e judikaturës. Kanë qenë dy-tri arsye të cilave nuk u kemi dhënë mbështetje dhe nëse e votojmë kështu, do të biem në dilemë, sepse nga becheler-juristët, asnjë nuk e ka provimin e judikaturës, sepse nuk ka mundësi. Ligji për judikaturë kërkon që për t'iu nënshtruar provimit të judikaturës, duhet të jesh së paku master. Prandaj, këto kanë qenë arsyet për të cilat nuk i kemi aprovuar, sepse po biem ndesh edhe me ligjin, por edhe me çështjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Nuk mundet vetëm jurist të jetë Avokat i Popullit, duhet të jemi më të hapur. Edhe, nëse e normojmë bash kështu, do të shtrohet edhe një dilemë tjetër. A kanë të drejtë doktorët e shkencave të jenë, se jemi përcaktuar shumë në master- becheler. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falën e ka kërkuar deputetja, Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues që ma dhatë fjalën!

Unë dëshiroj të theksoj se i jap përkrahje propozimit të profesor Rizës, duke marrë parasysh se në shumë shtete tjera, që për shembull në shtetin suedez, Avokati i Popullit duhet ta plotësojë kushtin

që të jetë jurist dhe duhet të jetë një jurist i njohur, me renome, kështu kjo praktikohet edhe në shtetet tjera, prandaj edhe kërkoj t'i jepet përkrahje profesorit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, në sallë janë 66 deputetë. Fillojmë me votimin.

Votojmë tani:

Amendamenti 6

Konstatohet që 22 vota janë “kundër” 21 “për”, 7 abstenime, rrëzohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Propozimi i Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Pra, ka të paraqitur, deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues.

Ky amendament është në harmoni me konstatimin e bërë këtu disa herë dhe të mbështetur nga Kuvendi që të evitohet mundësia e përjashtimit nga procedurat e zgjedhjes në vende si kjo e Avokatit të Popullit, të atyre që kanë qenë viktimë të padrejtësive të sistemeve të mëparshme.

Prandaj edhe është propozuar që të shtohet paragrafi, përveç kushteve tjera do të thotë, të dënuar, por të shtohet: për veprë penale, të dënueshme me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Sa për ta njoftuar edhe Kuvendin, jam informuar se Komisioni për Legjislacion, ka miratuar këtë formulë në disa ligje që kanë të bëjnë me gjyqësinë.

Funksioni i Avokatit të Popullit edhe me shumë kërkon kujdes në këtë çështje, që të mos përjashtohen ata që janë dënuar pa të drejtë dhe mendoj që kjo është edhe në mbështetjen e Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Votojmë tani amendamentin 7 me sqarimet që i dha deputeti.

Amendamenti 7

Votojmë tani:

Me 48 vota “për” 3 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Ka dy propozime, të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe propozimin e Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Sipas Rregullores, në fillim votojmë propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Këtë amendament ne e kemi bërë para se ta shohim amendamentin e Komisionit, i cili në një mënyrë edhe e plotëson këtë kërkesë.

Vërejtja ime tani është e vetëm se në formën siç është hartuar në formulën e Komisionit, është përsëritje me paragrafin e parë të nenit vijues 7. Të dytë e përjashtojnë mundësinë që Avokati të jetë i angazhuar në funksione partiake, kurse neni që po e diskutojmë, ka të bëjë me kushtet për

zgjedhjen, do të thotë, para se të zgjidhet a mund të jetë, do të thotë, ka të bëjë me të kaluarën. Prandaj edhe në formulën tonë kemi thënë që të mos jetë bartës i funksioneve të larta shtetërore, do të thotë, të mos ketë qenë bartës i funksioneve partiake në funksion të, si të thuash profilit gjithëpërfshirës, të paanshëm e tjera. Nëse Komisioni e pranon këtë riformulim, do të thotë vetëm që të thuhet të mos ketë qenë bartës i funksioneve ose në mënyrën siç është thënë, në do ta mbështetnim, por edhe kështu nuk insistojmë në amendamentin tonë, por mendoj që do të evitohet tautologjia, sepse është përsëritje e të njëjtit paragraf edhe në 7.1.

Vetëm po të thuhet në të shkuarën që të mos ketë qenë bartës ose të mos ketë ushtruar funksione të larta partiake, atëherë është në rregull. Ai vë kushtet, ky papajtueshmëri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Votojmë amendamentin e 8.

Me 45 vota “për”, 9 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Edhe ky amendament ka 2 propozime, një propozim është i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe një propozim i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Të paraqitur nuk ka.

Fillojmë votimin tani për propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tani:

Me 49 vota “për”, 7 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti i evidentuar nën (b), nuk hyn në votim për shkak të rezultatit përkatës.

Amendamenti 10

Votojmë tani:

Me 57 vota “për”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Ka dy propozime, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si dhe Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Nuk ka të paraqitur, votojmë propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi...

Zoti Hydajet Hyseni, e ka fjalën, ose Bahriu, cili po doni?

Bahri Hyseni e do fjalën.

BAHRI HYSENI: Jo, unë vetëm po tregoj arsyen pse nuk e kemi përkrahur. Propozimi është përafërsisht i njëjtë, mirëpo Kuvendi i Kosovës është organizatë buxhetore dhe jo në raste të caktuara, por në të gjitha rastet është punëdhënësi, ai duhet të shpallë konkursin publik. Nuk ka mundësi ta shpallë Kryesia e Kuvendit. Kryesia e Kuvendit nuk është punëdhënësi dhe kjo është e rregulluar shumë qartë me ligj. Bile, bile, ju e dini që në mandatin e ardhshëm nuk do të ketë Kryesi të Kuvendit, do të jetë, por do të jetë me nënkryetar, që do të jetë formë tjetër e organizimit, por esenca e problemit qëndron. Kryesia e Kuvendit, nuk është punëdhënësi, punëdhënësi është Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit!

Pa dashur ta kontestojmë këtë, ne e kemi bërë amendamentin në tekstin e projektligjit, kurse teksti i projektligjit ka paraparë që Komisioni të publikojë thirrjen-konkursin dhe ne kemi kontestuar këtë. Komisioni është trup punues i Kuvendit dhe nuk mund të shpublikojë konkurse e tjera. Unë megjithatë mendoj që kështu siç është propozuar nga Komisioni Legjislativ, Kuvendi e le të paqartë, sepse Kuvendi është edhe Kryesia edhe Komisioni. Prandaj, meqë është në variantin e parë, do të thotë, të Qeverisë, Komisioni mbetet e pasqaruar. Në praktikën e deritashme ka qenë kompetencë e Kryesisë, mendoj që Kuvendi punon me Kryesinë... dhe kjo nuk e përjashton, por për mendimin tim është më shprehëse, më eksplicite nëse thuhet Kryesia, megjithatë, nuk shoh arsye për të kundërshtuar, le të vendosin deputetët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Konstatoj që të dytë dhatë sqarime të nevojshme.

Votojmë sipas Rregullores propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në fillim.

Votojmë tani:

Me 51 vota “për”, 4 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 11 i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Amendamenti 12

Votojmë tani:

Me 48 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Kam nevojë për një sqarim, sepse në tekstin që e kemi përpara është bërë një gabim, besoj teknik. Amendamenti është riformulues, paragrafi 14, kurse amendamenti që ne kemi proceduar nuk kërkon të riformulohet, por kërkon që pas paragrafit 14, të shtohet një paragraf i ri, do të thotë, nuk kërkohet që të hiqet ky paragrafi që thotë: të paktën njëri nga zëvendësit, duhet të jetë i gjinisë femërore, nuk guxon ta heqim këtë dhe kjo është arsyeja pse insistova që megjithatë të bëhet ky sqarim dhe pas kësaj të jetë paragrafi që është propozuar dhe besoj të votohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, meqë teknika është në defekt, nuk ka të paraqitur. A do të flas Bahriu? OK. Atëherë, vazhdojmë votimin.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Më 49 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 3 abstenime ... miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16, propozim i Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Është paraqitur deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Është kërkuar, zonja e zotërinj deputetë, me këtë amendament që të fshihet paragrafi i nenit 12.1.1. që thotë “paaftësia fizike apo mendore që shkakton pamundësinë e tij për kryerjen e funksioneve si arsye për shkarkimin eventual të Avokatit të Popullit”.

Kemi konsideruar se paaftësia fizike apo mendore është shumë relative, e pamatshme lehtë dhe mendoj që nuk është normale të jetë një formulë e tillë si bazë për shkarkimin e Avokatit të Popullit. Është fjala për 12.1.

KRYESUESI: Vazhdojmë me votimin e amendamentit 16 dhe votojmë tash:

Me 47 vota “për”, 6 abstenime, 5 “kundër”, miratohet amendamenti 16.

Vazhdojmë me amendamentin 17.

Votojmë tash:

Më falni, do ta ndërpresim votimin, sepse amendamenti 17 ka dy propozime:

Propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe Propozimin e deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Për fjalë është paraqitur deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues,

Të nderuar kolegë, deputetë, ministra,

Projekt-amendamenti im iu ka referuar nenit 12, paragrafit 2 të këtij projektligji, i cili thotë kështu: “Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me rregullat e veta”, cilat rregulla të veta “i miraton procedurat formale”, do të thotë, ne do të duhej të miratonim një rregullore, udhëzim a çka po di unë për këtë çështje “përmes të cilave e përcakton procedurën lidhur me shkarkimin ose suspendimin e përkohshëm nga detyra e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij”. Kjo është e paparë, kudo qoftë në teori, qoftë në praktikë që ne të përcaktonim, të bënim rregullore për shkarkimin eventual të Avokatit të Popullit apo zëvendësve të tij.

Komisioni funksional ka propozuar që të hiqet suspendimi i përkohshëm që në substancë nuk e ndryshon këtë. Kudo është rregull e padiskutueshme që procedura “pro” emërimit, si dhe për shkarkimin janë të njëjta, veç është nisma e kundërt. Kjo vlen për cilindo institucion.

Unë kam formula kështu. Paragrafi 2, të ndryshohej dhe të riformulohej siç vijon: “Suspendimi, përkatësisht shkarkimi i Avokatit të Popullit ose i zëvendësve të tij, aplikohet në procedimin e njëjtë me atë të zgjedhjes së tyre, të përcaktuar me këtë ligj”, se ky është ligj special.

Dhe shfrytëzoj rastin këtu të them që administrata, herëve të tjera të mos m’i heq fusnotat dhe referencat se deputetët kur t’i lexojnë ato, s’do të kisha pasur nevojë unë fare për të folur këtu. Po e cungojnë plus dhe po e shoh se kanë bërë ndryshime, por gabim në formulim të caktuar.

Dua të them se unë kam propozuar në konformitet me standardet juridike bashkëkohore. Procedura e emërimit, procedura e shkarkimit është e njëjtë, vetëm se nisma, si të them është e kundërt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani janë paraqitur 3 deputetë: Bahri Hyseni, Hydajet Hyseni dhe Gani Buçinca.
Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po befasohem nganjëherë, por ne duhet së pari ta kemi Kushtetutën para vetes dhe Kushtetuta flet vetëm për shkarkimin. Kuvendi i Kosovës nuk suspendon njerëz që i emëron dhe nëse e shihni propozimin e Komisionit për Legjislacion, ne kemi edhe nga projekt-propozuesi, domethënë, nga Qeveria ka qenë, ne e kemi eliminuar fjalën suspendim, sepse Kuvendi i Kosovës ose e shkarkon ose e emëron, nuk suspendon, nuk ka masa disiplinore ndaj një organi siç është Avokati i Popullit dhe këtu, ju lutem, mos t'i lëshojmë në dilemë deputetët. Kuvendi duke u bazuar në Kushtetutën apo edhe në përshkrim të një rregulloreje të veçantë e shkarkon Avokatin e Popullit kur i përmbush ato kriteret për të cilat kërkohet dhe s'ka suspendim, nuk ka komision disiplinor ndaj Avokatit të Popullit, prandaj ky është sqarimi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hydajet Hyseni, apo deputeti Riza Smaka. Je paraqitur për replikë apo...?

Zoti Riza Smaka, për replikë.

RIZA SMAKA: Është rregull unanime në të drejtën bashkëkohore aplikative që ai që mundet më shumë, mundet më pak. Kjo është një. Në qoftë se ky Kuvend ka autorizim për ta emëruar, ka edhe për ta shkarkuar, e atëherë për ta suspenduar. Nuk hapet procedurë disiplinore, por jepet një propozim. Kjo është një.

Dy, nuk është rregull e parë, pra e paprecedencë kjo zgjidhje në formulimin e këtij neni, që ne në Kuvend të bënim rregulla për suspendimin eventual të Avokatit të Popullit. Prandaj, ky është një standard juridik që është në harmoni me teorinë dhe me praktikën juridike bashkëkohore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

(Ndërhyrje, Bahri Hyseni: Është mirë mos me ... po a bën për një praktikë për dhjetë vjet sa funksionon Kuvendi, kë e ka suspenduar Kuvendi?

KRYESUESI: Mos ta zgjasim tash për këtë.

Hydajet Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: E kam fjalën për amendamentin tjetër që ishte, që u ngatërrua dhe s'po dua ta ngatërroj këtë çështje prandaj, ju lutem ma jepni fjalën në fund, para se të votohet.

Atëherë, me mirëkuptimin tuaj, si duket nuk isha shumë i qartë. Shikoni ju lutem, në fund të ligjit, tekstin e amendamenteve që janë prezantuar, do të thotë, në fund të ligjit janë edhe në shqip edhe në serbisht. Për amendamentin 12, amendamenti 6 imi – i Komisionit, më saktë, ka paraparë në nenin 12, të fshihet paragrafi 2. Ky amendament nuk është përfshirë fare në rekomandimet e Komisionit, as nuk është mbështetur, as nuk është kundërshtuar, por thjesht është lënë jashtë. Unë prandaj thashë janë dy vërejtje edhe procedurale që besoj administrata i ka bërë pa qëllim dhe sugjerimi im ishte që kjo të korrigjohej, meqë amendamenti është parashtruar me kohë, është pjesë e tekstit, pse të lihet?

Megjithatë, nuk insisto, por të mos mbetet e pasqaruar çka ishte, ishte pikërisht fjala për atë nen dhe ishte fjala për një lëshim të administratës, mund të jetë edhe një vërejtje që vërtet administrata të mos lejojë lëshime të tilla.

KRYESUESI: Faleminderit!
E ka fjalën zoti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues! Unë desha vetëm të sqaroj diçka. Të dy amendamentet e kanë një defekt brenda. Kuvendi nuk i ka emëruar zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe nuk ka kurrfarë përgjegjësie as kurrfarë ingerencash t' i shkarkojë ose t' i suspendojë ata. Kjo është e para.

E dyta, unë e përkrah propozimin e Komisionit funksional, mirëpo të hiqet së paku për zëvendës, të shlyhet kjo se nuk kemi ne çka të merremi me zëvendësit. Me zëvendësit merret dikush tjetër. Ne kemi të drejtë të merremi vetëm me Avokatin e Popullit, atë që e emërojmë atë edhe e shkarkojmë. Ajo është çështje e brendshme e Avokatit atje dhe e zyrës. Kjo ishte krejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S'ka më të paraqitur. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamentit 17 dhe votojmë tash:

Është varianti i parë dhe po dihet, i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Më 35 vota “për”, 4 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Votojmë tash:
Me 44 vota “për”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Votojmë tash:
Më 50 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Votojmë tash:
Me 50 vota “për”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Votojmë tash:
47 vota “për”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.
Votojmë tash:
Me 52 vota “për”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23, ka dy propozime:

- a) Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe
- b) Propozimi i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Është paraqitur deputeti Riza Smaka, për sqarim.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues,
Qeveritarë dhe deputetë të respektuar,

Nëse i krahasojmë këto dy propozim-amendamente, për afërsisht e kanë një qëllim, po mos të keqkuptohem, jam i bindur se formulimi im është më i qëlluar, më juridik dhe më i plotë, më komplementar dhe do të isha angazhuar për mirëkuptim që të miratohej. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bahri Hyseni e ka kërkuar fjalën.

BAHRI HYSENI: Edhe unë kisha dashur ta aprovoj seriozisht, por që kjo na lë dilema, në fund. Thotë, parashtruesi i ankesës mund të plotësojë ankesën me ndihmën e zyrtarit të Avokatit të Popullit. Dhe kjo lë dilema, domethënë, Avokati i Popullit dhe zyrtarët t' i ndihmojnë parashtruesit të ankesës të parashtrojë ankesa dhe me...

KRYESUESI: Faleminderit! Hapim votimin!

Votojmë tash:

Votojmë amendamentin 23, propozim i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, sipas Rregullores.

Atëherë, kemi 30 vota “për”, 6 abstenime, 9 vota “kundër”, miratohet amendamenti 23, propozimi i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, kurse rrëzohet propozimi i deputetit Riza Smaka.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Me 47 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Më 45 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Më 54 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 2 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

57 vota “për”, 3 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Votojmë tash:

Faleminderit! 53 vota “për”, 3 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 31.

Tani votojmë për tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Faleminderit! Konstatohet se në sallë janë 70 deputetë. “Për” kanë votuar 57 deputetë, kanë abstenuar 3 deputetë dhe konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për Avokatin e Popullit. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për grevat

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për grevat dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Sadik Idriz, apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandimet.

Deputetja Teuta Hadri e ka fjalën, në emër të komisionit.

TEUTA HADRI: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se gjatë amendamentimit të këtij ligji janë përfshirë dy gabime teknike, çka grupi punues dhe vetë si raportuese dhe Komisioni i Shëndetësisë i ka kaluar, por ja këtu në ligj është futur si gabim teknik. Jam te neni 3, duhet të votohet sipas ligjit që ka qenë, jo sipas amendamentit, se është bërë një gabim teknik, ka hyrë dhe te neni 25, gjegjësisht amendamenti 8 dhe 9, këtu është bërë përsëri gabim teknik te pika apo paragrafi 2.2 dhe te 9.3.2, ku në vend të numrit 7 duhet të jetë numri 8. Domethënë, sipas nenit 8, se kjo bie në kundërshtim me atë 7, kështu që si grup punues dhe si Komision i Shëndetësisë i kemi paraqitur këto vërejtje dhe shpresoj se do të mirëkuptohet nga deputetët.

KRYESUESI: Atëherë, veç një sekondë, Emrush!

Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Për amendamentin numër 1 po bëhet fjalë. Këtu në amendament thuhet që organizimi i grevës në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Shërbimin e Zjarrfikësve, shërbimet emergjente dhe organet me interes të veçantë për Republikën e Kosovës, rregullohet me ligj të veçantë të këtyre organeve. Domethënë, kam biseduar edhe me disa anëtarë të Komisionit. Organizimi i grevës në Forcën e Sigurisë së Kosovës, vetvetiu është një gabim, mendoj një lëshim teknik, sepse edhe sipas Ligjit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, pjesëtarët e saj nuk mund të bëjnë grevë. Kjo është e qartë, domethënë, vetëm kjo hiqet – FSK dhe kurrëgjë tjetër.

KRYESUESI: Para se të hyjmë në votim propozoj që vërejtjet e komisionit t’i votojmë menjëherë. I hedh në votim propozimet e vërejtjeve që i ka dhënë në emër të komisionit, deputetja Teuta Hadri.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet propozimi i deputetes.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Jo, i kemi votuar! Atë, propozimin e komisionit.

(Ndërhyrje e Ibrahim Makollit)

E, bre, ajo është e regjistruar dhe e qet teknika gjatë spastrimit të tekstit.

(Sugjerime, propozime)

Atëherë, ju lus që kur është fjala për amendamentin, paraqituni tek amendamenti, jo në fillim të propozoni diçka që duhet për të votuar në amendamentin 21. OK dhe ju lus që të mos e komplikojmë sistemin e votimit.

Atëherë, votojmë amendamentin 1 dhe votojmë tash:

(Ndërhyrje)

Ani, kërkon të tërhiqet amendamentin 1?

Domethënë, Komisioni në fjalë propozon që të tërhiqet amendamenti 1.

Votojmë tash për tërheqjen e tij, ose më mirë të themi e kemi votuar, por hajde... edhe një herë.

Atëherë, miratohet me 36 vota. Hiqet amendamenti 1.

Votojmë amendamentin 2.

Votojmë tash:

46 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 46 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 46 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

52 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 7, me vërejtjet e deputetes, të paraqitura më herët.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Me 31 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8.

Ju lutem, sa deputetë janë në sallë? 69, po duket s’po votojnë deputetët.

Amendamenti 9, me vërejtje paraprahe të komisionit.

Votojmë tash:

Faleminderit! Me 41 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Tani votojmë për tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Në sallë janë 69 deputetë.

Me 57 vota “për”, 1 abstenim, konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për grevat.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Duhet të dini që në orën 14 e diçka do ta caktojmë një pauzë më të gjatë dhe, nëse jeni për pauzë, e marrim tash. Shpresoj se e kalojmë shpejt. Hajt, të vazhdojmë, besoj se e kryejmë deri në orën 13:30.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për miniera dhe minerale dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të shkojmë për votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandimet.

Nuk ka të paraqitur. Janë disa të paraqitur më herët, ju lutem që t’i tërhiqni. Këtu nuk është i paraqitur askush. A e keni shtypur atë? OK.

Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Buxhet e Financa, në aspektin buxhetor i ka shqyrtuar amendamentet e Komisionit funksional dhe unë kisha kërkuar nga Komisioni funksional se a e ka përfshirë një vërejtje të cilën e ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe që ka të bëjë me krijimin e Institutit të Shërbimit të Gjeologjisë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, kur e dimë që i njëjti ka qenë një departament në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe të mos na dalin dy mekanizma që dublikojnë edhe punën dhe natyrisht edhe krijojnë probleme edhe me çështjen e buxhetit? Kjo

ka qenë vërejtje e Komisionit, prandaj ne nuk kemi marrë një konfirmimi nga komisioni se a e ka pasur parasysh këtë fakt dhe a është i përfshirë në amendamentet e projektligjit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, si kryetare e komisionit.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëendetje për të gjithë.

Duke marrë parasysh se pas vërejtjeve të komisioneve parlamentare, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, ka marrë vërejtjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe definitivisht është vendosur që të bartet i gjithë drejtorati i cili ka funksionuar brenda KPMM-ës në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave dhe mos të kemi dualizëm të kompetencave brenda një institucioni të pavarur dhe një institucioni qeveritar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka shqyrtuar me vëmendje amendamentet e Komisionit funksional dhe ka kërkuar që në amendamentet 53, 60, 62 dhe 63, të intervenohet për të përmirësuar amendamentet, sepse bien ndesh me dispozitat ligjore.

Nga raporti përfundimtar që kemi këtu në seancë është vërejtur se Komisioni funksional nuk i ka marrë parasysh dhe unë po i përmend amendamentet të cilat nuk do të duhej të votohen gjithsesi se përndryshe do të vijmë në situatë që ligji ose nuk do të hyjë në fuqi ose do të jetë i pazbatueshëm.

Po filloj me nenin 53, fjala është për Inspektoratin e Minierave apo udhëheqësin, kryeinspektorin i cili thotë – i raporton bordit të KPMM-ës, kryeinspektori emërohet nga Komisioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Domethënë, janë dy çështje. Është kundër-kushtetuese, në rend të parë, sepse kryeinspektori është shërbyes civil dhe ai emërohet konform Ligjit të Shërbimit civil dhe e dyta, është prapë kundër-kushtetuese, sepse komisionet parlamentare nuk kanë të drejtë për të emëruar shërbyes civilë, as t'i emërojnë dhe as t'i shkarkojnë dhe unë nuk po lodhem me krejt amendamentin, por, domethënë, amendamenti i Komisionit funksional, komplet amendamenti 53, nuk duhet përkrahur.

E njëjta situatë vazhdon prapë te amendamenti 60, paragrafi 3.4 dhe me kohë i kemi rekomanduar Komisionit funksional, po prapë s'e ka marrë parasysh, është fjala te përzgjedhja tash e drejtorit ekzekutiv brenda Institutit Gjeologjik që e kanë propozuar Komisioni për Buxhet, të jetë këtu, thotë: i raporton ministrit, kurse emërohet nga komisioni i Kuvendit të Kosovës, prapë. Është një çështje prapë kundër-kushtetuese, drejtorët janë shërbyes civilë dhe duhet të emërohen në bazë të rregullave të Shërbimit civil. Mandej flet edhe për përzgjedhjen, bile edhe për kriteret e këto bien ndesh komplet.

Gjithashtu, te amendamenti 62 është për publikimin e Rregullores, domethënë, një rregullore e përbashkët, mirëpo unë vetëm i bëra si vërejtje, janë 3 amendamente, të cilat nuk duhet t'i aprovojë Kuvendi i Kosovës, sepse bien ndesh edhe me Kushtetutën edhe me ligjet aktuale. I kemi sugjeruar me kohë, shihni raportin, mirëpo Komisioni funksional ka menduar që ndoshta ka të drejtë Komisioni funksional të emërojë shërbyes civilë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA. Faleminderit, kryesues!

Përsëritet Kabinet qeveritar,

Përsëritet zonja ministre Justina Pula-Shiroka,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të gjithë të pranishëm,

Tani është një ditë që unë konsideroj që është shumë e rëndësishme që na vjen pas një viti qëkur ka kaluar në leximin e parë Projektligji për miniera dhe minerale, më 9 korrik të vitit të kaluar dhe Komisioni funksional e ka bërë një punë shumë të madhe, një punë shumë të mirë dhe është përpjekur që në mënyrën më të mirë të mundshme të bëjë amendamentimin dhe të bëjë përsosjen e këtij draftligji.

Natyrisht se në përpjekje e sipër, domethënë, ka pasur edhe lëshime dhe lëshime tjera që i përmendën edhe kolegët – kryetarët e komisioneve, përkatësisht të Komisionit të Legjislacionit dhe të Komisionit të Buxhetit. Propozimin e Komisionit të Buxhetit, siç e përmendi edhe kryetarja, e kemi marrë në konsideratë, ndërsa propozimet e Komisionit të Legjislacionit nuk kanë hasur në mirëkuptim as në grupin punues e as në komision. Mirëpo, unë si raportuese e amendamenteve të këtij ligji kam rezervuar të drejtën të bëj amendamente në mbështetje të vërejtjeve që i ka dhënë me të drejtë Komisioni i Ligjeve dhe kisha kërkuar nga seanca që të mbështeten këto amendamente, pikërisht në ato 3 pika që u përmendën edhe më herët, por sidoqoftë karshi materies që rregullon ky ligj që është shumë i rëndësishëm, këto mund të jenë edhe cikërrime, unë kërkoj vëmendjen e deputetëve dhe që të miratohet ky ligj sa më parë që është e mundur, sepse segmenti shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës deri tash ka funksionuar pa ligje bazë, ka funksionuar vetëm në bazë të rregulloreve të UNMIK-ut të cilat nuk dua t'i komentoj se e kemi një mënyrë shumë të shkapërderdhur në sektorin minerar, tani e kemi rastin që t'i bëjmë ligjet bazë siç është ligji për miniera dhe minerale dhe pastaj edhe ligjet dytësore që e rregullojnë këtë fushë shumë të rëndësishme.

Unë, edhe një herë më lejoni t'i përsëritet kolegët e mi në komision që vërtet janë përpjekur të bëjnë një punë të madhe dhe kërkoj nga seanca që ta mbështesë dhe të ketë vëmendjen pikërisht në këto vërejtje që i dha Komisioni i Ligjeve, tek neni 59 dhe kur të vijmë atje shpresoj se kryesuesi do të ma jap fjalën edhe për arsyetim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali e ka kërkuar fjalën!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kam një kërkesë nga shumë ekspertë të shoqërisë civile që pajtohem edhe unë, ka të bëjë me amendamentin numër 30. Këtu e patëm diskutuar vitin e kaluar, pra më 9 korrik 2009. Pra, flas për nenin 30, të kohëzgjatja e licencave për shfrytëzimin e mineraleve energjetike, me theks të posaçëm këtu gjithnjë veçohet miniera e Sibovcit. Origjinali në pikën 2.1 ka qenë kohëzgjatja maksimale prej 40 vjetëve. Flas për pikën 2.1 të nenit 30. Dhe pastaj, të njëjti nen, gjithmonë po flas të ligji apo projektligji i mëparshëm, ka qenë pika 2.3 ku thuhej: “Nuk mund të vazhdohet afati”. Ka pasur pakënaqësi nga shumë ekspertë, po them, sidomos të ata të shoqërisë civile, po edhe të tjerëve, që është një kohëzgjatje e tepruar.

Tashti me këto përmirësime, na ka ardhur, gjithnjë i referohem po ashtu nenit 30, pika 2.1. që kohëzgjatja maksimale të jetë prej 30 vjetëve, mirëpo në pikën 2.3. janë shtuar edhe 15 vjet, pra

“mund të vazhdohet për një periudhë shtesë prej 15 vjetëve” që e përkeqëson situatën në 45 vjet apo dyzetepesë vjet. Kërkesa është që deputetët e nderuar të Kuvendit, ta pranojnë, pikën 2.1 si “që kohëzgjatja maksimale prej 20 vjetëve” dhe në pikën 2.3. “mund të vazhdohet për një periudhë shtesë po ashtu prej 20 vjetëve”. Pra, kjo është kërkesa që është bërë nga shumë ekspertë. Unë po habitem edhe nga komisioni gjegjës, sepse një nga anëtarët e komisionit gjegjës, nëse ju kujtohet bile ka qenë i opozitës, në seancën e 9 korrikut pati apeluar edhe te opozita që ta votojnë në parim projektligjin, sepse komisioni do ta përmirësojë këtë, fjala është për zotëri Berim Ramosaj, po e cek këtu, e kam transkriptin “se komisioni funksional do ta shqyrtojë këtë dhe kemi shansin ta rregullojmë”, e tjera, e tjera dhe “bën apel që opozita ta votoj”. Këtë e pati bërë sa ishte në opozitë, zotëri Berim Ramosaj, pas nja dy jave doli në pozitë, atje në LDK, ndoshta e ka ndryshuar edhe mendimin pastaj.

Andaj, po apeloj edhe një herë që të merren parasysh kërkesa e shoqërisë civile në këtë amendamentin gjegjës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti, zoti Ethem Çeku, e ka kërkuar fjalën!

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Ky projektligj ka kaluar një debat shumë të gjerë dhe e shihni që janë diku rreth 74 amendamente. Do të thotë, të themi përafërsisht është rishikuar ky projektligj në komisionin tonë. Pra, ne e kemi cilësuar se është një nga projektligjet më të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të energjisë dhe minierave, për të dy sektorët dhe është bërë përpjekje që t’u japim institucioneve që krijohen me këtë ligj pavarësinë e duhur nga zhvillimet e deritashme të cilët nuk kanë arritur ta kenë një pavarësi të duhur. E kemi fjalën tek inspektori, kryeinspektori i minierave. Është funksioni më i rëndësishëm, i cili duhet ta ketë autonominë e vet në procesin e vendimmarrjes.

Prandaj, në praktikat e deritashme të përzgjedhjeve, unë mendoj që Komisioni ka bërë propozimin e duhur ku i kemi lënë që Kuvendi, përmes mekanizmave përkatës, të zgjedhë kryeinspektorin e minierave. Ai nuk është shërbyes civil, ka zhvillime të tjera, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, i marrim disa institucione të tjera të cilat janë zgjedhur nga Kuvendi, janë zgjedhur nga Kuvendi dhe të auditimit edhe të institucioneve të tjera.

Prandaj, mendoj që duhet të mbetet që kryeinspektori duhet të zgjidhët nga Kuvendi dhe duhet të miratohen amendamentet të cilat janë dhënë nga Komisioni funksional.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë për veten time gjithnjë po e shoh të domosdoshme që të rifutemi Rregullores për ta bërë edhe një herë dhe kjo situatë në mes komisioneve dhe këto qëndrime të kundërta në mes komisioneve do të duhej që të harmonizoheshin në Komisionin për Ligje dhe jo të vini këtu në Parlament me gjithë këtë diskrepancë njëri me tjetrin. Meqenëse këtu po vazhdojnë të paraqiten për të diskutuar dhe deputetët nuk janë në sallë, atëherë ne po vazhdojmë me të paraqiturit, por mendoj që gjitha këto amendamente të pa harmonizuara në mes komisioneve do të kenë pasojë pastaj në zbatueshmërinë e ligjit. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje kolegë deputetë, ministra,

Arsyeja që e mora fjalën, më shtyri vetë fillimi i këtij debati për këtë pikë të rendit të ditës.

Mendoj që mungoi një arsytim prej kryetares së Komisionit funksional për shkak të peshës dhe rëndësisë së madhe që ka ky projektligj, plotësimet dhe ndryshimet të cilat janë bërë, mundit të

madh të cilin e ka dhënë Komisioni funksional që ka mbi një vit që e ka pasur në shqyrtim, në debate të përbashkëta me Ministrinë, me ekspertë, me njerëz... Mendoj që kjo mungesë e kësaj informate nuk është mirë të ndodhë herëve tjera, sepse na sjell në këtë situatë çfarë erdhëm tash. Për atë pra ne duhet t'u drejtohem dhe komisioneve që të japim sqarimet adekuate, në mënyrë që të kemi të artikuluar para aprovimit se çka realisht ka pasur projektligji që shkoi dhe çka kemi, të them kështu në parim, në linjat e trasha atë çka i jep një përmbajtje e re këtij projektligji me aq rëndësi për jetën ekonomike, politike, gjegjësisht kësaj Ministrie që funksionoi kur është në pyetje minierat dhe mineralet. Prandaj, janë do çështje teknike që dolën në plan të parë të cilat mund Kuvendi t'i sqarojë a duhet të aprovohen ato amendamente të komisionit funksional apo jo dhe mendoj që projektligji duhet të kalojë në votim jo të shtyhet. Mbi një vit ka që jemi marrë me këtë projektligj. Në qoftë se është gabim amendamentimi nga ana e komisionit funksional në dy-tri çështje që u theksuan këtu është korrekte prej anës sonë si deputetë ta kemi parasysht atë, të mos bëjmë ndonjë shkelje ligjore dhe të votojmë amendamentet me radhë në mënyrë që ligji të ecën. Po, sinqerisht po ju them, është punua aq shumë në këtë projektligj sa 80% e këtij projektligji që ka ndryshuar jep një përmbajtje krejt të re e jo tash të amendamenteve, qoftë për afate, qoftë... janë debatuar, janë shter debatet dhe mendoj që është me rëndësi të miratohet ky projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

(Reagim)

Pesë herë, s'mund ta marrësh fjalën! Vazhdoni! E keni pasur fjalën, ju lutem!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryesues! Edhe unë po duhet ndoshta atë kontribuoj në zgjidhjen e kësaj... Mendoj se kjo përplasje e komisioneve për shkak të amendamenteve të ndryshme, e bën të pamundur që sot me këtë lexim ky projektligj të kalojë.

Unë vetëm po përmend dhe po kërkoj prej komisionit funksional le të na sqarojë, le të na thotë se ku është thirrur që komisionet zgjedhin kryeinspektorë. Thjesht, ne para disa muajve kemi nxjerrë, kemi miratuar Ligjin për shërbimin civil dhe Kuvendi nuk e ka të drejtën dhe nuk do të duhej që të ndërhyjë në kompetencat e tjera, sepse, kështu, në këtë vend zgjidhen me qindra drejtorë dhe kështu po i bie se si komisionet duhet t'i zgjedhin drejtorët.

Prandaj, këto propozime që janë prej komisionit, edhe pse nganjëherë po dëgjohet dhe do të ishte mirë kolegë që të na thoni këtu, sepse shumë herë po na thoni që lartë prej lartë ata kanë thënë, të na tregoni se kush janë ata lartë që kanë thënë, ose të na i sillni këtu, për të na i sjell këtu ata lartë që kanë thënë dhe të na bindin neve pse do të duhej me ndryshuar praktikën Kuvendi. As me Rregulloren të Kuvendit nuk ka që komisioni zgjedh drejtorë, as kryeinspektorë. Prandaj po kërkoj që kjo të kthehet në lexim të tretë, të shqyrtohet edhe një herë brenda komisioneve dhe pastaj të kalojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani janë rikthyer për të diskutuar prapë edhe kryetarja e Komisionit Myzeje Selmani.

MYZEJE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me të gjitha komentet të cilat u dhanë tash nga deputetët dhe nga deputetët e vetë komisionit dhe deputetët që janë në seancë këtu mund t'ju them shumë sinqerisht se të gjitha rekomandimet nga Komisioni për Buxhet dhe nga Komisioni për Legjislacion kanë dalë në mbledhjen e komisionit parlamentar dhe nuk janë miratuar. Dhe është esenca që në mbledhje të komisionit nuk janë miratuar 3 herë këto rekomandimet e dy komisioneve, me përjashtim të Komisionit për Buxhet dhe Financa

që ka kaluar se ka qenë një gabim teknik. Ndërsa sa është punuar në këtë ligj, është punuar jashtëzakonisht shumë, mirëpo esenca e gjithë komisionit dhe gjithë deputetëve të kësaj seance është që është dashur të kthehet ky ligj menjëherë dhe Qeveria të sjellë një ligj më të mirë dhe sot mos të humbim kohë kot duke diskutuar këtu. Se nuk është çështja se po do me këtë ligj me u shkel Kushtetuta. Të jemi të qartë. Se më së pakti ne deputetët jemi adhures të shkeljes së Kushtetutës. Ndoshta, ekzekutivi po, por deputetët jo.

Dhe të jemi të sinqertë se për arsye të mos implementimit të politikës në përzgjedhjen e kryeinspektorit se mjaft punë ka komisioni parlamentar që të merret edhe me kryeinspektorin dhe të merret me punë të ekzekutivit. Nuk ka qenë as dëshirë e komisionit parlamentar që të ndërhyjë në çështjet e ekzekutivit. Dhe, në rast se ashtu po ju duket që është shkel Kushtetuta dhe ka mangësi, atëherë si kryetare e Komisionit me gjithë mundin njëvjeçar ia kisha dorëzuar Qeverisë që të bie një ligj si duhet dhe tjera herë mos të nxjerrë debat këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash shkojmë me radhë, e ka kërkuar Sala fjalën, në fillim. Deputetja Sala-Berisha.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Unë veç dua të them një diçka që të më kuptojnë kolegët e mi deputetë. Nuk e di, me vetëdije apo pa vetëdije kërkojnë të zvarritet ky ligj ende dhe kërkojnë me këtë zvarritje të vetëdijshme apo të pavetëdijshme të bëhen tutelë e atyre që kanë interesa të mos ketë sektori minerar ligj në Kosovë dhe të abuzojnë me minierat qysh kanë abuzuar qe 10 vjet. Dhe ju kisha lutur, çështjet për të cilat po debatohet dhe po ju duken shumë të rëndësishme se si zgjidhet kryeinspektori, si zgjidhet drejtori, se ku do të jetë Shërbimi Gjeologjik, janë çështje tepër minore karshi materies që e rregullon ky ligj dhe është i punuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Prandaj kërkoj mirëkuptim nga kolegët e mi deputetë të mos dëgjohen zëra të tillë që të shtyhet ky ligj m tutje, ngase ky ligj sot duhet të përfundojë, ta marrë miratimin e kësaj seance.

Mua më lejoni edhe një herë të bëj arsyetimin se u dëgjua nga dikush se është ribërë dhe kur të ribëhet ka mundësi që të ketë lëshime të padëshirueshme. Ky ligj është aq voluminoz, përfshin segmente që kishin mund të rregullohen me ligje të veçanta, hulumtimet minerare, shfrytëzimet minerare me ligj të veçantë, licencimi me ligj të veçantë, Komisioni i pavarur me ligj të veçantë, Shërbimi gjeologjik me ligj të veçantë, të gjitha këto që i përmenda janë të inkuorporuar në këtë ligj, prandaj edhe ka dalë shumë voluminoz, jo për fajin e Qeverisë a ku ta di unë, në qoftë se ka pasur diktat më herët, derisa ka ardhur ky ligj në Kuvend ju lutem kolegë deputetë jemi përfaqësues të qytetarëve tanë dhe të jemi pak më serioz në këto çështje shumë serioze, shumë jetike për Kosovën.

Unë kërkoj që mos të lejohet të zhvillohet më debat në lidhje me këtë ligj, por t'i hyjmë procedurës qysh i kemi hyrë edhe ligjeve tjera. Pra, në lexim të dytë nuk ka debat, prandaj është e çuditshme kjo punë pse lejohet debati pikërisht në këtë ligj dhe lejohet në ato çështje që janë tepër minore karshi asaj se çka rregullon ky ligj?

Edhe një herë kërkoj që të procedohet, të shkojmë amendament për amendament, çështjet për të cilat dikush tha këtu duhet t'i kthehet Komisionit, të merret vesh, janë çështje tepër minore, për ata janë edhe amendamentet, është edhe projektligji dhe deputetët të përcaktohen a dëshirojnë t'i votojnë amendamentet e Komisionit apo donë të votojnë draftligjin që e ka sjell Qeveria. Janë dy zgjidhje dhe ai që merr votë më shumë le të shkojë.

Edhe një herë kërkoj që të procedohet e jo të shtyhet. Është tepër e dëmshme dhe tepër joserioze, është një mesazh jashtëzakonisht i keq që i dërgohet qarqeve të caktuara që nuk ia dëshirojnë të mirën Kosovës dhe segmentit të minierave, mesazh i keq që i dërgohet pikërisht nga ky tempull që nuk do të duhej të ishte ashtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë konsideroj që ligjet nuk miratohen as për opinione as për Qeverinë, as për komisionet, as për Parlamentin, por ligjet miratohen për të funksionalizuar shtetin dhe në rregull edhe kjo është pjesë e funksionalizimit të shtetit dhe nuk jemi ne të parët që po zbulojmë diçka. Ligji për miniera është gjithkund, në rajon kemi ligje për miniera dhe është shumë e lehtë, por kur domi ne me i ndryshuar dhe me i prish ligjet ne krijojmë këto situatash.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Bahri Hyseni, prapë e ka kërkuar fjalën.

BAHRI HYSENI: Zoti kryesues,

Pa dashje, do të jem shumë i shkurtër, sepse s'kemi nevojë të bëjmë shumë debat. Ne po flasim, sinjerisht, a dëshirojmë ta respektojmë ligjin dhe Kushtetutën? Unë po pyes, nëse e emëron kryeinspektorin komisioni i Kuvendit të Kosovës apo Kuvendi i Kosovës, çfarë statusi ka ai, a është ministër, a është anëtar i bordit, a është shërbyes civil, a është këshilltar politik apo çka është?

Ne e kemi bërë të qartë rekomandimin. Komisioni parlamentar, dhe as Kuvendi i Kosovës, nuk ka të drejtë ta emërojë asnjë shërbyes civil. Shërbyesi më i lartë civil në Kosovë, me ligj është sekretari i përhershëm. Nga sekretari i përhershëm mandej mund të shkojmë kryeshefa, kryeinspektorë, e të gjithë më poshtë. Nuk është çështje e inatit, nuk është çështje.... por ne nuk kemi kohë. Unë po ju them sinjerisht nuk kam kohë si kryetar të sillem tërë ditën nëpër zyre duke më thirrur, jo nuk kemi nënshkruar, jo këtu është në kundërshtim me këtë.

Ne kemi vepruar me kohë dhe i kemi rekomanduar Komisionit me kohë. 3 amendamente të Komisionit funksional janë kundër ligjit dhe kundër përgjegjësive dhe detyrave. Ligji duhet të votohet. Kur janë këto amendamente, duhet të mos përkrahen dhe mospërkrahja e këtyre amendamenteve është krejt në rregull, sepse në projektligji nga Qeveria është shumë në rregull, atje kanë vepruar tamam konform ligjit, kush e zgjedh kryeinspektorin, si zgjidhen procedurat, kanë vepruar konform ligjit që është në fuqi.

Nuk e dimë për çka dhe kujt iu është dashur ta qesë në Kuvend dhe nëpër komisione parlamentare? Cili autoritet është ministri për t'i bërë 3 kandidatë. Unë nuk desha krejt në detale, se çfarë autoriteti është ministri për t' i klasifikuar 3 kandidatë dhe t' ia dërgojë Komisionit parlamentar? Nuk është pazar këtu. Këtu ka rregulla dhe procedura dhe duhet respektuar. Dhe nuk është dëshirë e vullnetit, po unë po pyes, nëse e votojmë kështu, a hyn në fuqi ligji? Jo, absolut, jo nuk hyn në fuqi, sepse nuk nënshkruhet dhe unë e kam një përgjegjësi, unë jam kryetar i Komisionit për Legjislacion. Mua po më thërrasin për ta thënë atë të fundit kur po ka pengesa.

Prandaj, është mirë që të vazhdojmë me procedim... Amendamentet në fjalë të mos përkrahen, janë krejt 3 amendamente dhe të vazhdojmë me procedim. Ligji le të hyjë në fuqi, sepse nuk ka... Po edhe nëse votojmë ashtu si është në projektligj, se është shumë në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues! Vërtet tashmë ne të gjithë deputetët apo Kuvendi i Kosovës është në një konfuzion të plotë për këtë ligj, pa dashur për të mohuar se ligji është i

rëndësisë së veçantë, pa dashur ta humbim punën që e ka bërë Komisioni funksional, por pa dashur as t'i mohojmë sqarimet që i jep kryesuesi i Komisionit për Legjislacion.

Domethënë, në bazë të këtyre çka na dëgjuam këtu, ky ligj nuk mund të procesohet pa asnjë problem që dikush nga këtu tha se dikush është i interesuar, unë besoj shumë që asnjë grup parlamentar në Kuvendin e Kosovës nuk është i interesuar ky ligj të mos votohet. Por, në qoftë se do ta votojmë kështu qysh u debatua deri tash, prapë nuk do ta kemi një ligj që realisht nuk guxojmë ligji të jetë apo të tangohet me vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Andaj, unë nuk po shoh që është problem i madh në qoftë se kemi pritur një vit për ta bërë një ligj të mirë, pa dashur për t'ia hedhur fajin askujt se është dashur 80% për t'u ndryshuar, pse, si e kërjt, ka ardhur ligji kur ka ardhur, tash një orë – dy komisionet mund të ulen për 3 amendamente bëhet fjalë, dhe unë pasi që e mora fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, propozoj që plus këtyre 3 amendamenteve të shqyrtohet propozimi i deputetit Driton Tali, që e përkrahim plotësisht që të jetë tek neni 26 dhënia e licencës 20 plus 20 se është shumë më mirë se sa ashtu që është në ligj dhe në amendamente. Kjo është çështje e thjeshtë që realisht, në qoftë se donë komisionet sot të ulen për të diskutuar në fund të kësaj seance, ne mund ta shtimë prapë në procedurë këtë ligj për ta votuar.

Përndryshe, kështu, Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk ka të qartë asgjë dhe realisht ne nuk votojmë një ligj i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Tali, edhe një herë, pasi të gjithë e morën nga dy herë, edhe ti merre për të dytën herë.

DRITON TALI: Po, pikërisht për atë, pasi që e morën të tjerët nga dy herë fjalën, unë edhe një herë, jo me deputeten e nderuar Besën, por me një parafolës tjetër, nuk po ia përmendi emrin për mos t'i dhënë shans për të biseduar dhe përsëri të na bëjë këtu debat.

Kërkesa ka qenë vjet, ka qenë shumë e zhurmshme, nga të gjithë ekspertët të spektrave të ndryshme, të cilët kanë kërkuar që kohëzgjatja mos të jetë 40 vjet, por të jetë 20 plus 20.

Këtu na është bërë përmirësimi 30 vjet plus 15 vjet, që nuk i paraqet kërkesat e tyre. Unë, pajtohem me këtë kërkesë dhe mendoj se është në interes të Kosovës pa e patronizuar askënd hiq. Është propozim i tyre, le të futet në shqyrtim. Kaq kisha! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministre, a pate diçka? Jo! Atëherë, si e kemi gjendjen në sallë, sepse kam përshtypje nuk kemi kuorum për të votuar tani?

Po presim pak, nëse dëshiron të vijë, nëse jo, atëherë po bëjmë pauzë. Janë 52 deputetë në sallë, nuk kemi kuorum për të votuar. Besoj se zilja duhet të bie një herë, e ndoshta kthehen.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Hajde, Ethem Çeku, edhe ti po do fjalën për të dytën herë.

ETHEM ÇEKU: Unë do të propozoja që ta marrim një pauzë. Komisioni duhet ta ketë një takim tani për një çështje të rëndësishme që ka të bëjë me agjencinë. Po ulemi së bashku me Komisionin për çështje të Legjislacionit dhe të shohim a mund t'i harmonizojmë për fillimin e mbledhjes pas pauzës.

Do të thotë, janë dërguar këto materiale, është e vërtetë, por ne mendojmë që kemi pasur të drejtë në qëndrimet tona, sepse nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën. Në qoftë se kolegë tjerë, nga Komisioni po sjellin argumente, të ulemi të diskutojmë dhe këto tri amendamente së bashku me amendamentin që e propozoi një koleg tjetër, ta harmonizojmë për vazhdimin e seancës.

KRYESUESI: Atëherë, konstatoj se nuk ka kuorum. Do të bëjmë pauzë deri në orën 16:00. A keni kohë që komisionet të takohen për t'i harmonizuar këto çështje? Nëse vini me amendamente të harmonizuara do të ishte shumë më mirë. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Edhe pse u vonuam pak, besoj që e arsyetojmë para opinionit, sepse kemi përcjell vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare. Ishte një vendim i gëzueshëm për të gjithë ne dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, prandaj më lejoni që në emër tuajin, përkatësisht të Parlamentit të Kosovës, t'i uroj të gjithë qytetarët e Kosovës për një vendim të tillë, të pritur nga ne...

(Duartrokitje)

... pra një vendim që ia garanton Kosovës të ardhmen më të mirë, të ardhmen më të sigurt dhe i garanton të gjithë qytetarët e saj për një jetë më të lumtur, për një jetë nën qiellin e Ballkanit të barabartë me kombet e tjera.

Prandaj, edhe një herë, në emrin tuaj, më lejoni që të shpreh besimin me të gjitha institucionet e Kosovës e ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Kosovën dhe të shpreh bindjen që ju si deputetë dhe të gjithë ne si deputetë, të gjitha institucionet e Kosovës do të përpiqen që në përputhje me hapat që duhet t'i marrim për interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës të punojmë me përkushtim.

Mendoj se sot atmosfera e punës në Kuvend do të duhej të ishte atmosferë gëzimi pas këtij vendimi dhe në bazë të kërkesës së shumicës nga ju, konsideroj se seanca për sot i përfundoi punimet dhe të vazhdojmë nesër në orën 10:00. Uroj që të kënaqeni sot me familjet tuaja! Faleminderit!

(Duartrokitje)

Më 26.07.2010, vazhdimi i seancës së datës 22.7.2010

Mbledhjen drejton: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar, vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 22 korrik 2010, për pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë 53 deputetë, prandaj nuk mund të vazhdojmë me pikën e tetë: - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për minierat dhe mineralet, por kryeministri i Kosovës e ka një fjalën dhe ia japim fjalën. Ndërkohë, të pranishëm kemi 58 deputetë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Më lejoni, të nderuar deputetë, që të prezantoj qëndrimin e Qeverisë sot në Kuvendin e Kosovës për zhvillimet e fundit të cilat kanë ndodhur për Kosovën.

Fillimisht, dëshiroj të theksoj se: Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare ka vulosur pavarësinë e Kosovës; Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare ka respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe vendimin për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur e sovran, të datës 17 shkurt 2008. Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare ka legjitimuar në gjithë botën pavarësinë e Kosovës. Ne kemi besuar gjithmonë në drejtësinë ndërkombëtare dhe çdo veprim e vendim politiko-juridik që e kemi marrë - gjithmonë e kemi në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe institucionet e shtetit të Kosovës do të respektojnë vazhdimisht të drejtën ndërkombëtare.

Opinionin e GJND-së ishte fitore historike për shtetin dhe popullin e Kosovës, por ishte fitore edhe për gjithë rajonin.

Ky mendim nuk është i drejtuar kundër askujt, por është në dobi të drejtësisë, paqes, stabilitetit dhe gjithë neve që jetojmë në rajon dhe më gjerë.

Opinionin e GJND-së i dha përgjigje të drejtë gjithë botës mbi të drejtën e luftës sonë për çlirim, liri dhe shtet.

Shteti i Kosovës sot është shteti më i legjitimuar në drejtësinë ndërkombëtare dhe historinë e re të krijimit të shteteve në botë.

Opinionin e GJND-së është i qartë, ashtu siç ishin të qarta përpjekjet tona për liri dhe shtet.

Ky mendim ka legjitimuar çdo përpjekje, angazhim politik e ushtarak, sakrificë individuale dhe kolektive të qytetarëve tanë gjatë shekujve për liri dhe pavarësi. Prandaj, sot, secili nga ne, por edhe secili qytetar i Republikës së Kosovës, kudo që jeton, duhet të ndihet mirë dhe krenar me këtë të arritur. Ky mendim ka vërtetuar se populli ynë ka bërë veprime të drejta, të urta, me mençuri dhe në përputhje me qasjen ndërkombëtare dhe tërësisht legale në përpjekjet tona, pa u luhatur asnjëherë se e drejta duhet të fitohet me drejtësi, me respekt dhe bashkëpunim për botën demokratike.

Ky mendim ka prekur edhe kujtesën tonë për të gjithë ata njerëz që sakrifkuan për lirinë e shtetit tonë dhe ka forcuar bindjen se rruga jonë e respektimit të drejtësisë ndërkombëtare dhe orientimit të drejtë, si vend dhe institucione, ishte e drejtë dhe se duhet të vazhdojmë me këtë bindje, këtë orientim dhe këtë punë.

Ky mendim është edhe emocional për secilin prej nesh, për secilin qytetar të Republikës së Kosovës, sepse ka forcuar bazamentin e së kaluarës sonë, por edhe ka hapur perspektivën tonë për veprime. Pra, veprimet tona do të jenë racionale dhe në koordinim të plotë me partnerët tanë.

Ky mendim rritë përgjegjësinë tonë për forcimin e shtetit tonë, për konsolidimin e tij, për trajtim të barabartë ndaj të gjithë qytetarëve tanë, për plotësim të zotimeve tona para botës demokratike të gjitha kritereve, për sjellje serioze në çdo rast që secili qytetarë ynë të jetë krenar me shtetin e Kosovës dhe bota tash e respekton me admirim duke u zhvilluar krah kombeve të botës së lirë.

Ky mendim edhe një herë respekton angazhimet tona për ndërtimin e shtetit demokratik dhe multietnik.

Duke ju përgëzuar, juve të nderuar deputetë, kabinet qeveritar dhe secilin qytetar të vendit tonë, zotohem se do të vazhdojmë të angazhohemi maksimalisht që besimin e qytetarëve dhe të botës

demokratike, legjitimitetin e drejtësisë ndërkombëtare ta shndërrojmë në punë, zhvillim për vendin, rritje të besimit nga bota dhe mirëqenien më të madhe për të gjithë qytetarët e vendit tonë dhe kontribut permanent për paqen, stabilitetin, zhvillimin e rajonit dhe të botës demokratike, pjesë e së cilës jemi.

Pra, ne kemi arritur që të fitojmë lirinë, të ndërtojmë shtetin. Tani do të vazhdojmë të bëjmë më tepër për zhvillimin ekonomik, më tepër për infrastrukturë, për edukim, për shëndetësi, për krijimin e vendeve të reja të punës, për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve tanë, me zotimin e sigurt se mendimi i opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare ka hapur perspektivë të sigurt dhe ka përshpejtuar procesin edhe për liberalizimin e vizave, për marrëdhëniet tregtare në Bashkimin Evropian dhe procesin e stabilizim-asocimit, por para se gjithash atë të integritit të shtetit të Kosovës në NATO, në Bashkimin Evropian, por edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Në të njëjtën kohë, i nderuari kryetar, të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës, dëshiroj të theksoj se gjatë kësaj periudhe edhe në vizitën time që kisha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe në takimin me zëvendëspresidentin Biden u rikonfirmua edhe një herë mbështetja e jashtëzakonshme për shtetin e Kosovës nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbështetja për progresin në Kosovë, për qeverisjen e mirë, transparente, të sundimit të ligjit, të luftës së pa kompromis kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe për vizionin tonë për ndërtimin e shtetit demokratik, multietnik dhe për ne interes nacional është gjithë territori i Kosovës dhe afirmimi i drejtave të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Dëshiroj të theksoj se edhe një herë është konfirmuar se vetëm do të afirmohet dhe thellohet bashkëpunimi ndërinstitucional në mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Është një mbështetje unike, e qëndrueshme dhe shumë e fuqishme edhe e administratës së presidentit Obama që rruga për t'u integruar në NATO, Bashkim Evropian, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Kosovën të përshpejtohet, prandaj më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës ta falënderojmë edhe një herë Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, popullin amerikan për mbështetje të jashtëzakonshme.

Ne jemi me fat që kemi partnerë dhe miq, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e Bashkimit Evropian, por edhe vendet e NATO-s. Ne do të jemi serioz në bashkëpunimin tonë edhe me vendet e Bashkimit Evropian në rrugën tonë të familjes evropiane, për t'u integruar edhe në NATO, por edhe miqësinë speciale specifike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

E ritheksoj edhe një herë, tani pas prezantimit të opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare, definitivisht pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës i ka ardhur fundi i suksesshëm. Po hyjmë në kapitullin e integritit në NATO dhe në Bashkimin Evropian dhe me autoritetin tonë sovran, kushtetues dhe ligjor. Në të njëjtën kohë, edhe një herë, në emër të Qeverisë së Kosovës, pasi që opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare i ka dhënë përgjigje më të mirë, më të drejtë gjithë botës, edhe atyre vendeve që ende janë në proces të vendimmarrjes për njohje, ftoj që ta përshpejtojnë këtë vendim dhe ta njohin shtetin e suksesshëm të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Të nderuar deputetë,

Tani kemi 71 deputetë në sallë. Kryetarja e komisionit, deputetja Myzejene Selmani e ka kërkuar fjalën lidhur me pikën e tetë të rendit të ditës: - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Përshëndetje për të gjithë!

Duke marrë parasysh punën e Komisionit parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe draftimin apo amendamentimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i cili me punën e tij janë thuaja se 76 amendamente të amendamentuara nga komisioni parlamentar në këtë projektligj dhe thuaja se një mund shumë i madh i të gjithë deputetëve të komisionit dhe stafit mbështetës, në seancën e kaluar u paraqiten disa vërejtje apo, më mirë të themi, keqkuptime të këtyre amendamenteve, duhet të bëjë të njohur për juve dhe për opinionin se te amendamenti 21, kohëzgjatja maksimale prej 30 vjetësh për licencat për shfrytëzim të mineraleve, përveç mineraleve energjetike, duhet të ju them se asnjë investitor nuk vjen në Kosovë në rast se i jepet mundësia vetëm për 20 vite të vjen dhe të investojë në sektorin e minierave dhe mineraleve. Ndërsa, te çështja e drejtorit të KPMM-së, ku u paraqitën vërejtje edhe nga Komisioni për Legjislacion, mund të them se ndoshta është një keqkuptim se nuk ka të bëjë që ne drejtorin e KPMM-së ta vëmë në seancë plenare dhe të votohet ai, mirëpo një përzgjedhje nga emrat e Qeverisë i drejtohet komisionit parlamentar dhe komisioni parlamentar prapë ia drejton Qeverisë apo Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe ne nuk do të merremi më shumë me drejtorin e KPMM-së, ndërsa çështja e kryeinspektorit, edhe këtu do të jap një sqarim. Në bazë të mbështetësve të cilët na kanë ndihmuar në amendamentimet e Projektligjit për miniera dhe minerale, kryeinspektori prapëseprapë do të zgjidhet nga KPMM-ja, me një listë dhe ajo listë do të vjen në komision parlamentar dhe prapë do t'i kthehet KPMM-së, jo komisioni parlamentar ta vendosë kryeinspektorin në seancë plenare.

E njëjta situatë do të ndodhë edhe te drejtori i Institutit Gjeologjik, ndërsa në rast se amendamentet e komisionit nuk kalojnë, atëherë mbetet e drejta e deputetëve apo deputetët me propozimet e tyre çka mendojnë për këto amendamente të cilat janë në këtë projektligj.

Esenca e gjithë projektligjit është që projektligji të kalojë sot në seancë plenare për arsye të rëndësisë së madhe që ka Projektligji për miniera dhe minerale. Të faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, i nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë, besoj, të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të gatshëm t'i votojnë amendamentet, përveç amendamentit 53, 60, 63 ku janë amendamente antikushtetuese dhe unë edhe një herë po e lexoj, po e lexoj me vëmendje dhe mos të mundohet dikush... Ne sapo e kemi një projektligj që na ka ardhur nga Zyra e presidentit, ku nuk nënshkruhet. Edhe një herë po e lexoj: Me inspektoratin e minierave udhëheq kryeinspektori, i cili i raporton Bordit të KPMM-së. Kryeinspektori emërohet nga komisioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komisionet parlamentare nuk kanë të drejtë të emërojnë askënd. Këtë autoritet e ka Qeveria e Kosovës, organet që i ka Qeveria e Kosovës, apo ministria përkatëse.

Prandaj, amendamenti që po flasim, nuk duhet të aprovohet në Kuvendin e Kosovës amendamenti 53, por edhe amendamentet e tjera. Dhe, aq më pak, nuk ka të drejtë të aprovohet që drejtorin duhet ta zgjedhë komisioni parlamentar. Edhe kjo është antikushtetuese. Dhe, nëse Kuvendi vazhdon dhe komisionet parlamentare vazhdojnë të bëjnë amendamente antikushtetuese, kjo nuk i ndihmon Kosovës, sepse sapo e kemi një projektligj që duhet edhe një herë të merremi në seancë plenare dhe

autoriteti i Komisionit për Legjislacion nuk do të lejojë asnjë amendament i cili bie në kundërshtim me Kushtetutën. Shumë mirë është në projektligj, vetëm nuk e votojmë amendamentin në komisionet parlamentare. Në projektligj është e rregulluar tamam me dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi, me Ligjin e shërbimit civil, me rregullat për mënyrën e zgjedhjes dhe përzgjedhjes së shërbyesve civilë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Deputetë, përgatituni për votim. Votojmë amendamentin e parë. Në sallë kemi 82 deputetë.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

“Për”, kanë votuar 61 deputetë, 1 “kundër”, 5 abstenime, kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 5 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Me 45 vota “për”, 2 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 2 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Në sallë kemi 82 deputetë, që do të thotë do se nuk janë duke votuar të gjithë.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Me 51 votë “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Në sallë janë tash 83 deputetë.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, 3 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

Me 46 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 10 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Votojmë tash:

Me 58 votë “për”, asnjë “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 2 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 2 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41.

Votojmë tash:

Me 62 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44.

Votojmë tash:

Me 65 votë “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 3 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 46.

Amendamenti 47.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48.

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50, i ka dy propozime:

a) Propozimin e komisionit funksional, dhe

b) Propozimin e deputetes Sala Berisha-Shala, pa përkrahjen e komisionit funksional.

A ka koment tjetër këtu? Nuk ka.

Urdhëroni! Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëndetje, kabinet qeveritar!

Përsëndetje, kryeministër!

Kolegë deputetë,

Nëse e analizoni me vëmendje, amendamentin 50, përkatësisht që ka të bëjë me nenin 63 – zgjedhja e drejtorit të KPMM-së, ne kemi zhvilluar debate të gjata në komision dhe në grup punues dhe gjatë spastrimit të tekstit gati se është i njëjtë amendamenti edhe i komisionit edhe propozimi im me draftligjin që e ka sjellë Qeveria, andaj ju thërras ta votoni! Ta votoni draftin e Qeverisë dhe është gati i njëjtë dhe nuk e di se si është përvjedhur në spastrim, por janë të njëjta dhe e votoni draftin e Qeverisë.

KRYETARI: Deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Jo, mendoj që nuk është asnjë pengesë. Mund të vazhdojmë me votim të amendamenteve dhe le të përcaktohen deputetët lidhur me këtë se a e votojnë amendamentin e komisionit funksional, apo të Salës. Nuk ka asnjë pengesë. Është përafërsisht si në Projektligj, i ka do ndryshime, s’vlen për t’u marrë...

KRYETARI: Atëherë, vazhdojmë me votimin e propozimit të komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 41 votë “për”, 12 “kundër”, 13 abstenime, miratohet amendamenti i komisionit funksional.

Sipas Rregullores, duhet të votojmë edhe për amendamentin... Atëherë, vazhdojmë.

Tash votojmë amendamentin 51.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 51.

Amendamenti 52.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 1 “kundër”, 11 abstenime, miratohet amendamenti 52.

Amendamenti 53, që i ka dy variante:

U diskutua për këtë variant, mendoj se varianti i komisionit funksional sipas kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin e shërbimit civil. Megjithatë, ne po vazhdojmë votimin.

a) është varianti i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 16 votë “për”, 47 “kundër”, 8 abstenime, nuk miratohet varianti i komisionit funksional.

Tash votojmë propozimin e deputetes Sala Berisha-Shala. Fjalën e ka deputetja Salë Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Ndoshta ka qenë mirë të ma kishit dhënë fjalën në fillim, para se të futemi në votim, se unë tërhiqem nga amendamenti im dhe e mbështes draftin që e ka sjellë Qeveria, ashtu edhe e kam votuar, s’ka nevojë të hidhet në votim fare amendamenti.

KRYETARI: Pra, mbetet varianti i Qeverisë, jo i komisionit: teksti i ligjit për amendamentin 53.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit 54.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 2 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 54.

Amendamenti 55.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 55.

Amendamenti 56.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 56.

Amendamenti 57.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 57.

Amendamenti 58.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 58.

Amendamenti 59.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 59.

Amendamenti 60, kemi dy variante:

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

E kemi të njëjtën situatë, domethënë amendamenti është antikushtetues. Nëse e lexojmë paragrafin 3 të amendamentit, thotë: “Instituti udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv, i cili i raporton ministrit. Drejtori ekzekutiv emërohet nga Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Ekonomi, Tregti dhe Industri”, mandej, më vonë vazhdon prapë, thotë: “E gjithë procedura duhet të shkojë përmes shpalljes publike. Ministria i propozon komisionit, komisioni për zgjedh njërin nga kandidatët”, prandaj propozoj që ky amendament të mos aprovohet.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Salë Berisha-Shala.

SALË BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Këtu kisha pasur dëshirë ta kemi pak vëmendjen e kolegëve deputetë, sepse ky amendament është i riformuluar tërësisht edhe nga komisioni parlamentar, por edhe amendamenti të cilin e kam ofruar në këtë raport. Ka të bëjë me Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Amendamenti im ka dallim nga amendamenti i komisionit në dy çështje, edhe te zgjedhja e drejtorit të Shërbimit Gjeologjik, që është në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit civilë, siç e ka ofruar komisioni parlamentar, po ndryshimi është edhe tek emërtimi i këtij institucioni.

Prandaj, unë do të përpiqem të jap një arsyetim lidhur me amendamentin tim. Sa i përket emërimit, ka të bëjë më tepër me çështjen profesionale – emërimit të institucionit, ndërsa ajo që ka të bëjë me emërtimin e udhëheqësit të këtij institucioni, ka të bëjë më tepër se është në kolizion me ligjin, siç e ceka më lart.

Prandaj, unë kërkoj nga kolegët e mi deputetë që ta votojnë amendamentin tim, sepse dikush mund të thotë se nuk ka dallim shumë emri – Shërbim Gjeologjik, nga ai Institut Gjeologjik që e ka ofruar komisioni, mirëpo unë këtu e kam një arsyetim që e kam nxjerrë edhe nga vendet në rajon se si e kanë të rregulluar këtë çështje, këtë institucion. Nëse jeni të interesuar, unë do ta lexoj edhe arsyetimin, por debati që u zhvillua në komision parlamentar i është bashkëngjitur edhe raportit, të cilin e kanë të gjithë deputetët përpara.

Prandaj, është një dallim, pothuaj se esencial në mes të Shërbimit Gjeologjik dhe Institutit të Gjeologjisë, sepse institutet zakonisht janë profile që kanë të bëjnë tërësisht me çështje shkencore-profesionale, ndërsa Shërbimi Gjeologjik, për të cilin ka nevojë Kosova dhe i ka munguar një kohë të gjatë, ka të bëjë edhe me çështje tjera praktike që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me punën në terren rreth hulumtimeve të pasurive nëntokësore.

Kërkoj që të hidhen në votim amendamentet dhe kërkoj që seanca të mbështes amendamentin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se t’ia japim fjalën deputetit Ethem Çeku, dua të them se ne e kemi votuar amendamentin 58. Edhe pse ndoshta është më mirë këtë që e tha, por e kemi votuar si institut, në amendamentin 58. Pjesa tjetër e amendamentit mund të jetë në rregull, por sa i përket emrit, mendoj që këtu duhet ta bëjmë një korrigjim. Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, kryetar!

Ju e shihni se janë 74 amendamente, do të thotë është rishikuar ligji. Nuk e ndajmë edhe një herë opinionin me kolegun që tha se është në kundërshtim me Kushtetutën, zgjedhja kyç në këto institucione, sepse një ligj mund t’i rregullojë disa çështje të cilat nuk janë të parapara me një ligj tjetër, mirëpo ato çështje përfunduan. Mendoj se ndoshta tani më nuk kemi alternativë edhe tek drejtori i institutit, duhet të mbesim në propozimet që kanë qenë më herët. Mirëpo, mendoj që jemi

duke e dëmtuar aspektin e funksionimit të këtij ligji dhe aspektin e funksionimit të minierave, në përgjithësi, përmes disa ndërhyrjeve të cilat po thuhën në emër të rregullit që ka të bëjë me Kushtetutën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas gjasave, është më mirë të mbetet varianti i propozuar, megjithatë ne duhet të shkojmë në votim. Më falni, fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, kërkoj falje. Ne kërkuam edhe më herët, pikërisht për të bërë dallimin. Sinqerisht, është për të ardhur keq ky konfrontim me standarde të komisionit funksional dhe të gjithë asaj që na krijojnë konfuzitet edhe vetë këtu me këto amendamente, ku pa marrë parasysh, po shihet qartë se ka ekzistuar mospajtimi edhe në aspektin profesional, ndoshta, duke u thirrur në gjëra të ndryshme, prandaj është mirë që kjo praktikë mos të paraqitet dhe ne të kemi kesi lloj kundërshtimesh.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Në shërbim të kësaj, zoti kryetar, mendoj se zgjidhja që është ofruar nga vetë projektligji është zgjidhja më e mirë dhe si e tillë duhet të pranohet. Vetë fjala e emërimit të këtij shërbimi në institut, institutet zakonisht janë jashtë çdo shërbimi, çdo mekanizmi tjetër dhe çdo institucioni tjetër dhe, si i tillë, shërbimi gjeologjik në këtë rast, sipas ligjit, është në kuadër të Ministrisë së Minierave dhe të Mineraleve, prandaj si i tillë emërtimi duhet të jetë shërbim gjeologjik, ndoshta në të ardhmen me mundësi të shndërrimit në një institut të veçantë, që do të jetë jashtë të gjithë mekanizmave dhe në këtë formë duhet të shkojë, prandaj nuk di pse të gjitha këto diskutime. Po, edhe një dua të them, mos të krijojmë precedencë me emërtime të drejtorëve. Ne kemi emëruar një bord të minierave dhe mineraleve dhe ka të gjithë kompetencën e vet bashkë me Ministrinë për përzgjedhjen e gjithë stafit tjetër të vet përkatës për funksionimin e këtyre shërbimeve.

Idea e njerëzve që gjithçka të kalojë nëpërmjet Kuvendit nuk është ide e mirë dhe nuk është praktikë e mirë as parlamentare dhe as politike, prandaj duhet të lirohem prej kësaj dhe, po e them, është mendim imi personal, opozita sikur është kah mendon se gjithmonë do të jetë opozitë dhe të bëjë ligje vetëm për sa i përket asaj që të bëjë

KRYETARI: Pa komente politike! Shikoni, ne e votuam amendamentin 58. Jo, më fal, mund ta merrni pastaj fjalën. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës zëvendësohet me Institutin Gjeologjik të Kosovës. Ky ndryshim vlen në tërë tekstin e ligjit. Ne e kemi votuar amendamentin 58. Prandaj, pse nuk keni folur kur kemi qenë te amendamenti 58? Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Në të kaluarën, në kuadër të KPMM-së ekzistonte Shërbimi Gjeologjik. Ekziston Shërbimi Gjeologjik dhe duhet të edukojmë dikë, i cili nuk e di që ekziston. Ekziston Shërbimi Gjeologjik, mirëpo është kërkuar për shkak se ka filluar, e kemi zhveshur Ministrinë, është zhveshur Ministria nga kompetencat, kemi kërkuar që Shërbimi Gjeologjik të rikthehet dhe të shndërrohet në një institut brenda Ministrisë. Kjo është e para.

Sa i përket asaj se a po mendon opozita, unë nuk dua të lëshohem në këtë koment politik, por duhet të theksoj se dy nga mekanizmat më të rëndësishëm, siç është Inspektorati i Minierave dhe kryeinspektori duhet të ishin institucione të pavarura, tërësisht të pavarura, mirëpo ne kemi bërë kompromis në hartimin e këtij projektligji apo në amendamentin, duke e shndërruar në pjesë të bordit dhe kemi kërkuar që kryeinspektori të emërohet për shkaqe të rëndësishme të madhe që ka në

ketë drejtim nga ana e Parlamentit, që me fushën e minierave Parlamenti ta ketë hapësirën e vet, mirëpo shihet që nuk ekziston një disponim i tillë, por jo nga ai koncepti dhe bindjet politike.

KRYETARI: Emërtimi ka mbetur - institut. Ai mbetet sipas ligjit, prandaj mendojmë se vlen e njëjta gjë sikur për amendamentin paraprak, që s'e votuam as variantin a) as variantin b) dhe më së miri e lëmë me ligj.

Votojmë tash, variantin a).

Me 14 vota “për”, 38 “kundër”, 11 abstenime, nuk miratohet amendamenti, varianti a).

Edhe variantin b) e qesim në votim, por për Shërbim Gjeologjik e kemi votuar. E vë në votim, por pa emërtimin, pa paragrafin 1. Ju mund ta votoni kundër, o burra. Atëherë, e votojmë edhe variantin b).

Votojmë tash:

Me 8 vota “për”, 45 “kundër”, 12 abstenime, nuk miratohet as varianti b). Mbetet sikur ka qenë në ligj, me përjashtim të emërtimit që mbetet Institut dhe ne e kemi votuar atë.

Amendamenti 61.

Votojmë tash:

Me 40 votë “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 61.

Vazhdojmë me votim.

Amendamenti 62.

Votojmë tash:

Me 45 vota “për”, 8 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 62.

Amendamenti 63.

Votojmë tash:

Me 36 vota “për”, 8 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 63.

Amendamenti 64.

Votojmë tash:

Me 47 vota “për”, asnjë “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 64.

Amendamenti 65.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 65.

Amendamenti 66.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 66.

Amendamenti 67.

Votojmë tash:

Me 51 votë “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 67.

Amendamenti 68.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 68.

Amendamenti 69.

Votojmë tash:

Me 51 votë “për”, 2 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti 69.

Amendamenti 70.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 70.

Amendamenti 71.

Votojmë tash:

Me 48 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 71.

Amendamenti 72.

Votojmë tash:

Me 47 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 72.

Amendamenti 73.

Në sallë kemi 70 deputetë.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 73.

Amendamenti, i fundit, 74.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 74.

Tash, të përgatiten deputetët dhe regjia, votojmë Ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, miratohet Ligji për miniera dhe minerale.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektorin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese

Këtu nuk kemi amendamente të kontestuara, kështu që shkojmë më lehtë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Inspektorin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Shkojmë drejtpërsëdrejti. Më duket s’ka të interesuar për të kundërshtuar. Tash votojmë amendamentin e parë.

Amendamenti 1.

Me 47 vota “për”, asnjë kundër, 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Votojmë amendamentin 2.

Votojmë tash:

Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

Konstatohet se me 51 vota “për”, 1 abstenim dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Në sallë janë prezent 62 deputetë.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Votojmë amendamentin 7.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 2 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Me 51 votë “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Në sallë janë prezent 61 deputetë.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Votojmë amendamentin 12.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Me 51 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 51 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryesues!

Kolegë të nderuar,

Angazhohem për t’u miratuar amendamenti 16 vetëm me këtë plotësim, nëse konsiderojnë deputetët e respektuar. Meqenëse është propozuar me vend që nga fillimi që mos të quhet “vendim” por “aktvendim”, sepse aktvendimi është akt juridik administrativ që miratohet nga individ, jo nga organi kolegjial dhe kudo dhe kurdo do të duhej të përdorej jo “padi” se padi është kuptimi juridik-material, por “akt padi” sepse e ka kuptimin juridik-formal, sikur që është akt padia, aktakuza, aktgjykimi, aktvendimi dhe do të ishte shprehje koherente me aktvendimin dhe akt padinë. Pra, angazhohem që paragrafi 4 i amendamentit 16, në mes aty, ku parashtrohet “padi” të thuhet “akt padi” dhe të miratohet me këtë plotësim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Ne edhe ashtu duhet ta votojmë amendamentin në versionin si është dhe pastaj nëse ka, domethënë, ju dëgjuat deputetin Smaka dhe e ka një ndryshim të vogël te paragrafi 4, mirëpo ne e hedhim pa këtë ndryshim, fillimisht për votim. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për të votuar tash.

Konstatohet se me 43 vota “për”, 10 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 16, pa propozimin e sapo paraqitur të deputetit Smaka, kështu që konsideroj se nuk kemi nevojë ta hedhim në votim propozimin.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Nekibe Kelmendi, për një sqarim.

NEKIBE KELMENDI: Sa për transkript, duhet të hiqet fjala juaj “fillimisht” sepse kemi amendamentin dhe e votojmë amendamentin. Tash sikur kemi një obligim tjetër që të votohet edhe diçka tjetër. Prandaj, tërhiqeni fjalën “fillimisht” dhe mbetet krejt në rregull.

KRYESUESI: Po, nuk kishim amendament me shkrim. Ke të drejtë ndoshta, që ne thamë së pari, po ishte një propozim aty për aty që po të merrnim.... Jo, e kam edhe unë sqarimin tim. Po të merrnim më pak vota për propozimin e dhënë dhe të mbeteshin më shumë vota “kundër” versionit të parë, ne do ta hidhnim, prandaj fillimisht ne e hodhëm atë dhe meqë nuk pati mundësi që të hidhet edhe propozimi i deputetit Smaka, do të thotë ka sens që thoni ju, mirëpo unë kështu duhej ta thosha patjetër, nuk e tërheq fjalën “fillimisht”.

Vazhdojmë me amendamentin 17.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Tash jo “fillimisht”, sepse s’kemi pse!

Faleminderit!

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, u miratua amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 48 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër” u miratua edhe amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë kundër, u miratua amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 48 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, u miratua amendamenti 20.

Votojmë amendamentin e fundit, 21.

Votojmë tash:

Para se të votojmë tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, ju njoftoj se në sallë janë 65 deputetë.

Konstatoj se me 51 “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 21.

Tani votojmë për tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Unë e kam para veti, versionin shqip.

Konstatoj se me 53 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e dhjetë:

10. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009

Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Raportin e Punës së Avokatit të Popullit për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009, dhe ka paraqitur Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim.

Me kërkesë të komisionit funksional, Kryesia e Kuvendit ka vendosur të ftojë Avokatin e Popullit, zotin Sami Kurteshi, për paraqitjen e raportit vjetor të punës. E ftojmë zotin Kurteshi, Avokatin e Popullit, që të marrë fjalën.

AVOKATI I POPULLIT SAMI KURTESHI: Mirëdita! I nderuari, zoti kryesues,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Duke iu falënderuar për ftesën e bërë nga ana e Kuvendit, kam kënaqësinë që për herë të parë t'ju prezantoj raportin vjetor 2008-2009, i cili paraqet punën, aktivitetet, arritjet e vështirësitë e institucionit të cilin unë drejtoj. Gjithashtu, ky raport paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes të respektimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut në Kosovë për periudhën të cilën e mbulon.

Miratimi i Ligjit të Avokatit të Popullit, edhe pse jo i përsosur, është një shtesë shumë e mirë dhe një veprim i drejtë, i shumëpritur dhe i domosdoshëm.

Më shumë se një përmbushje e obligimit kushtetues, ky veprim i Kuvendit dëshmon qartë për qasjen e institucionit më të lartë shtetëror ndaj të drejtave të njeriut.

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, miratimi i Kushtetutës është kumti më inkurajues dhe më shpresëdhënës për të drejtat e njeriut, që kanë dhënë ligjvënësit kosovarë.

Se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Republikën e Kosovës nuk janë vetëm fjalë kurtuazie, por paraqesin edhe bazën e rendit juridik të saj, këtë e dëshmojnë jo vetëm mishërimi normativ i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut duke i bërë ato norma kushtetuese, por edhe ngritja në kategori kushtetuese, si dhe funksionalizimi ligjor e teknik i institucionit që garanton dhe atij që mbron të drejtat e njeriut - Gjykatës Kushtetuese gjegjësisht Institucionit të Avokatit të Popullit.

Raporti që keni para jush, është i nënti me radhë dhe përfshin periudhën kohore 1 korrik 2008 – 31 dhjetor 2009. Pra, një periudhë kalendarike prej një vit e gjysmë, të ndarë në dy periudha statistikore, që përbëjnë një urë logjike për krahasime statistikore.

Periudha e parë është 1 korrik 2008 – 31 qershor 2009 dhe periudha e dytë raportuese 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2009.

Aktivitetet, statistikatat dhe të dhënat e paraqitura në periudhën raportuese mundësojnë krahasimin dhe vlerësimin e gjendjes me raportet e periudhave të mëparshme.

Ky raport përbëhet nga 8 kapituj, pas pjesës hyrëse dhe prezantimit të misionit të institucionit, kapitulli i 3-të përbën thelbin e raportit ku paraqitet analiza e situatës së të drejtave të njeriut sipas radhitjes së kapitullit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në vijim, kapitulli i 4-të paraqet rekomandimet e Avokatit të Popullit, kurse në kapitullin e 5-të dhe të 6-të janë pasqyruar aktivitetet dhe bashkëpunimi që Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur me institucione të ndryshme në nivel lokal, qendror e ndërkombëtar.

Një pjesë integrale e këtij raporti është dhe kapitulli i cili prezanton në mënyrë statistikore mënyrën si janë trajtuar rastet e të drejtave të njeriut nga institucioni.

Ky raport ka ngjashmëri me raportet e mëparshme dhe paraqet një vazhdimësi të punës së institucionit, kur është fjala për përmbajtjen lëndore. Të drejtat e njeriut dhe mirë ose keq-qeverisja janë dy qëllimet kryesore të mandatit të institucionit.

Ky raport dallon nga raportet e mëparshme në aspektin konceptual, ngase:

Së pari, temat në raport janë paraqitur sipas radhitjes së tyre në kapitullin e dytë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe thelbi i raportit është në përputhje të plotë me të. Raporti paraqet një

analizë kritike të çështjeve të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Së dyti, raporti është rezultat i punës të të gjithë bashkëpunëtorëve të institucionit, prandaj edhe të metat, dobësitë, por edhe të mirat dhe anët pozitive janë fryt i punës dhe përpjekjeve të përbashkëta.

Së treti, edhe pse Republika e Kosovës nuk është anëtare e Këshillit të Evropës si dhe nuk ka qasje në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut – Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përmbajtja e Kapitullit të dytë të Kushtetutës dhe të drejtave dhe lirive themelore individuale dhe kolektive të shpërndara nëpër kapitujt e tjerë të Kushtetutës, përkon plotësisht me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Në këtë kontekst, mënyra e trajtimit dhe e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, siç paraqiten në raportin në fjalë, është në përputhshmëri të plotë me kriteret e vendosura nga Këshilli i Evropës.

Marrja e obligimeve të njëanshme nga Republika e Kosovës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ashtu si ka bërë në Kapitullin II të Kushtetutës, dhe sidomos me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që garanton interpretimin sipas vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë obligime shtesë dhe të rënda, por janë të dobishme.

Natyrisht, Institucioni do të dëshironte dhe i inkurajon ligjvënësit kosovarë që sa më shpejtë, listës së instrumenteve ndërkombëtare të numëruara në nenin 22 të Kushtetutës t’ia bashkëngjisnin edhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe me këtë të plotësojnë rrethin e plotë të instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Raporti vjetor 2008-2009 është një pasqyrim i gjendjes, por edhe i ndryshimeve në fushën e të drejtave të njeriut, në mbrojtjen dhe promovimin e tyre brenda periudhës raportuese.

Gjithsesi, duhet pasur parasysh se raporti nuk paraqet gjendjen aktuale, përkatësisht periudhën 7 mujore të këtij viti që e lëmë pas. Prandaj, mund të kuptohet edhe frustrimi i atyre që mund të presin që Avokati të trajtojë temat dhe problemet aktuale, të nxehta. Këtë nuk e bën Avokati i Popullit pasi kjo nuk përkon me misionin e institucionit.

Avokati i Popullit në plan të parë ka, krahas mbrojtjes nga shkeljet aktuale, edhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Në plan të dytë vazhdon të mbetet përgatitja dhe ngritja e vazhdueshme profesionale e të punësuarve në institucionin e Avokatit të Popullit, sepse vetëm një staf i përgatitur mirë profesionalisht mund të përmbushë misionin e vet në mënyrë të denjë.

Në plan të tretë është stabilizimi dhe zhvillimi institucional dhe material i institucionit të Avokatit të Popullit. Pas zgjedhjes së Avokatit të parë vendës, vitin e kaluar, një hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim është bërë këto ditë me miratimin e ligjit për institucionin.

Nga afër 1300 raste të paraqitjes së ankesave në institucion, numri më i madh i tyre ka të bëjë me gjyqësorin dhe sistemin e drejtësisë. Në bazë të ankesave të paraqitura nga qytetarët, pas gjyqësorit radhiten Qeveria, komunat, Policia, Agjencia e Privatizimit, si dhe institucionet tjera për të cilat ka më pak ankesa.

Vihet re numri në rritje i qytetarëve të cilët duke mos pasur apo duke humbur krejtësisht besimin në sistemin e drejtësisë, gjegjësisht tek gjyqësori, drejtohen tek institucioni i Avokatit të Popullit për zgjidhjen e çështjeve të tyre.

Do të dëshiroja të theksoja edhe një herë se Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi. Ky është misioni vetëm i gjykatës, e këto dy institucione kanë rol e funksione qartësisht të ndara nga njëri-tjetri.

Avokati i Popullit, sipas mandatit kushtetues, në rastin më të mirë mund të japë rekomandime në rast të keqadministrit të çështjes, por nuk ndërhyjnë në asnjë fazë të procesit gjyqësor.

Brishtësia ose problemet në funksionimin e gjyqësorit, si njëri nga tri shtyllat themelore të shtetit ligjor, mund të ketë pasoja jashtëzakonisht të rënda për çdo shoqëri dhe shtet, veçanërisht për shoqërinë kosovare, që është në fazën e shtet-ndërtimit.

Një shoqëri mund të ndërtojë shtet vetëm nëse i beson atij. Qytetarët i besojnë shtetit, vetëm kur të binden në drejtësinë e tij.

Bazuar në ankesat e qytetarëve dhe bisedat me ta, shumë brengosës është fakti i humbjes së besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Me të drejtë! Nëse ajo nuk është e drejtë për të gjithë.

Drejtësia nuk është e drejtë për të gjithë, nëse ka vetëm edhe një rast të vetëm që nuk i bindet asaj, ngase është mbi të, është mbi ligjin!

Besimi në drejtësinë do të kthehet vetëm kur askush të mos jetë mbi ligjin dhe secili prej nesh do të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë t'i vazhdohet mundësia për diskutim.

AVOKATI I POPULLIT: Faleminderit, shumë zoti kryesues! Kam edhe për një minutë.

Në përfundim të fjalës time e bazuar në raportin e paraqitur, do të doja të theksoja dhe një herë faktin se në Republikën e Kosovës konstatohen ende shkelje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga institucionet publike. E kjo gjendje shqetësuese kërkon një angazhim të përbashkët për të minimizuar e mënjeluar këtë fenomen.

Zoti kryesues,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke mbetur me shpresë se ne si qytetarë, institucioni që unë drejtoj dhe ju, si përfaqësues të organit më të lartë ligjvënës, do të punojmë së bashku për të fuqizuar bazat e një shoqërie demokratike ku zbatohen e respektohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, unë Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të deputetëve, falënderojmë zotin Sami Kurteshi, Avokat i Popullit për raportin e punës njëvjeçare të institucionit të tij.

Tash hapim diskutimin lidhur me raportin. Sipas radhës, kryetari i komisionit funksional apo raportuesi i komisionit. Këtu janë paraqitur disa. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, më duket në emër të komisionit.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, zëvendëskryeministër, ministër,

Kolegë deputetë,

Mendoj që është me shumë rëndësi sot që Parlamenti i dha fjalën Avokatit të Popullit për njërën ndër çështjet më të mëdha që sot po ashtu e tangon shoqërinë tonë. Ky ishte edhe mendimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut të këtij Parlamenti në ditën kur patëm debatin dhe dëgjimin publik lidhur me raportin vjetor, rëndësinë, peshën e madhe që ka fjala e Avokatit, mesazhi dhe porosia e tij se çfarë është gjendja dhe zhvillimet aktuale kur janë në pyetje liritë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë.

Prandaj, edhe kërkesa jonë që Avokati t'i drejtohet Parlamentit, që bazohet në Kushtetutë, ne e çmojmë, pra edhe vlerësimin e Kryesisë që sot i mundësoi Avokatit të Popullit në foltore t'i drejtohet qytetarëve dhe këtij Parlamenti për të shprehur përmes raportit vlerësimin, qëndrimin dhe punën e madhe që ka bërë Avokati, gjegjësisht çfarë është gjendja aktuale e zhvillimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Nisur nga fakti se edhe në procesin e integritetit të vendit tonë, njëra ndër çështjet, qoftë në Raportin e progresit, qoftë në udhëtimin tonë të mëtutjeshëm drejt Evropës janë liritë dhe të drejtat e njeriut, një sfidë shumë e madhe për institucionet, një sfidë shumë e madhe për shoqërinë, prandaj mendoj se kujdesi më i madh duhet t'i kushtohet realizimit të atyre rekomandimeve, të atyre porosive dhe të atyre objektivave që i ka shtruar Avokati i Popullit për institucionet.

Ishte një paraqitje e Avokatit, të cilin ne e mbështesim dhe mendoj se e gjithë ajo që u tha në foltore nga vetë Avokati i Popullit flet shumë për punën e madhe dhe për gjendjen aktuale, gjegjësisht për mesazhet dhe porositë që kanë të bëjnë me rekomandimet, që i tha vetë.

Për të mos i përsëritur disa nga çështjet themelore, ne nga ajo përmbledhje që është dhënë në tabelat në fund të raportit kemi parë se pasqyrojnë, gjegjësisht tregojnë se cilat institucione në Kosovë i respektojnë apo nuk i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, prandaj nga kjo dalin edhe porositë për vetë emrat e atyre institucioneve dhe përfaqësuesve se duhet të punojmë shumë më shumë në mënyrë që t'i përmbushim së paku ato minimumet e standardeve të cilat kërkojnë për t'u respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut.

Po ashtu, brenda vetë raportit ju keni parë se në cilat fusha cenohen liritë dhe të drejtat e njeriut, në të cilat përmbushen dhe unë mendoj që mbështetja nga ana e Komisionit për të Drejtat e Njeriut është e plotë për Avokatin e Popullit, për rekomandimet, për objektivat që të arrihen në këtë sferë.

Po ashtu, shfrytëzoj rastin që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike t'i japim përkrahje të plotë këtij raporti në mënyrë që realisht institucionet të përmbushin edhe misionin e tyre në realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në pajtim me atë çka e tha vetë Avokati i Popullit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, fjalën e ka deputeti Haki Shatri, por si duket nuk e do fjalën.

(Ndërrhyrje)

Jo, jo. Raportin e Avokatit të Popullit e ka mbështetur edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, prandaj është e udhës që edhe ai, nëse e do fjalën, t'i jepet fjala. Mirëpo, meqë nuk e ka kërkuar fjalën askush në emër të komisionit....

(Ndërhyrje)

Mirë, tash jeni paraqitur lidhur me këtë dhe e ka fjalën Gani Koci.

GANI KOCI: Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike ka të bëjë me raportet e audituara të të gjitha institucioneve. Për pasqyrat financiare, të gjitha raportet e institucioneve tjera është Komisioni për Buxhet dhe Financa, në këtë rast dhe në qoftë se kemi të bëjmë me raportin e audituar atëherë vërtet... Unë jam edhe anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare, por kryetari duhet ta ketë fjalën rreth kësaj dhe të mos ngatërrohen pikat rreth kësaj çështjeje. Ne kemi të bëjmë me raportin e përgjithshëm të punës, me raportin e punës që përfshin edhe pasqyrat financiare dhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka pasur në dorë këtë raport dhe i ka dhënë vlerësimet e veta, sigurisht që i keni rekomandimet dhe ka një mendim të përgjithshëm të Komisionit për Buxhet dhe Financa që për sa i përket buxhetit të Zyrës së Avokatit të Popullit, këtu edhe Qeveria, edhe Kuvendi i Kosovës duhet të jenë shumë të kujdesshëm në mënyrë që vërtet në aspektin financiar të mos kenë pengesa në funksionimin dhe kryerjen e përgjegjësiave edhe kushtetuese, edhe ligjore që i ka si institucion.

KRYESUESI: Faleminderit! E keni edhe ju për të njëjtën... Desha të jap një sqarim se mund të jetë gabim nga hartuesi, nga Sekretaria e Kuvendit që e ka ngatërruar komisionin. Përndryshe, unë kështu e kam përpara, do të thotë para veti. Dhe, unë e lexova atë që e ka përgatitur Sekretaria. Tash, nëse e keni fjalën për të njëjtën çështje, nuk mendoj se ka nevojë për debat më shumë. Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa kryetari e dha mendimin dhe mund të kalojmë.... Urdhëroni, zonja deputete! E ka fjalën deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryesues!

Unë kam edhe autorizim në emër të kryetarit për Mbikëqyrje të Financave, meqenëse ai mungon sot dhe e ka arsyetuar mungesën e tij, të flas në emër të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave për çështje që sot do të debatohen në Kuvend.

Sidoqoftë, unë do të ngre ndoshta një shqetësim apo vërejtje timen personale sa i përket çështjes së trajtimit të raporteve nga institucioni i Avokatit të Popullit. Kemi pikën 10, ku thotë – Shqyrtimi i Raportit të Punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009, dhe pika 14 thotë – Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009. Sikur këtu, zoti kryesues, i është vë më tepër theksi raporteve se sa vetë institucionit të Avokatit të Popullit. Këto dy pika është dashur të trajtohen si një pikë e përbashkët, sepse edhe çështja është dashur ta marrë.... debati është dashur të shkojë në këtë frymë. Fillimisht, debatohet për punën që ka paraqitur Avokati i Popullit, mandej përfundimisht debatohet për çështjet financiare dhe raportet financiare që i ka bërë auditori. Në këtë mënyrë, si një qasje e ndarë, mendoj se nuk i bën nder edhe Avokatit të Popullit, sepse i është kushtuar vëmendja më tepër të raportet sesa të vetë puna, për deri sa i kemi ndarë si pika të veçanta.

Përndryshe, sa i përket mbështetjes, përkrahjes ose mospërkrahjes, këtë do ta themi te pika 14, meqenëse e ka votuar seanca, ne e kemi mbështetur, por edhe atëherë kur do t'i vjen radha, do ta themi fjalën për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Veç duhet të rikujtoj se kur është aprovuar rendi i ditës për këtë seancë, është aprovuar me dy pika që lidhen me Avokatin e Popullit, si dy pika të veçanta dhe është dashur këtë ta thoni kur është aprovuar rendi i ditës. Gani Koci e ka fjalën, përsëri, por nuk kisha dashur rreth kësaj se ne kemi agjendën e punës. Urdhëroni! Veç shkurt, mundësisht...

GANI KOCI: Unë e thashë mendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për sa i përket pikës 10 që e kemi në shqyrtim – Raporti vjetor i punës së Avokatit të Popullit, që është një kaptinë e veçantë e këtij raporti që ka të bëjë me financat publike, me pasqyrat financiare.

Për sa i përket raportit të auditimit, ai nuk është raport i Avokatit të Popullit, por është i Zyrës së Auditorit Gjeneral që kalon nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare, prandaj janë dy raporte të veçanta dhe duhet të shqyrtohen si dy raporte të veçanta.

KRYESUESI: Faleminderit! Këtë desha ta them edhe unë, sepse Kryesia e ka pasur parasysh se bëhet fjalë për dy raporte të ndryshme dhe i ka bërë dy pika të veçanta, por këtë nuk do ta komentojmë më shumë. Vazhdojmë me radhën e diskutuesve që përfaqësojnë grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, unë kam disa të paraqitur. Është mirë që ta ngrit dorën se kush do të flas në emër të Grupit. E ka fjalën, shefi i Grupit, deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër dhe ministra, sa kanë mbetur,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot po ndihem mirë, bashkë me Grupin tim Parlamentar që për herë të parë para Kuvendit raporton një institucion që e kemi zgjedhur dhe nuk jemi të penduar, më duket, që e kemi zgjedhur.

Është shumë mirë dhe një përshëndetje e veçantë për Avokatin e Popullit, zotin Sami Kurteshi për këtë raport sa konciz, aq përmbajtësor dhe logjik dhe gjithsesi të pasur, për aq sa ka të nevojshme të jetë një raport i tillë, me tetë kapitujt e tij dhe unë në emër të Grupit Parlamentar i jap mbështetje të plotë këtij raporti, pa dilemë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së fjalën e pati deputeti Fatmir Rexhepi, i cili foli edhe në emër të Grupit. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Zylfije Hundozi e ka fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Nga ky raport mund të kuptohet shumë mirë situata në fushën e respektimit të drejtave të njeriut në Kosovë, të garantuara me Kushtetutën e Kosovës. Numri i personave që e kanë vizituar institucionin e Avokatit të Popullit është 2.620. Shumica e këtyre rasteve kanë qenë të lidhura kryesisht me çështje procedurale, siç janë zgjatja e procedurave në gjykata, heshtja e administratës, mosekzekutimet e vendimeve, çështjet pronësore, çështjet sociale, ankesat lidhur me abuzime të autoritetit.

Vetëm 30% të rasteve, pas rekomandimit të institucionit të Avokatit të Popullit janë zgjedhur pozitivisht, ndërsa 70% të rasteve kanë mbetur të pazgjidhura edhe pas rekomandimeve të këtij institucioni.

Nga pasqyra statistikore, të dhëna në këtë raport, mund të kuptohet që shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë nuk është dukuri e rrallë dhe ajo çka është dëshpëruese, është se mospërfillja e rekomandimeve është bërë nga institucionet publike, siç janë gjykatat dhe komunat në 39% të rasteve, ndërsa nga ana e ministrive është 22%.

Shkelja e të drejtave të njeriut, të cilat janë të garantuara me Kushtetutë dhe mospërfillja e rekomandimeve nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, na tregon që Kushtetuta po shkelet bash prej atyre të cilët duhet ta mbrojnë më së shumti, e ato janë gjykatat dhe Qeveria.

Pas anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar dhe në Bankën Botërore, Kosova ka aspirata të anëtarësohet edhe në institucionet tjera me rëndësi, siç është Këshilli i Evropës, anëtarësim ky që paraqet kusht të domosdoshëm për pranimin në Bashkimin Evropian, e njëri prej kushteve për anëtarësim është respektimi i të drejtave të njeriut, prandaj institucionet e Kosovës duhet t'i zbatojnë 16 rekomandimet e dhëna në këtë raport nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2008-2009, edhe pse një numër i madh i tyre është i lidhur me reformën e gjyqësorit, e cila urgjentisht duhet filluar, përndryshe besimi i qytetarëve të Kosovës në institucione do të bie edhe më tutje dhe kështu do të rritet mundësia që zgjidhja e konflikteve të bëhet nga palët të cilat janë të dëmtuara dhe kot e kanë pritur që këto konflikte t'i zgjedhin institucionet adekuate.

Përndryshe, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe unë po e shfrytëzoj rastin që të përshëndes Avokatin e Popullit dhe ta përgëzoj për këtë raport shumë të detajuar përkitazi me gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë. Është raporti i parë i Avokatit të Popullit të cilin po e shqyrton seanca plenare dhe kjo padyshim paraqet një të arritur.

Megjithatë, më lejoni që të jap disa prej vërejtjeve tona sa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Raporti i Avokatit të Popullit sikurse edhe raportet e shumë organizatave tjera qofshin ato vendore, qofshin ndërkombëtare, paraqesin një mori shkeljesh të të drejtave të njeriut, pothuaj se në të gjitha fushat e jetës në Kosovë, e në veçanti në sistemin e drejtësisë që akoma vazhdon të jetë shkelësi më i madh i të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ky raport pasqyron gjendjen e rëndë të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe abuzimet me to nga ana e organeve shtetërore, të cilat, duke abuzuar me ligjin, po shkelen të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare.

Në këtë rast, unë do të shtroj pyetjen se cilat janë ose sa realizohen në Kosovë të drejtat politike civile, të drejtat ekonomiko-sociale, të cilat parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse 8 prej dokumenteve ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ajo që më tepër bie në sy në këtë raport, ka të bëjë me një numër të madh të shkeljes së të drejtave të njeriut që vijnë drejtpërdrejt nga administrata e shtetit dhe atë në disa fusha: në aftësinë e kufizuar në Kosovë ose persona me aftësi të kufizuara në Kosovë, gjendja e të cilëve vazhdon edhe më tutje të jetë jo e lakmueshme dhe larg standardeve ndërkombëtare, po ashtu të drejtat e fëmijëve në Kosovë abuzohen dhe institucionet shtetërore nuk kanë arritur që të krijojnë mekanizma përmes të cilave do të mbronin të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuara mendore, që po ashtu vazhdon të jetë një prej çështjeve më problematike në vend, e që Kosova shpeshherë merr edhe vërejtje nga ana e organizatave të ndryshme ndërkombëtare për mungesë të trajtimit adekuat të personave me aftësi të kufizuara mendore.

Një gjendje po ashtu jo e mirë në fushën e të drejtave të njeriut vazhdon të jetë ndaj personave të ndaluar dhe të paraburgosur, vërejtjet e të cilave ose të cilëve paraqiten edhe në këtë raport, por edhe në raporte të shumta të organizatave për të drejtat njeriut.

Në Kosovë vazhdon të shkelen të drejtat e shërbyesve civilë nga ana e udhëheqësve të institucioneve.

Po ashtu, një prej fushave shumë të rëndësishme në të cilën kemi shkelje të të drejtave të njeriut, e që paraqiten edhe në raporte të tjera, jo vetëm të Avokatit të Popullit, ka të bëjë me trafikimin me qenie njerëzore, një dukuri e cila Kosovën e ka rënduar tej mase dhe që është dështuar përkundër faktit që janë ndërtuar disa prej mekanizmave institucionalë, megjithatë trafikimi me qenie njerëzore ka shënuar rritje në këto dy-tri vitet e fundit.

Një prej kategorive e cila po ashtu është lënë tërësisht në përkujdesje të vetvetes, ose thjeshtë më mirë të them që nuk ka përkujdesje të institucioneve të vendit, janë edhe kategoritë e dala nga lufta, të cilët nuk po arrijnë që të realizojnë të drejtat e tyre të parapara edhe me dokumentet ndërkombëtare, por edhe me ligjet vendore.

Një prej problemeve ose vërejtjeve që paraqitet edhe në Raportin e Avokatit të Popullit është edhe mungesa e qasjes në pronë, si një e drejtë e garantuar. Në Kosovë një pjesë mjaft e madhe e qytetarëve të vendit nuk arrijnë që të gëzojnë të drejtën në pronë për shkak të shumë defekteve që janë shënuar, kryesisht në sistemin e gjyqësisë, por edhe në mungesën e mekanizmave të tjerë.

Raporti po ashtu... që do të duhej të kihej parasysh edhe nga ana e ekzekutivit që sot po mungon këtu, nuk është përbërje në të cilën do të duhej të jetë, sepse ky raport ka të bëjë drejtpërdrejt me shkeljen e të drejtave të njeriut që vijnë nga institucionet shtetërore e që ministrat do të duhej që të dëgjonin këto vërejtje dhe këtë raport të Avokatit të Popullit. Raporti vë në pah edhe një herë mungesën e bashkëpunimit në mes autoriteteve shtetërore me institucionit të Avokatit të Popullit, që paraqet shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Institucionet, por edhe institucioni i Avokatit të Popullit, duke përfshirë në këtë rast konsideroj edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, duhet që të ndërmarrë masa ndaj autoriteteve që abuzojnë me të drejta të njeriut, në mënyrë që Kosova të arrijë standardet ndërkombëtare për të drejta të njeriut.

Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet fuqishëm Raportin e Avokatit të Popullit, sikurse që e mbështet institucionin e Avokatit të Popullit dhe kërkon nga autoritetet e ekzekutivit që të përgjigjen në raport me kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit ashtu siç parashihihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së nuk kemi të paraqitur. Deputetja, Drita Maliqi e ka fjalën!

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Raportin e Avokatit të Popullit e kemi shqyrtuar me vëmendje të posaçme edhe ne Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, i cili është i pranueshëm në mënyrë që t'i mbrojmë të drejtat e njeriut sa më mirë, edhe pse u bë një kohë e gjatë deri sa ky Kuvend e zgjodhi Avokatin e Popullit. Me një fjalë, Raporti është i vonuar, i cili përfshin një periudhë një vit e gjysmë në të cilin janë të përfshira të drejtat e njeriut të përcjella me punën e Qeverisë, respektivisht puna nëpër institucione tona shtetërore në mënyrë që të kemi institucione funksionale e jo institucione të cilat i shkelin të drejtat e njeriut duke mos përfillur vendimet e organeve të pavarura dhe të gjyqësorit.

Gjatë shqyrtimit të këtij raporti të Avokatit të Popullit, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë kemi vërejtur se përpjekjet kanë të bëjnë me një analizë reale që i përgjigjet realitetit në Kosovë. Në raport janë të përfshira rekomandimet që u adresohen institucioneve përkatëse në sugjerimet që duhet të merren, ku në shumë fusha janë të cenuara të drejtat e njeriut, që u tha dhe u cek edhe më lartë, edhe më tutje domethënë në Kosovë shkelen të drejtat e njeriut.

Në këtë raport është bërë përfshirja e të dhënave statistikore dhe sa i përket këtij raporti e ngre edhe një çështje shumë të rëndësishme - çështjen e moszbatimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, sepse ka ankesa të shumta të kësaj natyre në vendin tonë. Ne jemi të vetëdijshëm se gjendja e të drejtave të njeriut është edhe më alarmante se sa paraqitet në raport, edhe pse është gjithëpërfshirës, ku dihet se kategoria e njerëzve me aftësi të kufizuara është më e diskriminuara, veçanërisht në rastin kur kanë të bëjnë me punësimin e tyre. Pastaj, rastet e cenimit të privatësisë, në rastet e arrestimeve me kamerë, të përgjimit të telefonave në mënyrë të paautorizuar dhe moszbatimi i formës së prerë të vendimeve nga gjykata, ku dihet se këto janë shkelje të të drejtave të garantuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit është kategori kushtetuese. Dua të besoj se edhe ligji i ri që është në procedurë, por edhe Qeveria do t'i krijojë kushte adekuate këtij institucioni, do t'i krijojë pavarësi të plotë financiare dhe do t'i respektojë plotësisht rekomandimet e këtij institucioni të rëndësishëm.

Andaj, Grupi ynë Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet këtë raport dhe mbështesim e inkurajojmë institucionin e Avokatit të Popullit në misionin e tij të afirmimit të vlerave universale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Unë, veç edhe një herë dua të sqaroj këtë se lidhur me pikën 10, pra me këtë raport, në emër të komisionit të çështjeve financiare duhej të fliste, ashtu siç tha zoti Koci, Komisioni për Buxhet e Financa dhe tash ma konfirmon Sekretaria – Shërbimi juridik këtë. Pra, isha në lajthitje nga këta, jo nga unë dhe kërkoj falje për ato që.... Do të thotë, u përmirësua kjo me vonesë. OK. Vazhdojmë! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav svima!

I Parlamentarna grupa „7+“ pozdravlja podnošenje godišnjeg izveštaja Narodnog advokata po prvi put pred poslanicima Skupštine Kosova.

Izveštaj Narodnog advokata koji danas razmatramo predstavlja realnu sliku u oblasti ljudskih prava, njihove zaštite i promovisanja tokom izveštajnog perioda od jedne i po godine.

Izveštaj je sveobuhvatan, detaljan, sa preporukama i sugestijama za dalje delovanje, sa statističkim pregledom žalbi i slučajeva, sa opisanim aktivnostima grupe za borbu protiv diskriminacije, za polnu jednakost i dečja prava.

Najveći broj slučajeva istraženih od strane ove institucije uglavnom su bili u vezi sa proceduralnim pitanjima, dužina trajanja postupka pred sudovima, neodgovornost administracije, ne izvršavanje odluka, pitanja svojine, socijalna pitanja i druga.

I Zakon o Narodnom advokatu, koji smo prošle nedelje usvojili, ima za cilj da doprinese stvaranju efektivnih normi u oblasti zaštite ljudskih prava i sloboda.

Narodnom advokatu, kao što se iz izveštaja vidi, svojim zahtevima i žalbama obraćali su se i predstavnici zajednica – Bošnjaci, Turci i ostali i njihove su žalbe takođe istražene.

Uzimajući u obzir da za efikasno i održivo funkcionisanje jedne institucije, kao što je Narodni advokat, za zaštitu građana neophodan je dovoljan broj zaposlenih, odgovarajući budžet koji bi ispunjavao realne potrebe ove institucije, odgovarajući prostor i uslovi za rad osoblja. Možemo reći da je ova institucija u toku izveštajnog perioda, bez obzira na probleme i poteškoće sa kojima se suočavala, odradila dobar posao.

Parlamentarna grupa „7+“ podržava Izveštaj Narodnog advokata u potpunosti, nadajući se da će se preporuke Narodnog advokata sprovoditi od strane odgovarajućih institucija. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit SLS, nuk kemi të paraqitur. Ndërkaq, në emër të Grupit për Integrim, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

I danas imamo pred sobom jako važan Izveštaj Narodnog advokata o ljudskim pravima, preporučen i od strane Komisije i Predsedništva Skupštine.

Jako mi je veliko zadovoljstvo da pozdravim gospodina Narodnog advokata, koji je danas na plenarnoj sednici izneo ovaj izveštaj sam u svojoj prezentaciji i to je jedna novina ovde pred nama u Parlamentu, koju treba da podržimo za dalje izveštaje kada imamo od posebnih mehanizama pred Skupštinom.

Jedno što hoću da kažem, neću da zamaram kolege oko načela ljudskih prava. Mi znamo kakva je situacija na Kosovu, da se ta načela faktički drastično, drastično krše i da uspostavljamo neki mehanizam gde treba ta ljudska prava da dođu negde pri zlatnoj sredini, da kažem, u Evropi.

Kada su u pitanju ljudska prava, mi moramo da znamo koja su načela i gde moramo više da pazimo i kažem da je ovaj izveštaj jako pozitivan kada je u pitanju jednakost pred zakonom – Zakon o diskriminaciji koji je dobro opisan, koji je imao više pristupa pri stanovništvu i sa pojedinim treninzima, kao što je opisano u izveštaju. Međutim, ta jednakost pred zakonom i dalje ostaje kao, da kažem, invalidna u našem društvu. Još ima invaliditeta, tako da nismo dovoljno učinili, znači, u toj oblasti.

Kada je pravo na lični integritet, isto moram da kažem da svaki građanin ima pravo na život, pravo na brak, pravo na ostalo, ali lični integritet našeg građanina mora da se stavi u sferi poštovanja kada je izrada svih zakona i legistratura koja postoji, a to isto je bilo zabeleženo i od strane Izveštaja Narodnog advokata. Naročito pravo na slobodu kretanja, pravo na privatnost, pravo na brak i porodicu, to što sam rekla, zaštita imovine. Ja moram da kažem da se ovaj Izveštaj jako malo bavio oko zaštite imovine. Mi znamo koji sve imovinski pravni okviri postoje na Kosovu i kada je imovina da se drastično krše prava oko zaštite imovine koja predstavlja faktor broj 1 da bi nas Evropska komisija prepoznala kao državu.

Drugo, što jeste jako važno, je pravo na obrazovanje. Malo više, ja moram da kažem i malo ću biti i kritična, moralo je da se posmatra obrazovanje na jedan malo kritični način i kada je obrazovanje manjinskih zajednica, kada je u pitanje predškolsko obrazovanje i normalno školsko obrazovanje.

Pravo na rad, to što Narodni advokat, moram da kažem, trebao je u ovom izveštaju da apeluje da se napravi pravna zakonska legistratura u vezi kršenja ljudskih prava koja se krše od strane Vlade, a to moram da kažem, da je pravo na rad i obavljanje profesije, to je član Ustava 49. znači Zakon o radu koji je u toku izrade. Dalja prava, osnovna prava, dečja prava na Kosovu, to je član 50. Ustava i zdravstvena i socijalna zaštita, član 51. Ustava. Mora da se donesu ova tri zakona pred Skupštinom, ovo je trebalo da apeluje Narodni advokat da se što pre donesu, jer tu u ova tri člana i ova tri zakona krše se ljudska prava. Kada kažem dečja prava na Kosovu, u Ustavu gde su samo obeležena i opisana, osnovno pravo, dečje pravo, deca gube pravo na dečji dodatak. Mi moramo više da podignemo glas za pojedina prava koje imaju sve regije i zemlje u Evropi. Mi smo to pravo imali stečenu, izgubili smo ga i moramo da damo domaći zadatak da se to pravo deci vrati.

Obavezno socijalno i zdravstveno osiguranje, rekla sam, to što nemamo i normalno odgovornost za životnu sredinu. Mi ovde imamo da je opisana jedna kompanija „Guri“ koja nije imala niti licencu, niti ništa a vršila je eksploataciju. Znamo u građevinarstvu, znamo da je najveće kršenje ljudskih prava, gde su naselja u pitanju, gde je zaštita životne sredine, gde je pravo rečeno zdravlje građanina ugroženo, i imovina, i zdravlje.

Zatim, jako, jako važno tumačenje odredbi ljudskih prava. Kako tumačimo ljudska prava i šta imamo kao sudsku zaštitu prava. Mi moramo da kažemo da se opet krši član Ustava broj 54. i član 24. Ustava. Nema znači ovaj izveštaj analizu sudskih predmeta. Moramo jednom da znamo i od strane Narodnog advokata kata je stub sud, ovo mora da se preispita, a ne da dobijamo izveštaj od evropskih komisija, znači da mi sami o sebi radimo više izveštaj koji smo, šta smo i šta imamo za rešavanje.

Jako važna saradnja sa domaćim institucijama je od strane ovog organa potrebna, znači to, kao što su Nezavisni nadzorni odbor Kosova, Agencija za borbu protiv korupcije, Centralna izborna komisija, Vrhovni sud Kosova, kao što su i ostali sudovi, ministarstva i opštine. Ovo je potrebno sa zajedničkim ciljem - identifikovanje problema i davanja rešenja za njihovo uspešno otklanjanje putem normalno službenih preporuka.

Vidimo da ima budžet od 509.000 evra, da je budžet skroman. Videli smo da ima 42 zaposlena službenika, da sa 5 regionalnih kancelarija i sa 80 otvorenih sastanaka da kažemo po opštinama, da se dovoljno trudila i radila na identifikovanju pojedinih problema.

Mi znamo da je kancelarija ili Ombudsperson da predstavljaju jasan znak stvaranja zakonskih normi u Republici Kosova. To je prva adresa, ja kažem slovo A u azbuci, gde se građani obraćaju za ostvarivanje svojih ljudskih prava. I taj prvi pristup građanina je jako važan i za takav pristup ova organizacija i mi kao Skupština, koji smo imenovali Narodnog advokata, treba da se potrudimo da stvorimo jako efikasan mehanizam koji će funkcionisati.

Sam Izveštaj ćemo mi kao, da kažem, Grupa za integraciju da podržimo i jako je bitan, jako je dobar i moramo što više da se angažujemo i sama služba i sve institucije ovde na Kosovu da ovaj mehanizam bude veza između građana i institucija. Toliko od nas! Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputetë të paraqitur për diskutim lidhur me këtë pikë janë 5: Sanije Aliaj; Gjylnaze Syla, Arsim Bajrami, Riza Smaka dhe Ibrahim Selmanaj. Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, Përhëndes fjalën e prezantuar të Avokatit të Popullit, si dhe vlerësimin e Raportit të Avokatit të Popullit për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me këtë rast kemi të bëjmë me shqyrtimin e Raportit që paraqet punën nga 30 qershor 2008 deri më 31 janar 2009, pra përfshin punën e këtij institucioni për një vit e gjysmë.

Ky është raporti i parë ... dhe paraqet vazhdimësinë e punës së institucionit të Avokatit të Popullit, plotëson standardet sepse paraqet punën gjithëpërfshirëse të këtij institucioni, i cili bën evidentimin e shkeljes së të drejtave të njeriut të garantuara me ligj, me Kushtetutë dhe këshillon e ndihmon palët në ndjekjen e procedurave për zgjidhjen e tyre.

Në raport pasqyrohet se edhe përkundër ekzistimit të infrastrukturës ligjore, si dhe mekanizmave institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet e institucioneve mbetet problematikë zbatimi i ligjeve sa i përket garantimit të njeriut. Kjo vërejtje është theksuar edhe në Raportin për të drejtat e njeriut të Komisionarit të Këshillit të Evropës, i publikuar më 2 korrik 2009.

Krahasuar me raportet e mëhershme, bazuar në përmbajtje, çështjet e ngritura në këtë raport janë bërë sipas radhitjes në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Zbatimi efektiv i standardeve të të drejtave të njeriut, konsolidimi i sistemit gjyqësor dhe i prokurorisë, si dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit janë dhe më tej mbeten ndër sfidat më të mëdha për Kosovën si shtet i ri. Pikërisht edhe në këtë raport fusha e gjyqësorit ka qenë dhe mbetet fusha e identifikuar me numrin më të madh të ankesave të paraqitura nga qytetarët e Kosovës në institucionin e Avokatit të Popullit për shkak të mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, zvarritjet e mëdha të procedurave gjyqësore, si dhe korrupsioni real në gjyqësor. Kjo bën që të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të shkelen dhe nëpërkëmbën në përditshmërinë tonë.

Në këtë raport pasqyrohen se afërsisht 2.610 persona kanë vizituar zyrën qendrore dhe rajonale të Avokatit të Popullit për këshillë dhe ndihmë juridike. Ankesat e pranuar në këtë institucion janë 1.318, prej të cilave 77% janë të gjinisë mashkullore, kurse 23% të gjinisë femërore. Ashtu siç paraqitet në Raport, rastet e hapura për hetim janë 518, kurse të mbyllura janë 424, pra mbi 60% të kërkesave janë të pashqyrtuara. Po t'i krahasojmë se në cilat institucione janë më shumë raste të hetuara, gjendja është kështu: Gjykatat i kanë 179 raste; ministritë 158 raste; komunat 132 raste. Kjo është vërejtje e madhe për institucionet tona për zbatimin e ligjeve kur është në pyetje respektimi i të drejtave të njeriut, e në veçanti respektimi i të drejtës në punë. Me vetë faktin se vetëm 299 ankesa

janë të gjinisë femërore, lë për të kuptuar se femra ende nuk e ka guximin për t'u ankuar kur ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Unë do të ndalem te e drejta e martesës dhe e familjes dhe me këtë rast kërkoj nga institucionet përgjegjëse një vëmendje të veçantë, sepse ashtu siç jemi në dijeni, është në rritje të vazhdueshme numri i shkurorëzimeve si pasojë e dhunës në familje, e papunësisë dhe pabarazisë objektive midis gjinive. Kjo jo vetëm që ndikon në shkatërrimin e familjes, ndikon negativisht në formimin e personaliteti të fëmijëve, por edhe femrën e sjell në pozitë të vështirë duke mos ditur kah të orientohej, prandaj sot në përditshmërinë tonë kemi të bëjmë me të padëshiruara sa i përket pozitës së femrës në shoqëri.

Me këtë rast kërkoj nga institucionet përgjegjëse të aplikojnë politika për të evituar perceptimin e gabuar dhe jo real se çështjet familjare janë çështje private, sepse kjo e dëmton shoqërinë në themel.

Edhe në raporte të mëhershme, por edhe në këtë raport, një pjesë e Raportit i kushtohet diskriminimit në pronë. Agjencia Kosovare e Pronës është krijuar për shqyrtimin e kontesteve të pronës në periudhën 89-99. Mungesa e mandatit të gjykatave për raste të tilla ka krijuar kaos në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me çështjet pronësore. Madje, në disa raste, vendimet e kësaj Agjencie edhe më tepër kanë fuqizuar diskriminimin duke përdorur standarde të dyfishta, sidomos në mosekzekutimin e vendimeve të Komisionit për pronat e qytetarëve shqiptarë, të cilat gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës, e sidomos për mospërmblidhjen e detyrimeve ndaj pronarëve që pronat e tyre i kanë në administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës. Me këtë rast AKP-ja, edhe me rastin e shqyrtimit të Raportit të auditimit të brendshëm, Njësisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm nuk i është ofruar raport dhe nuk i ka krijuar kushte e rrethana për auditim të brendshëm, që lë për t'u kuptuar se kjo agjenci nuk është në nivel të përgjegjësisë për të cilën është themeluar.

Dukuria e diskriminimit është e përhapur edhe ndaj grupeve të njerëzve që janë në pozitë më të rrezikuar. Personat me aftësi të kufizuara jetojnë në varfëri dhe janë të izoluar nga jeta shoqërore, ekonomike dhe politike. Ata kërkojnë përkujdesje të veçantë, sidomos në fushën e përkujdesjes shëndetësore, të arsimit dhe punësimit për realizimin e të drejtave për një jetë aktive në shoqëri.

Të premtën e kaluar, deputetët e Ferizajt janë ftuar nga shoqata "Hendikos" në një tryezë për të debatuar rreth pozitës së tyre. Edhe përkundër ngritjes së këtij problemi në Ministrinë e Shërbimeve Publike, nga institucioni i Avokatit të Popullit nuk është vërejtur përparim në këtë fushë. Kjo obligon deputetët për monitorimin e zbatimit të Ligjit për personat me pasoja të veçanta. Raportin e përkrah me rekomandimet e komisionit funksional, se pasqyrimi i gjendjes në shoqërinë tonë sa i përket zbatimit të drejtave të garantuara me Kushtetutë është sinjal për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në të gjitha institucionet, në mënyrë që raportet e Këshillit të Evropës në të ardhmen në vitin 2010 të jenë më pozitive. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka një rëndësi të madhe për mbrojtjen, por edhe për promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, mbrojtjen nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Kjo vlen sidomos duke marrë parasysh vetë kompetencat dhe mënyrën e punës së këtij

institucioni që përmes pavarësisë së vet dhe qasjes jo konfliktuoze luan një rol të rëndësishëm në këtë fushë.

Sa i përket raportit, ky përfshin një periudhë prej një vit e gjysmë, prej korrikut 2008 deri në dhjetor 2009. Është një raport gjithëpërfshirës, voluminoz, i cili ka një përmbajtje me përfshirjen e shumë mekanizmave dhe ligjeve të cilat kanë të bëjnë me fushën e të drejtave të njeriut.

Nga raporti shihet se numri më i madh i ankesave, të cilat i janë drejtuar Avokatit të Popullit, kanë të bëjnë kryesisht me funksionimin e gjyqësorit. Të gjeturat flasin se gjyqësori nuk funksionon në asnjë pjesë të tij, duke filluar nga zvarritja e procedurave, domethënë zbatimi i vendimeve gjyqësore, keqadministrimi, pastaj dukuria e korrupsionit dhe humbja e besimit. Sidomos nuk funksionon gjyqësori në veriun e Kosovës. Të gjitha këto duhet të jenë shqetësuese për ne, duke marrë parasysh se kjo është një shenjë se shteti ligjor nuk po funksionon.

Gjithashtu, sa i përket raportit, një çështje tjetër e cila trajtohet dhe të cilën dëshiroj ta theksoj, është çështja e të drejtave të njeriut, sidomos të fëmijëve. Çështja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve është e rregulluar me instrumentet ligjore në Kosovë, duke përfshirë Kushtetutën, por edhe Konventën për të drejtat e fëmijëve. Por, në praktikë këto instrumente ligjore nuk po zbatohen. Këtë e dëshmojnë të dhënat shqetësuese për nivelin e keqtrajtimit të fëmijëve, sidomos keqtrajtimit fizik në burgjet e Lipjanit, por edhe të rrezikimit të jetës së fëmijëve nga qentë.

Liria e shprehjes dhe çështja e lirisë së mediave, është edhe një problem tjetër. Nuk zbatohet Ligji për qasje në dokumente zyrtare, ka kërcënim të gazetarëve, pra mungon infrastruktura ligjore. Mungojnë edhe ligjet themelore, me çka cenohen të drejtat e njeriut, si Ligji për punën, Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor, Ligji për sigurimin shëndetësor. Po ashtu, autoritetet qeverisëse nuk kanë arritur që të nxjerrin aktet e nevojshme ligjore për zbatimin e ligjeve.

Një çështje tjetër të cilën dëshiroj ta përmend dhe të cilën e shoh si problem, është sidomos diskriminimi në marrëdhëniet e punës. Një rast të cilin e përmend në dokument Avokati i Popullit, është diskriminimi në marrëdhënien e punës në mes të teknikëve mjekësorë të Njësisë së Kujdesit Intensiv në Repartin e Neonatologjisë në Klinikën Gjinekologjike të spitalit rajonal të Prizrenit, të cilët teknikë deri në vitin 2002 janë paguar njëjtë sikurse mamitë e kësaj klinike, gjegjësisht të këtij reparti. Pas vitit 2002, ata janë paguar më pak, sepse puna e tyre është vlerësuar më pak. Kjo nuk ka ngjarë pra në pjesë tjera të Kosovës, gjegjësisht në spitalet tjera rajonale, si në Prishtinë, Pejë, Gjakovë dhe Gjiilan.

Arsimi, gjithashtu, duhet të jetë pjesë e shqetësimeve tona, duke marrë parasysh se sidomos vajzat braktisin shkollat, pastaj nuk ka ujë të pijshëm, kushtet higjienike në shkollë janë të këqija. Pra, vëmendja e autoriteteve qeveritare nuk është e mjaftueshme në këtë aspekt.

Në fund, rekomandimet e Avokatit të Popullit duhet marrë parasysh dhe duhet të përkrahen dhe të zbatohen meqenëse këto janë masa plotësuese në përpjekje për përmirësimin e qeverisjes, sidomos të kësaj qeverisjeje të keqe, dhe krijimin e një qeverisjeje më të mirë, më të hapur, më llogaridhënëse dhe të shërbimeve të cilat do ta vënë qytetarin në qendër të qeverisjes.

Të gjitha shkeljet të cilat i përmenda, por edhe ato tjerat të cilat përbëjnë raportin, sa i përket shkeljeve të drejtave të njeriut nga autoritetet shtetërore, përbëjnë rastet më serioze të keqadministrimit, gjegjësisht të qeverisjes.

Kam edhe disa rekomandime për institucionin e Avokatit të Popullit, duke marrë parasysh se zgjedhjet për Avokatin e Popullit janë çdo 5 vjet, atëherë, duhet të përcaktohen prioritetet për 5 vite të ardhshme, duke përfshirë prioritetet kryesore, ashtu që do të përfitojnë qytetarët e Kosovës.

Po ashtu, Avokati i Popullit gjatë 5 viteve duhet të zhvillojë strategji pesëvjeçare të bazuar në misionin të cili ne ka.

Krahasimi i rasteve duhet të bëhet në mes të vitit 2008 dhe 2009, sepse këto të dhëna do të shihen se cilat raste paraqiten më shumë, cilat kërkesa janë zvogëluar dhe kjo do të ndihmojë pastaj edhe për caktimin e prioritetëve të Avokatit të Popullit.

Aktivitetet të cilat është dashur të përcillen janë gjithashtu ankesat lidhur me tenderët, si dhe ato shkelje të cilat janë bërë nga misionet ndërkombëtare. Duhet të zhvillojë një aktivitet më të shquar mediatik për të promovuar respektimin e të drejtave të njeriut. Në parim këtë raport e përkrah. Faleminderit!

Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues,

I nderuari zëvendëskryeministër, i nderuari ministër,

Më lejoni që fillimisht të përgëzoj këtë raport, sidomos për hartimin e tij profesional. Njëkohësisht përshëndes edhe paraqitjen gojore të raportit nga ana e Avokatit të Popullit, sepse kjo është hera e parë që Avokati i Popullit drejtpërdrejt prezanton raportin, që është edhe një kulturë kushtetuese, por edhe një praktikë e mirë e Kuvendit.

Raporti është hartuar jashtëzakonisht mirë profesionalisht dhe ka bërë një analizë të mirë të gjendjes së të drejtave të njeriut dhe është raporti i parë që po shkruhet pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila, siç dihet, një kaptinë ia ka kushtuar të drejtave të njeriut dhe në këtë pjesë Kushtetuta e Kosovës është ndër kushtetutat më afirmative në rajon, por kjo assesi nuk duhet të krijojë përshtypjen që ne duhet të ndihemi komod sa i përket të drejtave të njeriut sepse avancimi i të drejtave të njeriut është një rrugë që duhet ta ndjekë Republika e Kosovës drejt integriteteve evropiane.

Duke e përshëndetur nivelin profesional të hartimit të raportit, më lejoni që të jap disa sugjerime, pa hyrë në opinione konkrete që u dëgjuan, sepse raporti është mjaft konkret, raporti ka përpunuar në mënyrë detale çdo liri dhe të drejtë kushtetuese dhe ka paraqitur gjendjen e respektimit të kësaj lirie dhe drejte kushtetuese, por dëshiroj t'i jap disa sugjerime që mund të jenë me rëndësi për punën e Avokatit të Popullit.

E tha edhe Avokati i Popullit, detyra e tij nuk është të gjykojë apo të marrë vendime të drejtpërdrejta, por të monitorojë dhe të konstatoj shkeljet dhe të përgatit raportet.

Megjithatë, unë mendoj se kapaciteti kushtetues i Avokatit të Popullit i mundëson një qasje më proaktive sa i përket evidentimit të shkeljeve të drejtave të njeriut, sepse Avokati i Popullit nuk duhet të kënaqet vetëm me konstatimin, vetëm me gjetjet, por duhet të jetë instrumenti më i fuqishëm që këto shkelje të eliminohen nga praktikat e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe vetëm të përkujtoj se kur kemi punuar pjesën për Gjykatën Kushtetuese, ne e kemi arritur konsensusin që

Avokati i Popullit apo Obduspersoni ta ketë fuqinë e drejtpërdrejtë të nisjes së procedurave të Gjykata Kushtetuese sa herë që konstaton që një institucion publik apo një autoritet publik shkel të drejtat e garantuara kushtetuese. Dhe mendoj se Avokati i Popullit nuk duhet të mjaftohet vetëm me konstatimin, vetëm me evidentimin, vetëm me emërtimin e institucionit që i ka shkelë të drejtat e njeriut, por duhet ta ketë autoritetin e plotë kushtetues që t'i nisë procedurat, t'i nisë procedurat para Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të ngritë kulturën shtetërore për respektin për liritë dhe të drejtat e njeriut. Unë e kuptoj se është viti i parë i punës së këtij institucioni pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese, por do të sugjeroja që pas konstatimit të shkeljeve dhe pasi që të jenë shterur të gjitha mundësitë tjera administrative dhe gjyqësore, të fillohet me praktikën që Ombudspersoni të mbrojë të drejtat e njeriut përmes fillimit të procedurave konkrete në Gjykatën Kushtetuese, ku në anën e të paditurës do të jenë edhe institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, sidomos ato që abuzojnë me të drejtat e njeriut. Kjo do t'i mundësojë Avokatit të Popullit një funksion pro-aktiv, një funksion ku ai nuk do të na dalë vetëm me konstatime, vetëm me tabela ku tregohet qartas se cilat institucione kanë problem me realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe do të ndikojë që vërtet ky afirmim kushtetues, që ne e kemi përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të jetë edhe afirmim praktik i realizimit të këtyre lirive dhe të drejtave të njeriut.

Raporti përndryshe është i plotë, është ndër raportet më të mira që kemi pasur deri më tash në Kuvend dhe unë edhe një herë e përkrah dhe jam i sigurt se ky institucion tani po funksionon me kapacitet të plotë kushtetues dhe jam i sigurt se është në rrugën e plotë të afirmimit si një institucion i fuqishëm për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, po njëkohësisht edhe për ngritjen e kulturës shtetërore dhe institucionale sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Zotëri zëvendëskryeministër,

Deputetë të nderuar,

Fillimisht dhe parimisht Raportin e konsideroj të mirë, elegant, gjithëpërfshirës, me disa mangësi. Natyrisht se s'mund të jetë as ky apo cilido raport plotësisht çfarë do të duhej të ishte.

Ky raport përmban, ndër tjera, edhe parime dhe norma kushtetuese në stilin deskriptiv, që gjykoj që nuk ishte dashur të ndalej aq tepër në përshkrime të dispozitave, sepse ato fundi i fundit janë të njohura, porse të ndalet në substancën e tyre se sa ato nuk përfillen dhe ku nuk përfillen dhe pse nuk përfillen.

Në Raport ka edhe premisa hipotetike, do të thotë çështje që mund të thuhet se shkelet e drejta e njeriut, por pa u verifikuar përfundimisht pothuaj se mbetet si hipotezë e rrëzueshme. Gjithsesi, është punë e mirë që edhe të jepet edhe nga ky aspekt e nga ky nivel, mirëpo ajo që këtij raport i mungon, unë konsideroj që është një mungesë qenësore, është kjo: Një numër i madh, jo numër i vogël, i akteve juridike, civile, administrative, penale, kundërvajtëse, ekonomike përfundimtare nuk përfillen nga ata dhe nga ato që detyrë primare e kanë përmbarrimin, ekzekutimin e tyre. Ju lutem, këto janë shkelje substanciale, esenciale, fundamentale të Kushtetutës, të ligjit – me germë të vogël domethënë, të ligjit referues të rendit juridik të Kosovës. Ose në raport, në përmbajtje thuhet, i referohet vetëm të të akuzuarit. Ju lutem, e ku është i pandehuri, se i pandehuri te na ka rast që po e zëmë 5 vjet e vuan dënimin, nuk ka aktgjykim të formës së prerë. Ose, për shembull, sa mund të strapacohet e të keqpërdorohet, e të nëpërkëmbët qytetari për deri sa ta merrte statusin e të akuzuarit, se i akuzuar bëhet atëherë kur aktakuza e merr formën e prerë. Prandaj, do të duhej të zbërthehej, medoemos.

Në këtë Kuvend kemi trajtuar edhe Raportin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Janë mbi 60 raste, mbi 60 vendime, raste juridike-administrative apo përfundimtare që nuk përfillen. Nga kush? Nga ministritë e caktuara. Ju lutem, nga ministritë e caktuara që është shkelje flagrante e të drejtave elementare të qytetarit dhe të institucioneve.

Do ta marr një shembull edhe më flagrant. Uzurpimet arbitrare, quhet lënda kësisoj. Ju lutem, janë 239 raste juridike administrative përfundimtare, jo brenda, si të them, këtyre dy-tre muajve, brenda dekadës, të cilat nuk përfillen edhe ato janë kësisoj, që i marr disa katunde, disa fshatra: Drelaj - 8 raste, Shtupeq i Vogël - 4 raste, Rekja e Llakës - 12 raste, Malajt - 3, Koshutan - 31, Shkrel - 2, Pepaj - 18, Kuçishtë - 2, Stakaj - 1, Dugajevë - 12, Boge - 17, Radac - 15, Lipkë - 28, Gillogjan-Nepojë - 20, Jabllanicë e Madhe - 42, Jabllanicë e Vogël - 48, Çellopek - 16... Ju lutem, po vetëm 10 raste të ishin, do të ishte çështje shumë serioze për t'u diskutuar dhe për t'u ndërmarr edhe masa. Këtu është fjala për 239 raste, që i kanë aktvendimet e formës së prerë dhe nuk përfillen nga autoritetet administrative. Është fjala për afër 1.000 hektarë, kullosa, pyje, ara, toka të cilat paraqesin burim elementar për pronarët e tyre, të cilët janë të privuar absolutisht padrejtësisht tani nga neglizhenca e autoriteteve tona, dikur nga tendenca hegjemoniste.

Dhe, përfundimisht, unë do të isha angazhuar që në raportet e ardhshme, po jo në raportet, por në punën e ardhshme të Advokatit, unë e quaj Advokat – advokate, apo jo, të popullit që të ketë edhe masa konkrete në kuadrin e ligjit, jo vetëm të konstatohet në mënyrë përshkruese, po ato rekomandime, ato konstatime, ato në variantet më të përshtatshme të bëhen botore, të dinë qytetarët se kush nuk i përfill të drejtat e njeriut, kush i shkel me të dy këmbët të drejtat elementare që ia garanton Kushtetuta dhe rendi juridik i Kosovës. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit! Për ta plotësuar diskutimin tuaj, dua të shpreh shqetësimin tim lidhur me situatën e krijuar pikërisht në tri fshatra: Jabllanicë e Madhe, Jabllanicë e Vogël dhe Radac, ku mendoj që KEK-u dhe ujësjellësi po shkelin të drejtat e njeriut, ua kanë ndërpre ujin e ujitjes dhe ujin e pijes 3 fshatrave. Të paktën është dashur që të kihet parasysh që fëmijët duhet të pinë ujë dhe s'po kërkojnë qumësht, për të vetmen arsye që pushteti lokal i Pejës dhe ndërmarrja e ujësjellësit dhe KEK-u nuk dakordohen se kush duhet të merret me çështjen e pagesave të pompave të ujit të pijshëm. Prandaj, vërtet qytetarët e këtij regjioni më janë drejtuar edhe mua, u janë drejtuar edhe shumë institucioneve këtu, do të duhej që dikush të merrej me ta dhe të zgjidhej çështja e ujit të pijshëm edhe përkundër asaj që ata kanë borxhe për shpenzimet e pompave të ujit që janë bërë. Më falni për ndërhyrjen, por meqenëse ishte një raportim që përfshinte edhe këtë regjion, desha që këto ditë të fundit, do të thotë akoma vazhdon gjendja, këto fshatra nuk furnizohen me ujë të pijshëm për shkak se KEK-u me urdhër ua ka ndërprerë rrymën pompave të cilat furnizojnë fshatrat me ujë.

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në radhë të parë përshëndes një raport që e ka sjellë Avokati i Popullit. Konsideroj se ka disa mangësi të cilat është dashur të përfshihen edhe disa shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, sikur është rasti i shkyçjeve kolektive që ka të bëjë me KEK-un, një politikë në vazhdimësi. Edhe përkundër sugjerimeve që janë dhe kanë rrjedh nga ky parlament, prapëseprapë ndodh i njëjti avaz dhe në këtë radhë jo të gjithë qytetarët i kanë borxh KEK-ut. Një element i dytë, që konsideroj se duhet të ishte përfshirë në raport, është sa misione ndërkombëtare kanë bërë shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut qoftë me punëdhënësit ose edhe forma tjera dhe sa ka informacione Avokati i

Popullit. Këtu nuk duhet t'i ikim edhe një fakti të tretë, një elementi shumë të rëndësishëm që janë të dënuarit në burgjet e Kosovës dhe shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut që kanë rrjedhur si pasojë. Ka edhe interesim të qytetarëve që kanë ngritur edhe peticione përmes të cilave edhe është shpenzuar kohë, por edhe nuk është marrë asnjë hap konkret në vazhdimësi se çfarë duhet në fakt të veprojmë për interesin e atyre qytetarëve.

Një element tjetër që është shkelje e të drejtave të drejtpërdrejta, shkelje e lirive të njeriut, është shfrytëzimi i pronës në veriun e Kosovës. Tash e dhjetë vite, qytetarët shqiptarë kanë prona në veriun e Mitrovicës dhe sot janë të privuar nga e drejta e shfrytëzimit së paku të qirasë, e ato prona shfrytëzohen, çka do të thotë se në pjesën tjetër të Kosovës nuk është e njëjta situatë.

Kur kihen parasysh këto fakte, që u mundova t'i përmend, si dhe qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet e Kosovës, përfshirë këtu edhe pushtetin qendror, edhe pushtetin lokal, Raporti i Avokatit të Popullit sjell një mesazh të pushtetit të dy niveleve, që të jemi dhe të marrim hapa konkretë dhe mos të kënaqemi vetëm me konstatimet.

Konsideroj se duhet t'i japim hapësirë shumë më të madhe Avokatit të Popullit, sidomos në komunat e Kosovës dhe të ketë edhe dikastere përmes të cilave edhe mund të kenë bashkëpunim dhe mund të zhvillojnë ose edhe mund të ndjekin situatën e interesit të qytetarëve. Unë mbështes raportin me këto sugjerime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bajram Kosumi e ka fjalën.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Unë dua të evidencoj faktin që Raporti i Avokatit të Popullit, që e kemi në shqyrtim, është një ndër raportet më të plota dhe të hartuara më së miri që i është ofruar Kuvendit të Kosovës, qoftë në aspektin e kulturës gjuhësore, qoftë në aspektin e sasisë së informacioneve që ofron raporti. Përveç teknikisht, si raport i hartuar mirë, gama e të drejtave që janë trajtuar në punën njëvjeçare të Avokatit të Popullit është mjaft e gjerë, janë 33 të drejta elementare që garantojnë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e që janë trajtuar nga Avokati i Popullit, që është një numër i kënaqshëm. I kënaqshëm nga aspekti pse janë trajtuar, por jo i kënaqshëm sepse ndodhin shkelje të tilla, të kaq shumë të drejtave në jetën e përditshme të njeriut në Kosovë.

Pajtohem me deputetët që ngritën po ashtu çështje tjera, të drejta tjera të cilat nuk i ka trajtuar Avokati i Popullit, e që ndodhin në jetën e përditshme dhe nga kjo mund të nxirret edhe një përfundim që përveç trajtimit të shkeljeve të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit duhet t'i nxisë qytetarët që të kundërshtojnë dhe të kërkojnë mendimin dhe ndihmën e Avokatit të Popullit sa më tepër për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

Tri çështje dëshiroj t'i dalloj nga raporti. Së pari, një çështje e procedurës së punës. Ne sapo miratuam javën e kaluar Ligjin për Avokatin e Popullit dhe aty e kemi hartuar një bazë të mirë të punës në të ardhmen dhe edhe fjala e Avokatit të Popullit ishte në këtë drejtim për herë të parë që i drejtohet Kuvendit të Kosovës, mirëpo kisha kërkuar nga kryesuesi që përveç fjalës së paraqitjes së Avokatit, t'i mundësohet që të japë përgjigje edhe në çështjet që shtrojnë deputetët gjatë debatit për raportin e punës. Është një ndërlidhje e natyrshme, nëse Avokati i Popullit e paraqet raportin e edhe me Ligjin që e kemi miratuar është kështu, atëherë ai duhet edhe të jap mendimin e tij, opinionin, përgjigjet ose kundërshtimin nëse është në lidhje me çështjet që i shtrojnë deputetët gjatë diskutimit për Raportin e Avokatit të Popullit.

Nën dy, Avokati i Popullit të shfrytëzojë mundësinë që të bëjë raporte të veçanta, jo veç raportin vjetor të punës. Shihni, ky raport i punës i ka 100 faqe dhe është mjaft dendur i shkruar, është vështirë për deputetët që ta lexojnë dhe ta analizojnë të tërin. Në ato çështje të cilat Avokati i Popullit merr vendim dhe institucionet e pushtetit në Kosovë nuk angazhohen, nuk e kryejnë, nuk i marrin veprimet e duhura, Avokati i Popullit duhet të bëjë raporte të veçanta për Kuvendin e Kosovës, qoftë edhe për një rast, dhe t'u ofrojë deputetëve shënime, të dhëna, qëndrimin e vet, mendimin e vet pse nuk po zbatohen kërkesat e Avokatit të Popullit. Pastaj, mbetet në barrë të deputetëve që këto çështje t'i ngrisin në raport me pushtetin. Dhe, në fund, unë e vë një theks te rekomandimet e Avokatit të Popullit, krahas miratimit të raportit të punës, duhet të dallojmë veçanërisht miratimin e rekomandimeve që ka bërë Avokati i Popullit dhe Kuvendi t'i ftojë të gjitha mekanizmat e pushtetit që të veprojnë në harmoni me këto rekomandime. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani u paraqitën edhe dy pasi përfunduan.

Zoti Buçinca e ka fjalën.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I përshëndes të gjithë të pranishmit këtu,

Unë do të ngre tri çështje për të cilat besoj se duhet të jemi të gjithë të shqetësuar.

Duke e vlerësuar raportin si raport shumë të mirë dhe duke e përkrahur dhe lavdëruar punën e institucionit të Avokatit të Popullit, që po bëhet, unë i ngre këto tri probleme:

E para, qytetarët e Kosovës kanë probleme me drejtësinë në Kosovë. Gjykatat tona janë shndërruar në vende ku fillojnë hallet e qytetarëve, e jo ku fillojnë zgjidhjet e halleve të qytetarëve. Mos shqyrtimi i lëndëve nëpër gjykata, mos përmbarimi i lëndëve nëpër gjykata, është një problem shumë shqetësues. Kjo është e para.

E dyta, shqyçjet kolektive qysh u përmendën këtu dhe shumë ankesa të qytetarëve që bëhen në rregullatorët e ndryshëm, qoftë për ankesat, për faturimin, mënyrën e faturimit, nuk shqyrtohen fare dhe qytetarët nuk marrin kurrfarë përgjigje adekuate për mënyrën se si e kanë bërë faturimin, qoftë ujësjellësi, qoftë KEK-u. Kemi fatura të fryra, kemi fatura të cilat i ngarkojnë qytetarët me shpenzime të cilat ata nuk i kanë shfrytëzuar prej këtyre kompanive. Këto janë probleme mjaft shqetësuese dhe ne duhet të ndërmarrim diçka që qytetari në raport me shtetin, të ketë një afat deri kur mund të marrë prej institucioneve të shtetit për një lëndë ose për një kërkesë, për një padrejtësi që i bëhet.

Pastaj, mos pagesa e 20% me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve është prapë një shkelje flagrante e të drejtave të qytetarëve të Kosovës. Pra, institucionet e Kosovës kanë bërë shumë pak në këtë drejtim dhe duhet një presion më i madh i opinionit që më në fund qytetarët t'i marrin ato që u takojnë se ajo është e drejtë e tyre legjitime që 20% ta marrin. Ka njerëz të cilët po vdesin pa e marrë 20%. Janë kontribute të tyre, janë vlera të tyre që i kanë krijuar me vite të tëra, me djersën e tyre dhe kjo po prolongohet në vazhdimësi. Një pjesë e këtyre problemeve janë edhe të trashëguara nga administrata ndërkombëtare, mirëpo, një presion më i madh nëpërmjet Avokatit të Popullit dhe Kuvendit, do të duhej të orientohet që sa më shpejtë këto probleme të zgjidhen, që më në fund, qytetari ta ndiejë dorën e shtetit.

Kam përshtypjen se çdonjëri prej nesh që jemi këtu, kemi problem me gjykata për çështje, qoftë të pronësisë, qoftë të ndonjë shkelje që i bëhet dhe individit është akoma shumë i dobët në raport me shtetin. Natyra e një shteti demokratik vërehet se çfarë raporti ka shteti me qytetarin, me individin. Edhe mua ma merr mendja se qytetarët në raport me shtetin, janë tepër të brishtë, tepër të dobët dhe nuk mund t'i realizojnë interesat e tyre, interesat legjitime dhe, në këtë drejtim, do të duhej të orientohemi edhe Kuvendi edhe Avokati i Popullit, që më në fund qytetari të ketë besim te institucionet e shtetit dhe dora e shtetit të jetë në favor të interesave të qytetarëve. Kaq. Ju faleminderit. Raportin do ta përkrah.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Unë po kërkoj falje prej Avokatit të Popullit se mu desh të dal jashtë pak për do punë tjera. Po dua të them, ndoshta i kanë thënë kolegët përpara. Sidoqoftë, unë e çmoj këtë institucion që në fakt është opozitë e pushtetit ...

Në qoftë se nuk kuptohet ky institucion si opozitë e pushtetit, atëherë ne në fakt nuk kemi bërë kurrëgjë. Kjo është e para. E dyta, shkeljet e të drejtave të njeriut janë të llojllojshme. Ka raste kur dikujt që i duket se i janë shkelur të drejtat, në fakt nuk i janë shkelur fare, kështu që në raportet për rastet e caktuara kur nuk jam i sigurt a ka mundësinë Avokati i Popullit ta bëjë një gjë të tillë, por është mirë që të jepet edhe versioni tjetër, sidomos kur kemi të bëjmë me ankesat kundër shkeljeve që institucionet shtetërore i bëjnë ndaj individit? Ajo që quhet si parim i Romës së lashtë, Auditor alterapars, unë mendoj se do të duhej të qëndronte në secilin raport, sepse ka gjasa që raportet për rastet e caktuara të jenë shumë subjektive, jo të Avokatit të Popullit, por atij që i rrëfëhet Avokatit të Popullit. Do të thotë, në qoftë se ka mundësi që Avokati i Popullit ta japë edhe versionin e alterapars unë do të isha shumë i bindur se ky institucion do të kontribuonte me të madhe në perceptimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, sepse kategoria e dytë, të mos harrojmë e individëve, qytetarëve është edhe ajo që praktikisht mësohen me shkeljen e të drejtave që atij i bëhen dhe ajo duket gjëja më normale në botë, do të thotë e kanë pranuar nënshkrimin.

Ta kuptojmë pra si proces të emancipimit të shoqërisë, që të kuptojë se çka do të thotë e drejtë elementare e njeriut dhe t'i mbajmë sytë hapur. Këtë desha të them. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoj se diskutues tjerë nuk ka. Në sallë janë 68 deputetë. Lus regjinë që të bëhet gati për votim të Raportit të punës së Avokatit të Popullit për vitin 2009.

Votojmë tani.

Konstatoj se me 74 vota “për”, asnjë “kundër” asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin e punës së Avokatit të Popullit për vitin 2009. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

(Reagime nga salla)

Po e kryejmë edhe këtë, pastaj do të ishte mirë se i kemi të shpejta, jemi marrë vesh që mundësisht të kemi sa më pak diskutime.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit të Kosovës për vitin 2009

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin e punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit të Kosovës për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin financiar të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2009 dhe ka rekomanduar miratimin e tij.

Sipas radhës, fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional, Myzejene Selmani apo raportuesi i Komisionit.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur më 27.4.2010, 25.5.2010 dhe 22.6.2010, shqyrtoi dhe miratoi raportin vjetor për vitin 2009 të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, datë 7.6.2010 dhe raportin plotësues të datës 20.5.2010 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM:

1. Të miratohet raporti vjetor i ART-së për vitin 2009 i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, të datës 7.6.2010 dhe raporti plotësues i datës 20.5.2010.

2. Të mbështetet angazhimi dhe largimi i operatorëve ilegalë dhe kërkohet mbështetja e të gjitha institucioneve të tjera dhe njëkohësisht ky angazhim të shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

3. Të bëhet marrëveshje me operatorët e shteteve fqinjë për eliminimin e interferencave të telefonisë mobile,

4. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të shtojë angazhimin në përgatitjen teknike së bashku me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, që sa më shpejtë ta zgjidhë çështjen e kodit shtetëror telefonik,

5. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të ndërmarrë masat e nevojshme që në afat ligjor të implementojë garancionin bankar lidhur me licencën e telefonisë mobile.

6. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit në afat sa më të shkurtër të rregullojë çështjen e operatorëve virtual në pajtim me ligjin, dhe

7. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të vendosë rregull për konkurrencë të barabartë në fushën e telekomunikacionit, me qëllim që të krijojë ambient të qëndrueshëm për investitorët potencialë.

Pasi akoma jam në këtë pikë të rendit të ditës, dua t'i njoftoj të gjithë të pranishmit në seancë se në Kuvendin e Kosovës më datën 19 të këtij muaji ka ardhur një letër apo një aktvendim, arsyetim me të cilën dihet çështja e garancionit bankar prej 16.200 milionëve, të cilën e kemi kërkuar nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit. Në mungesë të kohës, zoti kryesues, kisha kërkuar që deri në përfundim të debatit zyrtarët ligjorë të Komisionit t'ua shpërndajnë të fotokopjuar këtë material gjithë deputetëve të pranishëm në këtë seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në radhë është kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci, në qoftë se ka diçka, por ai nuk dëshiron fjalën.

Nga kryetarët e grupeve parlamentare, zoti Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar pak ministra që keni mbetur,

Kolegë të respektuar deputetë,

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar me vëmendje këtë raport dhe nga ky shënim ka dalë që ne e mbështesim këtë raport si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, është paraqitur Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, drejtues i seancës!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

I ngarkuar në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së për të paraqitur vlerësimin tonë në parim lidhur me raportin e njërës prej agjencive më të rëndësishme siç është ART-ja dhe bazuar në punën e madhe që kemi pasur bashkërisht me kolegët e tjerë deputetë gjatë debateve në Komisionin parlamentar si dhe dëgjimit publik, por edhe me pjesëmarrjen e vetë përfaqësuesve të Bordit të ART-së, nga drejtori, ekspertë dhe të tjerë, mendoj që bashkërisht kemi arritur të trajtojmë këtë fushë të sektorit të telekomunikacionit dhe këtë raport për shkak të dimensionit të madh dhe impaktit të madh që ka në jetën ekonomike të zhvillimit të vendit.

Unë e falënderoj bordin dhe drejtorin për të gjitha informatat të cilat i kanë dhënë në Komisionin parlamentar, në debatet publike, por edhe të gjitha informatat tjera që i ka përcjell me shkrim ashtu siç kemi kërkuar si grup i punës, vetëm e vetëm për të arritur pra për të sqaruar një transparencë të plotë të një pune gati po thuaj se dyvjeçare. E dhashë këtë ekspozë për hir të asaj se që nga shpallja e kushtetutës dhe marrjes së kompetencave të këtij autoriteti të plotë ashtu qysh e jep ligji dhe kushtetuta, është hera e parë që ne, përkundër kërkesave të mëhershme të kemi një raport në Parlamentin e Kosovës lidhur me zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit nga ana e ART-së dhe mungesa e atëhershme na ka marrë mjaftë kohë thashë që ta kompensojmë me informata shtesë të cilat pra i kemi sot në raport.

Prandaj, për mua si deputet dhe në emër të grupit që e drejtoj janë sqaruar çështjet e përkrahim në parim këtë raport. I përkrahim në parim po ashtu të gjitha ato vlerësime të cilat i ka dhënë për politikën lidhur me zhvillimin e këtij sektori, vërejtjet dhe problemet e mëdha që i ka pasur ART-ja, qoftë nga mungesa e kuadrit që nuk e kemi plotësuar si Parlament. Pra, pastaj ka reflektuar shumë në zhvillimet të cilat është dashur më vonë pra të vlerësohen dhe të shihen se çfarë pasoja dhe çfarë defekti kanë sjellë në fushën e telekomunikacionit në Kosovës, të cilat nuk kanë qenë të pakta, dhe vështirë se kompensohen ato gjëra të cilat ndodhin brenda një viti ose një viti e gjysmë në ndonjë sektor siç është ky i telekomunikacionit. Prandaj, ne i përkrahim në parim të gjitha aktivitetet që i ka dhënë ART, lidhur me promovimin e mundësive, pra plasimin e asaj para opinionit, investitorëve të huaj dhe vendorë brenda, në rregullimin për atë sa ka pasur mundësi dhe kohë të plotësimit dhe ndryshimit të ambientit, pra kornizës ligjore si dhe të respektimit të saj për të përcjellë besueshmëri tek investitorët e huaj, tek partneriteti privat-publik, te sektorët e tjerë të cilët duhet të investojnë në fushën e telekomunikacionit si njëra ndër sferat që ka impaktin më të

rëndësishëm dhe mundësinë më të madhe, kapacitetin më të madh pra të zhvillimit tonë ekonomik.

Njëherësh këtu mund të shihen, për ata që dëshirojnë të lexojnë edhe informatat të tjera që kanë të bëjnë me tregun e brendshëm, lidhur me çmimet, shërbimet, pra me konkurrencën dhe atë çka ka ndodhur brenda kësaj periudhe dyvjeçare, si dhe përpjekjet që janë në vazhdim lidhur me atë që u përmend për kodin shtetëror i cili ka një rëndësi të veçantë pra për vendin, për institucionet, për sigurinë dhe për shumë gjëra tjera, aktivitete shtesë që tani besoj është një lehtësim pas asaj që ndodhi në GJND në Hagë, para atij vlerësimi lidhur me pavarësinë nga ana juridike, pra që ky proces të ecën më shpejtë.

Kemi në raport po ashtu një gjendje të paraqitur mjaft mirë në tregun e telekomunikacionit e cila flet lidhur me atë se çka ka ndodhur me telefoninë fikse që realisht janë vërejtje të mëdha për arsye se nuk kemi pasur investime në rrjetin e telefonisë fikse gjatë këtyre dhjetë vjetëve, që ka qenë një gabim pra, brenda atyre që kanë menaxhuar këtë sektor sa i përket kompanive publike.

Kemi zhvillimin në tregun e telefonisë mobile, vlerësimet përkatëse, problemet, por edhe një konkurrencë e cila është e pranishme, e cila sigurisht ka ndikuar në çmim, në treg në cilësi të cilën ne sot e kemi para veti si dhe tregu që ka të bëjë me internetin e kështu me radhë. Një kapitulli i veçantë gjatë gjithë debatit, por edhe në këto shënime të këtij raporti, i jepet pra asaj që më së shumti e ka cenuar sektorin e telekomunikacionit, operatorëve ilegalë në vend dhe asnjëherë nuk është gjetur një zgjidhje, asnjëherë nuk kemi pasur një vendimmarrje, një përkrahje të plotë për ART-në, qoftë më herët, qoftë më vonë, qoftë tash aktualisht, pra që mos të kemi cenim të integritetit ose sovranitetit territorial kur kemi interferim pra të këtyre operatorëve ilegalë në gjithë vendin tonë. Përkundër përpjekjeve e kemi edhe kërkesën e ART-së edhe bordit të tanishëm që të kenë përkrahje më të mëdha të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të largohen, të merren masa dhe t'i përkrahë ky autoritet që ta rregullojë fushën e telekomunikacionit për shkak të impaktit të madh që ka kjo ndërhyrje si ekonomi e zezë në ekonominë e vendit. Miliona e miliona, pra domethënë të hyra në buxhetin e Kosovës që e cenojnë nga këta operatorë ilegalë e mos të flasim për sigurinë dhe për çështjet tjera, të cilat po ashtu janë të ndjeshme në këtë sferë.

Prandaj kërkesa e ART-së, që ka të bëjë me operatorët ilegalë në këtë raport dhe në aktivitetet tjera që ka ndërmarr, mendoj se është mirë politikisht të përkrahët nga Parlamenti, nga Qeveria, për masat e reja që të ndërpritet veprimi i këtyre operatorëve ilegalë, kështu që bashkë me rekomandimet e Komisionit Parlamentar, rekomandimet, po ashtu, të cilat i ka dhënë ART-ja në këtë raport për aktivitet që do t'i ndërmarrë në të ardhmen lidhur me forcimin, vendosjen e rregullit në këtë treg të telekomunikacionit në Kosovë, konkurrencës, transparencës dhe të tjera, mendoj se duhet ta përkrahim dhe si Grup Parlamentar i LDK-së. Ne e përkrahim për arsye se e shohim se edhe vetë objektiva e këtij institucioni që ka kaq peshë të madhe, vetë strategjia që e kanë zgjedhur, aktivitetet që i ka përshkruar, synimet që i ka, duhet të përkrahen pra me qëllim që të kemi një impakt pozitiv në ndërhyrjet që i ka në vetë ekonominë ky sektor i telekomunikacionit, prandaj e përkrahim në parim dhe kërkojmë po ashtu nga kolegët që ta përkrahin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, janë dy të paraqitur. Kush dëshiron fjalën?

E ka fjalën zoti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Më lejoni që edhe një herë të shpreh njëllor brengje për çështjen e ndërtimit të bordeve dhe funksionimit të bordeve, do të thotë, bordet tek ne, realisht nuk funksionojnë ashtu siç duhet, nuk ndërtohen me kohë ashtu siç duhet dhe në qoftë se i shohim vendimet e tyre dhe politikat e këtyre bordeve, e shohim se sa kanë ndikuar këto borde në stagnimin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Prandaj, mendoj që duhet të bëjmë një legjislacion, një ligj i cili bën ndërtimin e bordeve dhe funksionimin e tyre. E kam fjalën dhe tek Bordi i ART-së. Vetëm për ta zgjedhur kryesuesin e Bordit, është nevojitur një kohe e gjatë dhe gjatë asaj periudhe kanë ndodhur shumë fenomene të cilat e kanë dëmtuar, në radhë të parë zhvillimin ekonomik të Kosovës. Nuk dua të përmend se sa është dëmtuar vetë sektori nga operatorët ilegalë, por duhet ta përmend se nga disa informacione që janë prezantuar, kapin shifrën mbi dhjetëra miliona euro humbje që janë bërë vetëm nga operatorët ilegalë në periudha të caktuara. Ne edhe si komision edhe si grup parlamentar e kemi shqyrtuar me kujdes, sepse impaktet e tij në fushën e ekonomisë janë impakte të mëdha dhe kemi shprehur vazhdimisht brengosje të thella për vonesat që janë bërë në bord dhe për politikat që janë bërë në këtë sektor të telekomunikacionit.

I merrni vetëm dy shembuj, atë që e përmendi edhe kolegu Fatmiri më herët që ka të bëjë me garancionin bankar, koha sa ka mbetur ai garancion, pa hyrë në funksion të buxhetit të Kosovës, pastaj operatorët virtual të cilët deri diku nga shumë analiza që janë bërë në komision ka dalë që ka pasur shumë pikëpyetje a janë në harmoni me Ligjin dhe problemet e tjera të cilat po zhvillohen në këtë sektor. Prandaj, edhe si grup mendoj që ky raport i cili është sjellë është raport i vitit 2009, posa është emëruar Bordi. Parimisht nuk kemi ndonjë far gjykimi që brenda kësaj periudhe ka pasur tendenca pozitive për të rregulluar, për t'i eliminuar operatorët ilegalë dhe për të rregulluar frekuencat për të krijuar marrëdhëniet e mira me vendet fqinje në këtë fushë, për kodin që ka mbetur i pazgjedhur i telefonisë tonë, mirëpo në periudhat e kaluara janë bërë shumë lëshime, prandaj, ne nuk ndajmë ndonjë opinion që duhet të mbështetet ky raport për periudhën 2009.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe në bazë të konstatimeve që ka gjetur në këtë raport, këtë raport nuk e mbështesim. Unë do të jap vetëm disa prej vërejtjeve pse ne konsiderojmë se raporti nuk i përmbushë kushtet dhe kriteret, sepse pastaj edhe kolegët e mi do të flasin për fusha të veçanta veç e veç.

ART-ja nuk ka realizuar detyrimet e saja ligjore, andaj edhe mund të vlerësohet më mirë të them si institucion i dështuar. Raporti nuk paraqet gjendjen reale në terren, por përshkruan dëshirat e Bordit të ART-së, dhe as objektivat që parasheh ligji. Këtu kam parasysh, në radhë të parë operimin e operatorëve ilegalë në territorin e Kosovës, që ART-ja nuk ka arritur që ta zgjidhë këtë problematikë tash që shumë kohë, ndërkaq është e thirrur në mbështetje të ligjit që të bëjë diçka të tillë. Shkaku i mosveprimit dhe mos përmbushjes së obligimeve ligjore të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, Buxhetit të Republikës së Kosovës i janë shkaktuar humbje me miliona euro.

Po ashtu, për shkak të mos përmbushjes së këtyre obligimeve nga ana e ART-së, po pësojnë konsumatorët. Unë do të ndërlidhem edhe në rekomandimin nr. 2 të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, i cili thotë: Rekomandon Kuvendin

ta mbështetë angazhimin dhe largimin e operatorëve ilegalë dhe kërkohet mbështetja e të gjitha institucioneve tjera dhe njëherit ky angazhim të shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Ky është obligim i ART-së, nuk është obligim i Kuvendit. Kuvendi ka hartuar ligjet dhe ka nxjerr rregulla për veprim, prandaj, ART-ja është e obliguar në pajtim me ligjin që të veprojë në mënyrë që të bëjë eliminimin e të gjithë operatorëve ilegal në vend. Edhe një herë po theksoj se ky raport nuk e gëzon mbështetjen e Grupit Parlamentar të AKR-së. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë, konsideron edhe pse me shumë vonesa, që do të thotë më shumë se dy vjet, nuk është raportuar në Kuvend, nga ART-ja, më në fund ky raport është kompletuar.

Shkaqet e vonesës së një raporti të ART-së, janë tani për të gjithë të njohura, vonesat gjatë vitit 2009, të organizimit dhe kompletimit të ART-së, gjë që e ka dëmtuar dukshëm dhe ka krijuar pasoja në sektorin e telekomunikacionit që ka rëndësi të veçantë jo vetëm për ekonominë, por edhe për të gjithë qytetarët. Në raport shihet se që nga prilli i këtij viti, pas një pune përgatitore ART-ja, ka çmontuar kontraktorë ilegalë dhe ua ka sekuestruar pajisjet kryesore telekomunikuese, gjithmonë duke përjashtuar veriun. Kështu 26 stacione bazë nuk kanë rikthyer në funksion, sepse po flitet se ka rikthim të sinjalit pjesërisht.

Se sa do të jetë e suksesshme ART-ja, në fazën e dytë të shkyçjes së operatorëve ilegalë, mbetet të përcillet nga përkrahja politike e institucioneve relevante, si institucionet vendore, KFOR-i, EULEX-i dhe ICO. Edhe pse ART-ja, ka kompetenca për tërë territorin e Kosovës, mirëpo realizimi i veprimeve të tyre varet nga mbështetja e institucioneve relevante. Vazhdimi i aktiviteteve komerciale të operatorëve ilegalë, po e sfidon mandatin ligjor dhe atë me nevojën e ekzistimit të rregullatorit karshi operatorëve të licencuar dhe hapjes së liberalizimit të mëtutjeshëm të tregut të telekomunikacionit si dhe seriozitetit e ka sfiduar interesin e investitorëve kredibil në sektorë, qoftë edhe në procesin e privatizimit.

Çështje shqetësuese që mbetet në këtë raport, është çështja e kodit shtetëror të telefonisë. Arsyeja se nuk jemi anëtarë të OKB-së që nuk kemi të drejtë ta kemi kodin, nuk është e qëndrueshme, natyrisht është e ditur se kodi telefonik merret prej IT-us. Shumica e anëtarëve të saj e votojnë dhe duhet të kenë mbështetje mbi 50% të anëtarëve të IT-us, andaj, në rrethana shumë të favorshme të krijuara tani për vendin tonë, konsiderojmë dhe kërkohet një strategji e qartë për t'ju qasur IT-us, është më se e nevojshme nga ART-ja.

Shqetësime shumë herë të ngritura nga deputetët këtu në Kuvend, nga ana e deputetëve lidhur me punën e ART-së, e që ka pasur të bëjë me një garancion bankar prej 16 milionësh, janë treguar të arsyeshme duke pasur parasysh që edhe vetë përfaqësuesit e ART-së kanë deklaruar se për Bordin çështja e garancionit ka qenë temë e panjohur deri kur është shtruar pyetja parlamentare. Gjithmonë po i referohem raporteve që i kanë bërë vetë përfaqësuesit e ART-së.

Për Kuvendin, kjo duhet të jetë tejet shqetësues, nga se shpjegimet që jep ART-ja nuk janë fare inkurajuese. Sipas ART-së, garancia ka validitet deri në vitin 2012, pra shteti nuk rrezikon

humbjen e parasë nga ai proces, po rrezikon shumë në aspektin legal se është procedurë shumë komplekse. Shtrohet pyetja, nëse është procedura shumë komplekse nga aspekti legal dhe nuk arrin të përmbyllet gjer në afat, a do të thotë se kanë mundësi të humbin këto 16 milionë?

Gjithashtu, shumë paqartësi dhe dilema mbetin me licencimin, gjegjësisht marrëdhëniet Dardafon-Dardafonet, sidomos duke pasur parasysh që baza ligjore, Ligji për telekomunikacion nuk lejon asnjë licencë të transferohet, gjegjësisht të bëhet. Andaj sipas ART-së, e gjithë dosja e Dardafonit dhe Dardafonetit është në duar të hetuesisë dhe pritet të shqyrtojnë dhe ta zbardhin rastin. Në raport janë paraqitur nevojat për hartimin e një ligji të ri, i cili sipas agjendës legislative parashihet nga fundi i këtij viti në Kuvendin e Kosovës. Si mangësi serioze të ART-së gjatë vitit 2009 e konsiderojmë mungesën e fillimit të analizës dhe monitorimit të tregut që është obligim- ushtrimi i ART-së, që nuk është kryer edhe më herët, konsiderojmë se ART-ja duhet të ketë objektivë monitorimin e tregut në këtë vit.

Duhet theksuar se mungesa që t'i silltet Komisionit, Raporti i auditimit të ART-së, duke pasur parasysh që ka qenë i disfavorshëm për punën e ART-së, fatkeqësisht Lidhja Demokratike e Dardanisë ngre dilemat tona të arsyeshme se ky agjencion po përballet me shumë sfida, dobësi dhe keqpërdorime në punën e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ne emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zotëri kryesues i Parlamentit!

Ju përsëritet juve, edhe stafin tuaj, edhe kabinetin e Qeverisë desha për ta përsëritetur, por shqyr “këmbët e lehta, faqja e bardhë”.

Grupi Parlamentar “7+” e ka analizuar këtë raport dhe me një interesim shumë të madh e ka lexuar, prandaj e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kërkoj falje për ndryshimin e radhës.

Në emër të SLS-së, a ka të paraqitur? Nuk ka. Atëherë deputetja Vezira Emrush nga Grupi Parlamentar për Integritet.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala, lepa na datu reč!

Opet pred nama je jedan jako važan izveštaj TRA o stanju na tržištu telekomunikacija.

Mi znamo da je ovo obaveza TRA na osnovu Zakona o telekomunikacijama za ovaj izveštaj, to je Zakon br. 2002/7, koji reguliše kako treba da se stvore uslovi za liberalizaciju tržišta telekomunikacije. Iz izveštaja vidimo da je tržište regulisano, kada su pokrivena tri polja, kao što je polje fiksne telefonije, polje mobilne telefonije, polje interneta i isto, ovaj Bord ustvari reguliše i pravo na korišćenje radio frekvencija. Neću puno da opterećujem poslanike, ali moram da kažem da je ovaj izveštaj jako siromašan, da nema prave stvari, da ne analizira potencijalno moguća sredstva koja mogu da pune budžet Kosova, koji sam priznaje da ima mnogo, da kažem, ilegalnih korisnika, da moram da kažem da je čak ovaj Bord i ova Komisija zahvalna za te ilegalne korisnike.

Mi znamo da je ova Komisija, da je ovaj Bord i TRA su prvenstveno namenski tu da pune budžet Kosova. To je budžetska organizacija, znamo da troši negde oko 1 milion i 400 i nešto za plate, robe i usluge, da je zaradila negde oko 5.900.000 eura i jako bitno, ima opis koliko je usluga i licenca dala, kojim operatorima, ali nešto što jako zabrinjava, ja ću da pročitam iz izveštaja a to je, operatore neću da kažem da ponavljam iz izveštaja, verujem da su ovo kolege pročitale i da građani znaju da je to javno preduzeće PTK, da je to IPKO, Kujtesa, ali jako, jako važno je to što se ovde kaže da se, kada je u pitanju tržište mobilne telefonije, da su licencirana do sada samo dva operatora, ali kaže da je Dukađini koji funkcioniše na osnovu komercijalnog dogovora sa IPKO.NET i Dardanija ili Dardafon je postigao dogovor sa javnim operatorom PTK Vala!

Ja smatram da ovaj Bord ne sme da da tržište, da kako da kažemo, kako da bude jasno građanima, nakupcima. Ne može ništa da se da sa dogovorom, sa razgovorom, sve to mora biti službeno i jedini subjekat koji može da da licencu i ovim operatorima je samo ova Komisija. Znači, ja ovo dajem do znanja da je TRA sam dozvolio ilegalne potrošače. Znači, moramo tržište da regulišemo sa posebnim komisijama, sa mehanizmima koja ova komisija bira i moramo da budemo jako jasni na tržištu iz razloga što imamo operatore koji su zainteresovani izvana da bi bili prikladni, jasni investitorima koji hoće da ulažu na Kosovu.

Ovo kažem iz razloga zato što je Vlada napravila proces plana privatizacije, gde znamo da su najveći, najveći deo budžeta za rad ili dividende i ostale usluge telekomunikacije, tako da ova Skupština i ova država treba da ima jako, jako otvoren sluh za ovu mrežu ili za ovu sferu prihoda. Da ne bi bilo zloupotrebe, znači ova TRA treba da se definiše jako dobro, da se zna ko daje licence, koji su mehanizmi i da ne smemo da stvaramo ilegalne korisnike ili davaoce brojeva i to što može na nezakoniti način da koristi kosovsko tržište.

Mi ćemo još dati doprinos kao grupa kada je u pitanju ovaj izveštaj, delimično moramo da kažemo da se ogađujemo od ovoga jer vidimo da je taj koji krši zakon, upravo ova Komisija, tako da imamo neke dileme i kao komisija mislim da nećemo u celosti da podržimo ovaj izveštaj. Hvala, lepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare vlerësimet janë dhënë, tani kemi disa të paraqitur. Mendoj se ne nuk mund ta përfundojmë, në qoftë se vazhdojmë menjëherë, por propozoj që ta marrim pauzën e drekës. Pra, po e lëmë që ta vazhdojmë seancën në orën 14:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimit të seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës

KRYETARI: Vazhdojmë me debatin.
Fjalën e ka Sanije Alijaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në raportin e ART-së për vitin 2009, vlerësohet se Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, veprimtarinë e vet e bazon në legjislacionin primar që është Ligji i telekomunikacionit dhe atë sekondar, në rregullimin e telekomunikacionit në Republikën e Kosovës, që të krijojë një treg të hapur i cili do të tërhiqte investitorët në këtë sektor shumë të rëndësishëm për Republikën e Kosovës.

Ky sektor, direkt, siguron zhvillimin e shoqërisë informative në përputhje me standardet e BE-së. Në Ligjin për telekomunikacionin detyrat dhe përgjegjësitë për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit, i takojnë Ministrisë së Transportit, që cakton politikat e ART-së e cila është e detyruar ta zbatojë Ligjin në telekomunikacion dhe politikat e hartuara nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Siç paraqitet në Raport, legjislacioni aktual nuk reflektor qasje adekuate ndaj dinamikës së zhvillimit tregut të telekomunikacionit dhe nuk është në përputhshmëri me direktivat e Komisionit Evropian, prandaj duhet plotësuar dhe ndryshuar që t'i mundësojë ART-së veprim sa më efektiv.

Edhe pse raporti i ART-së plotëson kriteret dhe standardet bazuar në ligj, me këtë rast kemi të bëjmë me vlerësimin e punës së bordit për dy muaj, sepse nga 1 janari deri me 1 tetor 2009, ART-ja, ka funksionuar vetëm në kapacitetet administrative.

ART-ja, nga janari deri në shtator 2009, në mungesë të funksionimit të bordit nuk ka mund të arkëtojë shumën prej 5.913.203 euro, e me ardhjen e bordit të ri, pas vlerësimit të gjendjes, ka filluar adresimin e vendimeve për arkëtimin e të hyrave nga operatorët e licencuar me efekt retroaktiv, duke i caktuar modalitetet dhe afatet për realizimin e tyre. Bordi i ART-së, qysh në start, formoi grupet punuese dhe autorizoi fillimin e punës për tri projekte kapitale, miratoi vendimin për vazhdimin e funksionimit të Komisionit për licencim, autorizim dhe monitorim, i cili miratoi licencën për shërbimet fikse kombëtare- Konet, licencën për shërbime ndërkombëtare, licencën për shërbime me vlerë të shtuar për kompaninë automatike dhe 5 licenca për shfrytëzimin e frekuencave.

ART-ja, ka licencuar tre operatorë: PTK-në ose telefoninë fikse në vitin 2004, IPKO 2006, dhe Konet 2009. Sa i përket shtrirjes së rrjetit, kanë arritur një mbulueshmëri deri në vitin 2009, rreth 98% e territorit të Republikës së Kosovës. Në kushtet e operimit të operatorëve vërehet qartë një konkurrencë efektive në treg, duke ofruar me këtë rast, siç pasqyrohet në raport çmime më të favorshme për konsumatorë deri në 50% më të lira. Por, edhe përkundër kësaj dhe përkundër faktit që kemi 3 operatorë mobil, dy privat IPKO dhe Zmobil, dhe një shtetëror VALA, prapëseprapë nuk e kanë liberalizuar thellësisht tregun.

Për ndaljen e veprimtarisë së operatorëve të palicencuar, bordi ka bërë planin operacional për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në pajtueshmëri me Ligjin për ndaljen, bllokimin e operatorëve të palicencuar dhe të paautorizuar. Përkundër të kësaj, nuk ka arritur të përdorë qasje profesionale dhe konkrete në eliminimin e konkurrencës së fqinjëve përreth që pajisjet e tyre të bllokohen dhe të vendosë antena gjithandej Kosovës për funksionimin e operatorëve tanë, derisa të tjerët interferojnë në mënyrë të theksuar në frekuencat e tyre të dedikuara për operatorët ilegalë.

Lejimi i funksionimit edhe më tej i këtyre operatorëve i shkakton humbje të mëdha buxhetit të Kosovës, madje ART-ja ka dështuar ta rregullojë çështjen e telefonisë fikse, duke mos investuar asgjë për dhjetë vjet për ta bërë më efektive. Në tërë territorin e Kosovës lejohet të operojë Telekom i serb. Bazuar në Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2009, buxheti i ART-së për vitin fiskal 2009 është 1 milion e 471 mijë e 488 euro, që në raport pasqyrohet mjaft qart se si janë shpenzuar këto mjete për funksionimin e tij. Por, për dallim nga raportet tjera, në këtë raport bordi prezanton planin e punës për vitin 2010, i cili, mes tjerash, paraqet strategjinë dhe objektivat për implementimin e projekteve kapitale. Prezanton planin e trajnimeve, vizitave studimore, pjesëmarrje në konferenca, work-chop gjatë vitit 2010, që lë për të kuptuar një angazhim serioz për një punë më

efektive në të ardhmen. Raporti plotëson standardet, por rezultatet e prezantuara në të janë simbolike. Raportin e përkrah duke kërkuar që ART-ja në vitin 2010 të realizojë planin e veprimit dhe strategjinë për realizimin e projekteve kapitale për të krijuar një treg të lirë dhe konkurrues në telekomunikacion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zef Morina. Zef, këqyr nëse mund ta racionalizosh kohën.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Unë dëshiroj që të jem vërtet ndoshta më i shkurtër, por të jem pak më konciz në disa gjëra të cilat është dashur dhe duhet ne bashkë si deputetë t'i shtjellojmë.

Raporti i ART-së, në përgjithësi përmban shumë gjëra, të cilat ne si deputetë dhe si komision i kemi kërkuar, por në fakt ky raport është për një periudhë kur ky bord nuk ka funksionuar, domethënë, vetëm një person nga ky bord, ka qenë pjesë e bordit ekzistues. Ajo që është me rëndësi të thuhet, janë dhënë, domethënë, punët të cilat janë kryer, por fatkeqësisht shumë gjëra të cilat është dashur të paraqiten në këtë raport, nuk janë paraqitur, sepse ne të gjithë e dimë që raporti i fundit i ART-së, ka qenë në vitin 2007. Domethënë, ky është për vitet 2007-2008 dhe 2009, që i përfshinë tri vjet, pra nëse e shikojmë punën e cila është dashur të kryhet gjatë këtyre tri vjetëve, raporti është shumë i mangët. Sido që të jetë, bordi ekzistues shihet se e ka marrë punën me seriozitet dhe vërtet shpresojmë që ky bord do të kryejë detyrën sipas ligjit.

Në shikim të parë, unë e kam një vërejtje tek logoja e ART-së, e cila me vetë prezantimin e saj e shkel Ligjin për telekomunikacion. Ligji për telekomunikacion shumë qartë e jep, e përcakton që ART-ja është në kuadër të Ministrisë, autoriteti i pavarur për kryerjen e detyrave, por i përgjigjet Ministrisë, ndërsa në logo është fshirë Ministria, por ka hyrë vetëm ART-ja. Kjo është çështje si duket pak teknike, por e ka edhe kjo domethënien e vet shumë të madhe.

Veprimi i ART-së, gjatë kësaj kohe prej kur ka ardhur bordi i ri të japë për të kuptuar që do të jetë shumë e përkushtuar që në Kosovë të ketë rregull në fushën telekomunikuese, sepse një gjë e tillë vërtet ka munguar për shumë vjet, natyrisht, të gjithë i dimë edhe problemet, arsyet pse ka ardhur deri te ajo.

Këtu, të them të drejtën gjërat të cilat është dashur të paraqiten në këtë raport, nuk janë paraqitur, por ne si Komision dhe si deputetë, është dashur që pak a shumë t'i shfletojmë dhe t'i shikojmë se ajo që është shumë me rëndësi të ceket, ART-ja e ka një detyrë të cilën duhet ta kryejë me përkushtim, krijimin e kushteve të mira në fushën telekomunikuese dhe respektimin e ligjit për të gjithë njëjtë.

Ne e dimë që, sipas ligjit është dashur të kemi edhe një operator të dytë të telefonisë mobile. Tash shihet që edhe gjatë asaj kohe ka pasur shkelje, ka pasur veprime të cilat, si duket më vonë do të paraqiten edhe pengesa për shkak të veprimeve joligjore dhe mund të shkojnë edhe në gjykata, për të cilat mund të kenë pasoja vetë ART-ja dhe besa edhe institucionet vendore. Në tenderin e dytë i cili është licencuar, domethënë operatori i dytë, me 23 shkurt 2007, në rend të parë është bërë shkelje e ligjit. Nuk është raportuar për këtë çështje, përveç atij garancionit të famshëm që ende po diskutohet, domethënë kanë marrë pjesë një konkurrues me dy emra, gjë që është bërë shkelje e ligjit dhe nuk është dashur të lejohet kjo dhe për këtë arsye ka ardhur te prolongimi i këtij garancioni ose i kësaj letre me vlerë apo sido që të jetë dhe sot kemi një material i cili na është

shpërndarë tash, kur kompania që është tërhequr, ka bërë padi kundër ART-së, gjë që është vërtet shumë për t'u brengosur.

Sido që të jetë ne, si institucione dhe si komision kemi kërkuar nga ART-ja, që të gjitha problemet t'i paraqesë në mënyrë që ne të jemi krah saj, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë që fushën telekomunikuese ta kemi vërtet në nivel të vendeve të rajonit. Interferimet e operatorëve të huaj, gjegjësisht operatorëve që janë jashtë kufijve të Kosovës, janë shumë më të mëdha se në të gjitha vendet fqinje, kjo për shkak që ART-ja, nuk ka qenë në gjendje që t'i bllokojë ato, qoftë me marrëveshje bilaterale në mes operatorëve ose mes ART-së, ose vendeve tjera, qoftë edhe të krijimit të kushteve teknike që këto të bllokohen dhe sigurisht, secili prej nesh, si të kalojë, ndoshta jo fort afër kufirit, por ka probleme me telefoninë e vet për shkak interesimeve. Pra, të mos flasim për operatorët ilegalë të cilët janë duke punuar, janë duke vepruar, edhe përkundër angazhimit të ART-së për t'i larguar nga tregu, jo vetëm ata që kanë antenën, i kemi edhe në vendet tjera të cilat janë lëvizëse dhe kanë të bëjnë me probleme shumë të mëdha me telefoninë, në përgjithësi në Kosovë.

Unë shpresoj që këtë raport, pa marrë parasysh që nuk është raport i këtij bordi dhe i cili ka shumë vërejtje, ne duhet ta mbështesim dhe duhet të kërkojmë nga ART-ja, që raportet e tilla të jenë shumë të përgatitura, jo vetëm për çështje financiare që kanë dhënë, por ajo çka është më me rëndësi, është çështja teknike, sepse kjo është pika kryesore.

Vërejtja jonë ka qenë edhe tek zbatimi i ligjit në dhënien e licencës ose në licencimin e operatorëve virtual. Nuk kanë qenë bindës në përgjigjen që na kanë dhënë. Sido që të jetë, unë dhe besoj edhe kolegët e mi do ta përcjellim me kujdes punën e ART-së, dhe raporti tjetër i cili do të na vijë sigurisht vitin e ardhshëm do të jetë shumë më i begatshëm se ky raport, sido që të jetë, unë e mbështes. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kisha filluar fjalën time me tërheqjen e vërejtjes për mospjesëmarrjen e ministrit këtu, meqenëse po flasim për një fushë e cila është në kaos, pra për fushën e telekomunikacionit, që është në përgjegjësi të ministrit. Patjetër që ministri duhet të jetë këtu për të dhënë sqarimet e nevojshme me interes për qytetarët e Kosovës, sidomos kur është fjala për kodin shtetëror. Lidhur me këtë ministri duhet të tregojë se se çfarë ka bërë deri më sot ose çfarë e ka mendjen të bëjë.

Zoti kryetar, kështu si po synoni të zhvilloni debatin në të vërtet do të jetë një debat ndërmjet ne, deputetëve pa një interaksion të nevojshëm dhe të domosdoshëm me Qeverinë. Nëse ministri për ndonjë arsye të rëndësishme shtetërore nuk ka mundur të vijë, së paku ta kishte autorizuar dikë tjetër. Sa i përket Raportit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2009, që në fillim është e dukshme se është një raport i mangët. Arsye kryesore është mungesa e vetë bordit të ART-së, i cili duhet t'i kryente punët për rregullimin e kësaj fushe. Pra, si mekanizëm rregullator, ky bord i ART-së nuk ka funksionuar për 9 muaj dhe kjo natyrisht është shprehur menjëherë në mungesën e aktiviteteve të nevojshme, apo thënë më saktë të mos aktivitetit për 9 muaj. Sipas ligjit, anëtarët e bordit duhet të takohen së paku një herë në muaj. Takimi i parë i bordit është bërë në tetor të vitit 2009, që do të thotë se bordi është takuar për herë të parë pas 10 muajve. Mund tas merrni me mend se sa shumë punë kanë mund të kryejnë brenda dy muajve.

Ajo çka vërehet nga aspekti ligjor, është se mungon korniza adekuate ligjore, së paku korniza rregullatore në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe në botën moderne dhe atë të BE-së, korniza rregullatore plotësohet dhe më shumë quhet si Ligj për komunikime elektronike, jo si ligj për telekomunikacion.

Po ashtu, në mungesë të bordit nuk janë bërë aktivitetet e rëndësishme ligjore, siç është marrja dhe nxjerrja e rregullave administrative dhe udhëzimeve për zbatimin e ligjit, që gjithashtu ka shkaktuar një kaos. Nga gjithë kjo më e rëndësishmja është se mosaktiviteti i tyre ka dëmtuar në radhë të parë qytetarët e Kosovës.

Kosova nuk ka kod të vetin shtetëror dhe kjo po i shkakton dëme buxhetit të Kosovës. Kurse, operatorët aktual kryesisht shfrytëzojnë kodet e shteteve tjera, Vala të Monakos 377, IPKO të Sllovenisë 386, kurse ajo fikse e Serbisë 381. Prandaj, kërkoja të jetë ministri këtu, që të tregojë se ekonomikisht sa po i kushton kjo buxhetit të Kosovës, çfarë dëmi buxhetor po iu bëhet qytetarëve të Kosovës? Për më tepër, operatorët e palicencuar që po operojnë, jo vetëm që po e dëmtojnë ekonomikisht buxhetin e Kosovës, por antenat dhe aparaturat përcjellëse dëmtojnë edhe shëndetin e qytetarëve të cilët jetojnë përreth. Operatorët e pa licencuar po iu shkaktojnë dëme të mëdha operatorëve të licencuar, diku llogaritet 4 deri në 5 milionë euro në vit, kurse buxhetit i shkaktojnë dëm diku 1.5 milionë euro në vit.

Ndërsa, sa i përket shkeljes së ligjit, po veçoj mosrespektimin ligjor të procedurave, gjegjësisht shkeljen e ligjit lidhur me kalimin e licencës nga kompania Dardafon tek Dardafonet. Dhe, në fund, ndoshta një nga zhvillimet kryesore të veprimtarisë së kësaj periudhe të ART-së, ka qenë legalizimi i të gjitha licencave të lëshuara nga bordi i mëparshëm, pra në periudhën dhjetor 2008- shtator 2009. Pastaj, legalizimin dhe formatizimin e katër licencave dhe atë licencës për shërbime fikse kombëtare për kompaninë NET, shërbimet telekomunikuese ndërkombëtare, prapë për kompaninë NET dhe licencën për nyje dhe pajisje telekomunikuese ndërkombëtare për kompaninë Konet. Pasiqë, kjo është bërë në shkurt të vitit 2009, është veprim antiligjor sepse nuk kemi pasur bord të kompletuar. Ndërsa bordi ka përgatitur edhe një organogram. Unë mendoj se është dashur të raportohet se çfarë përmban ky organogram, cila është struktura e tanishme e ART-së dhe a ka paraparë ART-ja rritjen e numrit të punëtorëve, sepse në qoftë se ka paraparë një numër më të madh të punëtorëve, atëherë duhet rrezitur edhe buxhetin dhe kjo mëtej bëhet përgjegjësi edhe e Kuvendit të Kosovës.

Sa i përket buxhetit të ART-së për vitin 2009, ka qenë afërsisht 1 milion e gjysmë, të hyrat vetjake që ka realizuar 671.000, kurse shpenzimet kapitale 800.000 dhe ky kryesisht ka pasur të bëjë me projektin kapital, projektin për menaxhimin dhe monitorimin e frekuencave, i cili as nuk është i vitit 2009, por është bartur nga viti 2008. Një mungesë të madhe të funksionimit të bordit për gjithë ata muaj ka qenë mos mundësia e arkëtimit të afër gati 6 milionë eurove. Në përgjithësi, unë mbështes rekomandimet të cilat i ka dhënë komisioni funksional dhe mendoj se ky raport kaq i mangët nuk duhet sot të votohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Duke marr parasysh se raporti i ART-së, është raport i cili duhet të vijë edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga organet e pavarura të cilat formohen nga Kuvendi i Kosovës, mund të them se raporti është përgatitur në bazë të dispozitave të Ligjit të telekomunikacionit, mirëpo i gjithë raporti duke marr parasysh raportin e vitit 2008, dhe ky raport është përgatitur në distancën

kohore 2009-2010, është mjaft i mangët. Ka shumë pak aktivitete. Gjithë aktiviteti i ART-së përfshihet vetëm në vitin 2010, duke marr parasysh se vendosja e Bordit të ART-së, është bërë me vonesë nëntë muajore.

Çështja e veprimit dhe e funksionimit të dy operatorëve D3 dhe Z-mobile, a po më mirë të themi të operatorëve virtual, gjatë diskutimit nga Bordi i ART-së në Komision mund të them se prapëseprapë të lë dilema se a është në bazë të Ligjit të telekomunikacionit. Duke marrë parasysh se nga përvoja e mëparshëm e bordit të kaluar, shishen edhe sot, ky raport për garancionin bankar i cili paraqet punën e bordit të kaluar dhe paraqet mënyrën e dhënies së licencave në të kaluarën se sa ka qenë funksional bordi i mëparshëm.

Në raport flitet edhe për mungesën e infrastrukturës ligjore ku mund të themi se gjatë monitorimit të ligjit, të cilin duhet ta zbatojë ART-ja, kemi parë se mungesa më e madhe ka qenë nga mos zbatueshmëria e ligjit se sa mungesa e ligjit. Mund të them se të gjitha rekomandimet e Komisionit Parlamentar i përkrah dhe njëkohësisht kërkoj që të gjitha këto rekomandime të cilat u dhanë sot për Bordin e ART-së, të jenë vendime që në të ardhmen mos të kenë humbje në buxhetin e Kosovës, për arsye të mos funksionimit të ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar për fjalën. Pasi që fjalimi im nuk dallon në esencë nga kolegët deputetë që folën në emër të grupit parlamentar, do ta dorëzoj në administratë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetit Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për hir të respektimit të marrëveshjes të arritur në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, diskutimin tim të përgatitur po e dorëzoj në formë të shkruar. Ju faleminderit.

Diskutimi i Abdyl Ymerit i dorëzuar me shkrim:

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit në fushëveprimin e tij ka një rol të rëndësishëm në rregullimin e tregut të telekomunikacionit, të krijojë një konkurrencë të lirë, të drejtë dhe të paanshme e cila do të tërheqë investitorë potencialë të cilët do të ndikonin në zhvillimin e këtij sektori, i cili është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Zhvillimi i këtij sektori në mënyrë direkte do të ndikojë në zhvillimin e shoqërisë informative në përputhje me kërkesat e tregut dhe standardet e miratuara në Bashkimin Evropian.

Prandaj, është koha që ART-ja dhe qeveria të punojnë në drejtim të avancimit të kornizës rregullative nga korniza rregullative e 1998 me të cilën është punuar deri tani në kornizat e 2003 *acquis communautaire* dhe 2007 *acquis communautaire*, të cilat janë me të avancuara dhe konform kornizave rregullative të BE-së.

Shikuar në përgjithësi në raport kemi një përshkrim me po thuaj se të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga ART-ja, të cilat kanë të bëjnë me politikat në sektorin e telekomunikacionit, me përshkrimin detal të gjendjes, zhvillimit, modernizimit dhe progresin e arritur në këtë fushë që ka ndikuar në rritjen e të hyrave nga shërbimet e sektorit të telekomunikacionit, por edhe problemet të cilat në

vazhdimësi po e përcjellin këtë sektor, sidomos operimi i operatorëve ilegalë, të cilët në mënyrë direkte dëmtojnë buxhetin e Kosovës e në të njëjtën kohë ngulfatin edhe konkurrencën e lirë.

Në raport shihet se kemi pasur një periudhë nëntëmuajore të funksionimit të ART-së pa bordin udhëheqës që ka ndikuar në mosrealizimin e objektivave të ART-së për vitin 2009.

Ndërsa bordi i ri i emëruar nga 1 tetori 2009, ka pasur një periudhë të shkurtër kohore për përmbytjen e obligimeve dhe detyrave, por shihet që përqendrimi i tyre në funksionalizimin dhe marrjen e vendimeve të ndryshme, të cilat kanë ndikuar në krijimin e kushteve për liberalizimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e tregut të telekomunikacionit.

Në raport kemi një përshkrim në detale sa i përket tregut të telefonisë fikse, mobile dhe tregut të internetit dhe shërbimet brezgjëra.

Nëse bëhet një analizë komperative në mes të telefonisë fikse dhe mobile, shihet se kemi një dallim të madh si për nga numri i konsumatorëve, mbulueshmëria e hapësirës, e po ashtu edhe nga shkalla e penetrimit që për telefonin fikse është 5%, kurse për telefonin mobile 70%. Nga kjo shihet se telefonja mobile ka një trend pozitiv dhe rritje të vazhdueshme krahasuar me telefonin fikse e cila ka ngecje.

Licencimi i katër operatorëve të telefonisë mobile dhe tre operatorëve të telefonisë fikse në Kosovë, ka ndikuar që të kemi një konkurrencë më të plotë dhe shërbime më të mira dhe çmime më të lira për abonentët.

Ndërsa 11 operatorë janë të licencuar që ofrojnë shërbime të internetit.

Do të përfundoj fjalimin tim duke kërkuar nga ART-ja që të bëjë një plan operacional për ndalimin e veprimit të operatorëve ilegalë, si dhe të punohet në drejtim që Kosova të ketë kodin e saj telefonik thirrës ndërkombëtar.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar!

Do të përfill aludimin e kolegëve të mëparshëm që unë do të jem konciz. Në parim u deklarua edhe shefi i Grupit Kuvendor se nuk pranohet ky raport, e unë do të kisha dhënë nja dy objeksione. Për shembull, konkretisht, ju lutem e marrim vetëm përmbajtjen prej faqes 1 deri në faqen 10, ka vetëm përshkrime të thata, ajo quhet copy paste, kopjohet prehet edhe qitet, panevojshëm, krejtësisht pa nevojshëm, ndërsa në pikat që janë neuralgjike, shumë të ndjeshme, shumë sensitive, nuk ka asgjë prej asgjëje, konkretisht 44 ku thotë operatorët e palicencuar. Ja çka shkruan këtu, do të thotë shkruan kurrgjë, kurrfarë shpjegimi nuk është dhënë, a këtu është dashur të jepet shpjegim përmbajtjesor. Për shembull thotë: Bordi i ART-së, menjëherë pas marrjes së detyrës me prioritet absolut e tjera e tjera, që nuk ia vlen të lexohet. Bordi i ART-së gjatë muajit nëntor ka autorizuar grupin funksional me objektivë inicimin dhe kompletimin e incizimeve e tjera e tjera edhe nuk thotë asgjë për një efekt apo jo, asnjë efekt sa i përket bllokimit të operatorëve të palicencuar e kjo është e dhimbshme, është e dëmshme për ekonominë, por edhe për politikën e vendit tonë se po del se ne jemi të paafte për ta zbatuar ligjin.

Prandaj, kjo është poenta esenciale sipas meje edhe nuk ka kurrgjë për sa i përket plaçkitjeve të shfrytëzuesve të shërbimeve, të cilët në mënyrë pothuajse publike, plaçkiten në çmimet, të cilat apriori shkurtohen edhe po asisoj nuk ka telefon i cili nuk përgjohet sistematikisht, e këto janë ilegale që dikush do të thoshte antikushtetutare po se po. Prandaj, ky raport do të duhej të përqendrohej në këto pika edhe jo ta bënte një përshkrim, por disa konstatime të cilat do t'i referoheshin ndonjë rezultati, sado qoftë të prekshëm. Këto nuk i ka ky raport, prandaj ky me të vërtetë nuk do të pranohej, së pakut prej Grupit Kuvendar të AKR-së. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Megjithatë ne raportin me rekomandime nga Komisioni e kemi. Të votohet raporti me rekomandime.

Edhe dy diskutuese janë lajmëruar pas kohe. Ne vazhdojmë, vazhdojmë me votimin.

Në sallë janë 62 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim Votojmë tash:

(Reagime nga salla, me fishkëllimë)

Konstatohet se me 30 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet Raporti me rekomandime.

Pika e dymbëdhjetë.

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institucionit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009

Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin për shqyrtim dhe miratim.

(Përgjigje e kryetarit, deputetit që reagon nga salla: Për ata kush i ka shtie në xhep, ti e di, me tërë vëllazëritë tu ke qenë aty)

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009, dhe ka rekomanduar miratimin e tij.

A e do fjalën kryetari i komisionit funksional, në emër të grupit parlamentar.

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, por njëkohësisht edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kanë shqyrtuar raportin për Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe me rastin e shqyrtimit kanë konstatuar se raporti edhe pse ka ardhur pak me vonesë në Kuvendin e Kosovës, megjithatë konsiderojmë se i plotëson të gjitha kushtet për aprovim. Vlen të përmendet që me rastin e emërimit të anëtarëve në Këshillin drejtues të Institutin Gjyqësor të Kosovës, ka pasur vonesa për shkak se një kohë e gjatë është dashur që institucionet të cilat parashihen me ligj për emërimin e anëtarëve, nuk kanë propozuar nga radhët e minoriteteve dhe kjo ka sjellë si pasojë që raporti të vonohet.

Unë nuk do t'ju marr shumë kohë, unë do t'i them vetëm dy-tri çështje, të cilat në esencë do ta kishin bërë raportin ndoshta edhe më të mirë se raportin që e kemi prezent. Çështja e parë është, ne në të ardhmen duhet t'i kërkojmë shumë qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e Institutit të Gjyqësisë të Kosovës. Ne i dimë kompetencat që i ka me ligj, janë për trajnime, për përgatitje profesionale të kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë dhe të mos marrë edhe kompetenca tjera të cilat nuk i takojnë me ligj.

Është një çështje tjetër, duhet raport i veçantë, por ndoshta Komisioni për Buxhet, rreth raportit financiar dhe çështja e fundit do të doja që në të ardhmen Këshilli Drejtues ta luajë rolin menaxhues dhe rolin primar që e ka mbi Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe mos të lejojë që në këtë Institut të trajnohen vetëm apo të japin trajnime ata të cilët kanë më së shumti detyra në institucionet e Kosovës nga organet e gjyqësisë, qoftë nga Prokuroria dhe gjykata, sepse po i lënë punët primare që i kanë nëpër institucione. Prandaj si Komision dhe si Grup Parlamentar e mbështesim raportin me këto vërejtje që i dhamë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh se Instituti Gjyqësor i Kosovës është institucion kryesor i trajnimit gjyqësor, i cili ofron trajnime për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës, aktivitete që janë paraqitur në këtë raport për periudhën e vitit 2009, për Grupin Parlamentar të LDK-së, pas shqyrtimit që kemi bërë, mendojmë se aktivitetet e përqendruara në ndërtimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor të Kosovës, e që janë të domosdoshme edhe në këtë proces të reformimit, vlerësohen pozitivisht dhe për këtë arsye i japim mbështetje këtij raporti të punës për vitin 2009, duke përfshirë edhe raportin financiar të shpenzimeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjala është për deputetin Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, kryetar!

Duhet thënë në fillim se ne do ta përkrahim raportin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, më lejoni vetëm të konstatoj se në krahasim me raportet që janë bërë deri më tash, vërehet një cilësi më e mirë në këtë raport edhe sasiore, por edhe me ofrimin e informacioneve të duhura për Kuvendin e Kosovës. Do të thotë, afrohen disa raporte më detajizuese për të parë për së afërmi punën që ka bërë Instituti Gjyqësor i Kosovës. Kjo na bënë që ta përkrahim, por gjithashtu dua t'i them edhe dy çështje që, për bindjen tonë janë të rëndësishme në punën që bën Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Së pari, në raport nuk janë evidentuar asnjë prej vështirësive me të cilat është ballafaquar Instituti Gjyqësor i Kosovës, në vitin për të cilin raportin, ndërsa nga praktikat dihet se ai është ballafaquar me disa vështirësi të cilat nuk i ka ndarë me Kuvendin e Kosovës. Realisht, do të duhej, jo vetëm për shkak të informacionit, por edhe për shkak të krijimit të strategjisë të punës për vitin e ardhshëm, Instituti Gjyqësor të merret edhe me vështirësitë që ka pasur gjatë vitit të kaluar.

Çështja e dytë që është po ashtu mungesë në raport, është mosha e gjyqtarëve dhe e prokurorëve të diplomuar sipas programit fillestar të arsimit të lartë. Edhe për gjeneratën e parë edhe për gjeneratën e dytë të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, ka të dhëna të mjaftueshme për shumë aspekte të punës dhe të karrierës së tyre, por nuk ka të dhëna për moshën e tyre. Në çfarë moshe janë gjyqtarët dhe prokurorët që kanë kaluar këto dy gjenerata të gjyqtarëve dhe të prokurorëve që kanë kaluar programin fillestar të arsimit të lartë?

Unë dëshiroj të theksoj se ne dëshirojmë që të shohim në këto programe të trajnimit dhe të arsimit të lartë gjyqtarë të rinj. Kjo për një arsye që edhe kur të emërohen gjyqtarët dhe prokurorë, të emërohen gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, jo vetëm ne, por edhe në Komision e kemi diskutuar këtë çështje, kemi bërë disa hapa pozitiv në Ligjin për gjykatat. Kuvendi i Kosovës dhe deputetët dëshirojnë që të shohin gjyqtarë dhe prokurorë të rinj që kalojnë nëpër programet e arsimit të lartë të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Prandaj, do të ishte mirë që në raportin e ardhshëm, Instituti Gjyqësor ta njoftojë Kuvendin më saktësisht për moshën e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kalojnë. Ne duhet ta themi hapur interesimin tonë si grup parlamentar. Ne dëshirojmë t'i shohim gjyqtarët dhe prokurorët të shkolluar pas luftës në Kosovë, ata gjyqtarë t'i shohim duke kaluar nëpër programet e arsimit të lartë të Institutit të Gjyqësor, që do të thotë edhe të emërohen më vonë si gjyqtarë dhe prokurorë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kush e do fjalën?
Fjalën e ka Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra, e paskemi ministrin e Shëndetësisë dhe e urojmë për prezencën.

Instituti Gjyqësor i Kosovës, është institucion i pavarur në arsimin ligjor, dhe, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar raportin e këtij Instituti dhe duke pasur parasysh se gjyqësia dhe sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës është sistemi më i atakuar në të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare, të Republikës së Kosovës.

Republikës së Kosovës i duhet një reformim rrënjësor i sistemit gjyqësor. Reformimi veç ka filluar në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, por do të jetë i ngadalshëm, dhe duke pasur parasysh këtë, Instituti Gjyqësor i Republikës së Kosovës ka filluar që të bëjë arsimimin ligjor të gjyqtarëve dhe të prokurorëve që do të emërohen në të ardhmen në gjykatat dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës.

Në raportet e institucioneve gjyqësore thuhet se, duke pasur parasysh se kanë pasur deficit në prokurorë edhe vendorë, Instituti Gjyqësor ka bërë një punë të madhe sepse ka arsimuar në njëfarë forme prokurorë dhe gjyqtarë të cilët më vonë dhe janë emëruar si gjyqtarë në gjykatat e Republikës së Kosovës. Edhe pse Kosova nuk ka mundur ende ta shtrijë tërë sovranitetin e vet në sistemin gjyqësor në tërë Republikën e Kosovës, dhe dihet se në regjionin e Mitrovicës, aty ku e kanë vendin gjyqtarët dhe prokurorët, nuk janë, ata janë në Vushtrri, prapëseprapë përpjekjet janë që gjyqtarët dhe prokurorët të shkojnë atje ku e kanë vendin.

Mund të thuhet se raporti i Institutit Gjyqësor, për periudhën janar- dhjetor të vitit 2009, i plotëson kushtet për ta votuar, andaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë do ta mbështesë këtë raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Grupi i AKR-së, le të më fal. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, në emër të Grupit.

RIZA SAMAKA: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Të nderuar deputetë,

Instituti Gjyqësor i Kosovës ka rol të rëndësishëm në sistemin gjyqësor edhe në gjyqësorin në përgjithësi. Është i kompletuar edhe në gjyqësorin në përgjithësi. Është i kompletuar, është funksional, e ka dhënë një raport të pranueshëm edhe ne e mbështesim raportin edhe organizimin funksional të këtij Instituti, natyrisht se dëshirojmë që të ketë efekte që të rekrutohen gjykatës meritor edhe të inkuadrohen në sistemin gjyqësor i cili lëngon nga shumë halle e shumë probleme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Parlamentarna grupa „7+“, je razmatrala izveštaj Kosovskog Instituta za pravosuđe i smatra da se radi o veoma jasnom izveštaju koji pokazuje pozitivne strane u radu ovog instituta. Takođe, parlamentarna grupa „7+“ podstiče Pravosudni institut da što veći broj pripadnika nevećinskih zajednica bude uključen u program obuke koji provodi ovaj institut, jer u Izveštaju stoji da je 97 pripadnika nevećinskih zajednica učestvovalo, od prilike to je 2,7% i mi podstičemo da se taj procenat pojača kako bi pripadnici ostalih zajednica bili uključeni u pravosudni sistem Kosova. U svakom slučaju, mi podržavamo izveštaj koji je kvalitetno urađen. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedniče!

Dame i gospodo,

Parlamentarna grupa SLS je prihvatila Izveštaj Kosovskog instituta za pravosuđe. Naravno, mi smo neke nedostatke uočili. Prvi nedostatak je nepostojanje informacije o izazovima i problema instituta u prethodnom periodu, a to je razlog da ne dođe do grešaka u budućnosti. Zato je veoma potrebno da Institut obrati pažnju na izazov i probleme koji su bili identifikovani u prethodnom periodu. Takođe, nedostatak informacija o broju članova zajednica u upravnim odborima i u svemu tome vidimo da treba da se podstiče i promoviše poziv, istovremeno uputi zajednicama da učestvuju što više u svemu ovome. Naravno, mi podržavamo ovaj Izveštaj i smatramo da je pozitivno što je institut izgradio mehanizme za osposobljavanje kandidata za pravosudni ispit, ali upućujemo jednu poruku i našu molbu ili zahtev da Institut radi više na tome da promoviše i pozove i ostale zajednice da uzmu učešće u svemu ovome. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

I mi ovaj Izveštaj kao grupa podržavamo. Isto imamo primedbu kada je u pitanju aktivnost ovog instituta i kada je u pitanju trening i sesija, kao što je o polnoj jednakosti i integraciji manjina, koja

je u Izveštaju ovog organa u planu i programu. Smatramo da je bilo malo prisustva manjinskih zajednica, kao što je rekao kolega iz „7+“, 2,7, znači 97 pripadnika je bilo trenirano, što smatramo da je jako mali pristup zajednica.

Ovde imamo da su izveštaji i treninzi urađeni na više jezika, te smatramo da kao pozitivno damo da se mnogo treninga i mnogo obuke i ostalo gde su naši pripadnici imali primedbu na jezik, te mislim ta se institut sam treba pozabaviti malo više i kada je u pitanju obuke i jezika manjinskih zajednica. Jako je ovo telo koristno, jako je korisna obuka sudija, jako je korisno sve što je u obrazovnom sistemu sudskog organa zato što znamo da se praktično pravi kamen temeljac, a to su sudije i organi koji treba da reše pravosudni sistem Kosova. Mi se nadamo sa našim doprinosom da ćemo kao grupa prihvatiti ovaj izveštaj i da će ovaj organ imati u budućnosti saradnju u i uspeh. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Do të thotë përfundiam me grupet parlamentare. Kemi edhe dy deputetë Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Unë e shfrytëzoj rastin të protestoj ashpër për mënyrën se si jeni duke e udhëhequr këtë seancë. Qëllimisht nuk ma dhatë fjalën për pikën e kaluar. U lajmërova shumë herë dhe hera e fundit kanë qenë tre diskutues para meje kur jam lajmëruar. Mua po më shtyn të dyshoj, ose je i involvuar edhe ti, zoti Jakup Krasniqi, në matrapazllëqet që po bëhen në korrupsion, sepse qëllimisht ndërhyjnë për të mos e lënë fjalën e lirë për t'u thënë në Parlament. E ke sjellë Parlamentin në nivelin më të ultë të mundshëm. Duhet t'ju vijë turp për mënyrën se si po e udhëhiqni këtë Parlament.

KRYETARI: Deputeti Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Mua më duhet ta shfrytëzoj rastin që të diskutoj lidhur me raportin, por normalisht gjithmonë duke involvuar edhe temën nga pika e kaluar...

KRYETARI: Jo, jo fjalën e ke për rendin e ditës, është i caktuar. Ai rend i ditës është kryer.

NAIM RRUSTEMI... Kapacitetet e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Kosova ka nevojë për një Institut të tillë, kapacitetet për një qeverisje të mirë, me të cilën së paku kërkohet që janë në vendimmarrje ta posedojmë siç është rasti me gjyqtarë, me prokurorë, por edhe me udhëheqës të tjerë dhe kryesisht ndoshta ka nevojë që të trajnoheni edhe ju, zoti kryetar, por para së gjithash kërkohet që njerëzit që udhëheqin dhe ata që i kanë afër, të kenë njohuri të mjaftueshme për politika dhe rregulla, pra të kenë të ngulitur në mendje se janë duke i shërbyer interesit të përgjithshëm publik.

Për kapacitetet institucionale nevojitet të ketë përkushtim ndaj interesit të gjerë publik, përkushtim, por nga mund të burojë një përkushtim për rregulla dhe procedura, prej nga, nëse nuk posedohet, nëse një udhëheqje nuk është e përkushtuar në sundim të ligjit. Normalisht, jashtë deklarime verbale të cilat nuk është e interesuar t'i fus në jetë. Pse? Si ka mundësi njerëzit që flasin për sundim të ligjit dhe të burgoset njeriu i parë i Bankës Qendrore, guvernatori dhe askush asnjë fjalë pos disa shprehjesh aq bajatë sa që as fëmijët nuk i përdorin. Me këtë dua të them se opozita nuk ngrit, se as opozita nuk ka ngritur ndonjë përkushtim ndaj sundimit të ligjit, sepse po të ishte e shqetësuar, do të kishte kërkuar nga ata që lobuan nëpër korridore të Kuvendit dhe që e manipuluan me ambasada mike të Kosovës, për vendosjen e guvernatorit dhe pasi u bë publik hazardi moral i njeriut të parë, të garantojë sistemin bankar.

Të nderuar,

Në botën tonë, përkushtimi ndaj sundimit të ligjit, të garantojnë institucionet, ndoshta edhe Kuvendi i Kosovës, të cilat marrin hapa, dënimin ndaj atyre që tradhtojnë besimin e qytetarëve. Që e gjitha kjo të ndodhë, nevojitet të kemi një sistem transparent dhe me përgjegjësi dhe tash po i kthehem edhe një herë Institutit Gjyqësor që të bëjë trajnime se jo me rastin e raportit të dërguar nga ART, kemi falsifikim të dokumentacionit, falsifikim.

Në faqen 34 të këtij raporti, është e shënuar Dardafon.Net se e ka marrë licencën 12.6.2008. Në atë kohë nuk ka ekzistuar kjo kompani. Prokurorët duhet të trajnohen në Institutin Gjyqësor të Kosovës, që kur ta lexojnë një raport të tillë, të marrin masa adekuate ligjore, sepse në njërin prej pyetjeve parlamentare, me këtë rast e ka konfirmuar edhe ministri Ahmet Shala, që janë të përzier edhe Ahmet Shala edhe Kryeministri i Kosovës edhe Bordi i ART-së edhe udhëheqja e PTK-së. Po flasim për falsifikim dokumentacioni. Por, kur e kemi fjalën të transparenca dhe përgjegjësia, si dy shtylla intrinsike të sundimit të ligjit. Si ka dikush mundësi pra ta përmend fjalën qeverisje e mirë me aq pak njohuri, me aq mosveprim, por edhe me veprime të kundërligjshme dhe prapë e thotë nga goja e vet fjalën qeverisje e mirë. E pakuptueshme kjo. Kjo mund t'u adresohet vetëm atyre që integritetin e kanë të ulët, pra nuk bëjnë atë se çka thonë se do ta bëjnë dhe më pastaj shkohet edhe më larg. Njerëzit, që kryesorët janë të lidhur me afera të mëdha korruptive thonë se kanë dërguar raport konfidencial në Kuvend. Kush është këtu Kuvendi që ka përsipër të merret me konfidencialitet? Pse nuk kanë dërguar të dhëna konfidenciale Agjencionit për Inteligjencë të Kosovës nëse vetëm është funksional?

Në vitin 2008, tenderin shumë kontraverz për operatorin virtual të telefonisë mobile, e pat fituar ndërmarrja Dardafon, përkundër shumë kundërshtimeve nga stafi i PTK-së, me një letër të botuar në gazetën e përditshme, por edhe nga shoqëria civile.

Për ata që nuk iu intereson të flas, atyre diku po ju dhemb, por nuk është mirë të të dhemb atje, sepse atje është bërë një matrapazllëk i llojit të vet. Nuk ka ku të shkojë më matrapazllëk dhe prapë kur vjen rendi i ditës, kërkohet fjala në mënyrë transparente, kryetar na e ke marrë fjalën në mënyrë jo shumë të sinqertë për mua.

KRYETARI: Unë Naim pajtohem me ju që dikush ka nevojë të edukohet, dikush ka nevojë të mësohet tërë jetën, dikush ka nevojë edhe të trajnohet, por jo të trenohen njerëzit. Naim Rustemi replikë.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit! Edhe që tash është më demokratike në replikë. Sigurisht që ka nevojë të trajnohet, sepse duhet të dihet se Kuvendi është një vend, ne po jemi përkushtuar për një vend demokratik, jo të udhëhiqet me masa të skajshme marksiste-leniniste edhe ato jo të konstruktura mirë, se me qenë të konstruktura dhe për t'i ndërtuar besnik ideve, do të ishte tjetër qysh.

KRYETARI: Nejse, edhe ato e kanë pasur kohën e vet. Nuk ka. Ju do ta merrni fjalën sa herë të doni, kur të lajmëroheni me kohë.

(Ndërhyn deputeti Driton Tali, flet nga larg, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Por, unë nuk kam faj që zërat e juaj kanë mbetur zëra kukuvajkash.

Në sallë kemi 67 deputetë.

Votojmë raportin me rekomandime. Votojmë tash.

Konstatohet se me 50 vota “për”, 5 “kundër”, 10 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2010.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës.

13. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë së Ujësjiellit rajonal “Prishtina” për vitin 2009

Komisioni funksional për mbikëqyrjen e financave publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin final dhe atë të auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë së Ujësjiellit rajonal “Prishtina” për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional, Haki Shatri, nëse është këtu. Ai nuk është këtu. Vazhdojmë me shëfat e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputetja Safete Hadergjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah raportin, rekomandimet të cilat i ka dhënë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Në raportin të cilin e ka sjell Auditori për auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë të ujësjiellit rajonal “Prishtina”, vërehen se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, megjithatë gjatë pikave të mëtutjeshme, vërejmë në raport, sepse ka shumë të meta dhe dobësi në menaxhimin e punëve në këtë kompani, ka lëshime në fatura, gabime në lëshimin e faturave, mandej ka angazhim të punësuarave jashtë listës së të punësuarve. Nuk e ka statutin të cilin e parasheh ligji se si të bëhet mënyra e funksionimit të kompanisë ashtu siç e parasheh Ligji për menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Megjithatë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i përkrah rekomandimet të cilat i ka dhënë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike për miratimin e këtij raporti dhe njëkohësisht sugjeron kompaninë rajonale të ujësjiellit “Prishtina”, që t’i zbatojë rekomandimet të cilat janë dhënë nga Auditori i Përgjithshëm dhe njëkohësisht sugjeron që të paraqesë raportin brenda 30 ditëve përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike se sa ka arritur deri në këto momente të bëjë implementimin e rekomandimeve të dhëna. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, pas auditimit të pasqyrave financiare të kompanisë së ujësjiellit rajonal “Prishtina”, për vitin 2009, ka konstatuar se në këtë kompani ekzistojnë dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar.

Dobësitë e gjetura në kompaninë e ujësjiellit rajonal “Prishtina” i arsyetojnë plotësisht rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, sidomos rekomandimi i dytë që

konsideroj se është shumë i arsyeshëm, me të cilin kjo kompani obligohet që në afatin prej 30 ditësh, nga dita e miratimit të këtij raporti, ta njoftojë Kuvendin për përmbushjen e rekomandimeve.

Prandaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i mbështet rekomandimet e Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Zonja e zotërinj deputetë,

Edhe Grupi i AAK-së i përkrah rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare, por i ka edhe shqetësimet e veta, sidomos dobësitë që i ka shprehur kjo kompani rreth menaxhimit të financave, angazhimit të punëtorëve jashtë listave të pagave dhe sidomos thyerjen e procedurave të prokurimit, do të thotë se nuk kanë punuar në bazë të ligjit në fuqi. Prandaj, me rekomandimet të cilat i ka dhënë Komisioni që në afat prej 30 ditëve pas miratimit në Kuvend, kjo kompani duhet të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit t'i përmbushë dhe ta njoftojë Komisionin dhe Komisioni ta njoftojë Kuvendin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Grupi Kuvendor i AKR-së e mbështet plotësisht Raportin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, referuar këtij dokumenti dhe thekson veçanërisht disa nga lëshimet e tjera të shumta. Bie fjala, menaxhimi i dobët i donacioneve, vetvetiu deshëm apo nuk deshëm çka reflekton, domethënë edhe abuzime edhe spekulime. Më pastaj mungesa e kontrollit të brendshëm kur s' ka kontroll të brendshëm, domethënë apriori ka dyshime për punë jo të rregullta, e punët jo të rregullta zakonisht redukohen edhe përfundojnë në punë të paligjshme. Më pastaj, që mungojnë politikat dhe procedurat e brendshme po asisoj sa i përket kontratave të punës, ka vërejtje edhe në procedurat e tenderimit. Këto i ka artikuluar, i ka definuar më mirë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave, ne e mbështesim dhe insistojmë që ato rekomandime të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave të realizohen, por edhe dikush lë të japë përgjegjësi për dështimet, për gabimet, për lëshimet për punët e parregullta të bëra edhe që ato të jenë me influencë që në të ardhmen të bëhen përmirësime të nevojshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë kam pasur autorizimin prej kryetarit të Komisionit për të dhënë sqarime për këtë raport, mirëpo, meqenëse ishte këtu edhe zëvendëskryetarja, pata përshtypjen se ajo do t'i lexojë rekomandimet, megjithatë ajo foli vetëm në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Sidoqoftë, rekomandimet u mbështetën edhe nga grupet parlamentare dhe tashmë i kemi të gjithë para vetës rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave dhe sikur u mbështetën nga grupet parlamentare. Unë do të shpreh mendimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të

Dardanisë për raportin në fjalë, për raportin, pasqyrat financiare të kompanisë së ujësjellësit rajonal “Prishtina” për vitin 2009.

Raporte të tilla nga auditori janë edhe dy të tjera, domethënë janë gjithsej 3 raporte të cilat kanë ardhur në Kuvend, mirëpo, nuk e di a është mënyrë e drejtë dhe formë e drejtë mënyra se si po i qasemi raporteve apo si po e bëjmë raportimin, sikur ka kaluar në një formalitet kjo çështje e raportimit apo mënyra se si Kuvendi po i kalon raportet. Është edhe absurd i llojit të vet kur një raport gjatë gjithë kohës kritikohet dhe në fund e merr notën pozitive dhe sikur ka humbur kuptimi në këtë drejtim.

Çështja tjetër, a ka pasur nevojë këto tri raporte të auditimit të shqyrtohen në Kuvend? Mendoj se jo. Është e tepërt, është Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e cila për një periudhë kohore, brenda një viti nxjerr diku rreth 60 raporte apo prodhon 60 raporte të auditimit, dhe nëse të gjitha ato raporte ne i shqyrtojmë në Kuvend dhe pa një përfundim, pa një rezultat konkret, unë mendoj se bëjmë një punë të keqe, në vend që të bëjmë një punë të mirë. Është një herë koha e pamjaftueshme për të cilën Kuvendi duhet të ndajë kohë, domethënë për 60 raporte minimum dhe e dyta, qasja se si Kuvendi po bën lojë me këto raporte.

Unë mendoj se këto raporte duhet të trajtohen në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave, aty ta marrin notën pozitive, negative dhe të kthehen prapë te auditori dhe auditori të merret me këto raporte. E kemi pasur raportin e Komisionit Qendror Zgjedhor, një raport të kualifikuar për të cilin ka pasur nevojë ky Kuvend të debatojë dhe ka nevojë të debatohet, është një raport i kualifikuar, është një raport që ka nevojë ta ketë qasjen e drejtë dhe të merituar dhe të merren masat në atë drejtim, por jo vetëm të debatohet për raporte dhe në fund të mos kemi një përfundim, sepse thjesht e kundërshtojnë gjatë gjithë kohës dhe në fund e votojmë, e mbështesim.

Raportimi bëhet për të parë punën njëvjeçare të institucionit për të cilin Qeveria ndan mjete dhe e financon dhe, nëse vërtetë aty ka parregullsi, ka keqpërdorim, ka keq menaxhim të cilat i konstaton auditori, atëherë duhet të merren masat konkrete. Kjo nuk po ndodh në Kuvend dhe kjo ka humbur, vërtet Kuvendi e ka humbur kuptimin gjatë shqyrtimit të raporteve dhe duhet të kemi një qasje pak më ndryshe, mendoj se duhet ta ndërrojmë qasjen e shqyrtimit të raporteve në Kuvend.

Sidoqoftë, meqenëse e kemi futur si pikë të rendit të ditës- Shqyrtimin e raportit vjetor të kompanisë rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” ne do të japim mendimin tonë edhe pse është ndoshta një mendim më tepër i përgjithësuar dhe për të përmbushur një kriter që sot po kërkohet nga kjo seancë se sa për t’i përmbushur nevojat që ka vërtet raporti i auditimit.

Auditori ka konstatuar disa parregullsi siç janë: gabimet në faturat e lëshuara, angazhimet e të punësuarve jashtë listave të pagave që i ka bërë kompania e Ujësjellësit “Prishtina”, mandej kemi si në çdo kompani edhe këtu kemi parregullsi dhe nuk është respektuar Ligji mbi prokurimin publik në Kosovë. Kompania nuk ka nxjerr rregullore të veçanta për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm dhe nuk ka nxjerrë rregullore të veçanta për sistemin e funksionimit të gjithë kompanisë ujësjellësit “Prishtina”. Megjithatë, janë vërejtje që sipërfaqësisht duken, por ka nevojë të trajtohen. Është edhe rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave dhe besojmë se këto do të përfillen, pra si raport do ta mbështesim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Shpresoj se në të ardhmen do ta trajtojmë temën: Pse Prishtina nuk ka 8 orë ujë në ditë.

Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues i Parlamentit!

Ju përhëndes juve,

Drejtorin Daut Beqiri,

Ministrin e Shëndetësisë, që e kemi për hasret.

Ne , Grupi “7+”e përhëndesim këtë raport. Se a ka a nuk ka ujë Prishtina, le të mendojë për këtë.

Ne në Prizren krejt mirë i kemi punët sa i përket ujit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna grupa SLS je pročitala Izveštaj revizije za finansijske preglede regionalne kompanije Vodovoda „Priština“ za 2009. godinu. Izveštaj je pozitivan, samokritičan i to je pohvalno. Međutim, nas zbunjuje činjenica koja se provlači kroz tekst u delu - opšti sažetak, u trećem stavu, piše: „prema našem mišljenju“. Smatramo da ta rečenica ili te reči nas zbunjuju. Jednostavno, trebalo bi da se prema činjenicama i prema podacima, prema tačnim informacijama nešto daje, a ne prema mišljenju, jer je mišljenje jedan relativan pojam. Znači, u ovom trenutku ćemo misliti ovako, u onom sledećem trenutku ili kako kome odgovara. Znači, prema tome smatramo da je u principu Izveštaj pozitivan. Mi ćemo ga podržati, ali bi trebalo da se izveštaj više to fokusira na činjenicama i okolnostima, a ne na nekom mišljenju, kao što je ovde slučaj. Hvala još jednom!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

I mi kao Parlamentarna grupa za integraciju podržavamo ovaj izveštaj. Znamo da je to obaveza na osnovu međunarodnog standarda o računovodstvu, na osnovu Zakona o javnoj nabavci, na osnovu Zakona o javnim preduzećima i na osnovu Zakona o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima.

Ovaj izveštaj možemo reći da je jako sažet, ali malo daje preglede unutrašnje kontrole kada je u pitanju revizija u regionalne kompanije Vodovoda „Priština“. Prve odlike revizije koje vidimo, vidimo da je veliko nezadovoljstvo i same revizije bilo kada je u pitanju softver kompanije koji praktično nije imao potpunu sigurnost te je imao i posledice, gde je bilo, gde je došlo do znatnih grešaka u izdatim računima. Znači, kao drugo jako važna primedba da su se angažovali ne putem ugovora, na platnom spisku radnici koji su bili isplaćirani iz blagajne, a znamo da nije oštećenje samo sredstava i blagajne, nego tim se radnicima ne plaća doprinos, te je izbegavanje i budžetskih sredstava koja moraju da imaju odliv kada su u pitanju javne kompanije koje kontroliše država.

Što je jako važno, konstatovala je ovo revizija da se ne vrši godišnja radna ocena performarce osoblja. Zašto ovo kažem? Zato što je faktor čovek mnogo značajan faktor u javnim preduzećima, koji ne samo da menadžira, rukovodi nego i ima radnu sposobnost i obavezu u preduzeću. Zatim ima nedostataka kod procedura nabavke, što je jako važno kada je Zakon o nabavkama u pitanju, i što je važno kada je u pitanju korupcija, gde smo prozvani da najviše vida ima kada su u pitanju javna preduzeća.

Zatim, nešto što je jako bitno ovde kada je u pitanju budžet ove kompanije, kada su u pitanju osnovna sredstva, da kažem aktiva i pasiva, gde je ustvari pregled bilansa stanja, gde daje revizija pravo stanje kompanije da ima kapital negde oko 70 miliona, 72 je imala u 2008. godini, ali nešto što zabrinjava jeste naplata koja je jedva 20%, što je jako žalosno i što je slika svih potraživanja na ime javnih preduzeća kada je u pitanju energija, voda, smeće i ostalo.

Ovo kažem iz razloga, kaže da je ne naplaćena realizacija, prikazali su da je 7 miliona 994, a praktično 37 miliona je ukupno nerealizovano sredstava od 99 godine, što znači da su se ova sredstva otpisala na ime sumnjivih i spornih potraživanja, što zakonski nije u redu, oni se prenose i uvek su sredstva kompanije, koja ima obavezu da naplati ta sredstva. Kada smo rekli količina vode i ovo, jedan od primera treba da nam bude i ova slika naplate, zato što je svaka elementarna potreba, kada je u pitanju za vodom, energijom i ostalo, to su samo zarade preko ovih sistema, gde se do zadnjeg potrošača iznalaze nove mogućnosti za nove izvore i kapacitete kada su u pitanju neophodni elementi, kao što je voda.

Ovo je za nas dobar izveštaj, ali ipak ima nedostatke kao što sam rekla u pojedinim stvarima, gde treba da se vodi malo više računa o javnoj nabavci, gde treba malo više da se štedi, gde su kao što je i sumnjivi dug kompanije u pitanju, tako da smo kao grupa pažljivo ovo čitali i verujem da svi znamo o čemu se radi i verujem da će biti u buduću više svesti i kod naših građana i kod menadžera i kod države kada su u pitanju ovi elementi, da više pažnje posvetimo strukturi ovih elemenata i ovih aktera na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Riza Smaka, e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!
Deputetë të nderuar,

Nga vetë raporti dhe nga vetë pohimet e autoriteteve të ujësjellësit, ndër të tjera, është konstatuar se shërbimet kontraktore, të quajtura “të jashtme” nga viti 2008, janë rritur nëpër vite shumë paarsyeshëm edhe pikëpyetje është çka janë ato shërbime të jashtme? Mund të jetë formulim, konstruksion juridik i paqëndrueshëm, që do të mbulojë diçka.

Nëpër vite, prej 2008-shit deri në raportim, janë rritur borxhet e këqija, të quajtura të këqija. Është konstatuar pa mëdyshje se nuk ka kontroll në tërë rrjetin e ujësjellësit. Ju lutem autoriteti i ujësjellësit nuk ka kontroll në tërë rrjetin, po të ishte sikur të ishte Nju Jorku, po e zëmë, hajde disi ose ndonjë qytet mbi mega qytet mbi 10 milionë, nuk ka kontroll mbi, më pastaj shihet se nuk ka kontroll mbi apo në stafin profesional.

Nga faturimet e gabueshme, zotëri kryesues edhe kolegë të nderuar, ju lutem, sot kur kemi, si të them sistem elektronik aq të përparuar, aq të specifikuar edhe të, që bëhen faturimet e gabuara afër 300 milionë janë shkaktuar humbje, pse faturohen gabimisht, duhet, ka, zgjon pakënaqësi të madhe te qytetarët e shfrytëzuesit, ankohen në procedura edhe shlyhen më në fund, domethënë jo afër po them 289.000 euro humbje. Ju lutem, këto janë çështje që nuk do të duhej të kalonin si të them sipërfaqësisht, raporti që kësisoj u miratua me disa vërejtje. Nuk ka kontroll të duhur në burimet njerëzore, lista të pagave, ka individë që nuk janë në marrëdhënie pune ose qenkan në marrëdhënie pune, që nuk mund të jenë në marrëdhënie pune pa pasur kontratë pune. Pastaj ka që kanë kontrata pune fiktive, simulative edhe këto janë ju lutem, ndër të tjera, lëshime edhe gabime që padyshim do të duhej të interferonin ato institucione për të cilat na kemi besim edhe janë themeluar, janë konstituuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Tani vazhdojmë me votimin e raportit final të Auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë të ujësjellësit... (Po presim një minutë që të bëhet kuorumi) Atëherë vazhdojmë me votimin e Raportit final të Auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë së ujësjellësit rajonal “Prishtina” për vitin 2008 me rekomandimet e Komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 6 “kundër”, 8 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin final të auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë së Ujësjellësit rajonal “Prishtina” për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit funksional.

Vazhdojmë me pikën katërmëdhjetë e të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009

Komisioni funksional për mbikëqyrjen e financave publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin e Auditimit të pasqyrave financiare të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009 dhe Kuvendi i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional, Haki Shatri, nëse është këtu. Është deputetja Synavere Rysha, e autorizuar në emër të Komisionit.

SYNAVERE RYSHA: Edhe raportin e Auditimit të institucionit të Avokatit të Popullit, Komisioni për Mbikëqyrje të financave e ka shqyrtuar dhe e ka trajtuar dhe ka përfunduar me dy rekomandime, njësoj me të tri raportet ka përfunduar me nga dy rekomandime. Mirëpo, unë do t'i lexoj vetëm dy rekomandimet e Komisionit, meqenëse në njëfarë mënyre unë si anëtare e Komisionit nuk jam pajtuar, por duke e pasur parasysh se në Komision merren vendime pa votë, atëherë unë do t'i paraqes për hir të korrektësisë do t'i paraqes ato kështu si janë. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave i rekomandon kësaj seance të miratohet raporti me rekomandime të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009, dhe rekomandimi i dytë është: Obligohet institucioni i Avokatit të Popullit që të punojë në programin e gjetjeve, zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe lidhur me këtë në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e miratimit të këtij raporti, të njoftojë Kuvendin përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Këto pra janë dy rekomandime që është vështirë në praktikë të zbatohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kryetari i Grupit, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i mbështet këto rekomandime të Komisionit në fakt edhe pse ne e kemi të qartë se Avokati i Popullit ose përgjegjësia e tij për këto pjesë të këtij raporti financiar, janë vetëm 5 muajt e fundit, por sido që të jetë ky raport dhe ato rekomandime që na vijnë nga Komisioni, ne i mbështesim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, shumë!

Zotëri kryesues,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë raport të Komisionit funksional dhe njëherit i mbështet rekomandimet si dhe çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e dobët të donacioneve, mungesën e kontrollit të brendshëm dhe mungesën e politikave dhe procedurat e brendshme, i mbështesim që këto rekomandime apo zbatimi i këtyre rekomandimeve të jetë i përputhshëm në afatin e kërkuar kohor nga Komisioni Funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, cili e keni fjalën?

Deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, me një qëllim që edhe ky institucion me një kredibilitet të mirë dhe të madh, duhet që në afat prej 30 ditësh të marrim nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave veprimet që i ka ndërmarrë në të gjeturat e auditorit të përgjithshëm dhe e të gjeturat janë, sepse është një menaxhim i dobët i donacioneve dhe nuk po i ngjan vetëm këtij institucioni, por edhe shumë institucioneve që po marrin donacione dhe mungesa e kontrollit të brendshëm që duhet të rritet me qëllim të menaxhimit më të mirë të financave publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Grupi Parlamentar i AKR-së, mbështet shqyrtimet e auditimit për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit dhe rekomandimet e Komisionit përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Po, zoti kryesues, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar raportin e auditimit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe e mbështesim raportin, sepse është një raport i mirë, raport i përmbledhur dhe paraqet gjendjen reale në institucionin e Avokatit të Popullit. Me rekomandimet e Komisionit funksional, pjesërisht pajtohem, sepse rekomandimi i dytë ashtu edhe siç e thashë në fillim, është paksa i vështirë për t'u zbatuar në praktikë, mirëpo kërkojmë që në të ardhmen raportet e tilla të mos procedohen për seancë, por t'i mbeten vetëm Komisionit, ndërsa raportet e theksuara me çështje të theksuara të bihen në seancë dhe të trajtohen më seriozisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Grupi "7+", mendon se raporti i sotëm është në rregull, prandaj e mbështesim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala gospodine!

Dame i gospodo,

Parlamentarna grupa SLS-sa je pročitala ovaj izveštaj i prihvatiće ga. Izveštaj u smislu preporuka Komisije za nadgledanje javnih financija, naravno svima nama je zapao u oči da postoje neke nedostatci, kao što je menađiranje donacija, nedostatak unutrašnje kontrole i nedostatak politika i unutrašnjih procedura, naravno sve to vezano za rok i mi smatramo da bi to treba da se ispoštuje. Znači, u načelu mi ćemo podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa!

Meni je žao, ali moram da kažem da sam se javila u ime Grupe za integraciju.

Kada se radi o Izveštaju, o finansijskom izveštaju pregleda Institucije Narodnog advokata za 2009. godinu, koja je imala kancelarija reviziju, godišnju reviziju, moram da kažem da je revizija urađena na jako adekvatan i dobar način i jako se radujem da je revizija počela da radi na terenu kada su u pitanju ovi autoriteti.

Jako važno, što ne smemo ovo da preskočimo, jeste da preporuke koje je revizija dala i tamo gde je dala manjkavosti, kada je u pitanju Zakon o menadžiranju i Zakon o knjigovodstvu, kada kaže da, jasno kaže da u izveštaju da ova Kancelarija narodnog advokata nije imala mesečne, tromesečne ni trogodišnje izveštaje o korišćenju donacija. Zašto kažem ovo, zato što su donacije jedan od izvora, dodatnih izvora mimo budžeta i da su donacije da se namenski koriste i ako se oni namenski ne koriste, ako nema izveštaj za prvo tromesečje, ne mogu se koristiti sledeća sredstva, kao što piše sledeća sredstva, tako da može doći da se i izgube sredstva donacije, a znamo da se putem tih sredstava prisustvuje raznim konferencijama, raznim treninzima, raznom usavršavanju stručnom u ovim kancelarijama i to bi trebalo jako, jako dobro da se vodi računa o donacijama i da budemo srećni kada neko od regija ili da kažem od evropskih zemalja želi da donira nešto kada su u pitanju ovi autoriteti.

Jako je zabrinjavajuće i to kada je u pitanju imovina. Zašto ovo kažem? Kaže, nema popisa imovine. Ja sam malo pre komentarisala da svako knjigovodstvo i Zakon o knjigovodstvu, postoji aktiva i pasiva. Mora da se vodi računa i o pasivi, jer pasiva je uvek veća od aktive i mora da znamo u kojim kancelarijama, u kojim autoritetima, u kojim agencijama, u kojim da kažem državnim institucijama koji kapital imamo, koji kapital imaju građani Kosova. Znači, s time dolazimo do saznanja da nije uopšte objavljen opis imovine ove Kancelarije i Komisija za popis i ocenjivanje imovine nije sastavila izveštaje pojedinačnih komisija, znači i za svakog radnika.

Imovina znamo da je prenosna, da se iz godine u godini ne uništava, da se putem amortizacije, revalorizacije daje nova utvrđena vrednost imovine, i moramo više da vodimo računa i o imovini agencija koje dajemo.

Ja moram da skrenem pažnju ovde poslanicima. Mi imamo, dobijamo izveštaje kada su u pitanju ova regulatorna tela, kada je u pitanju kancelarija Narodnog advokata, gde imamo pored plate i dnevnice

u budžetu, najveći troškovi su kapitalni troškovi. Non stop kupujemo kapital a ne vodimo popis o tom kapitalu. Šta je kapital? Taj kapital može da se zloupotrebi, da se uništi, da se proda, da se otuđi i svaki kapital mora više da ima ličnu kartu, nomenklaturu, broj, šta smo kupili, gde i dali treba sledeće godine da kupujemo. To je jedan vid štednje za nas. Ja bih puno pričala o ovome, ali

vidim da zainteresovanost ne postoji. Zahvaljujem se u ime naše grupe i potrudili smo se da damo jedan svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas radhës është paraqitur deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Sa i përket auditimit të pasqyrave financiare të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009, konsideroj se ka qenë e rëndësishme të shqyrtohet kjo gjë duke marrë parasysh se dy vjetët e mëparshme, në vitin 2007 dhe 2008, institucioni i Avokatit të Popullit nuk është audituar. Gjetjet të cilat i ka dhënë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm thotë se janë pasqyra të vërteta financiare, por nga ana tjetër vërejtjet dhe dobësitë të cilat janë shprehur dhe të cilat janë përmbledhur në tri grupe, që është menaxhimi i dobët i donacioneve, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe mungesa e politikave dhe procedurave të brendshme. Për ta mbështetur këtë, po thirrrem në numrat e paraqitura ku thuhet se në vitin 2009, shuma e donacioneve ka qenë afër 95.000 euro, kurse janë shfrytëzuar vetëm 12.500 euro, që domethënë vetëm 13% të donacioneve janë shfrytëzuar që është fakt me rëndësi se mjetet nuk janë menaxhuar si duhet.

Rekomandimet e auditorit kanë qenë që planifikimet dhe shpenzimet e donacioneve të bëhen sipas projekteve, projekt-propozimeve dhe të realizohen brenda afatit të caktuar kohor. Ndërsa, sa i përket menaxhimit të shpenzimeve, ku janë parë gjithashtu dobësi, rekomandimet e auditorit kryesisht kanë të bëjnë me procesin e rekrutimit të stafit, i cili duhet të jetë transparent dhe jo favorizues si dhe nënshkrimet të bëhen nga autoriteti përgjegjës, jo nga Avokati i Popullit, por nga menaxheri përkatës. Ndërsa, sa i përket procesit të prokurimit, janë vërejtur dobësi dhe në fund për të rregulluar mekanizmin e kontrollit të brendshëm, rekomandimi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është që institucioni i Avokatit të Popullit të lidhë marrëdhënie bashkëpunimi me ndonjë njësi të auditimit të brendshëm të ndonjë institucionit të pavarur.

Konsideroj se Komisioni ka bërë një zgjidhje të mirë kur i ka propozuar Kuvendit që të përcjellë më tej punën e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm brenda 30 ditëve edhe pse jam skeptike që për 30 ditë, të gjashtë rekomandimet e ZAP-it mund t'i zbatojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

I lus deputetët që janë jashtë që të vijnë në sallë, sepse nuk kemi forum, papë po ju them, edhe dy deputetë duhet të jenë në sallë të paktën për të votuar.

Atëherë konstatoj se në sallë janë 65 deputetë dhe lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Konstatoj se me 62 vota “për”, 2 abstenime, konstatoj që Kuvendi miratoi Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2009

Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit Qendror të zgjedhjeve për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2009 dhe ka rekomanduar miratimin e tij.

Sipas radhës për diskutim, është kryetari i Komisionit funksional, deputeti Bahri Hyseni apo raportuesi i Komisionit në fjalë, pra fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me rastin e shqyrtimit të parë, më 14 maj ka konsideruar se raporti nuk ka qenë i plotësuar dhe ka kërkuar raport shtesë. Pas raportit shtesë, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që të shqyrtohet dhe të miratohet raporti i punës së Komisionit Qendror të zgjedhjeve për vitin 2009, të ngritën kapacitetet e Komisionit Qendror të zgjedhjeve për menaxhimin përkatës të procesit zgjedhor në vendin e votimit dhe numërimit dhe të rishikohet çështja e mos përfshirjes së votimit me kusht në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe të bëhet spastrimi i listave të votuesve në bashkëpunim me institucionet e autorizuar.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka pasur të qartë se tanimë ka filluar procesi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet, dhe me qëllim që grupi punues për zgjedhje ta ketë më lehtë, i kemi nxjerrë tri rekomandime të cilat i kemi konstatuar që kanë qenë defekte gjatë punës së Komisionit Qendror Zgjedhor gjatë organizimit të zgjedhjeve, por edhe vet procesit të menaxhimit të zgjedhjeve. Prandaj, i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tani kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk ka asgjë.

Kryetarët e grupeve parlamentare.

Në emër të PDK-së, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar me vëmendje këtë raport dhe natyrisht që mbështesim edhe raportin edhe rekomandimet e Komisionit, në mënyrë që ky të jetë i përplotësuar ashtu siç duhet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e punës së KQZ-së për vitin 2009, raport i cili përmban edhe atë që ishte vit i zgjedhjeve. Raporti i plotëson kushtet për raportim për Kuvendin e Kosovës, por ne duhet t'i cekim sfidat dhe vështirësitë që e kanë përcjell procesin e përgatitjeve të implementimit dhe përfundimit të procesit zgjedhor të zgjedhjeve lokale 2009. Prapë mbetet brengosese, po i ceku vetëm shkurtazi dhe pak më shpejt se lista e votuesve, votimi jashtë Kosovës, votimi me kusht, ankesat dhe parashtresat, këtu mospërcaktimi i saktë i përgjegjësisë lidhur me vendimin për anulimin, përkatësisht përsëritjen e zgjedhjeve apo edhe anulimi i vendvotimeve të zgjedhjeve lokale për vitin 2009 nga KQZ-ja. Pra, edhe ne i mbështesim rekomandimet që kanë dalë nga dy komisionet funksionale që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe vetë KQZ-në. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Realisht, kur dikush e sheh këtë raport të punës të Komisionit Qendror Zgjedhor, fillon të mendojë ku jemi duke jetuar ne, deri ku mbërrin konformizmi? Çka po ndodhë kështu? Po flas vetëm për pjesën teknike fillimisht dhe po e them kush i ka thënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ne duhet ditur adresën e GZAPIT se na ka shkruar në raport, për shembull. Çka ka lidhje ajo punë ose çka na ka vyer ta shtimë në këtë raport listën e partive politike ose organogramin e sekretariatit e shumë çështje? Domethënë kur e merr edhe e sheh këtë volum, ta merr mendja që dikush ka thënë qitu sa më shumë letra sikur ai nxënësi i keq që shkruan në provim mbushe faqen se ndoshta s' e lexon. Realisht raporti të cilin një Parlament kishte dashur ta ketë është krejt diçka tjetër prej këtij raporti. E vetmja pjesë e cila është realisht pak a shumë në rregull, është kjo far pasqyra financiare e cila prapëseprapë është e mangët, por shihet se ka dashur të tregojë diçka KQZ-ja. Pjesët tjera, realisht janë pjesë të cilat ku as nuk ka sistem analitik, as nuk ka diçka që mundet të na bëjë na bëjë për të menduar si organ më i lartë i pushtetit ligjvënës që e zgjedh presidentin e kryeministrin, e krejt për të menduar çka duhet bërë në të ardhmen ne që ta përmirësojmë sistemin e zgjedhjeve, shembull ta marrim ose proceduat për shkak se, besoj se nuk është më shumicë numri i njerëzve në Kosovë i cili beson se ka qenë në rregull.

Tani prej nesh në Kuvend nuk pritet me qenë profesionist, na jemi përfaqësues të popullit, kemi profesione të ndryshme erdhe kemi ardhur për të përfaqësuar, mirëpo prej KQZ-së dhe prej Sekretariatit pritet të kenë

pak profesionalizëm. Çka po mendoj me këtë profesionalizëm, jo vetëm për t'i zbatuar urdhrat, por për të reflektuar domethënë në mënyrë që institucioni i cili realisht merret me këto çështje, të ketë mundësi të mos bëjë gabime në të ardhmen. Në demokraci, këto far institucione që janë kësiaj sikur KQZ-ja, duhet të sjellin informacion edhe analizë për shkak se ndryshe ne po mbesim vetëm duke u marrë me këtë raport dhe duke thënë secili raport i plotëson kushtet për t' u votuar. Çka ka në raport? Çka i ndihmon Kuvendit raporti? Pse duhet KQZ-ja t' i raportojë Kuvendit, nëse raporti është vetëm i plotëson kushtet për të kaluar.

Nëse do të kishim hyrë në detaje, mendoj se tani do të kisha mbetur vetëm, po më duket ose Grupi Parlamentar i AAK-së do të kishte mbetur vetëm se po e shoh që të gjithë po thonë, është, i plotëson kushtet për të kaluar, ama në të ardhmen do të provojmë të ngremë edhe çështje tjera kur na vijnë kësi raporte për shkak se është konformizëm total, është jo profesionalizëm total, është

neglizhencë totale e funksionit për të cilin ekzistojnë këta njerëz. Me këtë raport, kushdo që e ka përpiluar dhe e ka nënshkruar në fund të fundit, populli thotë: “Ka dashur me heq dert”, sikur me qenë diçka, o veç hiqe prej duarve le të shkojë në Kuvend se kurrfarë rëndësie në fund të fundit s’ ka. Edhe një herë po them, nëse dikush ka mendim ndryshe prej deputetëve, kisha pasur dëshirë për ta dëgjuar, mirëpo nuk është hera e parë dhe nuk është raporti i parë që vjen në Kuvend vetëm sa për ta hequr prej duarve duke e krijuar atë bindje ose edhe për të na krijuar përshtypjen se kurrkush nuk e lexon, kurrkujt nuk i vyen gjë vetëm se dikush e ka shkruar në ligj, pa asnjë arsye reale do të thotë, pa asnjë arsye të vërtetë të sjellë raporte.

Mendoj se Kuvendi duhet ta ndërrojë qasjen ndaj institucioneve të cilat i raportojnë Kuvendit, duhet të ketë momente në të cilat do të thotë jo, jo çfarë raporti është ky? Nuk është raport ky, ky raport është i përpiluar shpejtë e shpejt, në këtë raport e keni qitur planin e punës që e keni bërë për veti, i keni qitur një 7-8 faqe përsëritje të gjërave që i dimë dhe kurrgjë më tepër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po dua fillimisht ta siguroj kolegun Gjini që nuk është vetë as ai, as Grupi Parlamentar në vlerësimin për këtë raport. Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së konsideron se Raporti nuk i plotëson kushtet që të miratohet pozitivisht në seancë plenare, megjithatë kam parasysh që Komisioni nuk ka pasur zgjidhje tjetër përpos që t’i ofrojë Kuvendit raportin e KQZ-së për t’u shqyrtuar në seancë plenare edhe pse, sikur u tha më herët ky raport nuk përmban pothuajse asgjë, sa i përket obligimeve që ka pasur Komisioni Qendror Zgjedhor të parapara me ligj.

Komisioni Qendror Zgjedhor si organ kryesor për organizimin e zgjedhjeve ka dështuar që të garantojë integritetin e zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe ato 2010, të ripërsëritura.

KQZ nuk ka arritur që përkundër kapaciteteve që ka, që të garantojë zgjedhje të lira dhe fer dhe kështu ka kontribuar që zgjedhjet e fundit të jenë nën minimumin e standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të drejta. Komisioni Qendror Zgjedhor, në krahasim me zgjedhjet paraprake që megjithatë ju patën përafuar standardeve, në zgjedhjet e fundit ka treguar mungesë të përgjegjësisë edhe individuale edhe institucionale. Ndër dështimet e mëdha të Komisionit Qendror Zgjedhor, vlerësohen të jenë edhe emërimi jo adekuat i këshillave të vendvotimeve, sepse pikërisht këto këshilla janë ata që kanë lejuar manipulim me zgjedhjet dhe abuzim me vullnetin e elektoratit. Zgjedhjet sikur e dini janë përsëritur në tri komuna, por jam shumë i sigurt që po të kishte vlerësim të drejtë, ato do të ripërsëriteshin në së paku gjysmën komunave në Kosovë.

Aleanca Kosova e Re është e pakënaqur me punën e Komisionit Qendror Zgjedhor, prandaj kërkon reformë të plotë të këtij institucioni.

KQZ edhe në këtë raport, të ashtuquajtur raport, nuk afron përgjigje pse ka dështuar në mandatin e vet. Komisioni Qendror Zgjedhor ka tejkaluar kompetencat e veta sepse, sikur e dini, ka votuar, në një rast ka votuar për vendimin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Si rrjedhojë e kësaj, për të mos e zgjatur, është se Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e mbështet raportin në fjalë, përkundër faktit që komisioni ka afuar rekomandime, të cilat konsideroj se do të duhej të përfshiheshin në Kodin e ri Zgjedhor në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Gani Geci e ka fjalën.

GANI GECI: Të nderuar deputetë,

Raporti i Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2009 ka qenë aq i mangët sa që ne në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi e kemi kthyer mbrapa njëherë për të përmbushur standardet, sepse me atë raport që ka ardhur në fillim nuk i ka përmbushur standardet as të vijë në Kuvend. Dhe, duke pasur parasysh që ne i kemi organizuar zgjedhjet e para vendore pa ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, kemi konstatuar se Ligji për zgjedhjet duhet të ndryshoj sepse ky ligj ka prodhuar mangësi të ndryshme gjatë procesit zgjedhor të vitit 2009.

Komisioni Qendror Zgjedhor nuk ka pasur kapacitete të mjaftueshme për të menaxhuar procesin zgjedhor as në vendvotime, as në vendnumërime dhe procesi zgjedhor i vitit 2009 ka treguar se shqetësimet e Lidhjes Demokratike të Dardanisë që zgjedhjet të monitorohen me kamera kanë qenë të arsyeshme, sepse ka pasur vjedhje masive të votave, me thasë.

Duke pasur parasysh se gjatë procesit të kaluar, për shembull, në komunën e Skenderajt unë kam parë që në një fshat kanë mbetur pa votuar vetëm 5 votues nga e gjithë lista e atyre që kanë pas për të votuar dhe, për ironi, më shumë se 100 nga aty kanë qenë të vdekur dhe ata shpejt e shpejt janë çuar prej vorri, kanë votuar për PDK-në dhe kanë hyrë prapë në varr. Interesant ka qenë kjo, sepse të gjitha votat kanë qenë për PDK-në. Prandaj, sikur të kishte Komision Qendror Zgjedhor dhe sikur të shiheshin që aty ka pasur mbi 100 të vdekur, i gjithë ai proces zgjedhor në atë fshat do të anulohet, por kjo s'ka ndodhur sepse s'ka pasur Komision Qendror Zgjedhor dhe Komisioni Qendror Zgjedhor nuk i ka fshi të vdekurit nga listat e votuesve.

Gjithashtu, në Kosovë ka parti politike që ju konvenon mosdalja e qytetarëve për të votuar sepse kujdesen shumë ata militantët, por edhe ato shërbime të tyre partiake që të votojnë për ta. Prandaj, unë do ta marrë një shembull. Një qytetar në një fshat të Drenicës është vonua për të votuar, por kur ka shkuar, dikush kish pas votua për të dhe i ka thënë - qe këtu e keni emrin që ka vdekur njeriu, voto për të! Do të thotë, të gjithë ata që janë të regjistruar për të votuar dhe jetojnë në botën e jashtme, voton dikush për ta, kujdeset dikush për ta, mos të bëhen merak se votojnë të tjerët dhe nuk ka problem, ata votojnë për dëshirën e atyre që janë në Gjermani, sepse e dinë sigurisht, ata militantë të partive politike të mëdha e dinë për kë duhet të votojnë punëtorët që janë në botën e jashtme.

Unë po them sinqerisht, partitë politike që kanë fuqi financiare, së bashku me shërbimet e tyre angazhohen maksimalisht një të diele që të vjedhin vota, dhe a e dini pse? Sepse një të diele duke vjedhur vota, vjedhin para të taksapaguesve rrafsh 4 vjet pa u ndalur dhe për këtë kemi shumë arsye të besojmë sepse vetëm gjatë 2 – 3 ditëve të fundit edhe ai drejtori më i madh i Bankës Qendrore ka rënë në burg.

Me gjithë mangësitë që ka ky raport, që ka mjaft mangësi, të paktën ky raport është i shkruar shqip se ne gjatë gjithë procesit zgjedhor u patëm pas mësuar ta dëgjojmë kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor të flas që nuk e dinim a po flet turqisht, a shqip, a serbisht, nuk mund as ta merrnim vesh. Prandaj, tash është bërë një ndryshim aty, besojmë që të paktën do të marrim vesh që do të flet shqip ai.

Ky raport nuk e meriton të votohet dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e mbështet këtë raport sepse ka qenë raporti më i keq që e kemi parë ndonjë herë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsedavajući!

Meni je drago da ste izdržali danas vi zajedno s nama, ali nemamo čitav dan nikog od predstavnika Vlade, s toga ja bih posebno pozdravio ministra Bukošija koji je izdržao ovu našu današnju celodnevnu raspravu, zaista, dok ministri o čijoj se problematici raspravlja, nema ih ovde. Mislim, mnogo puta govorimo o tome, al se ništa ne menja, izgleda da nemamo mehanizme kako da privolimo, a znamo kako je to u nekim zemljama.

Vidite, ovaj izveštaj, samim tim što su izbori vrlo složen proces sam po sebi, mi smo po prvi puta, što su i kolege reali, ovoga puta sami sprovodili ove izbore i oni nisu prošli bez problema. Ovaj izveštaj pokušava da bude i transparentan, i razumljiv, i sadržajan, međutim nije se u tome uspeo mnogo. Ja bih rekao da je naša Centralna izborna komisija nekoliko puta menjala predsednika, nikada se nismo zapitali zapto? Verovatno nije imalo dovoljno kompetencija, pa su je mnogi napuštali, znamo gospodina Baraliju, pa po tom gospođa Ljušta, i tako dalje, i sad imamo dakle dalje sledeće promene.

Imamo informacije da je Centralna izborna komisija putovala u neke zemlje da se upozna sa njihovim izbornim procesima, kako bi to pomoglo sprovođenju procesa kod nas. Ali ja ne mogu da ne pomenem jednu anegdotu ovde, koja je kružila u vreme održavanja izbora. Navodno je bračni par krenuo na izbore i dogovorili su se muž i žena da glasaju za istu partiju. Kad su izašli, pita muž ženu, - jesi li glasila za? Kaže – zaboravila! Ajmo da se vratimo nazad da isprave, a kada su se javili biračkom odboru da isprave glas, pošto je moja žena pogrešila, oni su rekli: - pa mi smo već ispravili, nemoj da brinete! To je bila jedna anegdota koja je kružila u vreme izbora, ali ja želim jednu parodiju da dam. Ne pominju se nigde problemi u drugom i trećem krugu, zašto je došlo do toga, zašto su napravljene greške, ko je odgovoran za to? Mi u opšte o tome nismo nijednu reč ovde pročitali.

Dalje, gospodo, kada su u pitanju izbori, ja bih poseban akcenat stavio na jedan problem koji smo raspravljali mnogo puta i u onim izbornim komisijama kada smo pravili prvi Izborni zakon. Naime, problem je glasanja u inostranstvo. Naša dijaspora nije uvažena od svoje matične države. Kako će biti uvažena, kada po podacima koje imamo stoji da je poslato 34.000 hiljada glasačkih listića u Kosovsku dijasporu. Pa zar mi imamo 34.000 glasača vani! Pa, molim vas, kako se to odričemo svojih građana? Šta to treba da učinimo da zainteresujemo te ljude da i oni kroje sudbinu svojim glasom svoje zemlje. Sada smo u prilici da to uradimo. Nikakvi pokušaji do sada nisu uradili. Ako vam još dodam podatak da je glasalo svega 1.300 naših građana u dijaspori, to je ispod 0,5%, 0,4%. Molim vas, uzmite u obzir šta znači 0,4% odziva birača u inostranstvo. Zaista je jedan paradoks koji ne može niko da shvati. Ovo što su moje kolege govorile o biračkim spiskovima, koji nisu revidirani i tako dalje, i tako dalje, sada imamo priliku da govorimo i o tome jer je formirana jedna nova Izborna komisija, koja ima za cilj, radna grupa koja ima za cilj da dosadašnji zakon malo revidira, preusmeri ga, dopuni i tako dalje.

Eh, sada, nemamo nikakvu informaciju šta se i kako se na tome radi. Tako da, sve u svemu, ja sam ovde govorio o problemima. Sigurno da smo zadovoljni da je negde bilo sve u redu, ali treba pomenuti zašto nije negde nešto bilo u redu, kako se to više ne bi ponovilo.

Mi, kao grupa, u svakom slučaju podržaćemo ovaj izveštaj, ali svesni da ima mnogo propusta i da ima mnogo poslova kako bi se ove neke nepravilnosti o kojima govorimo, otklonile. Ja podržavam

takve neke primere koje su kolege spominjali, ali je činjenica, trebamo zasukati rukave kako nam se ne bi više ovakvi promašaji debili, pa da nam izborni proces traje zaključno sa trećim krugom, 6 meseci su trajali izbori. U jednoj državi gde pola godine traju izbori od početka do kraja, nije li to previše i nije li to bacanje senke na izborni proces. Hvala, ja bih toliko o izborima!

KRYESUESI: Faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Ja ću naše izlaganje, znači izlaganje Parlamentarne grupe SLS započeti jednom krilaticom, a to je - ko radi, taj greši, ali smatramo da u ovom izveštaju CIK nije naveo greške, a bilo i grešaka i nedostataka, i složićemo se sa prethodnim diskutantima i govornicima koji su te greške definisali. Da ne bi to ponavljao, smatram preporuke Komisije za sudstvo i zakonodavstvo, naročito njihove stavke koje se tiču prečišćavanja glasačkih spiskova, izgradnje kapaciteta, odnosno menadžiranju izbornog procesa na biračkim mestima i brojanju glasova i osim ostalog ima tu i još dosta toga, da trebamo da se pozabavimo tim pitanjima, mislim to se odnosi na Centralnu izbornu komisiju. Takođe, preporuke koje je Komisije za budžet i financije dala, takođe ćemo prihvatiti. Da ne bi dužio, kažem vam, bilo je grešaka, CIK treba ovo da shvati kao dobru našu volju i nameru, da obrate pažnju na svoje greške, da ih u buduću ne bude. Mi ćemo glasati za ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit për Integritet, Branislav Grbić.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući!

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Godišnji izveštaj o radu i aktivnosti CIK-a je jedan tehnički materijal koji u suštini nam ne ostavlja mnogo mogućnosti i prostora da možemo da razrešimo da li pozitivan ili negativan. Sagledavajući cifre e nameru u osnovu čega je dat ovaj izveštaj, može da se usvoji. Međutim, mi smo u ovom izveštaju očekivali znatno jednu korektniju i ažuriraniju politiku Centralne izborne komisije u smislu da je zaista na osnovu proteklih izbornih rezultata i iskustva bilo dosta tih anomalija koje su uticale na same izborne rezultate, ujedno znači na jedno stvaranje standarda ponašanja takve jedne organizacije i standarda poverenja građana Kosova. I sigurno u interesu građana Kosova je da je ovaj izveštaj mogao da ima i malo pozitivnih i kritičnih situacija, da ipak se upoznamo sa jednom materijom koja je zaista jako teška i u granicama objektivnosti i smatram da što se tiče rada sa međunarodnim kancelarijama, tu je moglo da se malo dodaje i aktivnost sa raseljenim građanima Kosova, kojih je zaista ili prek 100 hiljada van Kosova, koji su ipak građani Kosova i kosovari i sigurno da je to jedna pozitivna stvar koja bi trebalo da se desi na narednom periodu, da bi takvi isti građani mogli na sledećim izborima da glasaju i da budu legitimni građani Kosova. I to je nešto što smatram da će ova Centralna izborna komisija u narednom svom izveštaju imati u obzir i mi ćemo, evo kažem, zbog interesa takve jedne organizacije prihvatiti ovaj izveštaj i nadamo se da će naše primedbe biti prihvaćene. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani radha është e deputetëve. Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër,

E vetëkuptueshme, u bë një punë e gjatë dhe ndoshta jemi lodhur, por po e ndiej të nevojshme t'i them disa fjalë rreth Raportit vjetor të KQZ-së.

Raportet kur bëhen, qëllimi kryesor i tyre është që në të ardhmen të shkojë puna mirë. Në bazë të asaj se çfarë lloj sfidash ka evidentuar Raporti vjetor i KQZ-së, duket se edhe vetë raporti nuk i plotëson kushtet që të jetë si duhet.

Sa u përket rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion edhe Gjyqësi, unë këto rekomandime që t'i bëhen KQZ-së, i mbështes plotësisht në emër të Partisë Socialiste, jemi kategorisht që duhet tërhiqet votimi me kusht, në bazë të sfidave të procesit zgjedhor, KQZ në mënyrë të tërthortë e ka pranuar se votimi me kusht ka qenë një vrimë e zezë, ku janë manipuluar votat dhe kjo nuk duhet përsëritur. Mendojmë se duhet që në kuadër të përgatitjes teknike të përfshihet montimi i kamerave gjatë procesit zgjedhor dhe sidomos i numërimit të votave dhe i bërjes së procesverbaleve të komisionarëve në vendvotime.

Vendosja e kamerave gjithashtu do të ndërpriste dukuritë e dënueshme të mbushjes së kutive në orët e paditës dhe të mbrëmjes. Rekomandimi tjetër duhet të jetë për KQZ-në edhe përgatitja për votim elektronik. Sado që mund të jetë i kushtueshëm, e thjeshton dhe e saktëson, normalisht që edhe e shpejton shumë rezultatin e zgjedhjeve. KQZ duhet t'i padisë komisionarët të cilët e keqpërdorin detyrën gjatë dhe pas votimit. Megjithëse ka pasur komisionarë që e kanë shkelur rregullat, deri më tash asnjëri prej tyre nuk është ndëshkuar penalisht. Kjo, për mendimin tonë, ka inkurajuar dhe inkurajon komisionarët për të ardhmen për të dëmtuar procesin zgjedhor deri në atë shkallë sa mund të bëjnë të papranueshëm për ata që dëmtohen.

Fare në fund, më lejoni të them edhe këtë. Komisioni Qendror Zgjedhor edhe prej këtij raporti, edhe prej rekomandimeve, por edhe prej punës tash që është duke vazhduar, qysh në start nuk i ka shërbyer punës së komisionit për këtë vit asgjë e kaluara. Tash ka filluar procesi i diskutimit të Kodit Zgjedhor dhe Komisioni Zgjedhor Qendror nuk i ka përfshirë të gjitha partitë që janë të regjistruara sipas ligjit në këtë diskutim të Kodit Zgjedhor. Kjo, të nderuar, është një shkelje e afrimit të shanseve të barabarta për partitë edhe qysh në start është absolut i papranueshëm.

Partia Socialiste e Kosovës iu ka drejtuar me shkrim KQZ-së edhe kërkon korrektësi në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Emrush!

Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ne e kemi diskutuar raportin e punës edhe në Komisionin për Gjyqësi dhe Legjislacion dhe fillimisht kemi qenë të pakënaqur me raportin, kemi kërkuar nga KQZ-ja plotësime. KQZ-ja i ka bërë disa plotësime dhe unë tash po e shoh që në raportin që ka ardhur në Kuvend mungojnë ato plotësime që i ka bërë KQZ-ja në komision. Mirëpo, edhe para plotësimeve, edhe pas plotësimeve puna e KQZ-së në vitin e kaluar lë shumë për dëshiruar e po kështu edhe raporti lë shumë për të dëshiruar. Me të drejtë, edhe në komision, por edhe këtu gjatë debatit janë përmendur disa prej vërejtjeve që mund t'i bëhen raportit dhe të tilla ka shumë. Mund të flitet për pastrimin e listave të votuesve, që është një problem shumë serioz për procesin e votimit. Mund të flitet për rishikimin e votave me kusht, mund të flitet për rishikimin e votimit jashtë Kosovës, mund të flitet për auditimin e rregullt të pasqyrave financiare të partive politike gjatë zgjedhjeve dhe shumë vërejtje tjera. Mirëpo, besoj se një problem kryesor është paraqitur në KQZ gjatë vitit të kaluar, por edhe më herët, problem që quhet -

menaxhim i procesit zgjedhor. Komisioni Qendror Zgjedhor nuk ka treguar kapacitete për t'i menaxhuar mirë zgjedhjet e vitit 2007 dhe zgjedhjet e fundit lokale 2009 – 2010.

Mund të përmendet vetëm fakti se në tri komuna janë anuluar zgjedhjet, zgjedhjet e fundit. Ndërsa janë 24 vendvotime ku janë anuluar dhe janë gjetur parregullsi të mëdha, por këta numra paraqesin vetëm ato raste kur ka pasur ankesa të mëdha. Mbetet me të drejtë të dyshojmë se në shumë vendvotime tjera ka pasur parregullsi dhe Komisioni Qendror Zgjedhor nuk i ka trajtuar ato çështje. Ajo që duhet të bëjë Komisioni Qendror Zgjedhor në vitin e ardhshëm dhe në vitet e ardhshme edhe për zgjedhjet e ardhshme, është të ngritë kapacitetet për të menaxhuar çdo qendër të votimit dhe çdo vendvotim. Nuk është i mundur keqpërdorimi i votave, nuk është i mundur krijimi i parregullsive në një vendvotim ose në një qendër të votimi pa bashkëpunimin e komisionarëve, të komisionarëve të cilët paguhen prej Komisionit Qendror Zgjedhor, do të thotë duhet të ketë një bashkëpunim midis komisionarëve që të keqpërdoret vota.

Çka do të thotë keqpërdorimi i votës, e dimë të gjithë. Por, më lejoni vetëm të them këtë fakt. Ne përditë flasim kundër korrupsionit dhe Qeveria e ngritë flamurin e vet kundër korrupsionit. Më lejoni t'ju them se korrupsioni në një tender është një gjë e vogël ndaj korrupsionit në keqpërdorimin e votës. Blerja e votës me vaj, blerja e votës me miell, blerja e votës me para, keqpërdorimi i votave, mbushja e kutive me fletëvotime është korrupsioni më i madh që mund t'i ndodhë një vendi. Është problemi më i madh, sepse me blerjen e votës po e blen mundësinë që votuesi ta ndikojë politikën, po ia pamundëson votuesit ta ndikojë politikën. Nëse votuesi bindet se nuk po ndikon në politikë, atëherë ai do të tërhiqet prej votimit, ai do të krijojë një distancë ndaj të gjithëve, ndaj të gjitha partive politike, ndaj pushtetit dhe do të rri e të shikojë punën e tij. Kjo është mënyra më e mirë për të krijuar hapësirë për grupet e interesit të vogël për ta dirigjuar politikën dhe për t'ia pamundësuar qytetarit që ai ta ndikojë politikën dhe ai ta përcaktojë fatin politikë të vendit. Kjo është arsyeja themelore të cilën e kemi diskutuar edhe në komision, për të cilën i kemi kërkuar Komisionit Qendror Zgjedhor që të hapë një debat të gjerë, që të marrë nisma Komisioni Qendror Zgjedhor që të bashkëpunojë me Kuvendin e Kosovës, me partitë politike për të krijuar rrethana më të mira për procesin e votimit, sepse keqpërdorimi i votës nuk është, dorën në zemër, vetëm kompetencë, mbikëqyrje e KQZ-së, por varet shumë edhe prej vullnetit të partive politike që marrin pjesë në zgjedhje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputetja Qamile Morina e ka fjalën.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!
Raporti i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2009, si vërejtje e përgjithshme do të ishte se raporti ka mangësi, paqartësi, pasaktësi dhe lëshime që nuk do të duhej të pranohej si i tillë. Për të mos përsëritur atë që e thanë shumica e deputetëve, unë do t'i adresoj disa vërejte të veçanta që janë në këtë raport: KQZ-ja dhe Zyra për regjistrimin e partive politike nuk e kanë pasqyruar gjendjen reale sa i përket regjistrimit dhe certifikimit të subjekteve politike. Për shembull, zyra i ka rekomanduar KQZ-së për certifikim edhe partitë që nuk i kanë kryer obligimet ligjore. Ne e dimë se kemi subjekte politike në vendin tonë që me vite të tëra nuk kanë mbajtur kuvende zgjedhore.

Nga raporti shihet se shërbimi votues ka dështuar sa i përket informimit dhe edukimit të votuesve. Projektet, veçmas ato për edukim dhe informim, janë të dështuara dhe pa pasqyrim të shumave të kushtueshme financiare. Votimi jashtë Kosovës, gjithashtu sipas raportit, është i dështuar, pa pasqyrim të shkaqeve dhe arsyeve të dështimit.

Sipas raportit, periudha e shërbimit të votuesve dhe periudha e kundërshtimit dhe sfidimit të listës së votuesve kanë dështuar fare. Spastrimi dhe azhurimi i listës së votuesve nuk është bërë dhe kjo ka shkaktuar probleme të qytetarëve gjatë votimit, si votimi me kusht, votuesit jashtë Kosovës pa të drejtë vote. Kështu, në këtë mënyrë janë lejuar mundësitë e manipulimit gjatë zgjedhjeve të kaluara. Operacionet në terren, si emërimi i anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe këshillave të vendvotimeve është bërë me vonesë dhe pasoja - nuk është realizuar strategjia e informimit të votuesve, sidomos të atyre të vendeve rurale. Buxheti nuk është pasqyruar fare mirë në raport, gjë që Raporti i Zyrës së Auditorit Gjeneral ka identifikuar shumë mangësi dhe shumë keqpërdorime.

Andaj, konsideroj që nga raporti shihet që organizimi dhe implementimi i zgjedhjeve të ardhshme do të jenë proces shumë sfidues, nëse procesi i zgjedhjeve do të udhëhiqet si gjër më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Arsyeja e vetme pse e mora fjalën është se disa herë e kam lexuar këtë raport. T'ju them të drejtën, unë edhe tash jam kah e lexoj edhe një herë dhe nuk jam kah e kuptoj se çka ka dashur KQZ-ja të na informojë, me çfarë informatash, çka duhet ne të dimë lidhur me atë çka po ngjet apo për çka KQZ-ja është e thirrur. Këtu u prekën disa herë nga deputetët e nderuar, kolegët e nderuar në forma të ndryshme ato informata të cilat na kanë interesuar, të cilat nuk na i kanë dhënë, por na i kanë dhënë disa informata. Nëse merrni faqen 2, do me thanë, dita e zgjedhjeve të 15 nëntorit 2009, dhe është për t'u qeshur një agjendë që e kanë qitur, madje është edhe në gjuhën angleze, tash do të thotë ne tash pa tjetër duhet ta dimë edhe gjuhën angleze për ta kuptuar. Madje edhe anglishten nëse e dimë, nuk e kuptojmë. Janë disa vija thotë këtu, kritikël, kritikël..., s'di çka kanë dashur të na informojnë. Është dashur së pari ata të na organizojnë një workshop për ta kuptuar këtë raport se çka kanë dashur të na tregojnë neve.

Pastaj, nëse shkojmë kah fundi, është edhe një pjesë edhe më e koklavitur. Nëse di dikush të ma shpjegojë, unë sinjerisht kërkoj nga kolegët, është faqe 41 apo faqe 23, thashë, varësisht si e njehim. Është faza e përgatitjes dhe implementimit task name dhe janë disa thënie këtu, disa rreshta, nja 3 – 4 faqe. Nëse i ka kuptuar ndokush, sinjerisht kërkoj në mënyrën më kolegiale që le të ma shpjegojnë. Unë e kam lexuar disa herë dhe s'di çka ka këtu, po mendoj, po di ta lexoj, por se çka kanë dashur të na informojnë, idenë s'e kam. Pastaj, këtu u përmend edhe pasqyra financiare. Në pasqyrën financiare është e vërtetë se disa të dhëna janë, por përsëri për t'i kuptuar ato të dhëna, ne tash duhet të kërkojmë kontot atje për shkak se, ndonëse i kanë qitur disa numra 1,2,3,4 por përcilli këto numra 1,2,3,4 dhe ne kur s'dimë se çka kanë dashtë të na tregojnë neve.

Me fjalë të tjera, është një nga raportet e shkruara më së keqi që kemi pasur dhe, siç e dini, kemi pasur shumë raporte të këqija të cilat s'i kemi kuptuar fare. Këtë raport, unë të paktën, po flas për aq sa e kam lexuar vetë dhe për aq sa më ka interesuar për këtë institucion për të më informuar për atë se çka ndodhë në sferën për çka është i thirrur, nuk kam kuptuar asgjë, andaj nuk do ta votoj, të them të drejtën. Shpresoj se në raportin e radhës KQZ-ja do të na sjellë ato informata për të cilat deputetët, po edhe partitë politike, qofshin ato të pozitës, qofshin të opozitës, janë të interesuara që t'i dinë edhe zyrtarisht. Faleminderit!

Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Faleminderit!
Armend Zemaj e ka fjalën, i fundit është.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, faleminderit!

Unë kam folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, por në mbledhjen e mbajtur më 7 qershor, kur është shqyrtuar raporti nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, është kërkuar plotësimi i Raportit të punës së KQZ-së për vitin 2009. Raporti plotësues ka ardhur tani nga kryesuesja e re Valdete Daka dhe është shqyrtuar me datën apo në mbledhjen e radhës më 13 korrik dhe ky raport plotësues nuk i është bashkangjitur Raportit të punës për vitin 2009, nuk e di pse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në sallë kemi 73 deputetë.

Raporti i komisionit është që të miratohet me rekomandimet e tij.

Të përgatitemi për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 38 vota “për”, 30 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2009 me rekomandimet e komisionit funksional.

Në radhë është pika e 16 e rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Programin Kombëtar të Shkencës

Komisioni funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Programin Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës për periudhën 5 - vjeçare dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin për shqyrtim dhe miratim. Kryetari i komisionit a është këtu? Nuk është këtu. Atëherë, kryetarët e komisioneve, kësaj radhe po e bëjmë një kapërcim. Fjalën po ia japim në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetit Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve, sidomos ministrin e Shëndetësisë, dr. Bujar Bukoshin, i cili e përfaqëson këtu Qeverinë e Kosovës.

Programi Kombëtar i Shkencës së Republikës së Kosovës, të cilin e kemi në shqyrtim, është përpiluar nga njerëzit kompetentë vendorë, bashkë me disa ekspertë ndërKombëtar. Me formimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës mendojmë se është bërë një hap i nevojshëm në përpjekjet për përparimin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore, politike, e sidomos ekonomike në baza të analizave përkatëse shkencore.

Kosova ka tashmë një fond të mirë të ekspertëve shkencorë të lëmive të ndryshme, të cilët mund të japin kontributin e nevojshëm në institute të ndryshme shkencore, por edhe jashtë tyre për zgjedhjen e problemeve të ndryshme të jetës ekonomike dhe shoqërore në Republikën tonë.

Në këtë program që po e shqyrtojmë janë caktuar prioritetet e sektorëve të ndryshëm që duhet përkrahen e të zbatohen. Kryesisht këto janë të natyrës ekonomike, gjë që është në rregull dhe e arsyeshme. Mirëpo, duhet të kemi kujdes të nevojshëm edhe për zgjidhjen e problemeve shoqërore e politike, sidomos në lidhje me konsolidimin e shtetit tonë të lirë, sovran e demokratik në kushte të reja të tona.

Pa shtet të mirëfilltë të pavarur e sovran, zhvillimi normal i jetës shoqërore dhe ekonomike e kulturore nuk ka perspektivë. Është e domosdoshme që për probleme të ndryshme të kërkohet mendimi dhe angazhimi i shkencës, i institucioneve përkatëse shkencore. Është bërë mirë që tani për shkencë është caktuar 0,7% ndihma financiare nga buxheti i Kosovës, i cili ka qenë deri tash vetëm simbolikë - 0,1%. Faleminderit, për fjalën që ma dhatë, të cilën e kërkoja me arsye personale.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Drita Kadriu e ka fjalën.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Në emër edhe të Komisionit të Arsimit, edhe në emër të Partisë Demokratike të Kosovës paraqesim qëndrimet rreth programit Kombëtar të Shkencës. Më lejoni t'i them veç 2 – 3 fjali, të cilat mendoj se janë të rëndësishme për miratimin e këtij programi.

Sipas Ligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore, sot kemi në votim Programin Kombëtar të Shkencës, me ç'rast kisha falënderuar të gjithë ekspertët, sekretariatën e Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe të gjithë personat e involvuar në hartimin e një dokumenti kaq voluminoz dhe kaq praktik.

Meqenëse gjatë hartimit të këtij programi janë identifikuar gjithsej 33 disiplina, në të cilat ka nevojë zhvillimi i Kosovës, zhvillim i cili do të mbështetet në shkencë, prej tyre janë identifikuar vetëm 5 fusha kryesore, janë përmbledhur 5 fusha, të cilat janë: mjedisi, energjia dhe resurset natyrore, prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit, kërkimet shkencore në mjekësi, zhvillimi i shoqërisë i bazuar në dije dhe studime gjuhësore, kulturore, historike. Ndërsa, teknologjia e informimit dhe komunikimi si prioritet është paraparë që të shtrihet në të gjitha këto fusha në aspektet horizontale.

Programi Kombëtar i Shkencës në vete përmban planin e veprimit, po ajo që është e domosdoshme, është i shoqëruar edhe me buxhetin për vitin 2010 – 2019. Meqenëse Qeveria këtë vit ka zotuar një milion euro për zhvillimin e shkencës, ne gjithashtu nga Kuvendi sigurojmë, besojmë që të gjithë njerëzit të cilët do të merren me veprimtari shkencore dhe me objektivat e zhvillimit të shkathtësive për hulumtime shkencore, të aplikojnë dhe të krijojnë mundësi për formimin e këtyre dokumenteve të cilat do t'i ndihmojnë zhvillimit të Kosovës.

Edhe në emër të Komisionit të Arsimit, edhe në emër të Partisë Demokratike ne i përkrahim rekomandimet e Komisionit, si dhe vetë programin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Adem Hajdaraj e ka fjalën. Kohën, racionalizojeni sa të mundëni!

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne, në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe mendojmë se i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme për t'u miratuar, për t'u votuar. Kemi vërejtur edhe në Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar i të cilit grup jam, se këtu kanë punuar njerëz të cilët i njohin çështjet e shkencës, zhvillimin e tjera e tjera, prandaj edhe pikërisht për këtë ne e përkrahim, i japim mbështetjen.

Mirëpo, unë, si deputet, mendoj t'i theksoj disa çështje që ma merr mendja që do ta plotësonin këtë program. Çështja e parë, për të cilën mendoj, është se Programi Kombëtar nuk e ka hulumtuar bazën, domethënë këto konsultime që janë marrë, këto 4 plus 1, prioritetet, fushat të cilat janë theksuar aty, nuk janë marrë në bazë të hulumtimeve për institucione, vende të nevojshme ku nxirren këto konkluzione dhe kjo, në të vërtetë, e ka ngecur edhe nxjerrjen e prioriteteve, sepse po të ishin marrë këto nga baza, dihet se që 20 vjet stafi akademik ka qenë tërësisht jashtë rrjedhave të zhvillimeve shkencore. Ata kanë punuar, njerëzit kanë punuar, institucionet, por nuk është pasur parasysh se të gjitha këto institucione shkencore, duke përfshirë Akademinë, duke përfshirë institutet, Institutin Albanologjik, të Historisë e tjera e tjera, kanë qenë të penguar në periudhën para 10 – vjeçare, domethënë gjatë kohës së okupimit dhe sigurisht që s'kanë mundur ta japin kontributin e vet as në fushë të shkencës, por megjithatë ka pasur përpjekje edhe janë bërë do përpjekje për t'i zbardhur, për t'i realizuar disa prioritetet që i kanë pasur. Ne mendojmë se prioritetet e nxjerra nga Programi Kombëtar janë të përgjithësuar pikërisht duke pasur parasysh këtë periudhë e mëparshme dhe tash kam përshtypjen se këto janë nxjerrë nga ministritë. Për shembull, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Kulturë ia ka propozuar këtë, Ministria e Bujqësisë këtë dhe i kanë marrë, domethënë pa i hulumtuar drejtpërsëdrejti, edhe pse anëtarët e komisionit janë njerëz me peshë, njerëz që i dinë këto çështje e që mendoj se janë edhe kompetentë që ta bëjnë këtë.

Prandaj, as Universiteti, as institutet, as Akademia domethënë nuk i kanë bërë hulumtimet e nevojshme për të nxjerrë konkluzione për këto 4 plus 1, prioritetet apo si të them fusha në të cilat është koncentruar domethënë Këshilli Kombëtar.

Një çështje tjetër që më duket se duhet ta zëmë në gojë edhe ta themi këtu, është edhe mbështetja financiare e vogël për një dhjetëvjeçar, 0.1% domethënë prej bruto produkteve vendore është një shumë shumë e vogël për shkencën e për hulumtimet tona, sepse pak është dhënë, edhe pse është bërë përpjekje të financohet pra, nuk është arritur që të financohen aq sa duhet dhe ky financim ka qenë i vogël dhe duhet të bëjmë përpjekje që në të ardhmen ta rrisim këtë përqindje për shkencën dhe zhvillimin e shkencës në tërësi.

Çështja tjetër, programi kombëtar, që thamë, duhet të jetë në nivel me ecje të zhvillimeve ndërkombëtare, por duke pasur parasysh atë periudhë e ngecjeve gjatë okupimit, përzënien nga institutet, nga akademitë, ku ta di unë, edhe ato që i ka bërë pushtuesi. Ne tash duhet të shkojmë me hapa shumë më të mëdhenj dhe unë mendoj se kemi ecur me hapa më të mëdhenj përball të gjitha këtyre pengesave, por këto ecje duhet të jenë në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare, gjithnjë duke i ruajtur karakteristikat kombëtare, se pa i ruajtur karakteristikat kombëtare përsëri nuk do të jetë, shkenca nuk do të shkojë në përparim në kuptimin e plotë të fjalës.

Ky quhet programi kombëtar dhe si thashë më parë, nuk janë studiuar të gjithë faktorët e domosdoshëm brenda për brenda dimensionit kombëtar dhe gjithëkombëtar, por edhe nga aspekti ndërkombëtar, se i kur i themi programi kombëtar, domethënë nuk është fjala vetëm për kombin këtu, por në tërësi program kombëtar.

Po, megjithatë, me gjithë këto që unë i thashë, mendoj se janë studiuar mirë këto 5 pika, nuk është kërkuar diçka, domethënë kanë qenë mjaft solid me shtrimin e këtyre 5 fushave, nuk e kanë tejkaluar, po janë kërkesa mjaft solide që mund të realizohen, ma merr mendja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Donika Kadaj e ka kërkuar fjalën.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Nuk është risi, do të thotë, është thënë në vazhdimësi që shkenca dhe hulumtimi janë prioritet i veçantë për një shtet të ri, për Kosovën. E dimë edhe që ka ngec, do të thotë, kjo sferë jashtëzakonisht shumë dhe që Këshilli Shkencor ka hasur në vështirësi të shumta edhe sa i përket buxhetit, edhe stafit, edhe objekteve, edhe problemeve të tjera të shumta me të cilat janë ballafaquar. Prandaj, konsiderojmë si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës që ky program është më se i mirë se ardhur. Ajo çka është shqetësuese për ne, është se jemi mësuar kohëve të fundit të marrim shumë dokumente, të cilave u janë dhënë emra të ndryshëm, si për shembull strategji, strategjia për veriun, plane të tjera të cilat më tepër janë shfrytëzuar prej ministrave dhe dikastereve përkatëse si një mekanizëm propagandistik seç në fakt kanë luajtur një rol konkret ose kanë avancuar sferën e caktuar. Prandaj, me shpresë që ky program nuk do të mbetet si i tillë, vetëm një mjet propagandistik i ministrit Hoxhaj dhe i Qeverisë Thaçi, do të thotë do ta mbështesim dhe do të shikojmë zbatimin e tij për së afërmi, duke kërkuar gjithashtu që edhe mjetet buxhetore prej 1 milion eurove, të cilat janë ndarë për këtë sferë, të mos keqpërdoren, sepse kemi keqpërdorime tepër të mëdha në të gjitha sferat. Prandaj, frikësohemi që edhe këto mjete do të shkojnë në xhepa të pushtetarëve dhe jo në hulumtim dhe shkencë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AKR-së deputeti Heset Cakolli e ka kërkuar fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përhëndetje, i nderuari ministër Bukoshi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Bazuar në Ligjin për veprimtarinë kërkimore - shkencore, është hartuar Programi Kombëtar i Shkencës së Republikës së Kosovës për periudhën e ardhshme 5 - vjeçare dhe duhet te synojë t'i identifikojë prioritetet shkencore dhe pastaj ky program duhet te miratohet nga Kuvendi i Kosovës, por njëkohësisht duhet te sigurohen fonde të nevojshme për zbatimin e tij në praktikë.

Programi Kombëtar i Shkencës ka për qëllim ti neutralizojë dhe zvogëlojë deficitet ekzistuese, por njëkohësisht duke ofruar një kornizë për forcimin e kapaciteteve ekzistuese dhe ngritjen e kapaciteteve te reja kërkimore në shkencë.

Ky program ka 5 objektiva kryesorë për veprimtarinë kërkimore - shkencore:

- 1) Zhvillimi i kapaciteteve ekzistuese,
- 2) Zhvillimi i infrastrukturës,
- 3) Ndërkombëtarizimi i hulumtimeve shkencore,
- 4) Vendorsja e lidhjeve të përhershme në mes shkencës dhe ekonomisë dhe
- 5) Avancimet në veprimtarinë kërkimore - shkencore.

Programi Kombëtar i Shkencës, pas shume diskutimesh dhe debatesh me ekspertë të fushave të veçanta i ka përcaktuar pese (5) prioritetet kryesore:

- 1) Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi,
- 2) Prodhimet bujqësore dhe siguria e ushqimit,
- 3) Kërkimet shkencore dhe mjekësore,
- 4) Studimet shoqërore dhe ekonomike, dhe

5) Studimet kulturore dhe historike.

Më pas, në pikën 5 të Programit Kombëtar të Shkencës së Republikës së Kosovës janë dhënë katër 4 arsye apo vlerësime për secilën nga pesë prioritetet e cekura më lartë, siç janë:

- a. Rëndësia për zhvillimin e vendit,
- b. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore,
- c. Gjendja e infrastrukturës kërkimore dhe shkencore,
- d. Temat që duhet trajtuar për secilin prioritet veç e veç.

Në pikën 6 të këtij programi është dhënë edhe plani i aktiviteteve, koha dhe orari i zbatimit të pesë objektivave të përcaktuara më parë.

Me këtë rast dëshiroj të theksoj se ky program paraqet një dokument i cili premtun një fillim të mirë për punën kërkimore - shkencore, por është e rëndësishme që të fillojë zbatimi i tij sa më parë, sepse shumë tema që duhet trajtuar janë kërkesë e kohës dhe nevojë e domosdoshme për zhvillim të përgjithshëm të shtetit të Kosovës.

Në fund, kam dy propozime konkrete:

1. Kërkimet e para shkencore në tema të caktuara duhet të jene në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë në tërësi, pra fillimisht kërkimet shkencore duhet të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies sociale me qëllim që ky sektor të fitojë besimin, rëndësinë dhe mbështetjen shoqërore.
2. Qeveria e Republike së Kosovës për periudhën e ardhshme 5 - vjeçare të gjejë forma dhe mundësi për rritjen e buxhetit, me kusht që të zbatohet ky program i shkencës deri në vitin 2015.

Në fund, ne si Grup Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i japim mbështetje të plote Programit Kombëtar të Shkencës dhe shpresoj se ky program do të zbatohet deri në fund të vitit 2015. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Parlamentarna grupa smatra da se radi o veoma sredenom programu. Nacionalni savet za nauku i tehnologiju je stavio akcionat na saradnju sa okvirnim programom Evropske unije pod nazivom IRC. U ovom poglavlju dat je grafikon koji je relativno nejasan jer je se ne vidi šta označavaju cifre na grafikonu. Smatramo da je ovaj program jedna dobra osnova, sa nadom da će biti dosledno sprovedenu u delu. U početku će iziskivati određene trokove, ali će kasnije sigurno dati veće plodove za dobrobit građana Kosova. Mi ćemo podržati ovaj Program nacionalnog saveta za nauku i mislimo da je neophodan za razvoj nauke na Kosovu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, kush e do fjalën? Nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka kërkuar deputeti Bransilav Grbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedniče!

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Nacionalni program za nauku Republike Kosova je nešto što sigurno treba da integriše sve građane Kosova, jer smatramo kao Grupa za Integracije da je ovo institucija koja treba da da jedan novi profil kadrova na Kosovu i da u skladu sa vremenom koje smo izgubili za nauku i tehnologiju sve evropskom, tako i svetskom, sigurno ćemo otvoriti bazu za nove rezultate i da ćemo u narednom periodu imati značajniju i ažurniju aktivnost u stvaranju naučnih kapaciteta. Po gotovo, radi se ovo što nas interesuje, to je radi se za srpsku zajednicu kao građane Kosova koji momentalno još uvek nisu uključeni u nastavni i naučni program Kosova, ali je jako bitno i nadam se da će i u skladu sa Ahtisarijem planom a i sa decentralizacijom opština, institucije i mogućnosti Vlade Kosova da se taj program otvori i da se predstavnici iz srpske zajednice uključe u taj nacionalni program. Hvala, najlepše!

KRYETARI: Faleminderit!

I kemi kryer diskutimet në emër të grupeve parlamentare.

Pa dëshiruar t'ua marr të drejtën të pavarurve, kërkoj racionalizim të kohës. Po vazhdojmë sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, ministra nuk po shoh.

Më vjen mirë që tash e kemi ministrin përkatës. Ne po diskutojmë sot një dokument të rëndësishëm. Unë e përgëzoj Këshillin Kombëtar të Shkencës për hartimin e këtij programi kombëtar, që në fakt është strategji e zhvillimit të shkencës në Republikën e Kosovës. Natyrisht, konsideroj se institucionet përkatëse që duhet ta mbështesin Këshillin Kombëtar të Shkencës, i kanë dhënë mbështetje me rastin e hartimit të këtij programi, që për mua është edhe strategji e zhvillimit, madje mjaft afatgjate, siç e kemi parë këtu me projeksione të tyre kohore për realizimin e aktiviteteve që i kanë paraparë. Sinqerisht, i gëzohem këtij programi për faktin se Kosova nja 10 vite në liri dhe nja 2 në pavarësi ka menduar pak për hulumtimet, për kërkimet shkencore, ka menduar pak për dijen dhe, kur themi ka menduar, domethënë mund të kemi menduar shumë, por kemi ndarë pak mjete ose aspak dhe kur kihet parasysh periudha pararendëse e viteve '90 nëpër të cilat ka kaluar shkenca e Kosovës dhe arsimit në Kosovë, natyrisht gjendja nuk do shumë koment, jemi shumë mbrapa, jemi po thaj 20 vite mbrapa, madje edhe vendeve të rajonit në fushën e kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore në mënyrë institucionale.

Dhe tash e kemi një program, që për mua është mjaft ambicioz. Ndoshta vende-vende lë përshtypjen që është pak më shumë ambicioz, për të mos thënë pretencioz, sepse prej hiçit të mbërrihen ato objektiva duket..., unë uroj që të jetë ashtu, po unë konsideroj që këtij programi duhet..., se në aktivitetet për zbatimin e këtij programi është thënë që Kuvendi duhet ta miratojë këtë program në gjysmën e parë të vitit dhe ne, si legjislativ i vendit, konsideroj që po e kryejmë këtë obligim tonë dhe po e zbatojmë. Po, këtij programi konsideroj që do t'i ndihmonte shumë që ky të bëhet në një farë mënyre i realizueshëm, aprovimi i Ligjit të arsimit të lartë, i cili është në agjendën legjislative, po duhet të vijë, sepse është mjaft i ndërlikur dhe sidomos Ligji për shkencën, kur kihet parasysh se baza ligjore mbi të cilën operon ky program, është me një ligj të vitit 2002 për shkencën. Mendoj që edhe ky ligj nuk jep hapësirë të mjaftueshme për implementimin e këtij programi, i cili është mjaft kontemporar, kështu në kuptimin e kohës mjaft bashkëkohor dhe me tendencë që t'i përafrojë standardet e vendeve të zhvilluara.

Çka mbetet edhe diçka, që për mua thashë duket...? Ky program ka mungesa, pash të projekteve konkrete. I tëri përkufizohet, domethënë te 5 doktoratat e para, që do të jenë në bashkëpunim me

institucione ndërkombëtare dhe do të merren diploma prej 2 universiteteve njëkohësisht dhe ka menduar që të ndajë... Të tjerat janë vetëm grande. Unë mendoj që institucionet që janë këtu bartëse e që përbëjnë pjesën kryesore të Këshillit Kombëtar të Shkencës, qysh është Akademia e Shkencës, Universiteti dhe Instituti Albanologjik, Universiteti i Prishtinës, konsideroj që këto nuk janë shumë institucione që duhet të mendojnë për grande. Grandet dihet kush i jep, domethënë mund t'i japë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministra e Ekonomisë, këto duhet të ofrojnë, ky Këshill Kombëtar ishte dashur të ofrojë në këtë program projekte konkrete dhe për to të kërkojë grande. Nuk më duket shumë që i shkon këtij Programi Kombëtar të shkencës kërkimi i grandeve, ne do të japim grande. Mund të jem unë i gabuar, por grandet i japin ata që i kanë paratë. Ndërkaq, ky Këshill Kombëtar i Shkencës bën projekte konkrete për çka duhet të jepen grandet. Domethënë, kjo është ajo vërejtja që mua m'u duk, përveç këtyre 5 doktoratave nuk kemi projekte konkrete për grande, por janë mjaft për përgjithësuara për çka kërkohen ato grande, sado që dihet, janë për fushat e avancimit të teknologjisë informative e tjera, e tjera për t'u përafëruar me standardet.

Po, në përgjithësi është një sihariq i mirë që e kemi para vetit një Program Kombëtar të Shkencës, me do objektiva të qarta, madje edhe me do projeksione për investime buxhetore që janë, kanë një rritje rapide, domethënë përafërsisht 1 milion, pas 5 vitesh mendohet që të jetë 6 milionë investime në shkencë. Kjo është inkurajuese, është ambicioze, uroj që të realizohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani fjalën po ia japim, me përparësi, Driton Talit.

DRITON TALI: Është dashur atëherë kur pata pak më shumë diçka për të thënë, të mos më anashkaloni, i nderuar, jo tash. Kam mund të pres edhe i fundit, s'ka problem, se s'e kam ndërmend ta zbuloj Amerikën me këtë pikë.

Gjersa, sa i përket Raportit të ART-së kam pasur shumë çka për të thënë, ku është shkelur ligji dhe ku dikush duhet të merret, mendoj dikush nga Policia, nga EULEX-i, më e mira ka qenë nga organet tona vendore të merren, po mbasi ato s'po munden, atëherë edhe EULEX-i, po edhe Ambasada Amerikane, se është përfolur shumë në lidhje me 16 milionëshin dhe në lidhje me Dardafonin, po s'ma dha mundësinë të flas, tash është çështje tjetër.

Sidoqoftë, po i kthehem pikës të cilën po e shqyrtojmë. Arsyeja pse u lajmërova të flas është se, duke e lexua këtë strategji, shpeshherë vjen në pah se disa autorëve, nuk po më intereson kush, ngase këtu ishte një listë e madhe e atyre që janë marrë. Nga dëshira për të treguar se me të vërtetë janë serioz në shkencë, e aktrojnë shkencëtarin, sidomos në mënyrën se si i përdorin futnotat apo fusnotat. Ja, për shembull, faqe 10.2, thotë: "Gjendja e kërkimeve dhe zhvillimeve në Kosovë", është një fjali shumë popullore, po mendoj nuk duhet të jesh edhe fort ekspertë, për më tepër për ata të cilët janë në këtë..., veprojnë apo paguhen në këtë lëmi. Flas për ata që merren me shkencë, pra edhe lista e atyre që janë..., e kanë bërë strategji, thotë: "Kërkimi dhe zhvillimi teknologjik është ende një ndërmarrje marginale në Kosovë", është shumë e qartë, "mungojnë edhe kërkimi bazik dhe statistika teknologjike", që është po ashtu shumë e qartë për çdo kë, "ende nuk ekziston një sistem funksional dhe i qëllimshëm i inovacionit" dhe pastaj përdoret pa lidhje një fusnotë, përdoren disa të huaj këtu, domethënë, unë për diçka çka ndodh në shtëpinë teme, duhet të pyes dikë krejt jashtë dhe ta përdorë atë si referencë për ta bindur vetveten se është ashtu. Mendoj se këtu është ai joprofesionalizmi i atyre që e kanë shkruar.

Pastaj, nëse shkojmë edhe në faqe tjera, ka gjëra, po them, nga dëshira për të tregua seriozitet shpeshherë bien në kurth, vetveten e qesin, shkojnë pastaj me këto ... analizat që na kanë lodhur dhe

është me të vërtetë joserioze një numër i madh, të paktën disa emra që i pash aty, të merren në këtë mënyrë, mos të them amatereske, por jo edhe të duhur për një program të tillë. Shumë bukur janë qitur objektivat, pastaj janë shkuar caçet, veprimet, shumë çështje për tekste shkollore dhe universitare, por jo edhe për... Pastaj, faqe 20, flitet, këtu thuhet arsyeshmëria e vendosjes së prioriteteve e tjera e tjera, vazhdohet me historinë e 50 vjetëve të fundit të vendosjes së prioriteteve në shkencë dhe në teknologji, tregon për deri 4 modele të ndryshme, të cilat nuk i bien një programi, një strategji të tillë, është një farë sheme këtu, një figurë, që po ashtu nuk i bie. Mendoj se më mirë është dashur të merren edhe me fenomenin e plagjiaturës. Dorën në zemër, ish dekani, nëse nuk gabo, që tash e kemi promovuar në Gjykatën Kushtetuese, pati filluar derisa prodekanit të tij nuk i doli plagjiatura, zotit Ahma, nëse nuk gabo, sipas medieve, dhe ndërpreu punën e plagjiaturës. Domethënë, në këtë strategji, strategjia është dashur të merret pak më shumë me plagjiaturën, nuk është e domosdoshme që secili mësimdhënës ta qet librin e vet, ta përkthejë pa nevojë. Një numër i caktuar i autorëve merren me botimin e librave, nuk është i obligueshëm çdo profesor. Edhe nëse e përkthen, atëherë duhet ta tregojë si të përkthyer, jo ta vjedhë punën e tjetërkujt. Domethënë, është dashur të futet plagjiatura pa tjetër, se shumë fytyra inponente, eminente, më falni, se mirë thashë inponente, se edhe inponohen, të cilët në shkencë sillen si politikanë, në politikë na shesin kopalla si shkencëtarë apo si intelektualë, mendoj kështu, e mendoj ashtu, a si intelektualë vjedhin, se plagjiatura është hajni, e tjera e tjera.

Po them, po të ishte ndonjë raport i ndonjë agjencioni, do ta pranoja me gjithë kënaqësi, por duke pasur parasysh se është një strategji kombëtare, titullin shumë të fortë, mendoj se shumë gjëra është dashur të shkruhen ndryshe. Mënyra e të shkruarit nuk i përket një strategji kombëtare qysh do të duhej të ishte. Po them, po të ishte shkruar raporti i KQZ-së në këtë mënyrë, do ta votoja, por megjithatë po them edhe një herë, për shkak të rëndësisë mendoj se shumë më ndryshe është dashur, sidomos disa pika të cilat kanë të bëjnë me shkencën është dashur të merren me sinqeritet në këtë strategji për ta ndryshuar apo për t'i tejkaluar disa probleme të cilat, sidomos arsimit, po edhe shkenca në atë kontekst të ballafaqohet. Sot ne e dimë se në çfarë niveli është Universiteti i Prishtinës, UP-ja pikërisht për shkak të këtyre anomalive, apo pikërisht të kësaj se shumë të punësuar aty e aktrojnë shkencëtarin apo e aktrojnë profesorin, e në realitet nga veprimet e tyre më së pakti mund t'ju thuhet se janë profesorë dhe, po them edhe një herë, e kanë prurë në këtë nivel çfarë është.

Këtë strategji unë e kam paramenduar si një rrugëdalje nga situata ekzistuese. Por, dyshoj se me këtë strategji do të dilet nga ky rreth vicioz që është arsimit edhe shkenca në atë kontekst, përsëri. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë diskutimet për Programin Kombëtar të Shkencës, jo për programin e plagjiaturës. Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ju përsëndes edhe njëherë, të nderuar kolegë,

I nderuari zoti ministër,

Padyshim që unë do të mbështesë Strategjinë Kombëtare të Shkencës, mirëpo derisa të vejë në spikamë disa sugjerime për në të ardhmen se si të duken hulumtimet shkencore në nivel të Kosovës.

Ne e kemi Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Në vendet më të përparuara dhe të konsoliduara ekonomikisht dhe në aspektin shoqëror kanë pasur mbas tranzicionit Ministrinë e Shkencës dhe Teknologjisë dhe mund t'ju them se në një vend ku kam jetuar unë, në kuadër të Ministrisë së Shkencës dhe Teknologjisë kanë punuar 220 ekspertë me tituj shkencorë. Dhe kryesisht ata i kanë

orientuar studimet shkencore, hulumtimet teknologjike në nivel të vendit dhe e kanë pasur për detyrë t'i menaxhojnë institucionet, përkatësisht institutet të cilat merren me kërkime shkencore, të cilat kanë qenë të licencuara dhe kanë pasur për qëllim që të përcjellin edhe kërkimet shkencore në kuadër të fakulteteve të ndryshme në universitet.

Ne, për fat të keq, nuk jemi në atë situatë ekonomike që të krijojmë ministri të veçantë dhe të ndajmë mjete aq shumë buxhetore për të nxitur kërkimin shkencor, mirëpo sidoqoftë, kjo strategji do t'i japë rezultatet e veta, pavarësisht se në fillim modeste, ndoshta edhe në fillim në kërkim të një identiteti për fushëveprimin e vet, ashtu siç do të duhej ta kishte.

Këshilli Kombëtar i Shkencës nuk mund t'i marrë ato kompetenca që mund t'i ketë një ministri për Shkencë dhe Teknologji, nuk mund të shkruaj programe për sfera të ndryshme të ekonomisë ose të shkencës. Aty ka njerëz të profileve të ndryshme dhe nuk ka mundësi, mirëpo mund të orientojë studimet, hulumtimet shkencore në nivel të Kosovës dhe mund të jetë si një fillim i mbarë për ta futur në vëmendje zhvillimin tonë, domethënë hulumtimet tona shkencore në Kosovë.

Pa dyshim se një prej mundësive më të mëdha për t'i nxitur hulumtimet shkencore duhet Ministria e Arsimit t'i orientojë në fakultetet të universiteteve, qofshin ato private, qofshin në universitetin publik. Në kuadër të universiteteve gjithkund në botë ekzistojnë nëpërmes, në katedra ekzistojnë institute të veçanta, të cilat e nxisin hulumtimin shkencor të kuadrove që veprojnë aty dhe njëkohësisht aty edhe e testojnë dijen e vet shkencore, domethënë egon shkencore e plotësojnë shkencëtarët pikërisht duke vepruar në kuadër të katedrave ku edhe punojnë.

Tek ne gradat shkencore, për fat të keq, merren shumë lehtë, merren pa hulumtime shkencore. Kemi profesor që punon në universitet që 30 vjet, e ligjëron një lëndë dhe nuk e ka nxjerr një tekst për lëndën që e ligjëron në gjuhën shqipe. Ne duhet të dimë që fëmijët tanë dëshirojnë të studiojnë në gjuhën shqipe. Ata që dëshirojnë të studiojnë në gjuhën angleze, shkojnë diku jashtë, mirëpo ata që studiojnë në Kosovë duhet dijen të marrin nëpërmes gjuhës shqipe, kurse gjuhët e huaja mund t'i përdorin si gjuhë ndihmëse. Një profesor i cili del në pension edhe i ka arritur titujt më të lartë akademik, po thuhet se gradat aty, pa e pasur një tekst për lëndën të cilën e ka ligjëruar, domethënë është absurditet.

Unë nuk pajtohem se në Kosovë nuk ka kompetencë shkencore dhe profesionale dhe unë nuk dyshoj se Këshilli Kombëtar me strategjinë e ofruar ka pasur qëllim të mirë dhe Ministria e Arsimit ka qëllime dhe ka vizion se si të nxitet hulumtimi shkencor dhe si t'i ndihmohet edhe sektorit privat, edhe zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë. Ajo çka mua më brengos, si qytetar i Kosovës, është ndërrimi i brezave në shkencë. Ne e kemi një vonesë të konsiderueshme për shkak të situatës në të cilën kemi kaluar dhe duhet sa më shpejtë një brez i ri i shkencëtarëve të futet në këtë sferë shoqërore dhe duhet stimuluar sidomos hulumtuesit e rinj, shkencëtarët e rinj që të përgatiten për të bërë zëvendësimin e natyrshëm të brezave të vjetër, të cilët tani për shkak të moshës edhe nuk janë aq aktiv sa duhet të ishin.

Kaq. Unë mendoj se ky është një fillim i mbarë për hulumtime shkencore dhe kërkimore në Kosovë dhe besojmë që në të ardhmen do të gjejmë edhe rrugë më të përshtatshme që të nxisim mendimin shkencor. Ju faleminderit!

KRYETARI : Faleminderit!
Deputeti Naim Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Unë do ta vazhdoj aty ku e la kolegu im Dritoni. Sigurisht se unë kam menduar se ka për të pasur vend shumë më shumë edhe për kritika për gjendjen aktuale në Kosovë, posaçërisht në lëmin e shkencës, duke pasur parasysh punën jo shumë transparente, punën shkencore po them, jo punën rreth financave publike e tjera. Kam pritur që do të jetë më shumë e eksploatuar çështja e plagjiaturës, sepse nuk është e ndershme, nuk është as morale, megjithatë edhe në shkencë ka një kod moralë, kod me të cilin komunikojnë shkencëtarët mes veti, kod me të cilin ju tregojnë edhe të tjerëve, e bëjnë të saktë se çka në të vërtetë është shkenca dhe çka në të vërtetë është hulumtimi, se megjithatë shkenca është diçka që ligjet e veta testohen dhe të arriturat e saj testohen.

Edhe unë po dal me një sugjerim konkret. I sugjeroj ministrit të Arsimit, nëse i merr parasysh disa prej sugjerimeve tona, që së paku puna shkencore e të gjithë atyre që pretendojnë se janë shkencëtarë, të bëhet publike. Me fjalë të tjera, të bëhen publike dhe transparente të gjitha, së paku master që i kanë marrë dhe temat e doktoratës, në mënyrë që të ketë mundësi opinionit publik të jetë në kontakt me nivelin shkencor të atyre të cilët kanë marrë tituj akademikë, tituj shkencorë, e për tituj akademik as të mos flasim. Me fjalë të tjera, ky kishte për të qenë një mekanizëm që është edhe prezentë në botë, edhe në Evropë, edhe në Amerikë. Temat përfundimtare të studimeve të doktoraturës janë publike gjithkund. I lejojnë mundësinë opinionit publik që të bëjë korrektimin edhe të shoh se me të vërtetë a është respektuar ai kod i nderit, ai kod moral në komunitetin e shkencëtarëve sa i përket plagjiaturës.

Unë, gjatë identifikimit të prioritetëve, kjo po shihet që është bërë një analizë..., në rregull, edhe ajo është një prej analizave që analizon ambientin se ku duhet, ambientin rrethues dhe mundëson si mjet për ndërtimin e një strategjie. Një prej prioritetëve që mua ma ka vlarë syrin shumë edhe mendjen që më ka shtyrë të mendoj, është prioriteti, në disa prej tyre, po prioriteti në studime shoqërore dhe ekonomike. Këtu hasim ne në kundërshti të drejtpërdrejta. Në njërin anë, përderisa opinionit edhe komuniteti i politikanëve me mburrje pretendojnë se afër veti kanë profesorë doktorë, njerëz me tituj, në anën tjetër kjo strategji gjatë analizës së gjendjes së burimeve njerëzore kërkimore - shkencore dhe zhvillimore, ankohet se nuk ka, jo nuk ka mjaftueshëm, po ka shumë pak. Për shembull, po e lexoj një fjali. "Për shkak të mungesës së kapaciteteve në fushën e shkencave shoqërore, publikimet e autorëve kosovarë në revista me reputacion janë të rralla". Nuk do të thotë nuk janë të mjaftueshme, janë të rralla dhe tash automatikisht lind pyetja - po si është e mundshme të jesh profesor, ku janë disa rregulla, janë disa statute të universitetit, konkretisht të UP-së, me të cilin fitohet titulli akademik sipas arsytimit të punës së vet shkencore që e ka bërë. Dhe nëse të gjithë këta tituj janë grumbulluar rreth, me fokus apo një shtyllë, një bosht, rreth boshtit politik, atëherë mua ma përkuqton, tash mund të gabo, më duket se është Platoni, një prej filozofëve grek, ku e pasqyron këtë gjendje deri diku mjaft mirë. Gjatë bashkëdyzimit, thotë, në rast se bashkëdyzohet një kali i racës që nganë shpejt, me një kali të racës që ngreh rëndë, thotë i vogli del një kali që as nuk ngreh rëndë, as nuk nganë shpejt. Me fjalë të tjera, hedhja në komunitetin e politikanit si shkencëtar, në komunitetin ku e rrethojnë politikëbërësit, si shkencëtarë dhe, përkundrazi, hedhja e individëve në komunitetin shkencor, ku bisedohet për shkencë si politikanë, kjo të lë për të kuptuar si një bashkëdyzim hermafrodit, t'i themi ashtu.

E kam edhe një vërejtje. Gjatë planit zbatues, shumë janë cekur titujt e dyfishtë. Në rregull, kjo është mjaft moderne të pranohet si term - tituj të dyfishtë prej disa universiteteve, se kjo na lejon të komunikojmë me universitete tjera dhe dija që nuk shkëmbehet, nuk është edhe dije. Tek e fundit, është edhe në kundërshtim me definicionin për hulumtim, për research, sepse ajo duhet të shkëmbehet me të tjerët. Por, si masë për tejkalimin e gjendjes unë nuk e shoh, sepse këtu ka hapësirë shumë për manipulim. Jam shumë i sigurt se i gjithë opinion publik e di, po unë e kam

temën, temën e kam pasur në x shtetin Gjermani, veç profesorët i kam pasur prej Gjermani, e kam kryer në Prishtinë. Kjo i lejon edhe universitetet e jashtme që të jenë pak sa më..., sepse kur ta afron gradën e vet shkencore një universitet, duhet t'i qëndrosh standardit, se certifikata është standard, diploma është standard, me të cilën të siguron se posedon një dije dhe nivel të caktuar.

Kështu që, në rregull, ndoshta si hapa të parë mund të jenë, por të jemi pak më syçelë dhe punën që bëhet në komunitetin shkencorë të jetë më e drejtpërdrejtë, sepse shkencëtarët nuk e kanë mundësinë me manipulim, se nuk është manipulim, se shkenca nuk definohet si manipulim, definohet si diçka që testohen ligjet shkencore, arritjet dhe hulumtimet, ngjashëm. Të jemi shumë më të saktë, kish për të qenë shumë më mirë dhe ndoshta të sfidohen titujt akademikë që janë të fituar. Janë të përfolur shumë emra të njohur, të proklamuar, se ndoshta nuk janë të njohur në komunitetin shkencor për plagjiaturë dhe më pastaj ne nuk ndërmarrim asnjë hap. Titujve që i lëshojnë institucionet akademike duhet t'u qëndrojnë mbrapa. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Po shkojmë në vijën e të pavarurve. Deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Unë e përshëndes këtë program që na është sjellë në Kuvend dhe më vjen mirë që për herë të parë sillet një program kombëtar i shkencës në Kosovë. Shpesh si vend, si shtet i ri kemi dëshirë të marrim modele të zhvillimit ekonomik, të zhvillimit të gjithëmbarshtëm, posaçërisht të vendeve perëndimore, por kur shohim në praktikë se sa këto shtete kanë investuar në arsim dhe në shkencë, sa për qind të buxhetit të mjeteve të tyre i dedikojnë për të krijuar stabilitet dhe zhvillim për vendin e tyre, atëherë mund të themi që në bazë të kësaj qasjeje ne nuk i kemi punët mirë dhe mund të themi që si shtet mund të jemi të rrezikuar në mbijetesë në rast se nuk i qasemi me seriozitet kësaj fushe. E them këtë, sepse si vend, si shtet i ri njihemi edhe me resurse humane, njerëzore, me gjeneratën e re që si aset ndoshta shumë kush do t'ia kishte me lakmi ta kishte, por nuk e ka, ndërsa ne si vend, si Kosovë e kemi këtë, por sa po investojmë në edukimin adekuat dhe sa po investojmë në aspektin e zhvillimit të shkencës. Talentet lindin çdo kund, pavarësisht shteteve apo popujve, po është në interes të shtetit, në këtë rast vendit tonë, që të hulumtojë, ata t'i gjejë dhe t'i sponsorizojë, t'i financojë në kërkimet e veta shkencore, pavarësisht nga ndarja e fushave që në këtë mënyrë janë bërë në bazë të prioritetëve. Mund të kesh prioritet zhvillimin e sektorit të bujqësisë apo të ushqimit, por mund të na dalë një kuadër shumë i mirë në fushën e shkencave të natyrës, të matematikës apo të kimisë dhe nuk e kemi futur në prioritet dhe ai mbetet pa e realizuar një bursë të doktoratës apo pa u paguar një punë shkencore që mund ta bëjë edhe jashtë vendit.

Konsideroj që Ministria e Arsimit, si përgjegjëse për mbikëqyrje të këtyre çështjeve, duhet të jetë e kujdesshme në këtë fushë. Është shumë mirë që është bërë ky plan dhe megjithatë kemi një ngritje të kësaj fushe edhe në aspektin e financimit, të përkrahjes së projekteve të ndryshme, por mendoj që nuk do të mbetemi me kaq, sepse është shumë i varfër në krahasim me atë çka e kërkon nevoja e zhvillimit të këtyre disiplinave shkencore. Duhet ta dimë se janë disa fusha në shkencën e Kosovës, që është duke shkuar teposhtë, jo duke u ngritur, në mungesë të kuadrove adekuate. Ajo thithja e trurit apo ikja e trurit nga vendi jashtë, është si rezultat se edhe shteti i Kosovës nuk përkujdeset sa duhet për t'i shtirë në veprim këto mekanizma dhe për të përkrahur veprimtarinë e tyre shkencore, se në rast se një shkencëtar, qoftë i ri apo i moshuar, në punën e vet disa vjeçare i duhet që botimin e vet apo publikimin e vet ta vetëfinancojë, të kursej të ardhurat që i merr për pagë për familjen e vet që e ka për obligim t'i mbajë e të kursej dhe t'i botojë punimet shkencore apo librat e vet shkencorë, të financojë vetvetiu, ai realisht do të jetë në pozitë të pafavorshme për të kontribuar për shoqërinë, sepse shoqëria nuk kujdeset në këtë rast.

Është përdorur si referencë manuali Fraskatit për ndarjen e këtyre 6 fushave shkencore por, si për çudi, tek fusha e shkencave shoqërore prapë nuk bëhet ajo radhitja adekuate dhe studimet gjuhësore, kulturore dhe historike mbesin në fund, ndërsa te ky manual flitet për studimet historike, si prioritet në raport me ato studime gjuhësore.

Unë dëshiroj t'ju përqendroj vëmendjen se nuk duhet të na zënë të papritura sikur kur ndodhi kur u botua një enciklopedi nga një shtet fqinj dhe duhej të jepej përgjigje e Kosovës, ndoshta e Akademisë Shkencave të Arteve të Kosovës, e cila nuk ka në mesin e saj asnjë historian. Nuk duhet edhe në këto fusha të prioritizohen sipas mundësisë, ndikimit, votave në grupe punuese, qoftë në këtë këshillë apo në atë tjetrin, por duhet të dimë që disa disiplina që nga regjimi i mëhershëm janë konsideruar që nuk duhet të merremi me këto, s'duhet t'ju interesoj e kaluara dhe na kanë futur në një gjendje që, thjeshtë, të jemi të papërgatitur në përgjigje të shumë çështjeve historike, shkencore, në raport ndoshta edhe me fqinjët, por edhe me faktorin tjetër ndërkombëtar.

Unë e mbështes këtë projekt, këtë program dhe kërkoj nga Ministria që të mos rri vetëm me këtë dhe të stimulojë, të inkudrojë hulumtime edhe tjera në fusha që nuk janë paraparë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I kemi edhe tre deputetë. Kisha kërkuar racionalizim nga këta të grupeve parlamentare. Deputeti Hajdin Abazi e ka fjalën.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Hoxhaj,

Unë i bashkëngjitëm parafolësit tim për t'u uruar për këtë program kombëtar të shkencës dhe mund të them se këtë e kam deklaruar edhe kohë më parë gjatë javës së shkencës që e ka organizuar Ministria në hotel Grand. Edhe aty e kam pa nga afër se ky program veç ka filluar ta stimulojë atë elitën tonë shkencore, atë që e kemi. Me të vërtetë është një nismë që në fillim duket modeste, por ne duhet t'ia fillojmë, sepse të ndahet një milion euro për Programin Kombëtar të Shkencës nuk është shumë, por është një fillim që premt. Mbi të gjitha prioritetet, këto 6 priorite ose 6 fusha që janë ndarë, konsideroj se të gjitha janë në përputhje me nevojat tona, sidomos ajo që shkencat natyrore, inxhinieria dhe teknologjia janë vënë në radhë të parë, sepse vendi ynë ka nevojë që të krijojë ekspertë dhe shkencëtarë nga këto fusha.

Prandaj, ky program jep mundësi edhe për konkurrencë individuale, për paraqitje me projekte konkrete të cilat do të paraqiten tek stafi përkatës dhe do të vlerësohen dhe do të jepen mundësi për veprimtarinë e mëtutjeshme.

Gjithashtu, programi si i tillë jep mundësi që të përgatiten projekte edhe për të konkurruar në Unionin Evropian, në mekanizmat përkatës për të përfutur donacione të ndryshme.

Unë, në këtë aspekt do ta ngrejë vetëm një shqetësim, që në shikim të parë mund të duket ndoshta thjeshtë vetëm në aspektin e një fjalori, por që ka kuptim më të thellë semantik. Nëse e krahasojmë përmbajtjen e programit në gjuhën shqipe dhe atë në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe gjithkund janë përdorë si bashkëdyzim fjalët kërkimor - shkencor, kurse në anglisht është vetëm fjala research, që do të thotë kërkim. Dhe unë jam interesuar dhe kam shikuar edhe në fjalor. Emri kërkim nënkupton një kërkim shkencor, por jo vetëm shkencor dhe lë mundësi edhe për kërkime, për shembull, teknike që nuk është shkencor, por është teknik, por që mund të jetë produktiv. Prandaj, unë do t'ju kisha lutur, zoti ministër, që të mos dalë drafti final me këtë gabim, por mjafton edhe në

gjuhën shqipe, sikurse që është në anglisht, të jetë vetëm kërkim, sepse p.sh. flasim për bujqësi, flasim për teknikë, e gjithkund është përdor, nëse e shikon kapitullin e pestë dhe nënparagrafët edhe nënkapitujt që janë aty, në shqip gjithkund është përdorë binomi kërkim - shkencor me vizë lidhëse, kurse në anglisht është vetëm research, e jo scientific research. Atëherë do të kishte kuptim. Do të thotë, këtu ose le të harmonizohet që të jetë edhe në anglisht, por në anglisht nëse do të ishte fjala scientific research gjithkund, do të dilte jo me kuptim të plotë, sepse janë disa sfera që nuk janë thjeshtë të natyrës shkencore. Prandaj, po e përsëris, për hir të semantikës që të jetë gjithkund në rregull, të jetë edhe në versionin në gjuhën shqipe vetëm fjala kërkim, sepse prej kontestit, prej përmbajtjes ajo kuptohet se është kërkim shkencor dhe nuk ka nevojë të sforcohet në mënyrë të dhunshme që është kërkim shkencor. Me këtë ndryshim që do të bëhej, unë konsideroj se edhe do të ekuilibrohej dhe do të kishte një unitet të tri versioneve dhe ky program shkencëtar, zoti ministër, ky program i shkencës në përgjithësi Kosovës, por personalisht juve do t'ju vë në një vend meritore edhe të nderit në historinë e mëkëmbjes së shkencës në Kosovë pas luftës. Faleminderit, për këtë!

KRYETARI: Deputeti Berim Ramosaj e ka fjalën, kurse i fundit është deputeti Riza Smaka.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar Krasniqi!

Përsëritje për ministrin,

Për kolegët e mi deputetë,

Vërtetë kur është fjala për Programin Kombëtar të Shkencës, pa dyshim që ne në këtë legjislaturë nuk na ka rënë shumë të bisedojmë rreth kësaj fushe, por duke marrë parasysh periudhën që ka kaluar Kosova, sidomos periudhën e paraluftës, që kemi pasur një periudhë afër 10-vjeçare me një sistem krejtësisht paralel edhe në arsim, edhe në edukim, por edhe në shkencë, pa dyshim, ekzistimi i një Programi Kombëtar të Shkencës paraqet jo vetëm një sihariq, por paraqet një bazë të shëndoshë për ngritjen e kapaciteteve tona në lëmin e dijes.

Duke marrë parasysh dinamikën shumë të madhe sot të zhvillimit jo vetëm ekonomik, por në fushën e teknikës dhe të teknologjisë dhe mundësitë tona infrastrukturore, në anën tjetër, duke u mbështetur qoftë në shkolla, qoftë në institute, qoftë në forma të tjera të edukimit permanent, faktikisht jemi larg. Mirëpo, ky program pa dyshim ka elemente edhe të strategjisë, edhe të një programi ambicioz, por unë mendoj se do të marrë kuptimin e zbatimit apo implementimit të tij duke u mbështetur në ligjet adekuate, të cilat i mundësojnë shkencës kosovare, shkencës në Kosovë të ecën përpara. Na thirremi vazhdimisht në resurset humane, në resurset njerëzore. Ato nuk janë resurse humane në qoftë se nuk janë të pajisura me dijen e caktuar që i përgjigjet tregut të punës dhe të njëjtën kohë nuk e kanë të shprehur vullnetin e tyre për të punuar. Për ta realizuar këtë vullnet të këtyre njerëzve të rinj, në njërin anë, dhe ta kenë atë dije që shumë lehtë mund të implementohet në tregun qoftë kosovarë, qoftë në regjion apo më tutje, pa dyshim që kërkojnë një nivel të njohurive të caktuara.

Unë mendoj se në këtë program theks i veçantë duhet t'i kushtohet aspektit të ngritjes së dijes në fushën e shkencës dhe teknologjisë, në fushën e biznesit dhe në fushën e inxhinieringut gjenetik. Pa dyshim, këto janë fusha ndoshta shumë propulzive sot për vendet e zhvilluara, mirëpo duke marrë parasysh Kosovën që është një entitet shumë i hapur, jemi një Republikë e re, pa dyshim mobiliteti është i madh i qytetarëve.

Unë mendoj se ne me këtë drejtim mund të konkurrojmë me vendet tjera, por këto subvencione, këto forma të investimeve në dije janë investime kapitale. Andaj, unë përgëzoj për këtë program, por dëshiroj edhe një herë t'ia theksoj edhe ministrit, edhe të gjitha atyre dikastereve që futen në këtë fushë, që mos të ndalen në kuptimin e implementimit qoftë me ligje, qoftë me infrastrukturë tjetër

juridike, e cila e bën më të kapshëm programin e rritjes së dijes dhe që, në fakt, janë investime kapitale në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit, deputeti Riza Smaka. Ndoshta na kursen kohën, deputeti.

RIZA SMAKA: Përshëndetje për kryetarin, për ministrin, për deputetët!

Natyrisht se në përshtatje edhe me renditjen, e renditja është këtu substanciale, se shumë kolegë kanë thënë gjëra që unë nuk do t'i përsëris, për aq do të jem edhe më racional.

Fillimisht unë e mbështes Këshillin Kombëtar të Shkencës përkitazi me Programin Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës, kjo është një.

Dy, po e them vetëm këtë se nuk ka përparim pa shkencë edhe çfarë e kemi shkencën sot, unë gjykoj, estimoj se e kemi gjendjen të ligë. Ka shumë improvizime, ju lutem, nuk ka suport të mjaftueshëm e tjera. Madje, madje, që do të duhej të ishte e kundërta, unë jam optimist se do të jetë e kundërta, ama është e kundërta e kësaj që dua ta them, sot shkenca është shumë më e ulët e shumë më pas se sa që ishte dikur. E marrë vetëm një shembull, tekstin universitar. Teksti universitar botohet eks-private, shitet nga autori që nuk është fare mirë as e hijshme, as e shijshme, apo jo. Më pastaj, shpeshherë pa recension. Ndonjëherë me ndonjë recension informal dhe inadkuat, që nuk i përngjan fare tekstit universitar që do të duhej të ishte tekst shkencor, po e zëmë, në shumë raste, jo në disa raste e tjera. Këto me pak mund unë jam i bindur se nëpërmjet aplikimit të këtyre postulateve këtu, por edhe të këtyre sugjerimeve, rekomandimeve që po japim ne, do të tejkalohen.

Meqenëse Qeveria nuk ka mundësi për të dhënë aq sa meriton shkenca jonë, sidomos shkenca jonë, se pa financim nuk mund të kemi shkencë. Unë do të isha angazhuar këtu për disa burime financiare suplementare. Bie fjala, është gati dukuri plagjiati, ju lutem, e tash sikundër ta aplikojmë Ligjin për të drejtën e autorit, po edhe Ligjin për shkencën, që duhet ta bëjmë të noveluar apo jo, shumë sanksione, dënime me të holla do t'i kishim orientuar në buxhetin për shkencën. Edhe pirateria, bie fjala, kemi Nau Hau, kemi patente, licencë e të tjera. Ato kanë impakte tepër negative në tregun, në ekonominë e tregut, na shkatërrojnë ekonominë e tregut, e pa ekonomi s'mund të kemi as shkencë, e kështu.

Përfundimisht, unë do të isha angazhuar, zotëri kryetar, zotëri ministër, tani po e shfrytëzoj rastin që jeni këtu, që edhe shumë apostrofime të Programit Kombëtar të Shkencës të riformuloheshin, të inkuadroheshin në Ligjin për shkencën, se pa ligjin nuk mund të bëjmë, se këtu më tepër ka apelime, ligji bile e ka atë tonin e imperativit, edhe do të isha angazhuar që mos të bëhen këto diskutimet tona formale, si zakonisht, diskutojmë, diskutojmë edhe merr fund, miratohet programi, por një numër i konsideruar i shumë rekomandimeve, që u dëgjuan deri tani, të inkorporohen në Programin Kombëtar të Shkencës në mënyrë që të pasurohet edhe ta ketë një karakter më serioz dhe të miratohet. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MIMOZA AHMETAJ: Programi Kombëtar i Shkencës, i hartuar në bashkëveprim me:

- Këshillin Kombëtar të Shkencës të Republikës së Kosovës,
- Institucionet e rëndësishme ndërkombëtare nga fusha e arsimit të lartë dhe të shkencës, dhe
- Ekspertët nga fusha e politikave shkencore, i miratuar nga Këshillin Kombëtar i shkencës, më 30 mars të këtij viti dhe i aprovuar nga Qeveria e Republikës, më 1

qershor 2010, është program zhvillimor i rëndësishëm në disa aspekte:

1. Zhvillimin e mëtejshëm dhe ngritjen e kapaciteteve për standardin e mendimit shkencor, i cili duhet të jetë i bazuar në argumentet shkencore nga fushat e ndryshme hulumtuese.
2. Ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për hulumtime bazike shkencore, të krahasueshme dhe ekuivalente me institucionet që kanë dhe zhvillojnë programe shkencore hulumtuese.
3. Kërkimi dhe Zhvillimi Teknologjik është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Ky Program Kombëtar i Shkencës i sjellë për miratim në Kuvendin e Kosovës, është i koncipuar në bazën e vlerësimit të gjendjes reale që sot është në institucionet që merren me hulumtime shkencore, infrastrukturën dhe kapacitet humanë të këtyre institucioneve.

Prandaj, ky program pesëvjeçar synon që përmes objektivave të dhëna për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, të jetë bazë në të cilën do të mbështetet zhvillimi soci-ekonomik i Kosovës. Në fakt, forcon lidhjet midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit. Mundëson konkurrencën e barabartë në mes institucioneve publike dhe atyre private për realizimin e projekteve shkencore hulumtuese.

Ndërlidhja në mes Programit Kombëtar të Infrastrukturës Kërkimore (i cili do të krijohet) dhe Programeve të Doktoratës, të përkrahura nga fondet për shkencë, është i vonuar pothuajse një vit, sepse Programi i Doktoraturës ka filluar në vitin e kaluar akademik në nivel të Universitetit të Prishtinës, prandaj ky program i shkencës është tejet i rëndësishëm edhe për gjeneratën aktuale e cila mund të jetë përfituese e këtyre fondeve përmes UP për disiplinat me prioritet të vëna nga Këshilli Kombëtar i Shkencës e që janë pjesë e planit zbatues për burimet natyrore, prodhimet bujqësore dhe ushqimi, shkencat biomjekësore, ekonomike, studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.

Jam e mendimit se krahas Programit Kombëtar të Shkencës dhe aprovimit nga ky Kuvend, është me rëndësi të posaçme ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për veprimtari shkencore, i cili e rregullon në formë me të detajuar financimin e veprimtarisë shkencore - kërkimore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, të lajmëruar për diskutim nuk ka, por ua kisha tërhequr vërejtjen, vërtet, kemi të bëjmë me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, kurse plagjiatura nuk është shkencë. Fjalën ia kisha dhënë ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Gjithë ju e keni marrë Programin Kombëtar të Shkencës dhe ju falënderoj shumë për propozimet, vërejtjet, sugjerimet edhe kritikën që kenë në frymën pikërisht të shkencës, si të përmirësohet. Për mua është një nder i veçantë që Kuvendi i Kosovës ka shumë akademikë, ka shumë profesorë të universitetit, shumë intelektualë, prandaj mendoj që edhe debati që ishte dhe mendimet që u dhanë, neve si Ministri na ndihmojnë që ne t'i sugjerojmë Këshillit Kombëtar të Shkencës se çka duhet të integrohet.

Dua vetëm t'i ngrejë disa çështje, se secili prej jush e keni programin para jush dhe e keni lexuar.

Së pari, dua të them që Programi Kombëtar i Shkencës që ju e keni në dorën tuaj, mund të jetë pakëz i gjatë, por është përshkrim i saktë i gjendjes në Republikën e Kosovës, sikurse ka menduar Këshilli Kombëtar i Shkencës që kjo është gjendja. Nuk është mendim i Ministrisë së Arsimit, por është analizë e saktë dhe kjo analizë e saktë është po aq e saktë sikurse ne do ta përshkruanim këtë sallë. Prandaj, krejt vërejtjet që ngriten me mungesë të kuadrove në këtë fushë, me çështje të ngritura janë një përshkrim i gjendjes objektive reale.

Së dyti, dua të them që ka pasur një debat shumë të gjerë dhe të gjatë për prioritetet që duhet t'i ketë ky program kombëtar i shkencës. Unë e di që nga profili dikush mund t'i japë përparësi kësaj shkence ose kësaj fushe. Mirëpo, meqë ky është Program Kombëtar i Shkencës, është menduar që resurset natyrore, burimet natyrore dhe shfrytëzimi i tyre për zhvillim ekonomik duhet të jenë prioritet i dorës së parë, me qëllim që Republika e Kosovës në një afat të mesëm ta ketë një zhvillim të hovshëm të saj. Prandaj, edhe resurset natyrore janë vendosur si prioritet i dorës së parë.

Së dyti, sigurimi i ushqimit. Na jetojmë në një kohë globale ku çështja e ushqimit është më e ndjeshme se sa mendojmë dhe sigurimi i ushqimit, studimet bujqësore dhe çdo gjë që ndërlidhet me ushqimin është një prioritet i shekullit në të cilin jetojmë. Prandaj, edhe është vendosur si prioritet i dorës së dytë ose i dyti. Shëndeti i popullit, studimet shëndetësore, diagnozat, ju e dini që shqetësimet më të mëdha që i ka, këtu është ministri Gashi, që i ka Republika e Kosovës, është diagnoza dhe aftësia jonë për diagnoza, që janë çështje të Qendrës Klinike, janë të ngritura pas debateve shumë të detajuara. Unë e di që dikush kishte pasur dëshirë që të shoh ndoshta prioritetet tjera, por këto kanë dal pas analizës së gjendjes në terren.

Shkencat ekonomike dhe sociale janë shumë të rëndësishme, janë shumë të rëndësishme për kohën të cilën realisht, ne si vendi i ri, jemi duke ndërtuar shtetin e ri. Unë e di që kuptohet që edhe shkencat gjuhësore, kulturore, historike kanë peshën e tyre. Ndoshta para nja 30 vitesh piramida e fokusit ka qenë e kundërt e kthyer krahasim me këto prioritetet. Mirëpo, ky këshill kombëtar i shkencës, i cili është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, jo nga ministri, emrat janë miratuar në Kuvendin e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe e tjera të Komisionit Evropian në kuadër të FPSV dhe me mbështetje të Qeverisë Austriake ka ardhur në përfundim që këto duhet të jenë prioritetet të cilat neve na ndihmojnë se kah duhet të lëvizim dhe të zhvillohemi.

Kuptohet që të gjitha këto objektiva nuk arrihen pa krijimin e parakushteve. Prandaj, edhe çështja e infrastrukturës, e laboratorëve do të mbetet për ne edhe më tutje një sfidë e madhe serioze. Për shkencat teknike, për shkencat mjekësore, për shkencat bujqësore do të jetë edhe më tutje, për shkak të mungesës së buxhetit, një shqetësim i madh se si të sigurohet aparatura e nevojshme shkencore. Po krahas kësaj, ky program kombëtar i shkencës merret edhe me çështje metodike. Ne duhet thjeshtë t'i mësojmë të rinjtë tanë se si të shkruajnë, mendojnë dhe të rezonojnë në fushën shkencore. Po përveç kësaj, shkenca nuk ka sot më karakter nacional, lokal, shtetëror, çdo herë ka pas karakter global edhe ndërkombëtarizimi i kërkimeve shkencore. Realisht, është një çështje që ngrihet se çfarë do të duhet të ndodhë.

Po vetëm dua të ju them që ky program kombëtar i shkencës është hartuar nga Këshilli Kombëtar i Shkencës, i cili është funksionalizuar në vitin 2008 dhe mbi të gjitha ka pasur ekspertë ndërkombëtarë, të cilët kanë bërë përpjekje maksimale që neve të na mundësojnë që ta përmirësojmë

gjendjen në nivel shkencor. Si mund të arrihet? Më lejoni vetëm të jap disa sugjerime se si mendohet që të arrihet.

1. Në çdo vend të botës institucionet arsimore, universitetet nuk janë vetëm institucione mësimdhënëse, janë edhe institucione kërkimore shkencore. Universitetet tona janë vetëm institucione mësimdhënëse. Prandaj, në ligjin, jam duke folur për universitete, nuk jam duke folur për kolegje. Kolegjet janë teaching institutions, universitetet janë institucione që merren me shkencë. Prandaj, edhe përpjekja jonë është që në kuadër të Ligjit të ri për arsimin e lartë, universitetet tona duhet të kenë edhe fakultetin, edhe departamentin, por edhe institutin, edhe qendra hulumtuese. Vetëm atëherë mund të ketë punë kërkimore, shkencore në universitet. Nëse ka vetëm fakultete, fakultetet janë vetëm korniza që iu mundësojnë universiteteve të afrojnë mësimdhënie, nuk mund të ketë shkencë.

2. Duhet të ketë përshtatje të punës së profesorit. Profesorët e universitetit nuk kanë kontrata veç për të mbajtur mësim 2 orë në javë. Profesori i universitetit do të ketë kontratë edhe si hulumtues. Kontrata e tij do të përbëhet prej mësimdhënies dhe për kërkimet shkencore ose kohëve të fundit është prej mësimdhënies edhe prej industrisë së ekonomisë, a ofron dije të aplikuar, a ofron standard më të lartë shkencor. Kështu që po ju siguroj që një gjë e tillë do të ndodhë. Prandaj, Ligji për arsimin e lartë, që do të sillet në Kuvend, do ta ketë parasysh që ta ndryshojë këtë gjendje. Ligji për shkencën, që është i vitit 2002, për mendimin tonë është shumë i vjetër, prandaj edhe arsyeja kryesore është që ky ligj duhet të sillet në Kuvend, se Republika e Kosovës me Program Kombëtar të Shkencës synon ta krijojë sistemin shkencor, por neve na mungon një sistem tjetër, sistemi i inovacionit. Askush s'e përmendi deri më tash, ne nuk kemi sistem të inovacionit. Unë mendoj që kur ta sjellim ligjin, ju si deputetë të nderuar duhet të na ndihmoni që ta krijojmë gradualisht edhe një sistem të inovacionit.

Unë e pash që u ngritën shumë çështje sa iu përket problemeve që ndërlidhen me shkencën dhe me jetën e institucioneve të arsimit të lartë. U ndërlidh çështja e plagjiaturave. Unë jam i hapur që kjo të hulumtohet deri në detale, por vetëm të ju them një gjë. Nuk merret Programi Kombëtar i Shkencës me këtë punë, se kjo është e drejtë e autorit dhe pronësia intelektuale. Prandaj, kisha ftuar që pronësinë intelektuale dhe të drejtën e autorit mos ta ngatërrojmë me këtë çështje. Të paktën, e keni një ligj që ka kalua në Kuvendin e Kosovës që e rregullon shumë këtë çështje.

Së dyti, u ngritën shumë dilema që janë të teorisë së shkencës, çka është e vërteta, gjysmë e vërteta, e përafërta, përafërsisht e vërteta, fakti, jo fakti, mendoj që këto janë çështje të cilat iu takojnë universiteteve, jo programeve kombëtare të shkencës.

Dhe, më lejoni për fund të them çka synon të arrijë ky program kombëtar i shkencës, që ta kem një matje precize. Programi Kombëtar i Shkencës synon ta përmirësojë cilësinë në arsimin e lartë.

Të nderuar deputetë,

Ne nuk mund të kemi kërkime shkencore që zhvillojnë ekonominë as industrinë. Unë kisha pasur dëshirë që në vitin 2010 ne të kemi shkencë që ofron rezultate teknologjike, rezultatet teknologjike ofrojnë rritje ekonomike. Po ky program kombëtar i shkencës synon që ta ngritë mësimdhënien në ekselencë, prandaj edhe si program i tillë është modest. Cila është pesha e tij? Pesha e tij është që kur janë shumë të nderuar akademikë këtu, unë dua ta përmendi vetëm një të dhënë. Pas 20 vitesh, Kosova për herë të parë ka Program Kombëtar të Shkencës.

Nga viti 1990, për herë të parë ne kemi një program kombëtar të shkencës. Unë personalisht do ta marr transkriptin, do t'i lexoj të gjitha sugjerimet, vërejtjet që ju i keni dhënë, do të ulem me Komisionin për Arsim, do të bëjmë përpjekje që t'i integrojmë në Programin Kombëtar të Shkencës dhe jam shumë i sigurt që nga ky vit do të fillojmë që ta jetësojmë. Po në të njëjtën kohë, secilin prej jush e kisha ftuar që të mendojmë se si në të ardhmen gradualisht ta ndërtojmë edhe një sistem të inovacionit, se kërkimet shkencore, hulumtimet pa këtë pjesën e inovacionit realisht nuk e kanë peshën e caktuar.

Dua t'ju falënderoj se në debatin e 2009-tës ka pasur disa deputetë që e kanë ngritur mungesën e Programit Kombëtar të Shkencës...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Ishte kënaqësi t'i dëgjojmë edhe sugjerimet, edhe lëvdimet, edhe vërejtjet, po të gjithë jemi dakord se Programi Kombëtar i Shkencës për ne do të thotë t'i shfrytëzojmë të arriturat e shkencës, ky kishte për të qenë suksesi më i madh në këtë fazë.

Tani kemi ardhur në fazën e votimi dhe të miratimit të Programit Kombëtar të Shkencës për periudhën 5 – vjeçare, me vërejtjet që do të hyjnë në këtë dokument mbi bazën e diskutimeve që u bënë këtu.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim edhe votojmë tash:
Në sallë kemi 69 deputetë, prezencën po e tregoj.

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, ministër t'i kartelë nuk ke, do të thotë, me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Programin Kombëtar të Shkencës për periudhën 5 - vjeçare. Urime, po ju themi! (Duartrokitje).

17. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009

Kryetari i komisionit nuk është këtu. Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare. Kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike? Fjalën e ka deputeti Ramë Buja, në emër të Partisë Demokratike.

RAMË BUJA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar me kujdes dhe vëmendje këto rekomandime të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale dhe natyrisht se e mbështet këtë çështje.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e ka fjalën? Armend Zemaj, si zakonisht.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, kryetar!

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport apo këtë rekomandim lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009, dhe dëshmitë e auditimit që janë paraqitur janë të mjaftueshme që të kemi një pasqyrë të plotë rreth administrimit të kontributeve pensionale sipas Ligjit 03/L-084 të Republikës së Kosovës.

Ne i përkrahim edhe rekomandimet e dhëna nga komisioni funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Xhevet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah rekomandimin e komisionit. Mirëpo, në parim do t'i them disa vërejtje, se Trusti Pensional vazhdimisht është duke pasur një rënie të parave, tash është edhe në faqen 3, thotë para në Bankën Qendrore janë mbi 122 milionë. Tash pas këtij skandali të burgosjes së guvernatorit të Bankës, po dyshoj se a i kemi edhe ato para në Bankën Qendrore dhe me siguri edhe Trusti Pensional mund të ketë ndryshime. Mirëpo, është mirë që Qeveria e Kosovës sa më shpejtë të bjen Ligjin mbi letrat me vlerë dhe të përgatisim legjislacion me qëllim të kthimit të parave të Trustit Pensional në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AKR-së, deputeti Riza Smaka. Faleminderit!

RIZA SMAKA: Në parim, duke e mbështetur këtë raport, ia vlen për t'i apostrofuar 2 – 3 vërejtje, të cilat janë theksuar edhe në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave.

1. Juridikisht nuk është i rregulluar si duhet edhe sa duhet Trusti për Kursimet sepse, një, po zëmë, pagesit e kontributeve janë pronarë të atyre parave të pakontestueshme deri në momentin e pagesës, nga ai moment e tutje ata, ani pse pronarë, nuk janë më ata që disponojnë as që pyeten fare, e nëse ndokush ka dëshirë për t'u apelua se kushtetuta e tjera, ja kjo është dispozitë eklatante që e cenon substancialisht kushtetutën, kjo është një.

2.Trusti i ka 21 të punësuar, 6 prej tyre i ka udhëheqës. Ju lutem, nga paraja e mjerë nëpërkëmbëse e pensionistëve, ju lutem, vetëm për paga Trusti i disponon euro 393.990, pjesëtua me 12 për 21, mesatarja për kapito euro 1563 euro. Domethënë, nga paraja e pensionistëve nëpërkëmbur nuk janë as pensionistë, apo jo, merren paga marramendësisht të larta. Ju lutem, shumë kush kritikohen jo deputeti kaq e kaq, po këtu pastruesi e ka pagën më të lartë se deputeti.

E shfrytëzoj rastin, ja po e zëmë, një pozicion. Kompensimet e benefiteve, zotëri kryetar, për vitin 2008 janë hiq më pak se 662.824 euro, vitin e mëparshëm - zero, s'ka pasur, domethënë 663.000 euro për kompensimet e benefiteve, e çfarë janë këto benefite, është pikëpyetje e madhe. Është fjala për paranë edhe publike, edhe të pensionistëve të ngratë.

Përfundimisht, angazhohem që këto vërejtje t'i shërbejnë Qeverisë, me qenë se e ka infrastrukturën për ta bërë një projekt të ligjit edhe për ta rregulluar juridikisht e jo me një rregullore statusin, organizimin, funksionimin, injeerncat, jurisdikcionin e kompetencat e Trustit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha e ka kërkuar fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Mua vërtet më befasoi dhe më shqetësoi ky mos interesim rreth kësaj çështje dhe rreth kësaj pike të rendit të ditës. Çështje e cila ka kaluar, Raporti i këtij institucioni nuk është kalua nga ky Kuvend dhe, thjeshtë, është dashur të trajtohet ndryshe dhe është pritur. Ne si Lidhja Demokratike e Dardanisë kemi pritur një qasje ndryshe ndaj Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Mirëpo,

mënyra se si Kryesia ka kërkuar që Raportin e kompanive private, siç është rasti me Raportin që po e shqyrtojmë sot, është Raporti i Kompanisë Deloitte Kosova, që po e trajtojmë dhe po e mbështesim Trustin përmes kësaj kompanie, për mua është i papranueshëm, por edhe për partinë tonë është i papranueshëm, sepse është dashur që me Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të merret ose Auditori i Përgjithshëm ose nuk është dashur ky raport të na vijë fare në Kuvend. Mirëpo, për t'i fshehur dobësitë që Qeveria po bën dhe neglizhencën që Qeveria dhe Kuvendi, në një farë forme edhe Kuvendi po e mbështet Trustin me keqmenaxhime dhe keqpërdorimet e theksuara që janë përmendur edhe në Raportin e punës së Trustit, që e kemi debatuar në Kuvend, për t'i fshehur të gjitha këto ka prurë një raport të Kompanisë Deloitte Kosova, që jo rastësisht përfaqësuesit, ka mjaft përfaqësues PDK-ja që e dinë mirë dhe i njohin raportet dhe nuk deklarohen për këtë raport. Është paksa e vështirë të deklarohesh, sepse mund të dyshojmë se kjo kompani është e negociuar nga Trusti dhe ka punuar në favor të Trustit të Pensioneve të Kosovës. Prandaj, duke pasur parasysh se ekziston një rrezik i tillë, ne do të mbetemi të përmbytur sa i përket pasqyrave financiare.

Ne nuk e kemi mbështetur punën e Trustit dhe nuk e mbështesim në vazhdimësi. Mirëpo, pasqyrat financiare është paksa një rrezik i madh, një përgjegjësi e madhe e deputetëve që t'i mbështesin në këtë mënyrë. Janë pasqyra nga një kompani e auditimeve, kompani private që i ka negociuar dhe i ka zhvilluar komplet Trusti i Kursimeve dhe sa janë të besueshme për neve si deputetë. Mua më vjen keq pse Kryesia ka obliguar Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave që ta debatojë dhe ta sjellë në Kuvend këtë raport. Ju lutem, ne nuk kemi nevojë raporte të tilla të debatohet në Kuvend. Dihet cilat raporte debatohen dhe si duket këtu është bërë një përshtjellim me qëllim për të nxjerrë nga situata në të cilën gjendet Trusti dhe thjeshtë ne nuk e mbështesim raportin në fjalë.

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi të bëjmë me Raportin e Komisionit për Kontrollin Financiar ose Mbikëqyrjen Financiare, për pasqyrat e audituara, nuk kemi të bëjmë me atë temë që nganjëherë po e ngrehim. Ju lutem, të mbesim në temë.

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz e ka fjalën.

(Reagim nga salla)

KRYETARI: Jo, s'ka replikë, rrini në rend të ditës! Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče,

Mi podržavamo preporuke komisije u vezi revizije u Trustu i znači nemamo šta da damo.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, jeni dakord? Po. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Bransilav Grbiq e ka kërkuar fjalën.

BRANSILAV GRBIĆ: Uvaženi predsedniče,

Dame i gospodo poslanici,

Poslanička grupa za integracije, s obzirom da se radi o jako ozbiljnoj materiji i o ljudima starijih godišta, sigurno da je ovo jedan ozbiljan izveštaj. Mi smatramo da je to jedan pozitivan izveštaj koji će sigurno doprinostiti životu i produženju života naših starijih građana Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi edhe 2 deputetë për fjalë.

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylaj.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, duke mos hyrë shumë në vlerësimin e performancës së pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009, dëshiroj të fokusohem në një çështje shumë të rëndësishme për të cilën ftoj Kuvendin, por sidomos Qeverinë, që të kryej obligimin e vetë ligjor. Në këtë raport, thuhet se në vitin 2009 Trusti ka punuar pa bordin menaxhues, gjithnjë derisa sa nuk është zgjedhur nga Kuvendi. Kjo ka ngjarë në kohë shumë të ndjeshme për ne, në periudhën kur ka ekzistuar kriza globale financiare, që ka pas ndikim si në botë ashtu edhe te ne, meqenëse mjetet e Trustit janë investuar jashtë vendit. Zoti kryetar, kërkoj nga Qeveria që të kryejë obligimin e vetë ligjor dhe të mbrojë kursimet e qytetarëve të Kosovës duke e kompletuar bordin dhe bërë të mundur funksionimin e tij. Duhet sa më parë të caktohet kryesuesi i bordit, duke marrë parasysh se ish kryesuesi, zoti Besim Beqaj, është bërë ministër i Qeverisë, gjegjësisht ministër për Integritet Evropian. Është përgjegjësi e mëtejme e Juaja, kryesisht dhe deputetëve për të kryer obligimin ligjorë, përzgjedhjen e kryesuesit të bordit. Në radhë të parë, natyrisht, përgjegjësia i takon Qeverisë, sidomos për tu kujdesur që propozimin për kryesues ta bëjnë sipas kërkesave ligjore e jo interesave partiake siç ka ngjarë gjer më tani. .

Prandaj, për t'u siguruar që kontribut-dhënësit në Kosovë nuk do të humbin kontributet e tyre gjatë kësaj periudhe, ftoj në kryerjen e këtij obligimi të rëndësishëm në afatin sa më të shkurtër kohor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë i mbështes rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2009. Mirëpo, kam për qëllim të theksoj një element që mendoj se është në favor të të gjithë kontribuuesve të kursimeve pensionale. Nga pasqyrat financiare të audituara të Trustit vërehet se gjatë vitit 2009 në këtë institucion të hyra totale kanë qenë më të larta se shpenzimet, domethënë është shënuar një suficit që është realizuar nga operacionet e realizuara në vitin 2009 dhe atë për 1.420.470 euro. Me qenë se shpenzimet operacionale të Trustit financohen nga mjetet të cilat grumbullohen nga taksa menaxhuese, që iu ngarkohet llogarive të kontribuuesve të kursimeve pensionale prej 0.9% për çdo muaj...

KRYETARI: Regjia, i bien ziles, deputetët të kthehen në sallë!

MYRVETE PANTINA: ... dhe derisa në pasqyrat financiare të këtij institucioni është paraqitur suficiti jo vetëm në vitin 2009, por edhe në vitet e mëhershme, domethënë derisa këtij institucioni i teprojnë mjetet, nuk duhet ngarkuar kontributet me shkallën ekzistuese të taksës menaxhuese, por ajo mund të jetë edhe më e ulët se 0.9%. Vlen të ceket se një pjesë e suficitit të akumuluar gjatë viteve bordi udhëheqës i Trustit ka vendosur që t'i përdorë për kompensimin e humbjeve të realizuara nga llogarimbajtësit, domethënë kontribuuesit e kursimeve të cilët i kanë tërhequr kursimet e tyre pensionale deri në fund të vitit 2009, ndërsa humbjet janë shkaktuar si rezultat i rënies së vlerës së aksioneve të Trustit gjatë vitit 2008. Mendoj se ky është një vendim i drejtë i marrë nga ana e bordit, me ç'rast Trusti ka paguar 662.824 euro në emër të 2742 kontribuuesve. Por, edhe pas pagesës së këtyre humbjeve, ende kanë tepëruar mjete, siç shihet nga pasqyrat e këtij institucioni.

Prandaj, bordi udhëheqës duhet gjithsesi të shqyrtojë mundësinë e uljes së taksës menaxhuese në nivel më të ulët se 0.9%, sa është aktualisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi diskutues tjerë.

Në sallë i kemi 62 deputetë, që do të thotë mund të shkojmë në procedurën e votimit.

Të përgatitemi për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 37 vota “për”, 18 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2009, me rekomandimet e komisionit funksional. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës për sot:

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Privatizimit

Komisionet e kanë shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Privatizimit dhe Kuvendit i kanë paraqitur rekomandimet e veta.

Ftoj kryetarin e Komisionit, për Tregti, Industri... Nuk e kërkon fjalën.

Atëherë, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Kërkoj që deputetët të kthehen në sallë, se jemi në pikën e fundit dhe kemi votim. Deputeti Gani Koci e ka fjalën, në emër të komisionit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni në një mbledhje të rregullt të veten ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për 4 anëtarët e Bordit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, të cilëve ju ka dalë mandati dhe, natyrisht, është bërë edhe pengesë e zhvillimeve të aktiviteteve që ka ky institucion. Prandaj, Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë listat e të propozuarve. Biografinë e tyre veç e keni të bashkangjitur dhe ne nuk kemi çka t’i shtojmë, është vetëm fakti se këta vazhdojnë edhe një mandat tjetër, sepse nuk ka pengesë ligjore që të vazhdojnë edhe për një mandat tjetër sipas Ligjit të Agjencionit të Kosovar Privatizimit. Prandaj, kërkoj që këto propozime të miratohen. Po, nëse është e nevojshme, ne si Grup Parlamentar, që mos t’ia lë Ramës ta përmirësojë performancën në raportet KDI-së, edhe në emër të Grupit Parlamentar ne e përkrahim këtë rekomandim dhe kërkojmë që të votohet.

KRYETARI: Faleminderit, për kujdesin!

Muzejane Selamani, në emër të Komisionit a e do fjalën? Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, do të thotë jeni dakord Lidhja Demokratike.

Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Disa fjalë po i them realisht, se s’ka vend për të folur shumë. Kjo mënyrë e punës, realisht, edhe pop t’ia japësh dikujt një shtet të fortë, e prishtë, e lëre më të ndërtojë shtet prej fillimit.

Ne kemi para vetes një propozim të Qeverisë dhe propozimin e Qeverisë e mbron Kuvendi, domethënë një komision i Kuvendit i cili ka mund të japë rekomandime, por jo të tregojë çka të bëjë, se në këtë formë, edhe pse pushteti e ka shumicën, Kuvendi po shndërrohet në agjendë të Qeverisë.

Mos harroni se normat që vendosen, e kanë një farë logjike, nuk janë vendosur vetëm se dikujt i ka rënë në mend, e thashë edhe më përpara kur ju nuk ishit këtu. Ka pasur arsye pse ligjet, kushtetuta dhe normat janë vendosur, nuk janë pa asnjë arsye të vendosura. Pse të paktën nuk ka ardhur dikush prej qeverisë, edhe pse është 18:30, në darkë, të na tregojë e të na i thotë disa fjalë të mira për bordin, çfarë pune ka kryer dhe të na kërkojë edhe një herë neve si Kuvend për t'i votuar këta njerëz. Por, çështja e parë është - a bën kështu? Po them edhe një herë, edhe po qe se e marrim një shtet të fortë, kjo është mënyra për ta prishur, e aq më pak për ta ndërtuar një shtet me ligje, me sundim të ligjit, po thoni. Sundimi i ligjit nuk është veç të flasim, sundimi i ligjit është edhe Qeveria ta respektojë ligjin, esenca e sundimit të ligjit është edhe Qeveria, edhe njerëzit në pushtet ta respektojnë ligjin. Kur njerëzit në pushtet nuk e respektojnë, çka po pritni prej tjerëve.

Çështja tjetër është, ndoshta duhet të marrë shënim dikush këtu dhe të fillohet të ndryshohet ligji. Me qenë se nuk po respektohet, atëherë më mirë është të ndryshohet, që të paktën bile e dimë se ne e kemi të drejtë të ndryshojmë ligje edhe kur i ndryshojmë, aty e tutje atëherë të ndryshuar, ashtu qysh na konvenon, i respektojmë. E kemi një temë këtu, për shembull. Qe po i lexoj emrat e anëtarëve të bordit: është Dino Hasanaj, është Naser Osmani, është Sllobodan Petroviq, është Haxhi Arifi dhe Bedri Shabani. Është votua më përpara ky, unë e di çka jam flas. Ky është bordi, do të thotë. Edhe nëse ky është bordi, janë bordi i partive në pushtet. Atëherë, pse t'ia sjellë Kuvendit për ta votuar, që të ndahet Kuvendi në pushtet dhe në opozitë gjithmonë. Bëni ligjin, le ta votojë Qeveria dhe mos të na bien hiq në Kuvend. Pse të na bien këtu, cila është arsyeja që ne të merremi tash me këtë temë, të votojmë këtu dhe gjithmonë të ndahemi. Pse? Edhe nëse kemi ndonjë preferencë në këtë listë, pse opozita t'ia votojë pushtetit njerëzit e vetë, çfarë logjike ka? Edhe një herë po e përsëris, patëm a s'patëm vërejtje në listë, ne jemi opozitë, kurrkush nuk na ka pyetur më herët dhe ne tash duhet t'ia votojmë. E po nuk ia votojmë, se janë njerëz të pushtetit, realisht. Edhe duhet të jenë njerëz të pushtetit, nëse dikush është në pushtet, po me qenë se duhet, atëherë hajde po bëjmë ligj, i cili thotë që i voton Qeveria dhe nuk na bien neve këtu. Edhe një herë po them, prishje e sistemit është kur propozimin e Qeverisë duhet ta mbrojë një deputet i Kuvendit, qoftë ai edhe i partive në pushtet, të paktën sa për normë, të paktën sa për respektim të asaj që e kemi shkruar dhe e kemi votuar vetë këtu në Kuvend, në fund të fundit edhe ju që jeni në pushtet. Faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të kursej në kohë për shkak se edhe është vonë, por qëndrimi i Grupit Parlamentar të AKR-së është që të mos e mbështet këtë propozim të Qeverisë për shkak se konsiderojmë që ky bord duhet të jetë profesional, ndërkaq disa prej anëtarëve nuk i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, konkretisht neni 12, paragrafi 6.

Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e mbështet propozimin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, kush e do fjalën? Deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet është bërë vonë dhe jemi të gjithë të lodhur, andaj do të pretendoj ose do të mundohem të jem shkumë e shkurtër, megjithatë nuk mund të anashkalojmë pa i thënë disa fjalë.

Përveç asaj që shkelen normat ligjore dhe që realisht me këtë formë Kuvendi kthehet në një vegël të Qeverisë, unë pyes kolegët e nderuar deputetë që këtë listë me këta njerëz të cilët na kanë dëshmuar për dy vitet e kaluara sa të suksesshëm kanë qenë, a e meritojnë që të vinë prapë në Kuvend dhe ta marrin votën. Kjo është vërtetë tërësisht e papranueshme, qoftë duke u thirrë edhe në ligjet aktuale që i kemi, siç është Ligji, pikërisht sipas nenit 12.6 nuk i plotësojnë asnjëri kushtet nga aspekti profesional dhe, çka është më e papranueshme ose edhe mund të them edhe skandaloze, secili person që ka prua CV-në, asnjëri nuk ka diplomë që ka dëshmuar ose që na ka prurë në këtë materialin e vet, veç kanë shkruar unë jam ky, kam krye këtë, kam bërë këtë, ndërsa asnjë certifikatë apo diplomë nuk e ka që e dëshmon në këtë material. Nuk dua të ndalem me individ të caktuar, por realisht po them që përveç që janë anëtarë të partive politike që janë në pushtet, nuk i plotësojnë as kushtet ligjore dhe çka është më e papranueshmja, për dy vjet procesi i privatizimit në Kosovë jo që është në përmirësim, por ka degraduar edhe më shumë.

Andaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk do ta mbështet këtë propozim të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Parlamentarna grupa „7+“ će podržati ovu listu još ovoga puta, jer od kako je formiran ovaj bord, nikada nije bio član borda neko iz ostalih zajednica, uvek je bilo iz jedne manjinske zajednice. Međutim, ovoga puta ćemo podržati, ali treba voditi računa o tom uravnoteženom pristupu, mislim da je red da i Vlada vodi računa o tome.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSEL HALILI: Zahvaljujem gospodine predsedniče!

Parlamentarna grupa SLS će podržati predlog odluke Vlade o imenovanju članova Borda Agencije za privatizaciju, a istovremeno to je i preporuka funkcionalne komisije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar për Integritet, Vladimir Todorović e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Parlamentarna grupa za Integraciju prihvatiće predlog Vlade. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të të pavarurve, Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk do t'i votoj këta kandidatë për shumë arsye, por arsyeja kryesore është sepse CV-të që na i kanë dërguar, nuk janë të sakta, të paktën nuk japin informata për institucionin e rëndësishëm të cilin tentojnë ta udhëheqin. Duke filluar nga kandidati i parë, zoti Dino Hasanaj, ky zotëria thotë, nëse e shihni te paragrafi 8, thotë aktualisht ai shërben si zëvendës, udhëheqës i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM-së) si dhe anëtar i Komitetit Drejtues për Termocentralin në Kosovë. Domethënë, ky zotëria kërkon edhe një herë të rizgjidhet, por as nuk është mundua ta rishqyrtojë CV-në e tij. Ja se çfarë vetëbesimi ka, se ai e di që do të shkojë në bord, sepse edhe s'ka lidhje çfarë

informata neve na jep, se Kuvendi këtu edhe ashtu do ta votojë për shkak se i ka votat, ashtu siç u tha, votat politike.

Pastaj, po shkojmë te paragrafi i 2-të, thotë Dino Hasanaj, ka lindur në Pejë, Kosovë dhe ka përfundua studimet e tij profesionale në Beograd – Jugosllavi më 1982, cilat? Nuk po flasim ne për një institucion minor, por jemi duke folur për institucionin i cili do ta udhëheq ekonominë e Kosovës, do të thotë privatizimin e Kosovës, dhe çka është ajo? Këtyre herë i thoshin VKV-e punëtorë, është domethënë punëtor me kualitet të lartë, murator, çka ka krye atje, por informatat në publik kanë dalë se e ka kryer shkollën ushtarake të mesme të këmbësorisë apo “pešadi” që i thoshin këtyre herë. Pastaj, e ke këtë ekstrem tjetër, thotë zoti Dino Hasanaj ka publikua libra profesionale dhe historike, siç është “Shekulli 21”, në vitin 1996 dhe “Kombi” thotë, në vitin 1997, si dhe shumë artikuj politikë dhe ekonomikë në gazetatat. Nuk është këtu ministri i Shkencës, sepse do të duhej mbas kësaj të dërgohej kështu automatikisht në Komitetin Kombëtar të Shkencës për ta hartuar këtë farë Programin Kombëtar të Shkencës.

Pastaj, paragrafi 4, jep një informatë që është arsye shumë e madhe pse mos të votohet ky njeri, ja se çka thotë: Dino Hasanaj ka qenë i përfshirë në ndërmarrjet shartuese, blla, bllla, blla, si për shembull në Kompaninë Ipko, është ofruesi i parë i internetit në Kosovë, si dhe në ndërmarrje tjera telekomunikuese në Kosovë. Ne kemi të bëjmë nesër me privatizimin e PTK-së, që është në konflikt të drejtpërdrejtë me këto informata të cilat zoti Dino Hasanaj na i jep. Ai është aksionar i Ipkos, sipas kësaj, dhe i disa ndërmarrjeve të tjera dhe ne, po them edhe një herë, nesër do të merremi me privatizimin e PTK-së dhe tash bindëm mua që ky s’ka gisht aty, apo s’do të ketë gisht.

Po ecim me personin tjetër, ky edhe e ka dhënë një informatë në CV edhe shumë ma të përzier, të pështjelluar. Ja se çka thotë në kronologji. Shkollën fillore thotë e ka fillua në vitin 1957 dhe e ka përfundua shkollën fillore në vitin 1965, mirëpo thotë shkollën e mesme e ka fillua në vitin 1963, domethënë ende pa e krye shkollën fillore, e ka filluar shkollën e mesme dhe e ka krye në vitin 1967. Merreni e lexojeni veç, domethënë ky sipas kësaj është dashtë atëherë të jetë në klasën VII, po paska kërcyer menjëherë në vitin e parë të shkollës së mesme. Pastaj, merreni edhe një sihariq tjetër, thotë se ka filluar studimet në Universitetin e Tiranës në tetor të vitit 1990. Shih ti, në vitin 1990 ka shkuar në Tiranë. Po ne e dimë kur ke mund të shkosh të shkollohesh në Tiranë. Jo, ashtu s’është shkuar, kishim për ta ditur, përndryshe. Domethënë, ka shkuar në Tiranë, ka studiuar nga tetori i vitit 1990 – 1995, dhe ne duhet të merremi me këta kandidatë për një institucion aq të lartë. Këto gjëra janë shkelje penale, të nderuar deputetë, kolegë.

Ja, ky tjetri çka thotë, tash sa e bindshme është kjo. Ndër të tjera, studimet i filloi në Universitetin e Kosovës në vitin e dytë të studimeve, domethënë në vitin 1987, viti i dytë pra, ka fillua në vitin 1986, është përjashtuar për shkak të veprimtarisë së tij politike nga universiteti. A nga ana tjetër është promovua në Trepçë në punë, domethënë është qua në një vend të punës të ri si kuadër i ri. Dhe tash po flasim për vitin 1985,86, 87, UDBA se ka lënë të shkojë në fakultet, po i ka dhanë promovime në Trepçë. Hajde, besojë këtë punë ti. Sinqerisht, këto janë gafe të cilat në CV-të për këso poste nuk do të duhet të ishin, andaj s’mund t’i votoj, sepse është në kundërshtim me rregullat, me standardet minimale për aplikim të punës. Faleminderit!

KRYETARI: Naim Rustemi, ndoshta na kursen kohën.

NAIM RRUSTEMI: Sigurisht se do t’ju kursej, se edhe ashtu e kam pasur ndërmend të shkoj nëpër këto CV dhe unë deklarohej publikisht, nuk do ta votoj. Shumë prej arsyeve apo arsyeja e vetme, unë po bëhem shumë i drejtpërdrejtë, arsyeja e vetme është CV, sepse unë jam shumë i vetëdijshëm

se çka do të thotë të udhëhiqet Agjencioni Kosovar i Privatizimit, shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik në Kosovë. Në rast se njerëzit me CV të dyshimta, me CV të dyshimta për të cilat ka nevojë të futet edhe ndoshta hetuesia a i kanë ofruar të dhënat e sakta që të jetë në shtyllën kryesore të zhvillimit ekonomik, e kam shumë të vështirë për t'i votuar dhe kisha bërë ftesë edhe te deputetë të tjerë. Unë e di se ftesa ime ndoshta do t'i detyrojë të votojnë "për", por unë kisha thënë që të vetëdijesohen dhe ta shikojnë një herë me gjakftohtësi edhe me zemër hapur se kujt po ia lënë ekonominë e Kosovës. Nuk ka arsye më vonë të thuhet, jo ne e kemi pasur për atë se Qeveria... Nuk ka asgjë politike këtu, as s'është partiake, nuk është çështje partiake, është çështje thjeshtë profesionale, është edhe çështje etike.

Unë do t'i shpalos edhe disa arsye tjera. Çështja e parë që kishte për të qenë shumë e rëndësishme për mua, është se pikërisht kryesuesi që është propozua që të jetë zoti Dino Hasanaj, është njeri prej njerëzve që udhëheq me projektin më të madh të privatizimit në Kosovë. Projekti më i madh i privatizimit nga aspekti financiar në Kosovë, njëri ndër më të mëdhenjtë, është fshati ndërkombëtar, është metodë e privatizimit, ka qenë ajo koha, dhënia e 11 hektarëve tokë në shkëmbim të ndërtimit të disa banesave. Shumë prej gazetarëve e kanë bërë edhe publike, në kërkesë për dokumentacionin zyrtar asnjëherë nuk e lejon as për t'i bërë publike se kush janë ata që mund të blejnë shtëpi në fshat ndërkombëtar 400 mijë euro një shtëpi. Me fjalë të tjera, 250 shtëpi atje, 400 mijë euro, deri në 400 mijë euro një shtëpi edhe përfliten shumë emra që janë drejtpërdrejt të involvuar në politikë, janë në pozicione. Një rrogë prej 1100 euro nuk mund ta blej një shtëpi 400 mijë euro dhe zoti Dino Hasanaj është udhëheqës i këtij projekti. Nëse kishte për të qenë etike dhe e ndershme dhe shtet formuese, së paku të bëhet publike se privatizim ajo ka qenë, është dhënë në shfrytëzim për 99 vjet, pavarësisht se prej kujt. Ne mund t'i japim emra çfarëdo, fshat ndërkombëtar, mund të manipulojmë edhe me emra, të themi fshat amerikan, po ato janë shtëpi që po shiten, shtëpi që po e thanë lekun, e jep paranë, 400 mijë euro një shtëpi edhe vendosesh në te, emra çfarëdo mundesh t'u vendosësh. Në rast se je udhëheqës kryesor i njërit prej projekteve më të mëdha të privatizimit në Kosovë dhe tash udhëheqës kryesor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, po bie pak sa ndesh. Gjithashtu, edhe në CV e ka të cekur gjithashtu se ka qenë aksionar në IPKO, prapë kemi të bëjmë me person i cili është në mënyrë të drejtpërdrejtë i involvuar në proces të privatizimit. Në rast se kishte për ta dëshmuar veten nga aspekti shkencor dhe profesional se e meriton një gjë të tillë, se pa te nuk bën, në rregull, kisha për të votuar edhe unë, po CV-të e dyshimta të krejt këtij grupi të Bordit të Privatizimit në Kosovë, unë nuk e shoh shumë të rrugës edhe i ftoj të gjithë që të jemi më mendje hapur, ndoshta edhe zemërgjerësi kërkohet të mos votohet asgjë politike, se s'është asgjë partiake.

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutimet kanë përfunduar. Konsideroj që anëtarët e propozuar kanë qenë edhe një herë këtu. Jo, nuk ka nevojë propozim, Ibrahim. Ne i kemi dy raportet e dy komisioneve.

Hymë në procesin e votimeve, në sallë janë 68 deputetë.

Të përgatitemi për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 30 vota "për", 22 "kundër" dhe 3 abstenime, Kuvendi emëroi kryesuesin dhe anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me mandat dyvjeçar. Dino Hasanaj, kryesues, Sllobodan Petroviq, anëtar, Haxhi Arifi, anëtar dhe Bahri Shabani, anëtar.

Mirupafshim në seancën e nesërme, në orën 10:00.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës

